


Hamude Abdulati

Islami në fokus



Logos-A

Shkup, 2000

Hamude Abdulati

ISLAMI NË FOKUS



Shkup 2000/1421

Titulli i origjinalit
Hammudah Abdulati
ISLAM IN FOCUS

Botues
American Trust Publications, Indianapolis, 1975.

Përktheu
Mr. Bujar Hoxha

Copyright © by *Logos-A*, 2000

CIP - Каталогизација во публикација
Народна и универзитетска библиотека "Климент Охридски", Скопје

297

ABDULATI, Hamude

Islami në fokus / Hamude Abdulati; përktheu Mr. Bujar Hoxha. - Shkup:
Logos-A, 2000. - 394 стр.; 20 cm. - (Biblioteka Mendimi islam)

Превод на делото: *Islam in focus* / Hammudah Abdulati

ISBN 9989-904-07-3

а) Ислам

Përmbajtja:

Parathënie	13
Kapitulli I BAZAT E FESË ISLAME	19
All-llahu xhel-le-shanuhu	21
Kuptimi i fesë islame	33
Parimet themelore të besimit në fenë islame	40
Vërejtje	58
Kapitulli II KONCEPTET THEMELORE TË FESË ISLAME	61
Koncepti i besimit (Imanit)	63
Koncepti i mirësisë (el-Bir-ru)	67
Koncepti i devotshmërisë (et-Takva)	69
Koncepti i pejgamberisë	70
Koncepti i jetës	72
Koncepti i religjionit	74
Koncepti i mëkatit	78
Koncepti i lirisë	83
Koncepti i barazisë	85
Koncepti i vëllazërisë	87
Koncepti i paqes	89
Koncepti i bashkësisë	90
Koncepti i moralit	95
Koncepti i Universit	110

Kapitulli III PJESA PRAKTIKE E BESIMIT	119
Hyrje	121
Namazi (Salati)	125
Qëllimi i namazit	125
Kushtet e namazit	128
Llojet e namazit	129
Kohët e namazeve.....	130
Abdesti.....	133
Prishja e abdestit	134
Tejemmumi	135
Lehtësimet e posaçme gjatë marrjes së abdestit	136
Larja e tërësishme e trupit - Gusli.....	136
Thirrja për namaz - Ezani.....	137
Ikameti.....	139
Procesi aplikativ i namazit	139
1. Namazi i sabahut.....	139
2. Namazi i drekës	144
3. Namazi i ikindisë	145
4. Namazi i akshamit	146
5. Namazi i jacisë.....	146
Namazi i përbashkët (me xhemat)	148
Namazi i Xhumasë	150
Rëndësia e namazeve të Bajramit	153
Namazi i Bajramit.....	158
Shkurtimi i namazit	162
Kohët kur namazet janë të ndaluara	163
Kompensimi për namazet e vonuara (kaza)	163
Namazi i Teravisë	164
Prishja e namazit	164
Namazi i xhenazes	165
Disa vërejtje të përgjithshme rreth namazeve	169
1. El Fatiha.....	172
2. Teshehudi.....	173
3. Pjesë (sure) të shkurtra nga Kur'ani.....	174
Agjërimi (Savm).....	176

Agjërimi në një perspektivë krahasuese	182
Periodha e agjërit	185
Kush duhet të agjërojë	186
Përjashtimet nga agjërimi	187
Rekomandime të përgjithshme	189
Zeqati	190
Sasia e zeqatit	193
Ata që duhet ta pranojnë zeqatin.....	196
Haxhi.....	198
Vërejtjet përfundimtare.....	205
Kapitulli IV JETA E PËRDITSHME NË FENË ISLAME.....	211
Hyrje.....	213
Natyra e brendshme	214
Jeta shpirtërore.....	214
Jeta intelektuale.....	215
Natyra e jashtme	218
Jeta personale.....	219
1. Pastërtia dhe pastrimi.....	219
2. Të ushqyerit	219
3. Veshja dhe zbulurimi.....	222
4. Sportet dhe argëtimet	224
Jeta familjare	227
1. Kuptimi i martesës.....	229
2. Përhershmëria e martesës	231
3. Marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve	233
4. Marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve	237
5. Aspekte tjera të jetës familjare.....	242
Jeta sociale.....	244
Jeta ekonomike	250
Jeta politike	258
Jeta ndërkombëtare	272

Kapitulli V SHFYTYRIMET RRETH FESË ISLAME.....	279
Hyrje	281
1. Lufta e Shenjtë (Xhihadi).....	282
2. Isai, biri i Merjemes	303
3. Poligamia (martesa me më shumë se një bashkëshorte)	323
4. Martesa dhe shkurorëzimi	352
5. Pozita e gruas në fenë Islame.....	361
Shtojca.....	377
Kur'ani dhe urtësia e tij.....	379
Dinamizmi.....	384
Prakticiteti	385
Maturia	385
Muhammedi (a.s.) - peygamberi i fundit.....	388
Kalendari islam	395

Përkushtim

*Me një përrulje të amshueshme e pranoj ndihmën
Tënde, o Zot!*

*Në frymën e vërtetë të fesë islame e çmoj mëshirën
Tënde, o Zot!*


Me gjithë zemër të falënderoj Ty, o Zot!

*Pa udhëheqjen dhe dashurinë Tënde,
kjo vepër nuk do të realizohej.*

*Po të mos ishin shkaku dhe ndihma Jote,
ky kontribut modest asnjëherë nuk do të
shndërrohej në realitet.*

*Dhe nëse kam të drejtë Të ta përkushtoj,
Të lutem bekoje me pranimin Tënd,
Kjo të është përkushtuar Ty, o Zot!*

Hamude Abdulati



Në emër të All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

1. Falënderimi i takon vetëm All-llahut, Zotit të botëve!
2. Bamirësit të përgjithshëm, Mëshirëbërësit!
3. Sunduesit në Ditën e Gjykimit (përgjegjësisë-shpërblimit)!
4. Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm te Ti kërkojmë ndihmë!
5. Udhëzona (përforcona) në rrugën e drejtë!
6. Në rrugën e atyre që i begatove me të mira,
7. E jo në të atyre që kundër vetes tërhoqën hidhërimin, e as në rrugën e atyre që e humbën veten!¹

¹ Të gjitha ajetet kur'anore janë marrë nga Kur'ani (Përkthimi me komentim), të përkthyer e të komentuar nga H. Sherif Ahmeti, botuar në Prishtinë më 1988.



Parathënie

Qëllimi i kësaj vepre është njohja e lexuesit të rëndomtë me mësimet themelore të fesë islame. Kuptohet qartë se me këtë nuk duhet ta kemi parasysh njohjen e problemit islam në gjerësi e në thellësi. Megjithatë, me këtë rast duhet të cekim se qëllimi i këtij libri është pajisja e lexuesit të zakonshëm, por të arsimuar, me një shikim të saktë e të qartë në mënyrë që ai të jetë në gjendje t'i çmojë rregullat që e përfaqësojnë fenë islame. Me nxitjen e një interesimi të këtillë, lexuesi do të ketë mundësi t'i thellojë dhe t'i zgjerojë dituritë e veta.

Muslimanët e hemisferës perëndimore, e veçanërisht të rinjtë muslimanë që jetojnë në vende më të largëta, ballafaqohen me probleme serioze dhe tejet të ndërlikuara. Të gjitha rrethanat ekzistuese që mbretërojnë në Perëndim janë në disfavor të fesë islame. Komentet e radios, të televizionit, shkrimet gazetareske, artikujt e revistave, filmat, madje edhe tekstet shkollore, që të gjitha gabimisht e interpretojnë fenë islame, mirëpo, për këtë, siç duket, janë fajtorë edhe vetë muslimanët. Përveç kësaj, disa grupe tejet entuziaste bëjnë përpjekje të vazhdueshme që ta ndryshojnë pozitën e këtyre muslimanëve, me shpresë të kthimit të tyre në ndonjë riemërim apo

sekt tjetër. Nga ana tjetër, jeta në vete ngërthen dëshpërime e disfata të shumta që faktikisht shkaktojnë devijim të vëmendjes njerëzore dhe drejtim të saj jashtë rrugës së vërtetë religjioze. Kjo dukuri, sa i përket rinisë, e veçanërisht në rastin e fesë islame, është mjaft negative, sepse Islami është fe e cila në këtë pjesë të botës nuk është kuptuar në mënyrë të drejtë. Është e vërtetë se disa prindër muslimanë përpiqen t'ua mësojnë fëmijëve të tyre njohuritë dhe dispozitat elementare fetare, por çfarë të mire mund të përfitojmë prej këtyre përpjekjeve të kufizuara, e përpos kësaj, çfarë efekti mund të kenë këto njohuri në rrethana të pavolitshme?

Ç'ndodh pas kësaj? Cili është rezultati i kësaj gjendjeje të vështirë? Përkundër sinqeritetit, duhet të pranojmë se gjendja është e zymtë, por jo edhe e pashpresë. Disa muslimanë, që janë "viktima" të pafajshme të rrethanave "me tension të lartë", shpeshherë janë indiferentë e të përmbajtur. Atyre u vjen turp, ndaj frikohen dhe dyshojnë në ambientin që i rrethon. Si pasojë e kësaj, ata nuk mund t'i japin shoqërisë së tyre ndonjë kontribut me vlerë ose të nxjerrin ndonjë përfitim të rëndësishëm nga ajo. Për fat të keq, ka edhe të atillë që vrapojnë pas afirmimit të shoqërisë, me qëllim që të jenë në hap me kohën dhe ecuritë e modës e që t'i pranojë bota. Këta, natyrisht, as nuk kontribuojnë e as nuk përfitojnë nga shoqëria në të cilën jetojnë. "Muslimanët" e tillë madje bëhen destruktivë e të pamëshirshëm, për arsye se nuk kanë moral efektiv religjioz. Përveç këtyre muslimanëve indolgentë, indiferentë e të tërhequr ekzistojnë edhe të tjerë që gjithashtu nuk

janë më të mirë se këta. Si duket ata janë të fascinuar nga ajo që quhet shkallë e lartë e organizimit efektiv të grupeve të caktuara religjioze, ose fascinoohen nga qarkullimi i gjerë shoqëror që e nxisin disa celula të tjera shekullariste. Zakonisht, individët e tillë janë vetëm njerëz marginalë apo shoqëruar të thjeshtë. Ata madje mund t'i konsiderojmë si shpirtëra të humbur në "turmenë e vetmuar", që është tejet karakteristike për shoqërinë moderne. Ata u bashkojnë jo pse kanë qenë të indoktrimuar nga besimi i këtij apo i atij grupi, e as nga ajo që kanë fituar një dashuri jovetjake për njerëzimin. Lirisht mund të themi se ata u bashkangjiten atyre grupeve, për arsye se nuk e çmojnë trashëgiminë e tyre islame. Si rezultat i kësaj dhe si rezultat i asaj se kanë jetuar jashtë rrethanave islame, ata nuk e kanë fituar diturinë dhe kurajon e mjaftueshme për të qenë muslimanë të denjë. Nëse "muslimanët" e tillë kanë ndonjë interesim real për religjionin, nuk do të devijojnë nga rruga e fesë islame, rrugë kjo që paraqet shkallën më të lartë të evolucionit religjioz dhe të aspiratave njerëzore. Përveç kësaj, nëse ata mendojnë pak më tepër për mirëqenien shpirtërore dhe morale të njerëzimit, kënaqësinë më të madhe do ta gjejnë pikërisht në suazat e fesë islame. Kështu, kurdoherë që ata do t'i bashkangjiten ndonjë grupi tjetër, mund të shprehin vetëm një interesim sipërfaqësor, p.sh., vetëm sa për zëvendësime të vobekta. Rezultat i gjithë kësaj është ajo se ata në këtë mënyrë e humbin kontaktin shpirtëror me bashkëbesimtarët e tyre muslimanë, duke mbetur në periferi të qarqeve të tyre të reja kuvenduese. Në qoftë se analizohen në

mënyrë të thuktë pasojat e fundit të situatës së përgjithshme, atëherë del se ata më tepër u bëjnë keq se sa mirë njerëzve. Humbja në platformën muslimane, është një humbje e madhe në të gjitha aspektet e tjera. Muslimani i vërtetë mund të kontribuojë në mënyrë më efikase për kuptimin e “nën-shtetësisë” së përgjegjësisë dhe paqes universale, për kuptimin e dyanshëm dhe vëllazërinë njerëzore, lirinë e vetëdijes, si dhe për ruajtjen e dinjitetit njerëzor. Të gjitha këto parime janë pjesë përbërëse të fesë islame. Ata janë të besueshme për çdo musliman, ndaj ai i gëzon këto të drejta. Nëse një musliman që duhet t’u përmbahet këtyre rregullave humbet ose bëhet indiferent, kjo don të thotë se i gjithë njerëzimi do të privohet nga kontributet e tij të vlefshme, ndërsa kjo, duhet pranuar se nuk është humbje e vogël. Muslimanët kanë arsye të forta të besojnë se libri i tyre, Kur’ani i shenjtë, është libri kryesor i shpalljes dhe standardi i vetëm i të vërtetës fetare. Ata po ashtu besojnë se feja islame ka ardhur që ta përdëftojë porosinë e amshueshme hyjnore dhe t’i eliminojë mosmarrëveshjet e mëparshme religjioze, në mënyrë që njerëzit të mund të nisen drejt aktiviteteve konstruktive e kreative në të gjitha sferat e jetës. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se muslimanët kanë dëshirë ta veçojnë vetveten nga pjesa tjetër e njerëzimit. Ata as nuk përpiqen t’ia imponojnë dikujt fenë islame, e as ta klasifikojnë njerëzimin në klasa superiore apo inferiore. Ata nuk janë për popuj të privilegjuar e të shtypur, e as nuk dëshirojnë ta fusin në lojë doktrinën e të zgjedhurit e të paganit. Në të vërtetë ata ua dërgojnë njerëzve porosinë hyjnore,

me qëllim të ndihmesës së obligueshme ndaj njerëzimit. Me fjalë të tjera, muslimanët nuk mund të jenë indiferentë, ekskluzivë apo arrogantë. Detyra e tyre parësore është t'i tregojnë dituritë e tyre të gjera në tërë realitetin jetësor dhe t'i zgjasin duart drejt njerëzve të të gjitha klasave, besimeve, racave e nacionaliteteve. E mira të cilën ata mund ta bëjnë bashkë me shërbimet e tjera, do të dalë në sipërfaqe vetëm nëse ata e praktikojnë fenë islame dhe nëse te njerëzit e tjerë e kërkojnë frymën humane të fesë islame.

Duke i marrë parasysh të gjitha këto rrethana, po përpiqemi ta njohim fenë islame në një frymë më të freskët. Qëllimi ynë nuk është që muslimanët të shndërrohen në fanatikë të verbër dhe të varfër në mendime, sepse feja islame kategorikisht është kundër dukurive të tilla. Shpresojmë se do të kemi sukses t'i rinjoftojmë këta muslimanë me të vërtetën e fesë islame dhe t'u ofrojmë një pasqyrim shpirtëror të Gjithësisë, e përveç kësaj, edhe një kuptim moral të gjendjes njerëzore. Nëse kjo mirëpritet dhe kuptohet ashtu siç duhet nga ana e tyre, atëherë ata do të jenë qytetarë me përgjegjësi në shtetet e tyre, pjesëtarë të ndershëm të racës njerëzore, e mbi të gjitha, njerëz të vetëdijshëm për praninë dhe të ekzistuarit e Zotit.

A thua kjo pasqyrë që e ofrova paraqet një pikëpamje pesimiste për ardhmërinë e fesë islame në botën moderne? Apo ndoshta është vetëm një thënie e suksesshme për shqetësimin dhe pafuqinë të cilën ndoshta e përjetojnë muslimanët? Ose, a është e gjithë kjo rezultat i pritur nga disfata e luftës së tyre

shpirtërore në botën e re? Sigurisht nuk është. Pessimizmi dhe shqetësimi janë kundër frymës së fesë islame, ndërsa mosmbështetja assesi nuk përputhet me besimin në Zot. Ardhmëria e fesë islame është ardhmëria e vetë njerëzimit, dhe nëse njerëzimi ka pak ardhmëri, gjë që besoj se sigurisht ka - atëherë ekziston një ardhmëri e madhe dhe e shkëlqyer edhe për fenë islame. Lufta shpirtërore që sot e bëjnë muslimanët, nuk është luftë e humbur, edhe pse progresi është i ngadalshëm. Nëse muslimanët për çfarëdo shkakut e humbin luftën e tyre shpirtërore, njerëzimi do të përjetojë humbje të pakompensueshme.

Rëndësia e kësaj parathënieje pra, është që të na japë një pasqyrë reale për situatën me të cilën ballafaqohen muslimanët e botës së re. Kjo le t'i paralajmërojë prindërit dhe bijtë e tyre për rreziqet, me qëllim që të mund të evitohen dëmet. Përveç asaj, le t'i përkujtojmë të gjithë ata që janë të interesuar për mirëqenien shpirtërore të njeriut, se duhet të jenë syçelë e të gatshëm dhe të kenë pikëpamje të qarta për njerëzimin dhe problemet e tij.

Le t'ia lëmë nën përkujdesje All-llahut xh.sh. vëllezërit tanë muslimanë, meqë vetëm në Të kemi besim të pakufishëm se përpjekjet tona nuk do të jenë të kota.

"...Unë nuk dua tjetër vetëm të përmirësoj aq sa mundem, por këtë mund ta arrij vetëm me ndihmën e All-llahut, vetëm Atij i jam mbështetur dhe vetëm te Ai jam drejtuar!" (Kur'ani, 11:88).

Hamude Abdulati

Kapitulli I BAZAT E FESË ISLAME

- ❖ *All-llahu xh.sh.*
- ❖ *Kuptimi i fesë islame*
- ❖ *Parimet themelore të besimit në fenë islame*
- ❖ *Vërejtje*

All-llahu xhel-le-shanuhu²

Njohja e Zotit dhe besimi në Të janë themelet e fesë islame. Ato janë aq të rëndësishme saqë na nevojitet një diskutim më i plotë dhe më i qartë rreth tyre. Me qëllim të qartësisë më të madhe, do të bëjmë përpjekje që të përdorim shembuj sa më të thjeshtë. Kjo ndoshta do t'i mërzisë ata që sadopak dinë më tepër lidhur me këtë temë. Personat e tillë, që janë të informuar në mënyrë konkrete, i lusim që të kenë durim e të tregojnë konsideratë ndaj rëndësisë së madhe të këtij problemi.

² Çështja rreth qenësisë së Zotit i ka preokupuar mendjet e mëdha njerëzore shekuj me radhë. Ata që besojnë në Zot, janë të një mendimi se intelekti i kufizuar njerëzor nuk mund ta dëshmojë qenësinë e Zotit të Pafundëm dhe të Pakufishëm Që është. Mendja njerëzore është në gjendje vetëm ta ilustrojë apo ta demonstrojë qenësinë e Tij, për kënaqjen e kureshtjes së vet personale. Ata që e mohojnë Zotin, thonë se mbështeten në shkencën, në filozofinë, apo në teoritë e veçanta të diturisë. Argumentet e tyre shpesh janë të pazbatueshme, disa herë irelevante, gjithmonë komplekse dhe shpesh të pakuptueshme. Sidoqoftë, mendja e lirë dhe e zhvilluar do ta gjejë rrugën drejt Zotit. Dështimi në gjetjen e kësaj rruge, nuk do të thotë se nuk ka rrugë të tillë. Mohimi i realitetit, nuk e bën atë joreal. Për një pikëpamje interesante krahasuese shih p.sh.: Jacques Maritain, "Approaches to God" (Qasjet kah Zoti) - New York: The Macmillan Company, 1954; Muhammed Zafrulla Han, "Islam: Its Meaning For Modern Man" (Islami: Kuptimi i tij për njeriun modern) - New York: Harper & Row, 1962; John Hick, ed., "The Existence of God" (Qenësia e Zotit), New York, Macmillan Company, 1964.

Ekzistojnë individë të cilët në emër të shkencës përpiqen të tregojnë dyshim për konceptin e Zotit, ose këtë e bëjnë për arsye të mungesës së përvojës apo mirëkuptimit. Pikëpamja e njerëzve të tillë reflekton një mentalitet të sëmurë, edhe pse reklamohen si intelektualë të shquar. Nuk do të anoj nga ajo që thonë apo mendojnë se janë ata, por do të përpiqem t'i analizoj pozitat e tyre të vërteta. Kjo do të na shpjegojë se pjesa më e madhe e diskutimit ka një formë të thjeshtë - sikur atë ta kishin udhëhequr disa fëmijë e jo njerëz të moshërritur. Nga ana tjetër, qëllimi kryesor i kësaj vepre është që muslimanëve të rinj t'u shpjegohet koncepti i vërtetë i Zotit në fenë islame. Arsyeja tjetër që iu reka kësaj pune është ajo se koncepti i Zotit është keqpërdorur në kokat e shumë jomuslimanëve - e që veten e konsiderojnë se janë të ashtuquajturit besimtarë të Zotit dhe bartës të religjionit.

Për arsye të këtyre shkaqeve, në këtë prezentim të fakteve kemi përdorur shembuj të thjeshtë, ndoshta edhe fillestarë. Megjithatë, thjeshtësia e shumë fakteve këtu, te shumica e njerëzve mund të nxisë mendime të ndryshme. Nëse është kështu, le të jetë kjo një thjeshtësi e dëshirueshme dhe kreative, e cila në vetvete bart një karakteristikë dalluese të fesë islame.

Nëse i shikojmë pak më mirë rrethanat tona, do të shohim se çdo familje ka "kryefamiljarin" e saj, çdo shkollë ka drejtor, çdo qytet ka kryetar, çdo shtet apo republikë ka kryeministër dhe çdo popull ka udhëheqësin e shtetit. Përveç kësaj, dimë se çdo prodhim pa dyshim është vepër e ndonjë prodhuesi

dhe se çdo art i bukur është krijim i ndonjë artisti të dalluar. E gjithë kjo është e qartë, por megjithatë kjo ende nuk e shuan etjen për dituri dhe kërshërinë e njeriut për gjërat e mëdha në botë. Njerëzit shpeshherë mahniten nga bukuritë e natyrës dhe mrekullitë e peizazheve të saj; me horizontin e pafund qiellor dhe zbrazëtirën që atij i takon; me ndërrimin e pafundshëm të natës dhe ditës në një mënyrë të rregullt e të saktë; me Diellin, Hënën dhe yjet e mëdha; me botën e gjallë dhe të vdekur; me procesin e vazhdueshëm të evoluimit të njeriut brez pas brezi, gjeneratë pas gjenerate. Njeriu shpeshherë habitet për arsye se dëshiron ta njohë krijuesin e të gjitha këtyre mrekullive me të cilat jetojmë dhe të cilat i gëzojmë.

A mund të gjejmë shpjegim për Gjithësinë e pafund?! A ekziston ndonjë interpretim bindës për sekretin e ekzistencës? Shumë lehtë mund të shohim se asnjë familje nuk mund të funksionojë si duhet pa e patur “kryefamiljarin” përgjegjës, se asnjë qytet nuk mund të ekzistojë pa patur ndonjë administratë të shëndoshë, dhe se asnjë shtet nuk mund të ekzistojë pa e patur presidentin e tij. Po ashtu është e qartë se asgjë nuk shfaqet vetvetiu. Përveç kësaj, mund të vërejmë se Gjithësia ekziston me qindra e mijëra vjet. A mund të themi pas gjithë kësaj, se e gjithë kjo ka qenë vetëm një “aksident” apo veprim i rastësishëm? Apo, a mund të themi se ekzistenca e njeriut dhe e gjithë botës ka qenë vetëm e rastit?

Po të ishte ashtu, d.m.th., njeriu ta fitonte ekzistencën e vet vetëm aksidentalisht apo vetëm për shkak se rasti ose fati e deshi ashtu, atëherë e gjithë jeta e tij do të bazohej në rastin e sipërpërmendur

dhe e gjithë ekzistenca e tij do të ishte e pakuptimtë. Por, asnjë njeri i vetëdijsëm nuk do të mendonte se jeta e tij është e pakuptimtë, dhe asnjë qenie racionale nuk do ta linte ekzistencën e saj në mëshirën e rastit fluktues (labil). Çdo qenie njerëzore e aftë për të menduar, përpiqet ta bëjë jetën sa më të kuptimtë dhe të krijojë para vetes një model të udhëheqjes së asaj jete, duke u përputhur me ndonjë plan (paraplanifikim). Individët, grupet dhe popujt po ashtu i planifikojnë aktivitetet e tyre, ndërsa çdo plan i suksesshëm i jep efektet e dëshiruara. Ajo që duhet të kuptohet këtu është se njeriu merr pjesë në këtë apo atë planifikim, dhe se mund t'i çmojë vlerat e një plani të mirë.

Megjithatë, njeriu ende paraqet vetëm një pikë të vogël në Gjithësinë e pafund. Nëse ai mund të planifikojë dhe t'i çmojë rezultatet e planit, atëherë ekzistenca dhe jeta e tij në Gjithësi mund të bazohen në një politikë planifikuese. Kjo do të thotë se pas ekzistencës sonë materiale ekziston një vullnet planifikues dhe se ekziston një mendje unike (tru unik) në botë, që ua sjell krijesave ekzistencën dhe i mban në një lëvizje të rregullt. Çuditë dhe mrekullitë e botës sonë si dhe fshehtësitë e jetës janë aq të mëdha, saqë nuk mund të jenë produkt i ndonjë ndodhie apo rasti të parëndësishëm.

Në botë, sipas kësaj, sigurisht ekziston një forcë e madhe që është vazhdimisht në lëvizje, e që mban gjithçka në rregull. Në natyrën e bukur sigurisht ekziston një artist i madh, që i krijon veprat më të çmuara artistike dhe që prodhon gjithçka për një qëllim të posaçëm në jetë. Kjo forcë është më e fortë

nga të gjitha forcat, dhe ky artist është më i madhi nga të gjithë artistët. Besimtarët e vërtetë dhe njerëzit e ngritur deri në kulm e njohin dhe e çmojnë këtë Krijues: ata e quajnë atë All-llah ose Zot. E quajnë Zot për arsye se Ai është Krijuesi dhe Arkitëkti Kryesor i botës, Nismëtari i jetës dhe Furnizuesi i të gjitha krijesave që ekzistojnë. Ai nuk është njeri, sepse asnjë njeri nuk mund të krijojë apo të bëjë ndonjë njeri tjetër. Ai nuk është as kafshë, e nuk është as bimë. Ai nuk është as idhull, e as statujë e çfarëdo lloji, sepse asnjëra nga këto nuk mund ta krijojë vetveten, e as të krijojë diç tjetër. Ai nuk është makinë. Ai nuk është as Diell e as Hënë ose ndonjë yll tjetër, meqë të gjitha këto sende i kontrollon një sistem i madh dhe vetë ato i bën dikush tjetër. Ai ndryshon nga të gjitha këto gjëra, për arsye se Ai është Krijuesi dhe Mbajtësi i të gjitha këtyre. Krijuesi i gjithçkaje duhet të jetë edhe më ndryshe dhe më i madh nga gjëja apo sendi që Ai e krijon. Po ashtu e dimë se asgjë nuk e fiton jetën vetvetiu, se bota e mrekullueshme nuk e krijoi vetveten dhe se ajo nuk filloi të ekzistojë vetëm rastësisht. Ndryshimet e vazhdueshme në botë e argumentojnë atë që është krijuar, kështu që e gjithë kjo që është krijuar, medoemos duhet të ketë krijues të njëfarë lloji.

Bërësi dhe Mbajtësi i botës, Krijuesi dhe Furnizuesi i njeriut, Forca aktive dhe Fuqia efektive në natyrë; që të gjitha këto janë të njëjta, e janë të njohura si All-llah apo Zot. Ky është sekreti i të gjitha sekreteve dhe qenia më Supreme nga të gjitha të tjerat.

Kur'ani Famëlart, libri i vërtetë i Zotit thotë:³

“All-llahu është Ai që juve ua bëri natën të pushoni në të, e ditën të ndritshme. All-llahu është dhurues ndaj njerëzve, por shumica e njerëzve nuk e falënderojnë. Ky është All-llahu, Zoti juaj, Krijues i çdo sendi, nuk ka zot pos Tij, e si prapësoheni? Kështu prapësohen ata që i mohojnë argumentet e All-llahut. All-llahu është Ai që ua bëri tokën vendbanim e qiellin kulm, dhe ju formësoi, e formën tuaj e bëri më të mirë dhe ju pajisi me të mira. Ky është All-llahu, Zoti juaj, i Lartë pra është All-llahu, Zoti i botëve! Ai është i përjetshmi, s'ka zot, vetëm Ai, pra adhurone Atë me adhurim të sinqertë ndaj Tij, falënderimi i qoftë vetëm All-llahut, Zotit të Gjithësisë”. (Kur'ani, 40:61-65).

“All-llahu është Ai që për ju e nënshtroi detin, që me lejen e Tij të lundrojnë anijet nëpër të, që të kërkonin begatitë e Tij, ndaj falënderone. Dhe për ju nënshtroi gjithë çka ka në qiej dhe çka ka në tokë.

³ Veprat e mira letrare nuk mund të përkthehen në mënyrë adekuate në një gjuhë tjetër. Kjo vlen më së shumti për rastin e Kur'anit, librin që i mahnitë zotëruesit burimorë të gjuhës dhe letërsisë arabe dhe që tregoi se janë të paaftë të krijojnë diçka, madje edhe të përafërt me kaptinën më të shkurtër të këtij libri. Është e pamundur, sipas kësaj, ta reprodukosim kuptimin, bukurinë dhe fascinimin që e shkakton Kur'ani në çfarëdo forme tjetër. Ajo që del prej kësaj, d.m.th., nuk është Kur'ani real apo përkthimi adekuat i tij, pasi një gjë e tillë nuk është e mundur. Do të kishim thënë se interpretimi njerëzor në gjuhë të ndryshme është ai që krijon kushte për mungesë të përkthimit adekuat të fuqishmërisë së librit të Zotit. Për këto shkaqe nuk do të përdorim thonjëza që ta shënojmë një tekst si citat të Kur'anit, por teksti do të mbetet ashtu siç është.

Njëmend, për njerëzit që mendojnë më thellë, në këto ekzistojnë argumente". (Kur'ani, 45:12-13).

Pronari suprem i gjithë botës dhe Krijuesi i çdo gjëje është All-llahu xh.sh. Pasi Ai është aq i madh dhe i ndryshueshëm nga qeniet e tjera, njeriu mund ta njohë Atë vetëm nëpërmjet mendimit dhe medimit. Ai ekziston në të gjitha kohët dhe fuqia e Tij e madhe është aksion nëpër tërë botën. Njeriu duhet të besojë në ekzistencën e Tij, për arsye se çdo gjë në botë e dokumenton se Ai ekziston. Vetëm besimi në Zot dhe në fuqinë e Tij të madhe, mund ta pajisë njerëzimin me shumë shpjegime të shkëlqyera. Kjo është rruga më e mirë drejt diturisë dhe pajisjes shpirtërore, rruga e drejtë për sjellje të mirë dhe moral të shëndoshë, që janë udhërrëfyesit më të mirë për fat dhe prosperitet.

Posa të besojë njeriu se Zoti ekziston, ai duhet t'i dijë atributet dhe emrat e Tij. Thënë përgjithësisht, çdo përsosuri dhe çdo mirësi absolute i takon Atij, kështu që kurrfarë e mete apo gabim nuk mund t'i mvishet Atij. Prandaj, njeriu duhet ta dijë dhe konkretisht ta besojë këtë:

1. *"Thuaj: Ai, All-llahu është Një! All-llahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë. As s'ka lindur kë, as nuk është i lindur dhe Atij askush nuk i është i barabartë."* (Kur'ani, 112:1-4).

2. *"Ai është All-llahu që nuk ka zot tjetër; vetëm Ai, që e di të fshehtën dhe të dukshmen; Ai është Mëshiruesi, Mëshirëbërësi! Ai është All-llahu që nuk ka ka zot tjetër përveç Tij, sundues i përgjithshëm, i pastër (prej të metave që i mvishen), shpë-*

timtar (që i shpëton njerëzit prej ndëshkimit të padrejtë), sigurues (që i siguroi njerëzit me premtimin e vet dhe peygamberët me mrekulli), mbikëqyrës (që mbikëqyr dhe përcjell çdo gjë), i plotfuqishëm, mbizotërues, i madhërishëm. I lartësuar është All-llahu nga çka i shoqërojnë! Ai është All-llahu, Krijuesi, Shpikësi, Formësuesi. Të Tij janë emrat më të bukur. Atë (All-llahun) e madhëron çka ka në qiej e në tokë dhe Ai është ngadhënjyesi, i urti!” (Kur’ani, 59:22-24 dhe ngjashëm 57:1-6).

3. Ai është i dashur dhe furnizues, mëshirues dhe bamirës, i pasur dhe i pavarur, falës dhe mëshirëdhënës, i durueshëm dhe i falënderueshëm, unik dhe mbrojtës, gjykatës dhe dashamir i paqes. (Shembuj në Kur’an, 3:31; 11:6; 35:15; 65:2-3).

Çdonjëri nga këta emra dhe attribute të Zotit përmendet në vende të ndryshme të Kur’anit të shenjtë. Do të kënaqemi me mëshirën e Zotit, i cili është i dashur me krijimin e Tij. Nëse përpiqemi t’i numërojmë të mirat që na i ka bërë, nuk do të arrijmë dot, sepse ato janë të pakufishme. (Shembuj në Kur’an, 14:32-34; 16:10-18).

Zoti është i lartë dhe suprem, por Ai është shumë i afërt me njerëzit e devotshëm, të përsëritshëm dhe mendimtarë; Ai u përgjigjet lutjeve të tyre dhe u ndihmon atyre. Ai i do njerëzit që e duan Atë dhe ua fal mëkatet. Ai u jep atyre paqe dhe fat, dituri dhe sukses, jetë dhe mbrojtje. Për Atë janë të mirëseardhur ata që dëshirojnë të jenë në paqe me Të dhe asnjërin prej tyre nuk e refuzon. Ai e mëson njeriun të jetë i mirë, të veprojë drejt dhe t’i shmanget të keqes. Për arsye se Ai është aq i mirë dhe i dashur,

Ai i rekomandon dhe i pranon vetëm sendet e mira dhe të drejta. Dera e mëshirës së Tij është gjithmonë e hapur për çdonjërin që në mënyrë të sinqertë e kërkon mbrojtjen e Tij. (Shembuj në Kur'an, 2:186; 50:60).

Dashuria e Zotit për krijesat e Tij është e pakufishme dhe përtej çdo imagjinate njerëzore. Nuk mund t'i masim apo t'i numërojmë shërbimet e Tij. Ai na krijon dhe kujdeset tepër për ne, jo vetëm prej kohës kur jemi lindur, por madje edhe një kohë të gjatë para asaj. Ai na formon në trajtën më të mirë të krijimit dhe na i jep të gjitha shqisat dhe aftësitë që na duhen për rritjen tonë. Ai na ndihmon kur ne nuk mund t'i ndihmojmë vetvetes, na furnizon me gjërat që na nevojiten dhe që u nevojiten atyre që varen nga ne. Ai te njeriu krijoi trurin, i cili është në gjendje ta kuptojë shpirtin dhe vetëdijen e të qenit të mirë dhe të drejtë, si dhe ndjenjat e të qenit xhentil dhe të sjelljes njerëzore.

Diturinë tonë të vërtetë, për ta parë dritën e vërtetë, e fitojmë me mëshirën e Tij. Meqë Ai është i mëshirshëm, Ai na krijon në trajtën më të mirë dhe na furnizon me Hënë dhe me Diellin, me Tokën dhe detin, me Tokën dhe qiejt, me bimët dhe kafshët. Ai është Krijuesi i të gjitha këtyre gjërave dhe i shumë të tjerave që janë në dobi dhe në shërbimin tonë. Ai i krijon gjërat që na shërbejnë në këtë jetë, Ai i jep njeriut dinjitet dhe intelekt, nder dhe respekt, sepse njeriu është krijesa më e mirë nga të gjitha gjërat e krijuara - njeriu është zëvendës i Zotit në Tokë. Mëshira e Zotit na jep shpresë, guxim dhe besim. Ajo na mundëson që t'i shërojmë mëkatet dhe bren-

gat tona, t'i kapërcejmë vështirësitë, të kemi sukses dhe fat. Me të vërtetë, mëshira e Zotit është aktive në çdo aspekt, gjatë gjithë kohës së jetës sonë. Disa njerëz mund të mos kenë sukses për ta njohur atë, por vetëm e marrin ashtu siç është (pa kurrfarë rëndësie më të thellë). Megjithatë, ajo është e vërtetë dhe mund ta ndiejmë me zemrat tona e ta çmojmë me trurin tonë.

Zoti i dashur dhe mëshirëplotë asnjëherë nuk na harron e as nuk na lë pas dore, e po ashtu nuk i injoron edhe thirrjet e lutjet tona të sinqerta drejtuar Tij. Ai me mëshirën dhe dashurinë e Tij na ka treguar rrugën e drejtë dhe na ka dërguar lajmëtarë e mësues, libra e shpallje, - që të gjitha të destinuara për ndihmën dhe udhëheqjen tonë. Lajmëtari i fundit i dërguar nga Zoti është Muhammedi a.s., kurse libri më i çmueshëm i Zotit është Kur'ani. Për Zotin falës (që fal shumë) mësojmë nga Sunneti (traditat) i Muhammedit a.s. dhe nga Kur'ani. Nëse një person bën mëkat apo diç jo të drejtë, kjo don të thotë se e ka thyer Ligjin e Zotit e me këtë ka bërë dëm e mëkat (fyerje) të madh(e) ndaj Zotit, me çka e shpërdoron dinjitetin dhe ekzistencën e Tij. Por, nëse ai është i sinqertë, do të pendohet. Ai me keqardhje mendon për veprat e tij të këqija, kështu që kërkon që t'i drejtohet Zotit; në mënyrën më të sinqertë e besimplote kërkon falje nga Ai, duke iu afruar në mënyrë të ndershme. Me këtë rast Zoti me siguri do t'ia falë mëkatet. Madje edhe ata që e mohojnë Zotin apo njëshmërinë e Tij, po ashtu sigurohen me falje, me kusht që të kuptojnë se kanë pikëpamje të gabue-

shme e të vendosin t'i drejtohen Zotit. Lidhur me këtë, Kur'ani thotë:

“S’ka dyshim se All-llahu nuk falë (mëkatin) t’i përshkruhet Atij shok (idhujtarinë), e përpos këtij (mëkati) i falë kujtdo. Kush i përshkruan All-llahut shok, ai ka bërë një mëkat të madh.” (Kur’ani, 4:48 dhe 116).

“Thuaj: ‘O robërit e Mi që e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së All-llahut, pse vërtet All-llahu i falë të gjitha mëkatet. Ai është që falë shumë dhe është mëshirues!’ Dhe kthehuni te Zoti juaj dhe përuljuni Atij para se t’u vijë dënimi, se pastaj nuk do të ketë kush t’ju ndihmojë.” (Kur’ani, 39:53-54).

Zoti për këto gjëra nuk kërkon si shpërblim asgjë nga ne, për arsye se Ai nuk ka nevojë për asgjë, sepse Ai është i pavarur. Ai nuk kërkon prej nesh t’ia shpaguajmë të mirat, për arsye se nuk mund ta shpërblejmë Atë dhe nuk mund t’i çmojmë shërbimet dhe mëshirën e Tij të pakufishme. Ai vetëm na urdhëron të bëhemi të mirë, të mund të falënderojmë e të çmojmë, t’i zbatojmë porositë dhe ligjet e Tij, ta manifestojmë mirësinë e vërtetë, të jemi të deleguar dhe përfaqësues të ndershëm të Tij në tokë. Ai nuk dëshiron të na bëjë robër, sepse vetëm Ai na garanton dinjitet dhe nder. Ai nuk dëshiron të na përdorë si skllevër, sepse Ai është i vetmi që dëshiron të na lirojë nga frika dhe besëtytnitë. Ai nuk dëshiron të na poshtërojë sepse Ai është i vetmi që na krijon dhe na ngritë mbi të gjitha qeniet e tjera. Sipas kësaj, çfarëdo lloj rregullash apo propozimesh që Ai na i parashtron, janë qëllimplote

dhe për të mirën e dobinë tonë. Ato kanë për qëllim të na ndihmojnë që të kënaqemi me jetën tonë në paqe dhe me xhentilitet, në vëllazëri dhe bashkëpunim. Qëllimi i tyre është të jemi në shoqërinë e Tij të lartë e të pëlqyeshme, si dhe ta përfitojmë mënyrën më të mirë për një lumturi të amshueshme.

Ekzistojnë mënyra të ndryshme për ta njohur Zotin dhe ka shumë gjëra për të treguar lidhur me Atë. Çuditë e mëdha dhe mrekullitë impresive të botës u ngjasojnë librave të mirëfilltë ku mund të lexojmë për Zotin. Kështu, duke menduar për natyrën, duke i dëgjuar fjalët e të dërguarve dhe duke i lexuar zbulimet e amshueshme, mund ta përfitojmë diturinë më bindëse për Zotin dhe ta gjejmë rrugën e drejtë drejt Tij.

Me qëllim të plotësimit apo arritjes së qëllimit të plotë të këtij diskutimi, do të japim disa rreshta të Kur'anit: *“All-llahu vërtetoi se nuk ka zot tjetër përveç Tij, e dëshmuar edhe engjëjt e dijetarët, dhe se Ai është zbatues i drejtësisë. Nuk ka zot përveç Tij, fuqplotit e të urtit”*. (Kur'ani, 3:18). *“All-llahu është krijues i çdo sendi dhe Ai është mbikëqyrës ndaj çdo gjëje. Vetëm te Ai janë çelësat e qiejve e të tokës, ndërsa ata që nuk i besuan argumentet e All-llahut, të tillët janë ata të dështuarit”*. (Kur'ani, 39:62-63). *“All-llahu e fillon krijimin, mandej e përsërit atë, e më në fund tek Ai do të ktheheni”*. (Kur'ani, 30:11). *“E Tij është çka ka në qiej e në tokë dhe të gjithë vetëm Atij i përulen. Dhe Ai është që e shpikë jetën dhe pastaj e përsërit atë, e ajo (përsëritja) është edhe më e lehtë për Të (sipas mendimit tuaj). Shëmbëlltyra më e lartë është vetëm e*

Tij, në qiej e në tokë dhe Ai është mbizotëruesi, i urti". (Kur'ani, 30:26-27).

Kuptimi i fesë islame

Fjala "Islam" rrjedh nga rrënja arabe "*silm*", që krahas të tjerave don të thotë edhe paqe, pastërti, nënshtrim dhe bindje. Në kuptimin fetar, fjala "Islam" ka domethënien e nënshtrimit ndaj vullnetit të Zotit dhe dëgjimit (zbatimit) të Ligjit të Tij. Lidhja ndërmjet kuptimit të vërtetë dhe religjioz të kësaj fjale është e dukshme dhe e fortë. Vetëm me anë të nënshtrimit ndaj vullnetit të Zotit dhe me anë të respektimit të Ligjit të Tij, njeriu mund të arrijë deri te paqja e vërtetë dhe të kënaqet në një pastërti të amshueshme. Disa njerëz fenë tonë e quajnë "Muhammedanizëm", kurse besimtarët e fesë islame "muhammedanë". Muslimanët i refuzojnë dhe reagojnë kundër përdorimit të këtyre emërtimeve. Po qe se feja jonë quhet Muhammedanizëm dhe po qe se ne quhemi muhammedanë, do të paraqiten implikacione serioze dhe gabime të mëdha. Njerëzit e tillë që në mënyrë të gabuar e emërtojnë fenë tonë, dëshirojnë të thonë se feja e merr emrin e vet sipas një qenieje e cila përjetoi vdekjen, që d.m.th., se Muhammedi a.s. dhe Islami nuk janë asgjë tjetër pos disa "-izmave", si p.sh. judaizmi, hinduizmi, marksizmi, etj. Një implikim tjetër negativ që del nga ky emërtim i gabuar është se opinioni mund të mendojë se "muhammedanët" si ithtarët apo besimtarët e Muhammedit kanë marrëdhënie të njëjta, si p.sh., të

krishterët që besojnë në Jezu Krishtin. Një mendim tjetër i gabuar që do të dilte nga ky keqpërdorim i emrit të fesë islame, është se opinioni mund të mendojë se Muhammedanizmi është religjion që e ka themeluar prijësi Muhammed e si pasojë e kësaj mund të shkojnë rrugës së gabuar. Feja islame nuk është një “-izëm” i ri. As muslimanët nuk e adhurojnë apo nuk e trajtojnë Muhammedin në të njëjtën mënyrë si p.sh., të krishterët, hebrenjtë, hindusët apo marksistët që i trajtojnë udhëheqësit e tyre. Muslimanët e adhurojnë vetëm Zotin. Muhammedi qe vetëm një njeri që iu nënshtrua vdekjes, i dërguar nga Zoti, që t’ua mësojë njerëzve fjalën e Zotit e t’i mësojë të jetojnë një jetë shembullore. Në historinë njerëzore ai njihet si shembull më i mirë dhe më i përsosur i njeriut të devotshëm. Ai është dëshmi e gjallë për atë se çka mund të jetë njeriu dhe çka mund të mbërrijë në saje të shkëlqesisë së virtytit. Përveç kësaj, muslimanët nuk besojnë se fenë islame e ka themeluar Muhammedi a.s., edhe pse ai e ripërtëriu në fazën e fundit të evolucionit të saj. Themeluesi i vërtetë i fesë islame nuk është askush tjetër përveç Vetë Zotit, dhe data e themelimit të saj na kthen deri në kohën e Ademit. Feja islame qysh prej fillimit të saj ka ekzistuar në këtë apo në atë formë, e kështu do të vazhdojë të ekzistojë përgjithmonë.

Domethënë, emri i vërtetë i fesë atëherë është Islam ndërsa ithtarë të tij janë muslimanët. Përkundër koncepteve të gabuara të njerëzve, Islami apo nënshtrimi ndaj vullnetit të Zotit bashkë me zbatimin e Ligjit të Tij, në asnjë mënyrë nuk do të thotë

humbje e lirisë individuale apo dorëzim ndaj fatalizmit. Koncepti i Zotit në fenë islame e përshkruan Atë si më të mëshirshmin, mëshirëplotin, më të dashurin dhe më të përkujdesshmin ndaj mirëqenies së njeriut; si dhe më të mençur dhe të kujdesshëm për krijesat e Tij. Vullneti i Tij, sipas kësaj, është një vullnet i mirëqenies dhe mirësisë dhe çkado që të urdhërojë Ligji i Tij, duhet të jetë në interes më të mirë të njerëzimit. Kur qytetarët u nënshtrohen ligjeve të shteteve të tyre, ata konsiderohen qytetarë të vërtetë dhe anëtarë të ndershëm të shoqërive të tyre përkatëse. Asnjë njeri me përgjegjësi nuk do të kishte thënë se ata e humbin lirinë e vet kur u nënshtrohen ligjeve të tyre. Asnjë qenie e arsyeshme nuk do të thoshte, apo nuk do të besonte, se njerëzit e tillë që u nënshtrohen ligjeve janë fatalistë të pandihmë. Analogjikisht, një person që i nënshtrohet vullnetit të Zotit, e që është vullnet i mirë, dhe që i nënshtrohet Ligjit të Zotit, i cili është ligji më i mirë, është njeri i shëndoshë e i ndershëm. Ai fiton mbrojtje për të drejtat e tij, e duke treguar respekt të madh ndaj të tjerëve, gëzon një shkallë të një lirie përgjegjëse e kreative. Nënshtrimi ndaj vullnetit të Zotit, sipas kësaj, nuk e privon lirinë individuale. Përkundrazi, ai ofron një liri të shkallës më të lartë në kuptimin më të plotë. E liron mendjen nga besëtytnitë dhe e pasuron atë me të vërtetën. E liron shpirtin nga mëkatet dhe e keqja, kështu që e afron nga e mira dhe pastërtia. E liron veten prej zbrazëti-rës dhe pangopësisë (lakmisë), prej inatit dhe tendosjes dhe prej frikës e pasigurisë. E liron njeriun nga besimi në hyjni të rrejshme dhe dëshira të ulëta,

duke hapur para tij horizontet e bukura të mirësisë dhe shkëlqyeshmërisë. Nënshtrimi ndaj vullnetit të Zotit bashkë me zbatimin apo aprovimin e Ligjit të Tij bamirës, është garanci më e madhe për paqe dhe harmoni. Ky e aftëson njeriun të vendosë paqe midis vetes dhe njerëzve të tjerë në njërën anë, dhe midis njerëzimit dhe Zotit, në anën tjetër. Krijon harmoninë ndërmjet elementeve të natyrës. Sipas fesë islame, çdo gjë në botë ose çdo fenomen tjetër që ndryshon nga njeriu, kontrollohet nga ligjet e krijuara nga Zoti. Ky është shkaku që e gjithë bota fizike t'i përulet Zotit dhe t'u nënshtrohet ligjeve të Tij, gjë që don të thotë të ndodhet në kuadër të fesë islame, apo të jetë botë muslimane. Bota fizike si e tillë, nuk mund të bëjë zgjidhje vetvetiu. Ajo s'ka mënyrë vullnetare të përcjelljes së punëve apo të jetës si pasojë e iniciativës së saj, por e aprovon Ligjin e Krijuesit, Ligjin e fesë islame apo të nënshtrimit. Vetëm njeriu dallohet me aftësitë e tij të intelektit dhe të të zgjedhurit, atij i jepet mundësia t'i nënshtrohet të mirës dhe vullnetit të Zotit dhe dëgjimit apo aprovimit të Ligjit të Zotit. Kur e zgjedh nënshtrimin ndaj vullnetit të Zotit, ai krijon harmoni ndërmjet vetes dhe elementeve të tjera të natyrës, e që medoemos janë nën urdhrin e Zotit. Do të jetë i pajisur me të vërtetën dhe do të ketë harmoni me të gjitha elementet tjera të Gjithësisë. Por, nëse nuk e zgjedh dëgjimin dhe aprovimin e Ligjit të Tij, do të devijojë nga rruga e drejtë dhe do të jetë i pavlefshëm. Përveç kësaj, ai do ta fitojë pakënaqësinë dhe dënimin nga Ligjdhënësi.

Meqenëse fjala “Islam” don të thotë nënshtrim ndaj vullnetit të Zotit dhe dëgjim apo bindje ndaj Ligjit të Tij bamirës, dhe meqë ky është thelbi i porosisë së lajmëtarëve të zgjedhur nga Zoti, një musliman të gjithë peygamberët para Muhammedit a.s., i pranon pa kurrfarë diskriminimi. Ai beson se të gjithë këta peygamberë të Zotit dhe ithtarët e tyre besimplotë janë muslimanë dhe se feja e tyre është Islami, feja e vetme universale dhe e vërtetë e Zotit (Kur’ani, 2:128-140; 17:42-44; 31:22; 42:13).

Me qëllim të rrumbullakimit të këtij diskutimi, do të ishte mirë të përkujtohem në tezën time që e botova në “Observer Dispatch” (O.D.) të Jutikës (Utica) më 4 dhjetor të vitit 1972. Përsëritja e pjesërishme e saj, për shkak të natyrës delikate të temës dhe nevojës për freskimin e pikëpamjes islame, në disa vende mund të arsyetohet.

Një lajm i ri (O.D. 25 dhjetor) është mjaft alarmant. E tërheq simpatinë, e përkrah publiku i painformuar si duhet - e kjo do të ishte mëkat për shumë arsimtarë shkollorë apo për njeriun që punon në kishë. Kjo është një thirrje për çdo njeri me vullnet dhe vetëdije të mirë, që t’u përmbahet obligimeve të tij morale.

Markus Elajsoni (Marcus Eliason) raportoi nga Jordania, e okupuar nga Izraeli, se “Muslimanët”, midis të tjerave, “e adhurojnë Abrahamin si Ibrahim..!”

Është e pabesueshme që në ditët dhe në periudhën e sotme në botën tonë kaq të vogël, të lexosh ndonjë botim të ri se muslimanët e adhurojnë Ibrahimin. Edhe më e pabesueshme është ajo se kjo vjen

nga burime pak a shumë të njohura e të ditura, e që kalon nëpër sytë e publikut të autorizuar për ta ditur.

Shumica e njerëzve në Perëndim me shekuj propagandonin se muslimanët e adhurojnë Muhammedin dhe se feja e tyre quhet “Muhammedanizëm” - këta në Perëndim u njohën me emrin muhammedanë. Më vonë, këtyre intelektualëve nga Perëndimi disi iu bë e qartë se muslimanët e adhurojnë All-llahun, “Hyjninë e të gjitha llojeve”. E gjëja më e re është fakti se muslimanët e adhurojnë Abrahamin si Ibrahim.

Është fakt i gjallë se muslimanët asnjëherë nuk e kanë hyjnizuar Muhammedin ose cilëndo qenie tjetër njerëzore. Ata çdoherë kanë besuar se edhe Muhammedi është i vdekshëm si të gjithë peygamberët para tij, dhe se është nderi më i lartë i njerëzimit me të cilin njeriu mund të arrijë statusin më të ndritshëm të peygamberisë.

Muslimanët besojnë se Muhammedi qe peygamberi i fundit, por jo edhe i vetmi, i cili e përforcoi dhe e bëri të përjetshme porosinë e amshueshme të Zotit ndaj njerëzimit. Këtë porosi Zoti ua zbuloi shumë peygamberëve të përkatësive të ndryshme kombëtare në periudha të ndryshme kohore, duke i marrë parasysh këtu Ibrahimin, Ismailin, Is'hakun, Davudin, Musanë, Isanë dhe Muhammedin (paqja qoftë mbi ta). Gjëja më e rëndësishme është se muslimanët u besojnë të gjithë këtyre, pa bërë kurrfarë diskriminimi të çfarëdo lloji.

Për arsye të pikëpamjeve të tyre universale dhe orientimit të tyre kozmopolit, muslimanët me keqardhje konsiderojnë se është gabim që ata të quhen

muhammedanë dhe besimi i tyre Muhammedanizëm. Ekzistojnë implikime serioze, edhe atë për shkaqe dhe argumente të forta. Muslimanët nuk mendojnë se i përkasin ndonjë race apo grupi të veçantë etnik, për të patur ndonjë monopol të veçantë. Feja e tyre nuk e mori emrin sipas ndonjë njeriu apo vendi, por ajo është transcendentale dhe jashtëkohore.

Emri i vërtetë i fesë është “ISLAM”, e ithtarët e tij quhen muslimanë. Në kontekstin fetar, fjala “Islam” don të thotë nënshtrim ndaj vullnetit të Zotit dhe aprovim i Ligjit të Tij. Kur’ani e definon vullnetin e Zotit si të mirë e të mëshirueshëm dhe se Ligji i Tij është më i miri dhe më i dobishmi. Çdo qenie njerëzore që kështu mendon dhe vepron, është musliman në një stad të fesë islame. Në këtë kuptim, Kur’ani Ibrahimin dhe të gjithë peygamberët e tjerë autentikë i quan muslimanë dhe i shënon fetë e tyre me një titull të vetëm - Islam. Sipas kësaj, muslimani nuk është vetëm ithtar i Muhammedit, por po ashtu edhe i Musaut, Isait dhe i Të dërguarve të tjerë të Zotit.

Më në fund, fjala All-llah në fenë islame thjeshtë, por në një mënyrë të spikatur, don të thotë - Një i vetmi Zot i Amshueshëm, Krijues i Gjithësisë, Pronar i të gjithë pronarëve dhe Mbret i të gjithë mbretërve. I vetmi mëkat që nuk falet në fenë islame është besimi në ndonjërin prej hyjnive të ndryshme apo në ndonjë tjetër përveç Zotit. Lutja më e shpeshtë në fenë islame është: “Në emër të All-llahut, Bamirësit dhe Mëshiruesit të përgjithshëm”.

Parimet themelore të besimit në fenë islame

Muslimani i vërtetë dhe besimplotë beson në këto parime kryesore të fesë islame:

1. *“Të Tij janë emrat më të bukur. Atë (All-llahun) e madhëron çka ka në qiej e në tokë dhe Ai është ngadhënjyesi, i urti!”* (Kur’ani, 59:22-24 dhe ngjashëm 57:1-6). Ai beson vetëm në Një Zot të lartmadhërishëm dhe të amshueshëm, të pafund dhe të fuqishëm, të mëshirueshëm dhe mëshirëplotë, krijues dhe furnizues. Ky besim, që të jetë efektiv, kërkon një besim dhe shpresë të plotë te Zoti, përkulje ndaj vullnetit të Tij dhe mbështetje në ndihmën e Tij. Kjo e siguron dinjitetin e njeriut, e ruan atë nga frika dhe nga brenga, nga faji dhe konfuzioni. Me këtë lexuesit i mundësohet kuptimi i fesë islame i shpjeguar më lart.

2. Ai u beson të gjithë lajmëtarëve të Zotit pa kurrfarë diskriminimi midis tyre. Çdo popull i njohur ka pasur një thirrës apo lajmëtar të Zotit. Këta lajmëtarë ishin mësues madhështorë të së mirës dhe kampionë të vërtetë të së drejtës. Zoti i zgjodhi ta mësojnë njerëzimin dhe ta përhapin Porosinë e Tij Hyjnore. Ata i dërgoi në periudha të ndryshme historike dhe çdo popull i njohur pati një apo më tepër lajmëtarë. Gjatë periudhave të ndryshme Zoti në të njëjtën kohë dërgoi dy apo më tepër lajmëtarë, të cilët i qenë dedikuar popullit të njëjtë. Kur’ani i Shenjtë i përmend emrat e njëzet e pesë lajmëtarëve të tillë, - muslimani u beson të gjithë këtyre, duke i pranuar si lajmëtarë të autorizuar nga Zoti. Me për-

jashtim të Muhammedit, ata ishin të njohur si lajmëtarë “nacionalë” apo lokalë. Por, porosia e tyre, feja e tyre, ishte kryesisht e njëjtë dhe u quajt ISLAM, për arsye se vinte nga një burim i vetëm - e që ishte Zoti, që çonte drejt një qëllimi të njëjtë - drejt udhëheqjes së njerëzimit kah rruga e drejtë e Zotit. Të gjithë lajmëtarët pa përjashtim ishin qenie të vdekshme, qenie njerëzore, të pajisura me shpallje e përjetime hyjnore, e të udhëhequra nga Zoti për të kryer detyra të ndryshme. Ndër ta, Muhammedi a.s. është lajmëtari i fundit, ndaj paraqet kurorën dhe krenarinë e themelimit të pejgamberisë. Kjo nuk është një pikëpamje arbitrare, e as një besim me marrëveshje. Si të gjitha bindjet tjera islame, kjo është e vërtetë autentike dhe logjike. Po ashtu, këtu do të ishte e nevojshme të përmenden emrat e disa nga lajmëtarët e mëdhenj si Nuhi, Ibrahim, Ismaili dhe Musau, Isau dhe Muhammedi; i bekoftë Zoti që të gjithë! Kur’ani i këshillon muslimanët në këtë mënyrë:

“Ne i besuam All-llahut, atë që na u shpall neve, atë që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Is-hakut, Jakubit dhe pasardhësve (të Jakubit që ishin të ndarë në dymbëdhjetë fise), atë që i është dhënë Musait, Isait dhe atë që u është dhënë nga Zoti i tyre pejgamberëve, ne nuk bëjmë dallim në asnjërin prej tyre dhe ne vetëm Atij i jemi bindur”. (Kur’ani, 2:136; ngjashëm - 3:84; 4:163-165; 6:84-87).

3. Si rezultat i pikës së dytë, muslimani i vërtetë beson në të gjitha shkrimet dhe shpalljet e Zotit. Ato e paraqesin dritën udhëheqëse, të cilën lajmëtarët e pranuan që t’ua tregojnë popujve të tyre përkatës rrugën e drejtë të Zotit. Në Kur’an ekzistojnë shpje-

gime të veçanta lidhur me librin sipas Ibrahimit, Musaut, Davudit dhe Isaut. Por shumë kohë para shpalljes së Kur'anit, para paraqitjes së Muhammedit, shumë libra dhe shpallje humbën apo u korrumpuan, të tjerat u harruan apo u fshehën. Libri i vetëm dhe autentik i Zotit që ekziston sot e kësaj dite është Kur'ani. Parimisht, muslimani beson në librat dhe shpalljet e mëparshme. Por, ku janë versionet e tyre të plota dhe origjinale? Ato ndoshta ende janë në fundin e Detit të Vdekur, e ndoshta ka edhe shumë gjëra që ende nuk janë të zbuluara. Ose ndoshta do të fitohen informata më të plota kur arkeologët e krishterë dhe hebrenj do t'ia zbulojnë publikut rezultatet e kërkimit të tyre të përhershëm në Tokën e Shenjtë. Te muslimani nuk ekziston një problem i tillë. Kur'ani në dorën e tij është komplet dhe autentik. Në të nuk mungon asgjë, e prej tij nuk kërkohet asgjë më tepër. Autenticiteti i tij është i padyshimtë dhe asnjë shkencëtar apo mendimtar nuk e ka vënë në dyshim gjenialitetin e tij të madh. Kur'anin e bëri Zoti që e shpalli atë si të vetin, me qëllim që ta mbrojë nga çdo ndërhyrje apo korrupsion i çfarëdo-llojshëm. Kjo për muslimanët paraqet një kriter standard me të cilin gjykohen të gjithë librat e tjerë. Kështu, çdo gjë që përputhet me Kur'anin pranohet si një e vërtetë hyjnore, e çdo gjë që nuk përputhet me të, refuzohet apo suspendohet. Zoti thotë: *“Ne me madhërinë tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij”*. (Kur'ani, 15:9; ngjashëm - 2:75-79; 5:13-14, 41, 45, 47, 6:91; 41:43).

4. Muslimani i vërtetë u beson engjëjve të Zotit. Ato janë qenie të pastra shpirtërore, natyra e të cilë-

ve nuk kërkon as ushqim, as pije e as gjumë. Ato s'kanë dëshira fizike e as nevoja materiale, ndërsa ditët dhe netët e tyre i kalojnë në shërbim të Zotit. Ekzistojnë shumë sish dhe çdonjëri nga ata ka detyrë të caktuar. Nëse nuk mund t'i shohim engjëjt me sytë tanë, kjo nuk do të thotë se ata nuk ekzistojnë. Ekzistojnë shumë gjëra në botë që janë të padukshme për syrin tonë apo të pakapshme për shqisat tona; por ne përsëri e pranojmë ekzistencën e tyre. Besimi në engjëjt e ka origjinën në parimin islam, se dituria dhe e vërteta nuk janë krejtësisht të kufizuara në aftësitë shqisore dhe në perceptimin shqisor. (Kur'an, 16:49-50; 21:19-20. Po ashtu shih edhe disa fragmente nga pika e dytë më sipër).

5. Muslimani i vërtetë beson në Ditën e Fundit, Ditën e Gjykimit (Kijametit). Kjo botë një ditë do të marrë fund dhe të vdekurit do të ngrihen për gjykimin e tyre të fundit dhe të vërtetë. Gjithçka që bëjmë në këtë botë, çdo qëllim që kemi, çdo lëvizje që bëjmë, çdo mendim që e mendojmë dhe çdo fjalë që e shqiptojmë, regjistrohet dhe mbahet në kujtesë të saktë. Të gjitha këto do të shfaqen në Ditën e Gjykimit. Ata, për të cilët mbahen "dosje" (mbahen mend) veprat e mira, do të shpërblehen dhe do të jenë të mirëseardhur në parajsë; kurse ata, për të cilët dihet se kanë bërë gjëra të këqija, do të dënohen dhe do të dërgohen në ferr. Natyra e vërtetë e parajsës dhe ferrit dhe përshkrimi i saktë i tyre dihen vetëm nga Zoti. Në Kur'an dhe në traditat e Muhammedit a.s. ekzistojnë përshkrime të parajsës dhe të ferrit, por nuk duhet të kuptohen fjalë për fjale. Në parajsë, ka thënë Muhammedi a.s., ekzistojnë gjëra që nuk i ka

parë asnjë sy, që nuk i ka dëgjuar asnjë vesh dhe që për to nuk ka menduar asnjë mendje. Megjithatë, muslimani beson se me të vërtetë do të ketë kompensim dhe shpëtim për veprat e mira dhe dënim për veprat e këqija. Kjo është Dita e Gjykimit dhe llogaria përfundimtare për të gjitha krijesat.

Nëse disa njerëz mendojnë se janë mjaft dinakë dhe se mund të ikin nga veprat e tyre të këqija, ashtu siç i ikin ndonjëherë dënimin të ligjeve botore, kjo do të thotë se kanë pikëpamje krejtësisht të gabuara, - ata nuk do të shpëtojnë lehtë në Ditën e Gjykimit (të llogarive). Ata do të kapen në momentin kur nuk do të jenë më në gjendje të mbrohen, - atëherë kur në emër të tyre nuk do të mund t'i mbrojë as avokati e as ndonjë këshilltar. Të gjitha veprat e tyre i sheh Zoti dhe ndihmësit e Tij. Dhe e kundërta, nëse disa njerëz të tjerë të mëshirshëm bëjnë vepra të mira që ta kënaqin Zotin dhe duket se nuk gjejnë kurrfarë çmimi apo mirënjohjeje në këtë botë të përkohshme, ata do të fitojnë kompensim të plotë dhe mirënjohje të thellë në atë ditë. Çdokush do të fitojë të Drejtën Absolute.

Besimi në Ditën e Kijametit është përgjigjja e fundit e Shpalljes për shumë probleme të shtresuara të botës sonë. Ekzistojnë njerëz që bëjnë mëkate, e mohojnë Zotin dhe kyçen në aktivitete amorale; e përsëri duket se janë "sipërfaqësisht" të suksesshëm në punën dhe jetën e tyre. Por, po ashtu ekzistojnë edhe njerëz plot virtyte e që mendojnë për Zotin; e përsëri duket se fitojnë pak shpërblime për përpjekjet e tyre të sinqerta, e më tepër vuajnë në botën e sotme. Kjo gjë është konfuzë dhe bie ndesh me dre-

jtësinë e Zotit. Nëse njerëzit fajtorë mund t'u shmangen ligjeve botore pa pasur kurrfarë pasoje dhe, nëse përveç asaj kanë perspektivë më prosperuese, atëherë ç'mbetet për njerëzit e pajisur me virtyte? Me çka do të shpërblehej vepra e moralit dhe e mirësisë? Duhet të ekzistojë ndonjë mënyrë për ta shpërblyer mirësinë e për ta dënuar të keqen. Nëse kjo nuk bëhet këtu në këtë tokë - meqë e dimë se kjo nuk bëhet menjëherë apo në kohë të duhur, - do të arrijë një ditë kur kjo do të realizohet; e kjo është Dita e Kijametit. Kjo nuk bëhet që të mëshirohen të deprimuarit, apo që të inkurajohen eksploatuesit e tyre. Kjo bëhet për t'ua tërhequr vërejtjen atyre që devijojnë nga rruga e drejtë dhe për t'i përkujtuar ata se drejtësia e Zotit do të shfaqet në formë të plotë, herët apo vonë (shihni, për shembull, diskutimet e mëparshme).

6. Muslimani i vërtetë beson në njohjen jokohore (që nuk njeh dimension të kohës) të Zotit dhe në fuqinë e Tij për t'i planifikuar dhe për t'i realizuar qëllimet e Tij. Zoti nuk qëndron indiferent ndaj kësaj bote, e as që është neutral ndaj saj. Dituria dhe fuqia e Tij veprojnë në të gjitha kohët, me qëllim që të mbajnë rend dhe disiplinë në suazat e Tij të gjera dhe ta mbajnë nën komandë të fortë krijimin e Tij. Ai është i mençur dhe i dashur. Nëse kjo shtresohet në kokat tona, ne duhet ta pranojmë me besim të mirë gjithë atë që e bën Ai, edhe pse ndoshta mund të mos e kuptojmë Atë plotësisht apo të mendojmë se ajo gjë është e keqe. Duhet të kemi besim të plotë në Të dhe ta pranojmë gjithë atë që e bën Ai, për arsye se dituria jonë është e kufizuar dhe procesi ynë

i të menduarit është i bazuar në konsiderime individuale ose personale; - përderisa dituria e Tij është e pakufishme, e përveç kësaj, Ai planifikon në baza universale.

Kjo në asnjë mënyrë nuk e bën njeriun fatalist dhe të pafuqishëm. Kjo vetëm vë një kufi të qartë ndërmjet asaj se ç'është puna e Zotit në njërën anë, dhe ç'është përgjegjësia e njeriut në anën tjetër. Meqë jemi të kufizuar nga natyra, ne kemi një fuqi dhe liri të kufizuar. Nuk mund të bëjmë gjithçka; e Ai në mënyrë të shenjtë mban përgjegjësi për gjithçka që bëjmë ne. Ato veprime të cilat ne nuk mund t'i bëjmë, apo të cilat Ai Vetë i bën, nuk bëjnë pjesë në kuadër të përgjegjësisë sonë. Ai është i drejtë dhe na ka dhënë një fuqi të kufizuar për ta udhëhequr natyrën dhe përgjegjësinë tonë të kufizuar. Në anën tjetër, dituria jokohore (që s'ka dimension të kohës) për Zotin dhe për ekzistimin e planeve të Tij, nuk na pengon në veprimtarinë dhe në planet tona në saje të sferës së fuqisë sonë të përkufizuar. Përkundrazi, Ai na shpie të mendojmë, të planifikojmë e të bëjmë zgjedhje të drejta - por, nëse nuk ndodh ashtu siç deshëm dhe siç planifikuam, atëherë nuk duhet ta humbim besimin apo ta dorëzojmë vetveten. Duhet sërish të përpiqemi, dhe nëse rezultatet nuk na kënaqin, duhet të dijmë se nuk kemi dhënë gjithë çka kemi mundur e se nuk ndihemi përgjegjës për atë, - për arsye se ajo është përtej kapacitetit dhe përgjegjësisë sonë, e kjo është vetëm puna e Zotit. Muslimanët e quajnë këtë pjesë të besimit "Kada" dhe "Kader", e që me fjalë të tjera don të thotë se dituria jashtëkohore e Zotit i anticipon (i ka në dije që më

parë) ngjarjet dhe se ato ndodhin në pajtim me diturinë e saktë të Tij. (Kur'ani, për shembull: 18:29; 41:46; 53:33-62; 54:49; 65:3; 76:30-31).

7. Muslimani i vërtetë beson se krijimi i Zotit (ajo që Ai e ka krijuar) është kuptimplotë dhe se jeta ka një qëllim më të lartësuar përtej nevojave fizike dhe aktiviteteve materiale të njeriut. Qëllimi i jetës është të lartësohet dhe të adhurohet Zoti. Por kjo nuk do të thotë se duhet ta kalojmë tërë jetën në vetmi dhe mendime. Ta adhurosh Zotin d.t.th., ta njohish Atë, t'i dëgjosh urdhrat e Tij, ta zbatosh Ligjin e Tij në çdo aspekt të jetës, t'i shërbesh shkakut (kauzës) të Tij duke vepruar drejt dhe duke e përbuzur të keqen dhe të jeshë i drejtë ndaj Tij, ndaj vetes dhe ndaj qenieve njerëzore. Ta adhurosh Zotin don të thotë ta "jetosh" jetën, e jo të largohesh nga ajo. Me një fjalë, ta adhurosh e ta besosh Zotin, don të thotë të pajisesh me atributet e Tij supreme (të shkëlqyerat). Kjo nuk është vetëm një fjali e thjeshtë, e as një thjeshtësim i tepërt i fakteve. Mund të kuptohet lehtë, e prej saj mund të nxirren përfundime. Sipas kësaj, nëse jeta ka ndonjë qëllim dhe nëse njeriu është krijuar për ta plotësuar atë qëllim, atëherë ai nuk mund t'i shmanget kësaj përgjegjësie. Ai nuk mund ta refuzojë ekzistencën e vet, apo ta injorojë rolin vital që e luan. Kur Zoti e ngarkon atë me përgjegjësi, Ai ia jep gjithë ndihmën e duhur. Ai ia jep njeriut intelektin dhe fuqinë për ta zgjedhur mënyrën e udhëheqjes së jetës së tij. Sipas kësaj, njeriu në mënyrë të fuqishme udhëhiqet nga parimet e Zotit, me qëllim që në mënyrë të rregullt e të plotë t'i shërbejë qëllimit të ekzistencës së tij. Nëse ai nuk është i

aftë të veprojë në këtë mënyrë, atëherë përgjigjet para Zotit për veprat e tij të këqija. (Shih Kur'anin, 21:17-18; 51:56-58; 75:37).

8. Muslimani i vërtetë beson se njeriu e gëzon statusin më të lartë në hierarkinë e krijesave të njohura. Ai e zë këtë vend të dalluar meqë posedon aftësi rezonuese, aspirata shpirtërore, si dhe fuqi për aksion. Por, aq sa lartësohet rangi i tij, aq më e madhe është edhe përgjegjësia e tij. Ai e zë vendin e të thirrurit të Zotit në tokë. Personi të cilin e ka caktuar Zoti të jetë i deleguar i Tij aktiv duhet të ketë fuqi e autoritet, e ndër të tjera, duhet të jetë i pajisur me nder dhe integritet personal. Ky është statusi i njeriut në fenë islame; raca e tij nuk është e dënuar apo e mallkuar që nga lindja e deri në vdekje, por ai është një qenie plot dinjitet që ka potencial për arritje të sukseseve të mirëfillta. E vërteta se Zoti i zgjodhi lajmëtarët nga raca njerëzore, dëshmon se njeriu është i besueshëm e i aftë dhe se mund të akumulojë pasuri të pafundshme të mirësisë. (Shih Kur'anin, 2:30-34; 6:165; 7:11; 17:70-72,90-95).

9. Muslimani i vërtetë beson se çdo person është i lindur si “musliman”. Kjo don të thotë se çdo lindje që ndodh është në pajtim me vullnetin e Zotit; me qëllim të realizimit të planeve të Tij dhe nënshtrimit ndaj urdhrave të Tij. Kjo po ashtu don të thotë se çdo person ka potencial shpirtëror dhe aftësi intelektuale që mund ta bëjnë musliman të mirë, me kusht që ta njohë mirë fenë islame dhe t'i zhvillojë e përkryejë rregullisht aftësitë e natyrës së tij të lindur. Shumica e njerëzve menjëherë do të mund ta pranonin fenë islame, nëse ajo atyre u prezentohet në

mënyrë të drejtë, për arsye se kjo është formula hyjnore për ata që dëshirojnë t'i kënaqin nevojat e tyre shpirtërore dhe aspiratat e tyre natyrore, për ata që dëshirojnë të jetojnë jetë cilësore e të shëndoshë; qoftë ajo personale apo shoqërore, kombëtare apo ndërkombëtare. Kjo është kështu për arsye se feja islame është fe universale e Zotit, Krijuesit të natyrës njerëzore; i Cili e di se ç'është më mirë për natyrën njerëzore. (Shih, Kur'ani: 30:30; 64:1-3; 8:6-8).

10. Muslimani i vërtetë beson se çdo person lindet i lirë nga çdo mëkat, sepse çdo thënie është në kuptim të virtytit trashëgues. Ai i ngjason një libri të bardhë (të pashkruar). Kur e arrinë moshën e pjekurisë, nëse zhvillimi i tij është normal dhe nëse është i shëndoshë, ai bëhet përgjegjës për nevojat dhe qëllimet e tij. Njeriu nuk është i lirë prej mëkatit vetëm derisa të mos bëjë ndonjë mëkat; por ai është i lirë të veprojë edhe në pajtim me planet e tij për të cilat vetëpërgjigjet. Kjo liri dykahëshe - liria nga mëkati dhe liria për të vepruar në mënyrë efektive - e pasturon vetëdijen e njeriut nga presioni i fortë nga ana e Mëkatit të Trashëguar. Ajo e liron shpirtin dhe mendjen e tij nga pengesat e panevojshme të Doktrinës së Mëkatit Fillestar (të Parë).

Koncepti islam i lirisë bazohet në parimin e drejtësisë së Zotit dhe në përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të individit ndaj Zotit. Çdo person duhet ta bartë "barrën" e tij dhe të përgjigjet për veprimet e tij, sepse askush nuk mund t'i shpaguajë mëkatet e tjetërkujt. Sipas kësaj, një musliman beson se nëse Ademi e ka bërë Mëkatin e Parë, vetë ka qenë përgjegjës për ta shpague vetveten lidhur me atë më-

kat. Supozimi se Zoti nuk ka patur mundësi ta falë Ademin dhe se ka qenë i detyruar të zgjedhë dikë tjetër për shpagimin e mëkatit të tij; apo supozimi se Ademi nuk u lut për të kërkuar falje nga Zoti, e cila nuk qe e garantuar, do të ishin shumë të papëlqyer dhe të kundërt nga mëshira dhe drejtësia e Zotit si dhe kundër atributit të Tij për falje e fuqi për të falur. Ta përmbash hipotezën e sipërpërmendur, do të thoshte një prishje e mendjes së shëndoshë dhe një atakim fatal i konceptit të Zotit (shih faktet e përmendura nën pikën nëntë: Kur'ani; 41:46; 45:15; 53:31-42; 74:35; dhe konceptin e mëkatit më poshtë).

Me këtë bazë rezonuese si dhe në pajtim me autoritetin e Kur'anit, muslimani beson se Ademi e ka kuptuar mëkatin që e ka bërë dhe se i është lutur Zotit që atë t'ia falë, ashtu siç do të kishte bërë çdo mëkatar i zakonshëm. Po ashtu në baza të ngjashme, muslimani beson se Zoti, falësi i mëkateve dhe i plotmëshirshmi, ia ka falur mëkatin (Kur'an; 2:35-37; 20:117-122). Sipas kësaj, muslimani nuk mund ta pranojë doktrinën se Ademi bashkë me gjithë racën njerëzore ka qenë i dënuar dhe se askush nuk ia ka falë dënimet, derisa nuk ka ardhur Isai që t'i shpaguajë mëkatet e tyre. Si pasojë e kësaj, muslimani nuk mund të mendojë se me vdekjen dramatike të Krishtit në kryq të gjitha mëkatet falen menjëherë.

Këtu duhet ta tërheqim vëmendjen e lexuesit, që të mos vijë në përfundime të gabuara. Muslimani nuk beson se Isain a.s., e kanë kryqëzuar armiqtë e tij, për arsye se baza e kësaj doktrine është e kundërt nga mëshira hyjnore dhe nga drejtësia - aq sa është e kundërt nga logjika dhe dinjiteti njerëzor. Një mos-

besim i këtillë në këtë doktrinë në asnjë mënyrë nuk e zvogëlon besimin e muslimanëve ndaj Isait a.s.; nuk e degradon statusin e lartë të fesë islame, e madje nuk e luhat aspak besimin e muslimanit në Isain a.s., si peygamber i dalluar i Zotit. Përkundrazi, me refuzimin e kësaj doktrine muslimani e pranon Isain vetëm me vlerë dhe respekt më të lartë dhe e çmon porosinë e tij të parë si një pjesë thelbësore të fesë islame. Atëherë, le të themi edhe një herë se një person, për të qenë musliman, duhet t'i çmojë dhe t'i respektojë të gjithë peygamberët e Zotit, pa kurrfarë diskriminimi. Për statusin e përgjithshëm të Isait në fenë islame do të diskutohet në një kapitull të mëvonshëm.

11. Muslimani i vërtetë beson se njeriu duhet të punojë për shpëtimin e tij duke e udhëhequr Zoti. Kjo do të thotë se me qëllim që ta fitojë shpëtimin, një person duhet ta kombinojë besimin me aksionin dhe me praktikën. Besimi pa aksion (veprim) është i pamjaftueshëm njësoj sikur veprimi pa besim. Me fjalë të tjera, kurrkush nuk mund ta arrijë shpëtimin derisa besimi i tij në Zot nuk bëhet dinamik në jetën e tij, derisa veprat e tij të shndërrohen në realitet. Kjo është në harmoni të plotë me thëniet islame ndaj besimit. Kjo na tregon se Zoti nuk pranon nderime sa për sy e faqe, dhe se asnjë besimtar i vërtetë nuk mund të jetë indiferent për atë që u përket kërkesave praktike të besimit. Kjo po ashtu na tregon se kurrkush nuk mund të flasë në emër të tjetërkujt apo të ndërhyjë ndërmjet atij dhe Zotit. (Shih për shembull Kur'anin: 10:9-10; 18:30; 103:1-3).

12. Muslimani i vërtetë beson se Zoti nuk mban ndonjë person në përgjegjësi derisa Ai vetë nuk na e tregon rrugën e vërtetë. Ja pse Zoti ka dërguar shumë lajmëtarë dhe shpallje dhe e ka bërë të qartë se nuk do të ketë dënime para tërheqjes së vërejtjes dhe alarmimit. Sipas kësaj, një person që asnjëherë s'ka pasur rast të ballafaqohet me ndonjë shpallje hyjnore apo me ndonjë lajmëtar, apo ndonjë person që nuk është psikikisht i shëndoshë, nuk merret në përgjegjësi për mosesuksesin në realizimin e detyrave hyjnore ndaj Zotit. Personi i tillë do të përgjigjej vetëm pse nuk e bën atë që do t'ia thoshte mendja e tij në gjendje të shëndoshë. Megjithatë, ai person që qëllimisht dhe me vetëdije e shkatërron dhe nuk e respekton Ligjin e Zotit apo devijon nga rruga e Tij e drejtë, do të dënohet për veprat e tij të këqija. (Kur'ani; 4:165; 5:16 dhe 21; 17:15).

Kjo pikë është shumë e rëndësishme për çdo musliman. Ekzistojnë shumë njerëz në botë që nuk kanë dëgjuar për fenë islame dhe nuk kanë mënyrë se si ta njohin atë. Njerëzit e tillë mund të jenë të ndershëm dhe të bëhen muslimanë të mirë, po që se e gjejnë rrugën e tyre drejt fesë islame. Nëse ata këtë nuk e dinë dhe nëse nuk kanë mënyrë se si ta dinë, ata nuk do të përgjigjen për atë pse nuk janë muslimanë. Përkundrazi, muslimanët që mund t'ua prezantojnë fenë islame njerëzve të tillë, do të jenë ata që do të merren në përgjegjësi pse nuk kanë qenë të aftë t'i udhëheqin drejt fesë islame e t'ua shpjegojnë se ç'është ajo. Kjo është edhe një thirrje drejtuar të gjithë muslimanëve të rruzullit tokësor, që jo vetëm ta predikojnë fenë islame, por edhe - që është më me

rëndësi - plotësisht të jetojnë me të. (Shih Kur'anin: 3:104; 16:125).

13. Muslimani i vërtetë beson se në natyrën një-rëzore, të cilën e ka krijuar Zoti, më tepër mbretëron e mira se e keqja, dhe se provueshmëria e reformës rrënjësore është më e madhe se sa ajo e mosuksesit të pashpresë. Ky besim del nga e vërteta se Zoti i ka dhënë njeriut detyra të caktuara dhe ka dërguar lajmëtarë me zbulime për udhëheqjen e tij. Po të ishte njeriu nga vetë natyra rast i pashpresë, i paaftë për reformë e për zhvillim, si do të mundej Zoti me mençurinë e Tij absolute t'i japë atij përgjegjësi dhe detyra për aktivitete të caktuara? Si do të mundej gjithë këtë ta bëjë Zoti, po të ishte e kotë? Fakti që Zoti e mban nën përkujdesjen e Tij dhe se anon nga interesi i tij, flet se njeriu nuk është as i pandihmë e as i pashpresë, por është qenie që e çmon të mirën më tepër se sa të gjitha të tjerat. Sigurisht që me një besim të shëndoshë në Zotin dhe me një besim të fortë në njeriun mund të bëhen edhe çudi, madje edhe në kohët tona. Me qëllim që të kuptohet kjo, duhet të lexohen me kujdes disa pjesë të Kur'anit dhe të mendohet pak më tepër rreth kuptimit të tyre.

14. Muslimani i vërtetë beson se besimi nuk plotësohet vetëm nëse ndiqet qorrazi ose nëse pranohet pa pyetje; derisa besimtari nuk kënaqet plotësisht. Nëse besimi inspiron ndonjë aksion dhe nëse besimi dhe aksioni na shpiejnë drejt shpëtimit, atëherë besimi bazohet në bindje të palëkundshme pa kurrfarë mashtrimi apo detyrimi. Me fjalë të tjera, personi që e konsideron veten musliman për arsye të traditave të tij familjare, ose nëse nën ndikimin e

dikujt apo me imitim rigoroz e pranon fenë islame, ai para Zotit nuk është musliman i vërtetë. Muslimani i mirëfilltë duhet ta ndërtojë fenë e vet në baza të forta, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe përtej çdo pasigurie. Nëse ai nuk është i sigurt për besimin e tij, atë e thërret Zoti ta kërkojë librin e hapur të natyrës, t'i shfrytëzojë fuqitë e tij të të menduarit dhe të mendojë për mësimet e Kur'anit. Ai, nëse është i aftë dhe i vendosur, duhet ta kërkojë të vërtetën e pamohueshme derisa ta gjejë. (Shih për shembull Kur'anin: 2:170; 43:22-24).

Ja pse feja islame kërkon bindje të shëndosha, kurse i dënon imitimet që bëhen në mëyrë të verbër. Çdo person që në mënyrë të drejtë është i kualifikuar si mendimtar gjenial dhe i mirë çmohet nga feja islame, kështu që atij i jepet mundësia që t'i zhvillojë këto aftësi deri në shkallën më të lartë. Por, nëse një person nuk është i kualifikuar dhe është i pasigurt në vetveten, duhet të mendojë deri në atë pikë deri ku kufizohen mundësitë e tij të të menduarit. Për atë njeri do të jetë e udhës të bazohet vetëm në burimet autentike të fesë, të cilat janë të mjaftueshme për vetvete, pa i drejtuar ndonjë pyetje kritike për të cilën ai nuk është në gjendje të japë përgjigjen e duhur. Qëllimi i gjithë kësaj është ajo se askush nuk mund ta konsiderojë veten musliman të vërtetë, nëse besimi i tij nuk bazohet në bindje të thella dhe nëse truri i tij nuk është pastruar nga dyshimet. Duke e pasur parasysh atë se feja islame mund të jetë e plotë vetëm nëse bazohet në bindje të thella dhe në liri për të zgjedhur, atë askush nuk mund ta pranojë me forcë; sepse Zoti nuk dëshiron të pranojë një fe të

tillë. Ai as nuk do ta konsiderojë atë si Islam të vërtetë, nëse nuk zhvillohet nga brendia ose nuk rrjedh nga bindje të thella e të lira. Për arsye se feja islame siguron lirinë e besimit, shumë grupe jomuslimane kanë jetuar dhe ende jetojnë në shtetet muslimane duke gëzuar liri dhe vetëdije të plotë të besimit. Muslimanët e kanë këtë pikëpamje për shkak se Islami e ndalon detyrimin në fe. Ajo është drita që duhet të ndriçojë brendapërbrenda, sepse liria e zgjedhjes është guri themeltar i përgjegjësisë. Kjo nuk e largon përgjegjësinë që e kanë prindërit ndaj fëmijëve të tyre, as nuk e ndalon të qenit indiferent ndaj dispozitave shpirtërore që kanë të bëjnë me prindërit. Në të vërtetë, prindërit duhet të bëjnë ç'mos për të ndërtuar një besim të fuqishëm shpirtëror.

Ekzistojnë rrugë të ndryshme për themelimin e fesë në baza të shëndosha. Ekziston ana shpirtërore e cila kryesisht bazohet në Kur'anin dhe në Sunnetin e Muhammedit a.s. Por ekziston edhe ana racionale (rezonuese) e cila shpie nga besimi e nga Qenia Supreme. Kjo nuk do të thotë se pikëpamja shpirtërore nuk ka racionalitet, dhe anasjelltas, as nuk do të thotë se pikëpamjes racionale i mungon spiritualiteti. Që të dy pikëpamjet, në të vërtetë e plotësojnë njëra-tjetrën dhe mund të vijnë në një gjendje reciprociteti të gjallërishëm. Nëse një person është mjaft i pajisur me cilësi racionale të shëndosha, mund të kthehet ose kah pikëpamja racionale ose kah ajo shpirtërore, ose t'i marrë parasysh që të dyja; e përsëri mund të jetë i sigurt se përfundimi i tij do të jetë i drejtë. Por nëse një person nuk është i aftë për një pyetje dhe

analizë të drejtë apo është i pasigurt për fuqitë e tij të të menduarit, ai mund t'i drejtohet vetëm pikëpamjes shpirtërore dhe të jetë i kënaqur me diturinë që mund ta nxjerrë nga burimet autentike të fesë. Poenta qëndron aty se pavarësisht a e përdor dikush pikëpamjen shpirtërore apo teknikën racionale, apo që të dyja, përsëri, më në fund, do të mbërrijë te besimi në Zot. Të gjitha këto rrugë janë njësoj të rëndësishme dhe të pavarura nga feja islame - e po të shkohet sipas tyre në mënyrë të drejtë, ato shpiejnë drejt një qëllimi të njëjtë - drejt besimit në Qenien Supreme. (Shih Kur'anin: 5:16-17; 12:109; 18:30; 56:80).

15. Muslimani i vërtetë beson se Kur'ani është fjala e All-llahut që Muhammedit a.s., ia ka dërguar përmes engjëllit Xhibrilit. Zoti e ka zbritur Kur'anin pjesë pas pjesë, në raste të ndryshme për t'iu përgjigjur çështjeve të caktuara, për të zgjidhur probleme të caktuara, për të zgjidhur debate të ndryshme dhe për të qenë udhëheqësi më i mirë i njeriut drejt të vërtetës së Zotit dhe lumturisë së amshueshme. Çdo shkronjë e Kur'anit është fjalë e Zotit dhe çdo tingull i tij është jehona e vërtetë e zërit të Zotit. Kur'ani është burimi i parë dhe më autentik i fesë islame që u shpall në gjuhën e bukur arabe. Ai ekziston dhe edhe më tej do të mbetet në versionin e tij origjinal dhe të kompletuar - arab, për arsye se Zoti e krijoi që të jetë udhërrëfyesi më i mirë i njeriut. Ai njerëzit i ruan nga korrupsioni (degjenerimi). (Shih Kur'anin: 4:82; 15:9; 17:9; 41:41-44; 42:7; 53:53).

Fjala e Zotit është dëshmi se Kur'ani është shkresa e vetme në historinë njerëzore që është ruajtur në versionin e saj të plotë dhe origjinal, pa kurr-

farë ndryshimi madje edhe në shenjat e pikësimit. Historia e mbamendjes së Kur'anit, e kompletimit të kapitujve të tij, e të shkruajturit dhe të ruajturit të tekstit të tij, pa dyshim është e përkryer jo vetëm në trurin musliman, por edhe të çdo shkencëtari serioz të ndershëm. Kjo është një e vërtetë historike, të cilin nuk e ka vënë në dyshim asnjë shkencëtar që i përket cilitdo religjion (përderisa e respekton diturinë dhe integritetin e tij). Në të vërtetë, kjo është mrekullia e Muhammedit a.s., meqë edhe po të ulej i gjithë njerëzimi, nuk do të mund të shkruante asnjë kapitull, madje as të ngjashëm me atë të Kur'anit. (Shih Kur'anin: 2:22-24; 11:13-14; 17:88-89).

16. Muslimani i mirëfilltë beson në një dallim të dukshëm ndërmjet Kur'anit dhe haditheve (traditave) të Muhammedit a.s. Kur'ani është fjala e Zotit, kurse hadithet e Muhammedit janë interpretime praktike të Kur'anit. Roli i Muhammedit ishte që ta përcillte përmbajtjen e Kur'anit ashtu siç e pranonte, ta interpretonte dhe ta praktikonte në mënyrë të përpiktë. Interpretimet dhe praktikimet e tij i dhanë të ashtuquajturat Hadithe të Muhammedit a.s. Ato konsiderohen si burimi i dytë i fesë islame, dhe duhet të jenë në harmoni të plotë me burimin e parë, Kur'anin - i cili është kriter standard. Po të vërehet ndonjë kundërthënie apo mospajtim ndërmjet haditheve dhe Kur'anit, atëherë muslimani i beson vetëm Kur'anit; dhe këtë mospajtim e konsideron si çështje të hapur, sepse kurrfarë hadithi i Muhammedit a.s., nuk guxon asnjëherë t'i kundërvihet Kur'anit.

Vërejtje

Gjatë diskutimit tonë lidhur me parimet themelore të fesë islame, qëllimisht u larguam nga pikëpamja tradicionale e këtij problemi. Ato nuk i kufizuar në pesë apo gjashtë njësi. Përkundrazi, u përpoqëm që të theksojmë sa më shumë parime. Megjithatë, këtu duhet të përmendim se parimet e theksuara të besimit, që më parë janë të bazuara dhe të marra nga mësimet e Kur'anit dhe mësimet e haditheve të Muhammedit a.s. Ndoshta me këtë rast do të mund të citoheshin edhe më tepër pjesë të Kur'anit apo të haditheve të Muhammedit a.s., për ta sqaruar këtë problematikë, por megjithatë këtë nuk e bëmë për shkak të vendit të kufizuar. Megjithëkëtë, Kur'ani dhe Sunneti (përmbledhja e haditheve) i Muhammedit, janë lëndë për studim më të thellë e më të hollësishëm.

Po ashtu u përpoqëm që t'i shmangemi terminologjisë perëndimore si p.sh., predeterminizëm, fatalizëm, vullnet i lirë, etj. Këtë e bëmë me qëllim të ikjes nga konfuzioni dhe përdorimi i tepërt i termave teknike. Shumica e termave teknike që përdoren për religjionin në mesin e popullatës joarabe, kur aplikohen lidhur me fenë islame, shpiejnë në rrugë të gabuar dhe lënë përshtypje të gabuara. Arritja e qëllimit të kësaj vepre do të ishte e pamundur me përdorimin e termave të huaja religjioze (dhe me adaptimin dhe zbatimin e tyre në fenë islame). Po të duhej këtu të përdorim terminologji të huazuar, do të duhej të shtonim kualifikime dhe komente të shumta për ta sqaruar natyrën e fesë islame. Kjo po ashtu do të

kërkonte shumë më tepër vend dhe kohë, që nuk do të mund t'i kënaqim në këto rrethana. Sipas kësaj, u përpoqëm që të gjitha gjërat t'i sqarojmë në gjuhën e zakonshme e të thjeshtë, e në këtë mënyrë do ta vazhdojmë shpjegimin deri në fund të librit.

Kapitulli II KONCEPTET THEMELORE TË FESË ISLAME

- ❖ *Koncepti i besimit (Imanit)*
- ❖ *Koncepti i mirësisë (el-Bir-ru)*
- ❖ *Koncepti i devotshmërisë (et-Takva)*
- ❖ *Koncepti i pejgamberisë*
- ❖ *Koncepti i jetës*
- ❖ *Koncepti i religjionit*
- ❖ *Koncepti i mëkatit*
- ❖ *Koncepti i lirisë*
- ❖ *Koncepti i barazisë*
- ❖ *Koncepti i vëllazërisë*
- ❖ *Koncepti i paqes*
- ❖ *Koncepti i bashkësisë*
- ❖ *Koncepti i moralit*
- ❖ *Koncepti i universit (kozmosit)*

Koncepti i besimit (Imanit)

Disa njerëz mendojnë se njeriu bëhet musliman nëse shpreh besim në Njëshmërinë e Zotit të Vërtetë dhe në Muhammedin si Pejgamber i fundit i Tij. Mirëpo, kjo është larg nga kuptimi i vërtetë i besimit. Kuptimi i vërtetë i besimit në fenë islame, në asnjë mënyrë nuk është diç nominale apo vetëm një formalitet i thjeshtë. Besimi në fenë islame është ndjenjë e fatit dhe gëzimit, e fituar me anë të virtytit si një aksion pozitiv, me anë të koncepcioneve konstruktive, si edhe me masa dinamike dhe efektive.

Kur'ani Famëlart dhe Sunneti i Muhammedit a.s., në mënyrë të qartë i definojnë masat e duhura dhe i përcaktojnë standardet që ndërtojnë një besim kuptimplotë. Sipas kësaj, besimtarë të vërtetë janë:

1. Ata të cilët besojnë në Zot, në engjëjt e Tij, në librat e Tij të kompletuara nga Kur'ani, në Të Dërguarit (Pejgamberët) e Tij, prej të cilëve Muhammedi a.s., është Pejgamberi i fundit, që besojnë në Ditën e Gjykimit, në diturinë absolute dhe në mençurinë e Zotit.

2. Ata që gjithmonë i besojnë Zotit dhe kanë një besim të paluhatshëm në Të.

3. Ata që e shfrytëzojnë atë që ua ka dhënë Zoti ashtu siç thotë Ai, qoftë kjo pasuri, jetë, shëndet, dituri, përvojë etj.

4. Ata që rregullisht i kryejnë ibadetet dhe namazet e tyre si dhe obligimet e tyre vjetore.

5. Ata që ua paguajnë obligimet e tyre fetare (zeqatin) benifikuesve të tyre të drejtë (individëve apo institucioneve), minimumi i të cilave është 2.5 për qind nga të ardhurat vjetore, ose vlera e përgjithshme e mallit në punët afariste, duke mos i marrë parasysh harxhimet apo kreditë.

6. Ata që kënaqen me të mirën e me të drejtën, e që luftojnë kundër rrugës së gabuar e së keqes me të gjitha mjetet e tyre të ligjshme që i kanë në dispozitim.

7. Ata që i përuhlen All-llahut dhe Të Dërguarit të Tij, Muhammedit, që ndiejnë një fuqi të besimit që sa shkon e bëhet më e madhe kur lexohet Kur'ani; dhe një përritësi të zemrës me të përmendurit e emrit të All-llahut xh.sh.

8. Ata që e duan më tepër Zotin dhe Pejgamberin e Tij; e që i duan bashkëbesimtarët e tyre vetëm për hir të All-llahut.

9. Ata që i duan fqinjët e tyre të afërt e të largët dhe tregojnë përzemërsi të duhur ndaj musafirëve të tyre, e sidomos ndaj të huajve.

10. Ata që e thonë të vërtetën dhe flasin fjalë të mira apo heshtin.

Nga kjo shihet qartë se vetë kuptimi i besimit e bën fenë islame që të hyjë thellë dhe konstruktivisht në çdo pore dhe aspekt jetësor. Sipas fesë islame, besimi i vërtetë ka një efekt tejet të vendosur e të rëndësishëm në gjithë jetën shpirtërore dhe materiale të njeriut, në sjelljen e tij personale dhe sociale, si dhe në pikëpamjet politike e në jetën financiare të tij. Që të tregojmë se si i përshkruan Kur'ani besimtarët e vërtetë, do të japim disa shembuj. Kur'ani

përmban ajete të shumta që kanë të bëjnë me këtë temë, siç janë p.sh. këto:

“E besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, të cilëve kur u përmendet All-llahu u rrëqethen zemrat e tyre, të cilëve kur u lexohen ajetet e Tij u shtohet besimi dhe që janë të mbështetur vetëm te Zoti i tyre. Të cilët falin (rregullisht) namazin dhe nga ajo me çka Ne i furnizuar, ata japin. Të tillët janë besimtarë të vërtetë dhe për këtë kanë vende të larta te Zoti i tyre, kanë falje dhe kanë furnizim në mënyrë të ndershme.” (Kur’ani, 8:2-4).

“Besimtarët dhe besimtare të dashur për njëri-tjetrin, urdhërojnë për të mirë dhe ndalojnë nga e keqja, e falin namazin dhe japin zeqatin, e respektojnë All-llahun dhe Të Dërguarin e Tij. Të tillët do t’i mëshirojë All-llahu. All-llahu është ngadhënjës, i urtë. Besimtarëve dhe besimtareve All-llahu u premtoi xhennete nën të cilët rrjedhin lumë, në to do të jenë përgjithmonë, dhe (u premtoi) vendbanime të bukura në xhennetin e Adnit, edhe një disponim nga All-llahu që është mbi të gjitha. Ky, pra është ai shpëtimi i madh.” (Kur’ani, 9:71-72).

“Besimtarë janë vetëm ata që i besuan All-llahut, Të Dërguarit të Tij, e mandej nuk dyshuan dhe për hir të All-llahut luftuan me pasurinë dhe me jetën e tyre. Të tillë janë ata të vërtetit.” (Kur’ani, 49:15).

Përveç këtyre ajeteve kur’anore, lidhur me këtë ekzistojnë edhe shumë hadithe të Muhammedit a.s. Për shembull, ai ka thënë:

“Nuk do të jetë besimtar (mu'min) askush nga ju, përderisa nuk i dëshiron vëllait të tij atë çka ia dëshiron vetes.”

Tri vlera janë shenjë e besimit të shëndoshë dhe ai që me të vërtetë i posedon ato, mund ta ndiejë shijen e ëmbël të besimit. Ato janë:

1. Ta adhurojë Zotin dhe Të Dërguarin e Tij më tepër se çdo gjë tjetër;
2. T'i dojë bashkëbesimtarët e vet vetëm për hir të Zotit; dhe
3. T'i kundërvihet kthimit në mosbesim, ashtu siç do të ishte larguar po ta hidhte dikush në zjarr.

“Për atë që beson në Zotin dhe në Ditën e Gjykimit është e ndaluar ta dëmtojë fqinun e tij; ai duhet të jetë i përzemërt me musafirët e tij - posaçërisht me të huajt, dhe duhet ta thotë të vërtetën ose të mos flasë aspak”.

Ekzistojnë edhe shumë ajete dhe hadithe siç janë ato që i cituam më lart, por megjithatë duhet të mbajmë mend se citatet e dhëna nuk mund të jenë fjalët e sakta të Kur'anit dhe të Muhammedit, ashtu siç janë në tekstin origjinal arab. Për këtë, arsyeja është e thjeshtë. Asnjë përkthyes, pavarësisht se sa i mësuar dhe i aftë të jetë, nuk mund ta shprehë në asnjë gjuhë fuqinë shpirtërore dhe shijen madhështore të Kur'anit. Zoti e bëri Kur'anin të paimitueshëm, ai e kapërcen imagjinatën njerëzore dhe fuqinë e tij për të krijuar diç të ngjashme. Ajo që është e vërtetë për Kur'anin, deri në njëfarë mase është po ashtu e vërtetë edhe për Sunnetin e Muhammedit a.s., për arsye se pas shkrimit të Kur'anit, fjalët e tij kanë një elokuencë të përsosur.

Koncepti i mirësisë (el-Bir-ru)

Feja islame gjithmonë është kundër koncepteve dhe ritualeve sipërfaqësore, kundër formaliteteve që nuk kanë jetë të qëndrueshme dhe kundër besimeve të paefektshme. Në një varg reprezentativ, Zoti e shpjegon kuptimin e plotë të mirësisë në këtë mënyrë:

“Nuk është tërë e mira (e kufizuar) t’i ktheni fytyrat tuaja kah Lindja ose Perëndimi, por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson All-llahut, Ditës së Gjykimit, engjëjve, librit që e zbriti All-llahu, pejgamberëve dhe pasurinë që e do, ua jep të afërmeve, jetimave, të varfërve, udhëtarëve, lypsarëve dhe për lirim të robërve, dhe ai që e fal namazin, e jep zeqatin, dhe ata që kur premtojnë e zbatojnë, dhe të durueshmit në skamje, në sëmundje dhe në flakën e luftës. Të tillët janë ata të sinqertit dhe të tillët janë ata të devotshmit.” (Kur’ani, 2:177).

Ky ajet i Kur’anit përmban një përshkrim të bukur e të pastër të njeriut të mirë. Ai duhet t’u përmbahet të gjitha rregullave të përshëndetjes, ndërkaq motivi i tij i sinqertë të jetë motiv i dashurisë ndaj Zotit dhe motiv i dashurisë ndaj bashkëbesimtarëve të tij, për hir të Zotit. Këtu kemi katër elemente:

1. Besimi ynë duhet të jetë i sinqertë dhe i vërtetë;
2. Duhet të jemi të përgatitur që ndaj bashkëbesimtarëve tanë, në vepër të tregojmë përzemërsi e shpirtmirësi;
3. Duhet të jemi qytetarë të mirë e t’i përkrahim institucionet që ofrojnë ndihmë si dhe organizatat sociale;

4. Duhet të jemi të vendosur e të paluhatshëm në çfarëdo rrethanash.

Sipas kësaj, është e qartë se mirësia nuk shihet vetëm në fjalë e premtime të kota. Ajo duhet të jetë e bazuar në një besim të fortë dhe në një praktikë të përhershme. Ajo duhet ta përfshijë mendimin dhe veprimin e njeriut dhe të zgjerohet në jetën e tij të brendshme e të jashtme, në punët e tij individuale e të përgjithshme. Nëse parimi islam i mirësisë kuptohet në mënyrë të drejtë, atëherë ai parim e siguron individin, pa marrë parasysh rrethanat me paqe, shoqërinë me siguri në të gjitha nivelet, kombin me solidaritet, e bashkësinë ndërkombëtare me shpresë dhe harmoni. Sa i qetë e i gëzueshëm mund të jetë njeriu që e posedon konceptin islam të mirësisë! Ç'mund të jetë më bindëse se besimi në një Krijues të mëshirshëm dhe investimi në qëllime aq të vlefshme? Ç'mund të jetë më njerëzore se lehtësimi i vështirësive të të nënshtruarve, zvogëlimi i mundimit të të eksploatuarve dhe përgjigjja ndaj nevojave të njerëzve nevojtarë? Ç'është më metodike dhe më e sinqertë se plotësimi i detyrave, ruajtja e ndërgjegjes së pastër dhe mbajtja e integritetit? Dhe më në fund, cila mund të jetë kënaqësia më e madhe shpirtërore se kryerja me rregull e të gjitha këtyre dhe, ashtu siç pritet, e gjithë kjo për hir të Zotit?

Koncepti i devotshmërisë (et-Takva)

Ajo që u tha për besimin dhe mirësinë, është në përgjithësi e vërtetë edhe për devotshmërinë. Përsëri ky koncept nuk është rezultat i ndonjë marrëveshjeje apo thënieje të posaçme, por është diç shumë më serioze se kjo. Si gjithmonë, Kur'ani është burimi ynë më i mirë, dhe kur flet për të devotshmit, i përshkruan ata si: *“Të cilët e besojnë të fshehtë, e kryejnë faljen (namazin) dhe prej asaj që Ne u kemi dhënë ata japin (zeqatë, sadaka, etj.). Dhe ata, të cilët besojnë në atë që t’u shpall ty, dhe në atë që është shpallur para teje dhe që janë të bindur plotësisht për (jetën e ardhshme në) botën tjetër (ahiretin). Të tillët janë të udhëzuar nga Zoti i tyre dhe vetëm ata janë të shpëtuarit.”* (Kur’ani, 2:3-5). Të devotshmit janë ata: *“Të cilët japin kur janë shlrirë edhe kur janë në vështirësi dhe që e frenojnë mllëfin, që u falin (të keqen) njerëzve, e All-llahu i do bami-rësit. Edhe ata të cilët kur bëjnë ndonjë (mëkat) të shëmtuar ose i bëjnë zullum vetes së tyre, e përmen-din All-llahun dhe kërkojnë falje për mëkatet e tyre - e kush i falë mëkatet përveç All-llahut? - dhe që duke e ditur, nuk vazhdojnë në atë që kanë punuar (në të keqen). Shpërblimi i të tillëve është falja nga Zoti i tyre dhe xhennetet nëpër të cilët rrjedhin lumenj e aty do të mbeten përgjithmonë. Sa i mirë është shpërblimi i atyre që punojnë.”* (Kur’ani, 3:134-136).

Me këto ajete kuptojmë se devotshmëria kërkon një përdorim të drejtë të mendjes - e kjo ngërthen në

vete edhe të kuptuarit e të vërtetës së Zotit dhe të jetës; një përdorim të drejtë të pasurisë duke e shpenzuar atë në rrugë të Zotit në të gjitha rrethanat; si dhe një përdorim të drejtë të aftësive shpirtërore dhe fizike të njeriut me anë të kryerjes së faljes (namazit). Kjo po ashtu kërkon një shkallë të lartë të vetëkontrollit ndaj hidhërimit dhe ndaj emocioneve të njeriut, një kapacitet moral për falje dhe durim dhe një thirrje të vetëdijshme për ta detyruar mëkatarin t'i rikthehet Zotit me keqardhje dhe pendim. Të jeshë i devotshëm, d.m.th., të jeshë njeri i bindjeve të thella e të vërteta, të jeshë njeri i vendosur e me karakter të fortë, me vullnet e kurajo të fortë, dhe mbi të gjitha, të jeshë njeri i Zotit. Devotshmëria, mirësia dhe feja kuptimplote varen nga njëra-tjetra dhe rrjedhin nëpër të njëjtin kanal. Ato na udhëheqin kah feja islame dhe e ndërtojnë muslimanin e vërtetë.

Koncepti i peygamberisë

Zoti i dashur dhe i plotfuqishëm na dërgoi shumë peygamberë në periudha të ndryshme kohore. Çdo popull i njohur ka pasur një ose më tepër peygamberë. Të gjithë peygamberët e Zotit ishin njerëz me karakter të fortë e me nder të lartë. Ata i përgatiti dhe i zgjodhi Zoti xh.sh. për t'ia dërguar njerëzimit porosinë e Tij. Nderi, vërtetësia, intelekti dhe integriteti i tyre janë jashtë çdo dyshimi. Ata qenë të pagabueshëm për arsye se nuk bënë asnjë mëkat apo nuk e thyen Ligjin e Zotit. Por, si të gjithë njerëzit që

i nënshtrohen vdekjes, ndoshta edhe kanë bërë gabime të paqëllimta në disa punë dhe vendime njerëzore. Gjykimet e tyre private nuk kanë qenë domosdo çdoherë edhe të sakta.

Dërgimi i këtyre pejgamberëve nga ana e Zotit është një manifestim i qartë i lidhjes së fortë ndërmjet Parajsës (Qiellit) dhe Tokës, dhe ndërmjet Zotit e njeriut. Kjo don të thotë se njeriu mund të bëjë reforma dhe se e gjithë e mira gjendet tek ai. Qëllimi i pejgamberisë është ta përdëftojë atë që njeriu e di apo mund ta dijë, dhe ta mësojë për atë që ai nuk e di apo që nuk ka mundësi ta dijë me mjetet e tij. Po ashtu ajo i mundëson njeriut që ta gjejë rrugën e drejtë të Zotit, për të bërë të mira e për ta përbuzur të keqen. Pejgamberia është një shprehje elokuate e dashurisë së Zotit për krijesat e Tij dhe për dëshirën e Tij që t'i udhëheqë ato drejt rrugës së drejtë të të besuarit dhe sjelljes së pëlqyer. Ajo e vë theksin në drejtësinë e Tij ndaj njeriut, sepse Ai së pari njeriut ia tregon mënyrën e një udhëheqjeje të vërtetë, e mandej e merr në përgjegjësi për veprat e tij. Ai e paralajmëron njeriun me anë të pejgamberëve të Tij, dhe nëse njeriu nuk arrin t'i vërejë rreziqet e veprave të këqija, sjellja e tij duhet të dënohet. Kjo plotësisht përputhet me dashurinë dhe drejtësinë e Zotit, e po ashtu edhe me vlerën dhe aftësinë e njeriut për të qenë përgjegjës ndaj Zotit.

Burimi i pejgamberisë dhe mbrojtësi i të gjithë pejgamberëve është Ai që gjithmonë është i Njëjti: ai është Zoti. Qëllimi i tyre është t'i shërbejnë Zotit, ta njoftojnë njeriun me Zotin dhe me mësimet e Tij hyjnore, të luftojnë për të vërtetën dhe të mirën, t'i

ndihmojnë njeriut ta kuptojë qëllimin e vërtetë të ekzistencës së tij dhe t'i ndihmojnë që ta jetojë jetën në një mënyrë kuptimplote. Në bazë të kësaj, muslimanët nuk bëjnë kurrfarë dallimi ndërmjet pejgamberëve, por i pranojnë mësimet e tyre si të qëndrueshme dhe komplementare (plotësuese të njëra-tjetrës). Po ashtu, ky është shkaku pse muslimanët besojnë në të gjithë librat e shenjtë dhe i pranojnë të gjithë pejgamberët e Zotit, siç edhe theksuam më lart.

Koncepti i jetës⁴

Jeta është një demonstrim brilant i mençurisë dhe i diturisë së Zotit, një reflektim i dukshëm i artit dhe fuqisë së Tij. Ai është dhënësi dhe krijuesi i jetës. Asgjë nuk ekziston rastësisht dhe kurrkush nuk e krijoi vetveten. Jeta është vlerë e shtrenjtë dhe e çmueshme dhe askush nuk do të pranonte ta humbte këtë vlerë me dëshirën e vet. Madje edhe ata që ndihen tepër të deprimuar dhe ia marrin vetes jetën me anë të vetëvrasjes, përpiqen që në çastin e fundit ta rikthejnë ekzistencën, duke dëshiruar të kenë rast të dytë për të jetuar. Zoti ia ka dhënë jetën njeriut dhe Ai është i Vetmi që në mënyrë të drejtë mund t'ia marrë; askush tjetër s'ka të drejtë t'ia shkatërrojë jetën. Ja pse feja islame i ndalon të gjitha llojet e vetëvrasjes e të vetëshkatërrimit dhe rekomandon durim dhe besim të mirë kur vdes një shpirt i dashur.

⁴ Lidhur me këtë koncept, shih më poshtë Konceptin e Gjithësisë.

Kur mbi vrasësin ekzekutohet dënimi, jeta i merret në bazë të së Drejtës dhe Ligjit të Zotit.

Kur Zoti ia jep jetën njeriut, Ai e pajisë atë me cilësi unike e aftësi të mëdha; e kjo nuk bëhet kot së koti. Nuk është e vërtetë se Zoti i jep njeriut obligime të caktuara. Ai mendon t'i ndihmojë njeriut për ta plotësuar qëllimin e jetës dhe për ta realizuar qëllimin e ekzistencës së tij. Po ashtu mendon t'i ndihmojë njeriut që ta mësojë artin cilësor dhe të kënaqet me shijen e mirë të jetës, që është në pajtim me udhëheqjen hyjnore. Jeta është një besim (amanet) nga Zoti, e njeriu është i besuari i Tij, i cili amanetin duhet ta trajtojë me nder e mjeshtri, me përkujdesjen e Zotit dhe me vetëdijen e përgjegjësisë ndaj Tij.

Jeta mund të krahasohet me një udhëtim që fillon në një pikë të caktuar, e që mbaron me një cak të caktuar. Ajo është një fazë kalimtare, një hyrje në jetën e amshueshme në parajsë. Në këtë rrugë njeriu është udhëtar dhe duhet t'i interesojë vetëm ajo për të cilën ka nevojë, që ta përdorë në jetën e ardhme. Me fjalë të tjera, ai duhet ta bëjë të gjithë të mirën që mund ta bëjë, e të jetë plotësisht i përgatitur për ta kaluar çdo çast në amshueshmëri. Jetën në tokë duhet ta konsiderojë si një mundësi të gjetur e të gatshme, për të dhënë sa më tepër derisa mundet; sepse kur vjen koha që ai të shkojë, shkuarja e tij nuk mund të vonohet as për një sekondë. Nëse nuk do të mund ta arrijë qëllimin, do të jetë tepër vonë për të bërë diç më tepër. Sipas kësaj, mënyra më e mirë e jetës është të jetohet sipas mësimëve të Zotit dhe të përgatitet një kalim pa pengesa në jetën e

ardhme të amshueshme. Pasi që jeta është një mjet i rëndësishëm për ta arritur qëllimin përfundimtar, feja islame na ka përpiluar një sistem të rregullativave dhe privilegjeve me të cilat i tregon njeriut se si të jetohej, çka të merret e çka të mos merret, çka të bëhet e çka të mos bëhet, etj. Të gjithë njerëzit vijnë nga Zoti dhe nuk ka dyshim se përsëri të gjithë duhet t'i kthehen Atij. Në njërin nga thëniet e tij më të rëndësishme, peygamberi Muhammed me të drejtë e këshillon njeriun ta konsiderojë veten si të huaj në këtë jetë, apo si një udhëtar që shëtiti nëpër botë.

Koncepti i religjionit

Gjatë gjithë historisë njerëzore religjioni është abuzuar, ndaj rëndësia e tij shpeshherë edhe është keqkuptuar. Disa njerëz atë e përdorin si mjet eksploatimi dhe për ushtrim të presionit, si pretekst për paragjykime dhe persekutime të ndryshme. Disa njerëz të tjerë atë e përdorin si mjet për demonstrimin e fuqisë dhe për dominim mbi elitën dhe masat e gjera popullore. Në emër të religjionit janë zhvilluar shumë luftëra të pakuptimta, është penguar liria e të menduarit të lirë dhe e vetëdijes; shkenca është persekutuar, është mohuar e drejta e individit për ngritje të tij individuale dhe profesionale, ndërsa nderi dhe dinjiteti i tij janë nëpërkëmbur në mënyrë flagrante. Në emër të religjionit u bënë padrejtësi të mëdha, me ç'rast edhe vetë religjioni përjetoj vështirësi dhe krajata të shumta.

Këto janë të vërteta historike të cilat askush nuk mund t'i mohojë. Por, a është ky funksioni i vërtetë i religjionit dhe a është kjo mënyra e drejtë e mësimit të tij? A mund të jetë ky qëllimi i religjionit? Përgjigjja që medoemos do të pasojë është një "Jo" bindshëm e theksuar. Në botë ekzistojnë religjione të shumta dhe çdonjëri prej tyre predikon se është i vetmi dhe i vërteti. Për çdo religjion supozohet se ka ardhur prej Zotit, për udhëheqjen e drejtë të njeriut. Megjithatë, të gjitha këto supozime bien ndesh me njëri-tjetrin, kështu që kanë shkaktuar mospajtime dhe reagime të ashpra midis njerëzve - në vend të udhëheqjes së njerëzimit drejt një vëllazërie universale nën një Zot të vetëm dhe bamirës. Kjo shkakton huti të çdo vërejtës neutral dhe ndoshta ndikon që ai të largohet nga çfarëdo qoftë religjioni.

Koncepti islam i religjionit është unik në kuptimin më të gjerë të fjalës. Është e vërtetë se religjioni burimor duhet të vijë nga Zoti për udhëheqjen e drejtë të njeriut. Po ashtu është e vërtetë se natyra dhe nevojat më të mëdha njerëzore kryesisht janë të njëjta në të gjitha kohët. Ky koncept na shpie vetëm në një përfundim të mundshëm: ekziston vetëm një religjion i vërtetë që vjen nga i Vetmi dhe i Njëjti Zot, i cili merret me problemet më të mëdha të njeriut në të gjitha kohët. Ky religjion është ISLAMI. Por, duhet të mos harrojmë se fenë islame nuk e solli vetëm pejgamberi Muhammed. Përkundrazi, mësimet e fesë islame i predikuan edhe pejgamberët para Muhammedit dhe të gjithë ithtarët e vërtetë të Ibrahimit dhe Musaut, si dhe ata të Isaut - u quajtën MUSLIMANË. Sipas kësaj, feja islame

ka qenë dhe do të vazhdojë të jetë religjioni i vërtetë universal i Zotit, për arsye se Zoti është Një dhe i Pandryshueshëm, dhe për arsye se natyra njerëzore dhe nevojat më të mëdha të vetë njeriut, pavarësisht nga koha, vendi, mosha apo edhe nga ndonjë kriter tjetër, në themel janë të njëjta.

Duke e pasur këtë parasysh, koncepti islam thotë se religjioni nuk është vetëm një nevojë intelektuale dhe shpirtërore, por edhe një nevojë sociale e universale. Ai nuk u krijua që ta tjetërsojë njeriun, por që ta udhëheqë atë. Jo për ta ulur atë, por për ta ngritur natyrën e tij morale. As për ta larguar atë nga diçka e nevojshme, e as për ta ngarkuar apo për t'i shtypur vlerat e tij, por për t'ia hapur thesarin e pasurive të pashterura të një mendimi të shëndoshë dhe të një aksioni të drejtë. Religjioni nuk e përkufizon njeriun në limite të ngushta, por ia zgjeron horizontet e së mirës dhe të së vërtetës. Me një fjalë, religjioni i vërtetë e njofton njeriun me Zotin, me vetveten dhe me Gjithësinë. Kjo, në realitet, nuk paraqet një thjeshtësim të tepërt të funksionit të religjionit. Tani do të shohim se ç' do të thotë kjo.

Po ta hulumtojmë me kujdes të plotë qëllimin e religjionit të vërtetë, do të shohim se religjioni i kënaq nevojat shpirtërore dhe nevojat mesatare materiale të njeriut. Ai i bashkon lidhjet dhe kompleksitetet e tij psikologjike, i zhvillon instinktët dhe aspiratat e tij dhe ka një disiplinë të fortë në dëshirat dhe në mbarë vijimin e jetës së tij. Religjioni i zgjeron njohuritë e tij për Zotin - për të vërtetën më të lartë në Gjithësi dhe të vërtetën për vetveten. Ai ia mëson njeriut sekretet e jetës, natyrën e njeriut - e

mëson se si të sillet me ato, ta dallojë të mirën nga e keqja, e pastron mendjen nga dyshimet, e forcon karakterin e njeriut dhe i korigjon mendimet dhe bindjet e tij. E gjithë kjo mund të arrihet vetëm nëse njeriu në mënyrë besimplote i kryen të gjitha detyrat shpirtërore dhe rregullativat fizike me të cilat na njofton religjioni.

Nga ana tjetër, religjioni i vërtetë e edukon njeriun dhe e mëson të ketë shpresë e durim në vërtetësi e ndershmëri, në dashurinë për të drejtën e të mirën, në kurajo e përballim - e të gjitha këto janë të nevojshme për ta mësuar mirë artin madhështor të jetuarit. Përveç kësaj, religjioni i vërtetë e siguron njeriun kundër frikës dhe humbjeve shpirtërore, duke e siguruar atë po ashtu, me ndihmën e Zotit, në një aleancë të pathyeshme. Religjioni e furnizon njeriun me paqe e siguri dhe me këtë e bën jetën e tij kuptimplote.

Ja se çka mund të bëjë religjioni i vërtetë për njerëzimin; e ky është koncepti i religjionit në fenë islame. Çdo religjion që nuk arrin t'i mbajë e t'i kultivojë këto fryte nuk është Islam, ose thënë më mirë, nuk është aspak religjion; dhe çdo njeri që nuk përfiton nga të mirat e religjionit, nuk është religjioz, apo nuk është i udhëhequr nga Zoti. Zoti është absolutisht i vërtetë e i drejtë kur thotë në Kur'anin e Shenjtë:

“Feja e pranueshme te All-llahu është Islami, e atyre që u është dhënë libri, pasi mësuan për të vërtetën, vetëm nga zilia mes vete kundërshtuan. E kush mohon argumentet e All-llahut, le ta dijë se All-llahu shpejtë do t'i japë llogarinë.” (Kur'ani, 3:19).

“E kush kërkon fe tjetër përveç fesë islame, atij kurrsesi nuk i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshpëruarit.” (Kur’ani, 3:85).

Koncepti i mëkatit

Një ndër fushat më të ndërlikuara të ekzistencës njerëzore është problemi i mëkatit apo i së keqes në botë. Në përgjithësi besohet se mëkati ka filluar me Ademin dhe Havën gjatë jetës së tyre në Kopshtin e Adnit. Kjo ngjarje çoi në disfatë dhe prej atëherë raca njerëzore është njollosur me faj, hutim dhe dinakëri.

Feja islame ka një qëndrim unik lidhur me këtë problem, që nuk njihet në asnjë religjion tjetër. Kur’ani thotë: *“... ‘O Adem, ti dhe bashkëshortja yte banoni në xhennet dhe hani lirisht nga frutat e tij kah të doni, por mos iu afroni asaj bime (peme) e të bëheni zullumqarë (të vetvetes suaj).’ Po djalli i bëri që ata të dy të mashtrohen në atë (pemë ose xhennetin) dhe i nxori ata nga ajo (e mirë) që ishin në të, e Ne u thamë: ‘Zbritni (dilni), jeni armiq të njëri-tjetrit, e ju deri në një kohë në tokë keni vendbanim dhe dëfrim.’ E Ademi prej Zotit të vet pranoi disa fjalë (lutje) prandaj Ai ia fali (gabimin). Ai është mëshirues dhe pranues i pendimit. Ne u thamë: ‘Dilni nga ky vend që të gjithë, e juve gjithqysh do t’ju arrijë udhëzimi prej Meje, e kush e pranon udhëzimin Tim, për ata nuk ka as frikë as që do të brengosen’.” (Kur’ani, 2:35-38 dhe 7:19-25; 20:117-123).*

Kjo ngjarje simbolike zbulon shumë gjëra me rëndësi të madhe. Na tregon se qenia njerëzore nuk është e përsosur dhe çdoherë kërkon të ketë më tepër, edhe pse veçmë jeton në parajsë. Por, bërja e një mëkati apo gabimi, ashtu siç bënë Ademi dhe Hava, gjithmonë nuk e vret zemrën njerëzore, nuk e pengon reformën shpirtërore, e as s'e ndalë zhvillimin moral. Përkundrazi, qenia njerëzore ka mjaft sensibilitet (vetëdije ndijimore) për t'i njohur mëkatet dhe të metat e veta. Ajo që është me rëndësi është vetë njeriu, që është në gjendje të dijë nga të kthehet e kujt t'i drejtohet për udhëheqje. Fakti më i rëndësishëm është se Zoti është çdoherë i përgatitur t'u përgjigjet thirrjeve të sinqerta të atyre që e kërkojnë ndihmën e Tij. Ai është aq bamirës dhe i mëshirshëm, se falja e Tij është e gjithmbarshme dhe mëshira e Tij gjithëpërfshirëse. Një zbulim i fundit gjatë leximit të kësaj ngjarjeje është se diskriminimi në bazë të gjinisë dhe faji apo mëkati i trashëguar, janë të huaja për frymën e fesë islame.

Ideja e Mëkatit të Parë apo kriminalitetit të trashëguar është po ashtu e huaj për mësimet e fesë islame. Njeriu, sipas Kur'anit (30:30) dhe sipas Pejgamberit, është i lindur në gjendje të pastër natyrore apo sipas gjuhës kur'anore, *fitre*, e ajo është Islami apo nënshtrimi ndaj vullnetit dhe Ligjit të Zotit. Ajo që ndodh me njeriun pas lindjes është rezultat i ndikimit të jashtëm dhe i faktorëve detyrues. Shqip-tuar me terma moderne, natyra njerëzore është e farkëtueshme; në realitet, me rëndësi vendimtare është procesi i socializimit, e sidomos rrethanat e jetës në shtëpi. Ky proces luan një rol vendimtar në formi-

min e personalitetit njerëzor dhe në zhvillimin e karakterit moral. Kjo nuk ia mohon individit lirinë e zgjedhjes, e aq më pak nuk e liron nga përgjegjësia. Në të vërtetë, kjo paraqet një lirim nga pesha e rëndë e kriminalitetit të trashëguar apo nga mëkati instinktor.

Zoti, sipas definicionit, është i drejtë, i mëshirueshëm, bamirës dhe i përsosur. Ai e ka krijuar njeriun duke fryrë në të nga Shpirti i Vet (Kur'ani, 15:29; 32:9; 66:12). Pasi Zoti është mirësi absolute e pafundshme dhe Shpirti i Tij absolut dhe i përsosur; pasi njeriu nëpërmjet krijimit pranoi një pjesë të Shpirtit të Zotit, del se njeriu duhej apo duhet të ketë në vete së paku një pjesë të vogël të Shpirtit të mirë të Krijuesit. Kjo është në favor të dispozitave të mira të njeriut dhe të përmbajtjeve të tij shpirtërore. Megjithatë, në anën tjetër, Zoti e krijoi njeriun ta nderojë e ta adhurojë Atë, jo të jetë i barabartë me Të, rival i Tij, inkarnim i përsosur apo mishërim (personifikim) absolut i mirësisë së Tij. Kjo don të thotë se pavarësisht nga ajo se sa i mirë dhe sa i përsosur është njeriu, duke i falënderuar mëshirës së krijimit, ai përsëri është shumë larg nga mirësia dhe përsosuria e Krijuesit. Është e sigurt se edhe njeriu ka cilësi të këtilla, por ato cilësi janë të kufizuara dhe të varura me natyrën e mbyllur njerëzore, me kapacitetin dhe përgjegjësinë e tij. Kjo mund ta shpjegojë jopërsosurinë dhe gabueshmërinë e njeriut.

Megjithatë, jopërsosuria dhe gabueshmëria nuk janë ekuivalente të mëkatit apo të kriminalitetit - së paku jo në fenë islame. Nëse njeriu nuk është i

përsosur, kjo nuk do të thotë se Zoti e lë si të pandihmë, që të bëhet viktimë e të metave të tij. Ai fuqizohet me shpalljet që bazohen në të menduarit e shëndoshë, fortifikohet me lirinë e zgjedhjes, e që udhëhiqen nga dispozita të ndryshme sociale dhe psikologjike, me qëllim që të arrihet përsosuria relative. Gravitimi konstant ndërmjet forcave të së mirës dhe së keqes në të vërtetë është vetë lufta e jetës. Ajo i jep njeriut shpresë, ideale për të kërkuar, punë për të vepruar dhe role për t'i luajtur në jetë. Ajo e bën jetën e njeriut interesante dhe kuptimplote, e kurrësi monotone apo stagnuese. Në anën tjetër, Zoti kënaqet kur i sheh robërit e Tij në gjendje të një fitoreje shpirtërore dhe morale.

Sipas ligjeve morale të fesë islame, nuk është mëkat që njeriu nuk është i përsosur apo që është i gabueshëm. Kjo pjesë e natyrës së tij e përcakton atë si krijesë të mbyllur e të kufizuar. Megjithatë, është mëkat nëse ai ka mënyra dhe mjete për përsosuri relative, e nuk përpiqet që atë ta kërkojë. Mëkati është një akt, mendim apo dëshirë që: (1) është qëllimplotë, (2) e refuzon Ligjin e paluhatshëm të Zotit, (3) i shkel të drejtat e Zotit apo të njeriut, (4) i bën dëm trupit apo shpirtit, (5) bëhet vazhdimisht duke u përsëritur, dhe (6) zakonisht mund të shmanget. Këto janë komponentet e mëkatit i cili nuk është i predisponuar apo i trashëguar. Megjithatë, është e vërtetë se njeriu ka kapacitet dhe potencial për mëkat latent (të pavërejtshëm), por ky kapacitet nuk është më i madh se fuqia për devotshmëri dhe mirësi. Nëse ai e zgjedh aktualizimin e potencialit për mëkat në vend të atij për mirësi, ai do t'i shtojë

elemente të reja të jashtme natyrës së tij të pastër njerëzore. E për këtë element të shtuar nga jashtë është përgjegjës vetëm njeriu.

Në fenë islame ekzistojnë mëkate të mëdha e të vogla, ashtu siç ekzistojnë mëkate kundër Zotit dhe mëkate kundër njeriut. Të gjitha mëkatet kundër Zotit, përveç njërit prej tyre, falen, nëse mëkatari kërkon falje në mënyrë të sinqertë. Kur'ani thotë se me të vërtetë Zoti nuk e fal mëkatin e *shirkut* (politeizmit, panteizmit, trinisë, etj). Megjithatë, përveç këtij, Ai ia fal të gjitha mëkatet tjera atij që do. Por, nëse politeisti apo ateisti i kthehet Zotit, mëkati i tij mund të falet. Mëkatet kundër njerëzve falen vetëm kur viktima ia fal fajtorit, apo vetëm nëse kompensimet ose dënimet e duhura zbatohen në mënyrë të rregullt.

Në përfundim të themi se mëkati është i fituar e jo i lindur, i shfaqur e jo i ndërtuar, i evitueshëm e jo i pashmangshëm. Mëkati është një shkelje e qëllimtë dhe e vetëdijshme e Ligjit të paluhatshëm të Zotit. Nëse njeriu bën diçka që me të vërtetë është pasojë e veprimeve që janë absolutisht të parëzistueshme, apo nga provokime të ndryshme të pakontrolluara, atëherë veprimi i tillë në fenë islame nuk quhet mëkat. Po të ishte kështu, qëllimi i Zotit do të ishte i pakuptimtë dhe përgjegjësia e njeriut do të ishte e kotë. Zoti e kërkon prej njeriut atë që është në kuadër të mundësive dhe arritjeve të tij.

Koncepti i lirisë

Shumë individë, grupe dhe popuj e kanë keqkuptuar konceptin dhe vlerën e lirisë. Shpeshherë edhe e kanë abuzuar. Është e vërtetë se njeriu nuk mund të jetë i lirë në asnjë shoqëri njerëzore në kuptimin absolut të fjalës. Çdoherë duhet të ketë kufizime të këtij apo të atij lloji, po qe se dëshirojmë që një shoqëri të funksionojë si e tillë.

Përveç kësaj ideje të përgjithshme që e përmendëm, feja islame na mëson për lirinë, e ushqen atë dhe ia garanton edhe muslimanit edhe jomuslimanit. Koncepti islam i lirisë u përket të gjitha aktiviteteve vullnetare të njeriut në të gjitha sferat e jetës. Siç edhe përmendëm, çdo njeri është i lindur i lirë në *fitre* ose në një gjendje të pastër të natyrës. Kjo domethënë se njeriu është i lindur i lirë nga nënshtrimi, mëkati, inferioriteti i trashëguar dhe nga pengesat trashëguese. E drejta e tij për liri është e shenjtë përderisa me qëllim nuk e shkel Ligjin e Zotit ose përderisa nuk i nënçmon të drejtat e të tjerëve.

Njëri ndër qëllimet kryesore të fesë islame është emancipimi dhe pastrimi i mendjeve nga besëtytnitë dhe pasiguritë; pastrimi i shpirtit nga mëkati dhe korrupsioni, pastrimi i vetëdijes nga presionet dhe frika, madje edhe ruajtja e trupit nga çrregullimi dhe degjenerimi.

Ndikimi të cilin e ushtron feja islame mbi njeriun për ta kuptuar këtë qëllim, po ashtu ka të bëjë edhe me përpjekjet e mëdha intelektuale, me vëzhgimet e vazhdueshme shpirtërore, me detyrimin e pari-

meve morale, madje edhe me rregullativat dietike. Kur njeriu është i aftë të ndjekë një vazhdë të këfillë - natyrisht në pikëpamje religjioze - ai medoemos duhet të ketë sukses në arritjen e qëllimeve të tij të fundit, e që janë liria dhe emancipimi.

Çështja e lirisë në relacion me besimin, adhurimin dhe vetëdijen, po ashtu ka një rëndësi tejet të madhe në fenë islame. Çdo njeri ka të drejtë lirie në besimin, adhurimin dhe vetëdijen e tij. Me fjalët e Kur'anit, Zoti thotë: *"Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota. E kush nuk i beson të pavërtetat e i beson All-llahut, ai është kapur për lidhjen më të fortë, e cila nuk ka këputje. All-llahu është dëgjues i dijshtëm."* (Kur'ani, 2:256).

Feja islame e ka këtë pikëpamje për arsye se religjioni varet nga besimi, nga vullneti dhe dedikimi. Të gjitha këto nuk do të kishin kurrfarë kuptimi po të ishin të imponuara me forcë. Përveç kësaj, feja islame e prezenton të vërtetën e Zotit në formë të një mundësie dhe ia lë njeriut lirinë e zgjedhjes ashtu siç dëshiron ai. Kur'ani thotë kështu: *"E ti thuaj: 'E vërteta është nga Zoti juaj, e kush të dojë, le të besojë, e kush të dojë, le të mohojë.'" (Kur'ani, 18:29).*

Koncepti islam i lirisë është një njësi e besimit, një urdhër i lartë i Krijuesit Suprem. Ai bazohet në parimet themelore që vijojnë. Së pari, vetëdija e njeriut është subjekt vetëm i Zotit, të Cilit çdo njeri i përgjigjet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Së dyti, çdo qenie njerëzore është personalisht përgjegjëse për veprat e veta dhe vetëm asaj i është lejuar t'i mbledhë frytet e punës së vet. Së treti, Zoti ia ka urdhë-

ruar njeriut përgjegjësine për të vendosur për vetveten. Së katërti, njeriu është i përgatitur me udhëheqje shpirtërore në sasi të mjaftueshme dhe i stërvitur me cilësi racionale që e aftësojnë të bëjë zgjedhje përgjegjëse e të shëndosha. Ky është themeli i konceptit islam të lirisë dhe kjo është vlera e lirisë në fenë islame. Kjo është një e drejtë natyrore e njeriut, një privilegj shpirtëror, një prerogativ moral dhe, mbi të gjitha, një detyrë religjioze. Në kuadër të konceptit islam të lirisë nuk ka vend për persekutime religjioze, konflikte klasore ose paragjykime racore. E drejta e individit për liri është e shenjtë, ashtu siç është e drejta e tij e jetës; liria është ekuivalent i vetë jetës.

Koncepti i barazisë

Njëri ndër elementet themelore në sistemin e vlerave të fesë islame është parimi i barazisë, ose thënë më mirë, i paanësisë. Kjo vlerë e barazisë nuk duhet të kuptohet gabimisht si identikalitet (njëllojshmëri) apo si një stereotip. Feja islame na mëson se para Zotit të gjithë njerëzit janë të barabartë; por nuk janë domosdo identikë. Ekzistojnë ndryshime në mundësi, potenciale, ambicie, pasuri, etj. Megjithatë, asnjëri nga këto ndryshime vetvetiu nuk mund të ketë një status të superioritetit të njërës apo racës tjetër. Njeriu, ngjyra e lëkurës së tij, sasia e tij e pasurisë dhe shkalla e prestigjit që ai e gëzon, nuk kanë lidhje me karakterin e individit sa i përket Zotit. Dallimi i vetëm që e njeh Zoti është dallimi në çështjen e devotshmërisë dhe i vetmi kriter të cilin e

zbaton Zoti, është kriteri i mirësisë dhe i dëlirësisë shpirtërore. Në Kur'an, Zoti thotë:

“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se tek All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat)...” (Kur'ani, 49:13).

Dallimet në racë, ngjyrë apo status shoqëror janë vetëm të rastësishme. Ato, në sytë e Zotit nuk ndikojnë në statusin e vërtetë të njeriut. Përsëri vlera e barazisë nuk është vetëm çështje e të drejtave të garantuara apo e të drejtave të një marrëveshjeje apo mirësie. Kjo është një njësi e besimit, të cilën muslimani e merr dhe i qaset seriozisht. Themelet e kësaj vlere islame janë të rrënjosura thellë në strukturën e fesë islame. Kjo vlerë i ka rrënjët në parimet themelore, si p.sh.:

1. Të gjithë njerëzit i ka krijuar një Zot - që është i vetmi Zot i amshueshëm, Zoti suprem i të gjithëve.
2. I gjithë njerëzimi i takon racës njerëzore dhe i ndanë në mënyrë të barabartë paraardhësit e për-bashkët, Ademin e Havën.
3. Zoti është i drejtë dhe i përzemërt për të gjitha krijesat e Tij. Ai nuk anon nga asnjë racë, moshë apo religjion. E gjithë Gjithësia është nën sundimin e Tij dhe të gjithë njerëzit janë krijesat e Tij.
4. Të gjithë njerëzit janë të lindur të barabartë, në kuptimin se asnjëri nuk sjell ndonjë gjë me vete, dhe vdesin të barabartë, në kuptimin se me vete nuk marrin asgjë nga pasuritë e tyre botore.

5. Zoti gjykon për çdo person duke u bazuar në meritat dhe veprat e tij personale.
6. Zoti ia ka dhënë njeriut titullin e nderit dhe të dinjitetit.

Këto janë disa nga parimet kryesore sa i përket vlerës së barazisë në fenë islame. Nëse ky koncept hyn në përdorim në mënyrë të duhur, atëherë nuk do të ketë vend për paragjykime apo persekutime. Dhe kur ky urdhër hyjnor do të kuptohet në mënyrë të duhur, atëherë nuk do të ketë vend për presion dhe shfrytëzim. Konceptet e njerëzve të zgjedhur e paganë, fjalët se ekzistojnë raca të privileguara dhe të dënuara, shprehjet se ekziston kasta sociale dhe qytetarët e dorës së dytë, në të vërtetë janë të pakuptimta.

Koncepti i vëllazërisë

Një element tjetër themelor në sistemin e vlerave të fesë islame është edhe vlera e vëllazërisë njerëzore. Kjo vlerë po ashtu bazohet në parimet e njëjta që i diskutuam lidhur me lirinë dhe barazinë. Përveç këtyre parimeve, vëllazëria njerëzore në fenë islame bazohet në një besim të paluhatshëm në njëshmërinë dhe universalitetin e Zotit të adhuruar; në unitetin e njerëzimit e të atyre që e adhurojnë Atë dhe në unitetin e religjionit si medium (mjet) i adhurimit. Për muslimanin e mirëfilltë e të devotshëm Zoti është Një, i amshueshëm dhe universal. Ai është Krijuesi i të gjithë njerëzve, gjykatësi i të

gjithë njerëzve, furnizuesi i të gjitha krijesave dhe sunduesi i të gjithë njerëzve. Statusi shoqëror, kufijtë kombëtarë dhe origjina racore, për Zotin nuk kanë kurrfarë rëndësie. Para Tij të gjithë njerëzit janë të njëjtë dhe vëllezër të njëri-tjetrit.

Muslimani beson në unitetin e njerëzimit në relacion me burimin e krijimit, me origjinën e paraardhësve dhe me fatin e fundit. Burimi i krijimit është vetë Zoti. Paraardhësit e parë dhe të përbashkët të të gjithëve janë Ademi dhe Hava. Çdo qenie njerëzore u takon këtyre prindërve të parë dhe është pjesë e tyre. Sa i përket fatit të fundit, në mendjen e muslimanit nuk ekziston dyshimi se Zoti është Ai të cilit do t'i kthehen të gjithë njerëzit.

Muslimani beson në unitetin e religjionit të Zotit. Kjo don të thotë se Zoti nuk e përkufizon religjionin e Tij apo nuk e favorizon asnjë popull apo racë, apo moshë të caktuar. Kjo, më tutje, don të thotë se nuk mund të ekzistojnë kundërthënie apo dallime kryesore themelore në religjionin e Zotit. Nëse e gjithë kjo interpretohet në mënyrë të drejtë, nuk do të ketë vend për autoritet të trilluar apo për ekskluzivitet të tepruar. E kur e gjithë kjo do të bëhet pjesë e mendjes njerëzore, atëherë ajo do ta furnizojë njeriun me një koncept të qartë dhe me një bazë të shëndoshë për vëllazërinë njerëzore. Për arsye se muslimani beson në njëshmërinë e Zotit, në unitetin e njerëzimit dhe në unitetin e religjionit, ai beson në të gjithë Të Dërguarit dhe Shpalljet e Zotit, pa kurrfarë dallimi.⁵

⁵ Shih diskutimin rreth parimeve themelore të besimit në Islam.

Koncepti i paqes

Me qëllim që të kuptohet mënyra e trajtimit të problemit të paqes nga ana e fesë islame, duhet të mendojmë edhe për disa fakte themelore që i përkasin fesë islame. Fjala “paqe” (selam) dhe fjala “Islam” janë të derivuara nga e njëjta rrënjë, ndaj duhet të konsiderohen si sinonime. Një ndër emrat e Zotit është edhe Paqja. Fjalët përfundimtare të namazeve të përditshme të çdo muslimani janë fjalët e paqes. Përshëndetja e muslimanëve kur ata i kthehen Zotit është paqja. Përshëndetjet ditore ndërmjet muslimanëve janë shprehje të paqes. Mbiemri “musliman” në njëfarë kuptimi don të thotë edhe “paqësor”. Parajsa në fenë islame është vendi ku mbretëron paqja e vërtetë.

Kjo tregon se sa elementare dhe dominante është tema e paqes në fenë islame. Individit që i qaset Zotit nëpërmjet fesë islame, nuk mund të mos ketë sukses në jetën në paqe me Zotin, me vetveten dhe me bashkëbesimtarët e tij. Duke i marrë të gjitha këto vlera bashkarisht, duke e vënë njeriun në vendin e tij të duhur në Gjithësi dhe duke e shikuar jetën nga perspektiva islame, njerëzit me besim dhe parime të shëndosha do të kenë sukses të krijojnë një botë më të mirë, ta rikthejnë dinjitetin njerëzor, ta arrijnë barazinë, ta gëzojnë vëllazërinë universale dhe të ndërtojnë një paqe të përhershme.⁶

⁶ Shih diskutimin rreth Luftës dhe Paqes më poshtë.

Koncepti i bashkësisë

Koncepti “bashkësi” ka disa konotacione; disa prej tyre janë romantike dhe nostalgjike, kurse disa përçmuese dhe reaksionare. Megjithatë, pasi qëllimi ynë është ta trajtojmë problemin që është më elementar rreth kësaj çështjeje, diskutimin tonë do ta përkufizojmë në kuptimet themelore të kësaj fjale.

Në një kuptim themelor, koncepti i bashkësisë i nënkupton “të gjitha format e marrëdhënieve që karakterizohen me një shkallë të lartë të afërsisë personale, të thellësive emocionale, zotimit moral, kohezionit shoqëror dhe të kontinuitetit në kohë..! Mund të gjendet në lokalitet, religjion, komb, racë, profesion, apo kauzë të përbashkët. Arketipi (origjina) i saj... është familja.” (Nisbet, fq. 47-8)⁷

Në një kuptim tjetër themelor, bashkësia është një grup i caktuar me dy karakteristika kryesore: (1) Grup në të cilin individi mund ta udhëheqë shumicën e aktiviteteve dhe përvojave të cilat për atë janë më të rëndësishme. (2) Grup i bashkuar që ndanë një sens të barabartë të përkatësisë dhe një ndjenjë të identitetit (Broom & Selznick, fq. 31).⁸

Momenti kryesor historik ka qenë lëvizja nga marrëdhëniet e brendshme, të thella dhe morale, në marrëdhëniet pavetore, formale dhe utilitariste (që drejtohet nga dobia e atypëratyshme) të një shoqërie

⁷ Robert Nisbet, “*The Sociological Tradition*” (Tradita Sociologjike) - New York: Basic Books, 1966.

⁸ L. Broom & P. Selznick, “*Sociology: A Text with Adapted Readings*” (Sociologjia: Teksti me lexime të adaptuara) - New York, Harper & Rowe, 1968.

masive. Kjo lëvizje ka pasur faza të ndryshme dhe ka qenë e përcjellur me pasoja të mëdha.

Nga kjo ecuri apo moment historik mund të nxjerrim disa përfundime. Së pari, ky evolucion historik nuk ka qenë tërësisht negativ ose krejtësisht konstruktiv dhe pozitiv. Që nga të dyja anët, si pasojat negative ashtu edhe ato pozitive, kanë ndikuar te njerëzit në përmasa të ndryshme. Së dyti, shoqëria moderne është larg nga përsosuria, ekziston një detyrë e rëndë që ende nuk është kryer. Së treti, gjendja njerëzore nuk është një shkak i humbur ose një rast i pashpresë. Është e vërtetë se ka kriza dhe pengesa, por gjendja nuk është krejtësisht jashtë kontrollit. Më në fund, njerëzimi është bërë më i ndërvarur dhe shoqëritë njerëzore më të lidhura ndërmjet veti. Ajo që ndodh me një segment të shoqërisë duhet të ndikojë edhe në segmentet tjera. Kur diskutojmë për konceptin islam të bashkësisë, këtë fakt duhet ta kemi parasysh.

Në përgjithësi është e saktë të thuhet se koncepti islam i bashkësisë ka disa karakteristika të përbashkëta. Karakteristikat e këtilla janë të lidhura drejtpërdrejt me themelin apo bazën e bashkësisë, me misionin dhe qëllimin e saj historik, me statusin e saj midis bashkësive të tjera, me identitetin dhe kontinuitetin e saj.

Bashkësia në fenë islame nuk bazohet në racë, nacionalitet, lokalitet, faretisni apo në ndonjë interes special. Ajo nuk e merr emrin e vet sipas emrit të udhëheqësit, themeluesit apo të ndonjë ngjarjeje. Ajo i kapërcen kufijtë kombëtarë dhe politikë. Themelimi i bashkësisë në fenë islame është parimi

që e ndërton nënshtrimin ndaj vullnetit të All-llahut, bindjen ndaj Ligjit të Tij dhe dedikimin ndaj kauzës së Tij. Me një fjalë, një bashkësi e fesë islame është e pranishme vetëm atëherë kur ushqehet dhe nxitet me ISLAMIN.

Bashkësia islame ka një mision historik që i kapërcen edhe luftën për ekzistencë, fuqinë, ushqimin edhe vazhdimësinë psikologjike. Kur'ani misionin e tillë e shpjegon me sa vijon:

“Nga ju le të jetë një grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillë janë ata të shpëtuarit.” (Kur'ani, 3:104). *“Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni All-llahun.”* (Kur'ani, 3:110).

Roli historik i bashkësisë islame është që ajo të jetë pasqyrë e vërtetë e njerëzve të virtytshëm dhe bujarë. Një bashkësi islame e vërtetë është roje e patrembur e virtytit dhe luftëtare kundër armikut të saj - keqbërësisë. Ajo që kërkohet prej një bashkësie islame në përgjithësi, po ashtu kërkohet edhe prej çdonjërit nga anëtarët e saj. Kjo është kështu për arsye se e gjithë bashkësia është një unitet organik dhe çdo individ është nën mbikëqyrjen e All-llahut. Rolin e individit - musliman më së miri e shpjegon thënia e Pejgamberit:

“Kush nga ju sheh një të keqe - le ta ndryshojë me dorën e tij, e nëse nuk mund ta bëjë këtë - atëherë me gjuhën e tij, e nëse nuk mund ta bëjë edhe këtë - atëherë me zemrën e tij, porse ky është imani më i dobët.”

Siç mund të shohim, ky përshkrim flet shumë dhe është tejet i rëndësishëm. Në këtë epokë të mendimit revolucionar, askush që mendon ashtu siç duhet nuk mund ta nënçmojë fuqinë e aksioneve konkrete, fuqinë e fjalëve të komunikimit, apo fuqinë e ndjenjave.

Roli historik i bashkësisë islame më tutje përshkruhet edhe në Kur'an:

“Ne u bëmë juve një popull të drejtë (një mes të zgjedhur) për të qenë ju dëshmitarë (në Ditën e Gjykimit) ndaj njerëzve dhe për të qenë I Dërguari dëshmitar ndaj jush.” (Kur'ani, 2:143).

Roli i tillë i dëshmimit është tepër i rëndësishëm, por edhe tepër i rëndë. Ai do të thotë se bashkësia e fesë islame duhet të jetë shembullore. Ai rol duhet t'i rregullojë standardet më të larta të shfaqjes dhe pikat e referimit për të tjerët. Në këtë pikëpamje duhet t'u shmangemi ekscesive dhe teprimeve, vrazhdësisë statike dhe avullimit momental. Të mund ta ndalosh rrjedhën e aktit, të jeshë i shpejtë dhe konciz, të dishë çfarë të pranosh e çfarë të refuzosh, të keshë parime dhe në të njëjtën kohë të keshë aftësi adaptimi, është sigurisht testi më i rëndë për karakterin njerëzor dhe për mbrojtjen e tij sociale. Megjithatë, ky është roli i bashkësisë islame dhe misioni historik i muslimanëve. Ky është kriteri i vetëm që e kualifikon muslimanin si bashkësi e njerëzve, e cila deri më tani ka evoluar më së shumti.

Identiteti i bashkësisë islame përqëndrohet në parimet e një drejtpeshimi të saktë, në një sjellje shembullore, në unitetin e qëllimit, në reciprocitetin e ndjenjave, në solidaritetin dhe barazinë. Janë të

shumta në numër thëniet e Kur'anit dhe Sunnetit lidhur me këtë (për shembull, shih Kur'anin, 4:135; 21:92; 23:52).

Në relacion me kontinuitetin e bashkësisë islame mund të përmenden disa momente. Muslimanët kanë për detyrë të bëjnë ç'është e mundur me të gjitha mjetet që i kanë në disponim, për ta siguruar atë kontinuitet. Rregullat e martesës dhe të trashëgimisë, detyrat (obligimet) e zeqatit dhe haxhit, të drejtat dhe obligimet e përbashkëta të farefisnisë, vetëdija individuale dhe përkatësia sociale - të gjitha këto janë të orientuara në kontinuitetin e shëndoshë të bashkësisë islame. Në anën tjetër, All-llahu është zotuar se do ta ruajë këtë kontinuitet në disa mënyra. Së pari, Ai na siguron se: *“Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij.”* (Kur'ani, 15:9).

Kjo don të thotë se çdoherë do të ketë një bashkësi sipas Kur'anit; Kur'ani nuk do të mbetet pa ithtarë, edhe pse mund të ekzistojnë edhe ithtarë të librave të tjerë. Së dyti, vetë feja islame është kontinuitet. Po të devijojë ndonjë popull nga rruga e All-llahut, Ai e përsërit fjalën e Tij, e përdëfton të Vërtetën e Tij dhe u jep detyrë peygamberëve ose reformatorëve të rinj që ta vazhdojnë rrugën e Tij. Së treti, All-llahu ka bërë një thirrje mjaft serioze në të cilën thotë se po qe se devijojnë muslimanët nga rruga e drejtë, ata do të jenë humbëtarë, e *“Ai do t'ju zëvendësojë me një popull tjetër, që nuk do të jetë si ju.”* (Kur'ani, 47:38).

Të përsërisim: besimtarëve u tërhiqet vërejtja se nëse cilido qoftë prej tyre largohet nga besimi i tyre,

Zoti shpejtë do të krijojë njerëz të cilët do t'i dojë, e ata po ashtu do ta duan Atë. Ai do të jetë i butë ndaj besimtarëve dhe i fuqishëm kundër mosbesimtarëve që luftojnë kundër Zotit, e asnjëherë nuk frikësohen se e keqja do t'u vijë prapa.

Koncepti i moralit

Koncepti i moralit në fenë islame kryesisht përqëndrohet në disa parime themelore të caktuara. Në mesin e tyre dallohen veçanërisht këto: (1) Zoti është krijuesi dhe burimi i gjithë të mirës, të vërtetës dhe bukurisë. (2) Njeriu është məkëmbësi i përgjithshëm, dinjitoz dhe i ndershëm i Zotit. (3) Zoti gjithçka që vendosi në qiej dhe në tokë - e vuri në shërbim të njerëzimit. (4) Zoti, me mëshirën dhe urtësinë e Tij, nuk e pret të pamundurën nga njeriu dhe nuk e mban atë në përgjegjësi për gjithçka që e tejkalon fuqinë e tij. Po ashtu Zoti nuk i ndalon njeriut të kënaqet me gjërat e mira të jetës. (5) Maturia, prakticiteti dhe balancimi janë garanci për një integritet të lartë dhe për një moral të shëndoshë. (6) Parimisht të gjitha gjërat janë të lejueshme, përveç asaj që është e veçuar si e obligueshme, asaj që duhet të kemi kujdes, asaj që është e veçuar si e ndaluar dhe asaj të cilës duhet t'i shmangemi. (7) Përgjegjësia e fundit e njeriut ndaj Zotit dhe qëllimi i tij më i lartë është kënaqësia e Krijuesit të tij.

Dimensionet e moralit në fenë islame janë të shumta, të mirëfillta dhe të kuptueshme. Morali is-

lam ka të bëjë me marrëdhëniet ndërmjet njeriut dhe Zotit, njeriut dhe njerëzve të tjerë, ndërmjet njeriut, elementeve dhe krijesave të tjera të Gjithësisë dhe ndërmjet njeriut dhe brendisë më të thellë të vetes së tij. Muslimani duhet t'i kontrollojë sjelljen e vet të jashtme dhe manifestimin e veprave të tij, fjalët dhe mendimet e tij, si dhe ndjenjat e qëllimet e tij. Në përgjithësi, roli i tij është ta shquajë atë që është e drejtë, kurse të luftojë kundër asaj që është e keqe; ta kërkojë të vërtetën kurse t'i shmanget të padrejtës; ta ushqejë të bukurën dhe të shëndoshën dhe t'i largohet të turpshmes dhe të shëmtuarës. Qëllimet e tij janë e vërteta dhe virtyti. Përuhtësia dhe thjeshtësia, përzemërsia dhe mëshira janë natyra e tij e dytë. Arroganca dhe zbrazëtia, vrazhdësia dhe indiferenca janë të pahijshme, ofenduese për të dhe të papranueshme te Zoti.

Në kuptimin më specifik, marrëdhënia e muslimanit me Zotin fshihet në dashurinë dhe dëgjimin, besimin e plotë dhe në ndershmërinë, në paqen dhe çmimin, në rehatinë dhe në shërbimin aktiv. Pa dyshim, ky moral i nivelit kaq të lartë do ta ushqejë dhe do ta forcojë moralin në nivelin njerëzor. Marrëdhënien e tij me bashkëbesimtarin, muslimani duhet ta tregojë në formë përzemërsie ndaj të afërmit të vet dhe kujdesit ndaj fqit të vet, respektit ndaj pleqve dhe mëshirës ndaj të rinjve, kujdesit ndaj të sëmurëve dhe ndihmës ndaj të varfërve, simpatisë ndaj të mërziurve dhe gëzimit ndaj të deprimuarve, lumturisë ndaj të bekuarve dhe durimit ndaj të keqduhëzuarve, tolerancës ndaj injorantëve dhe faljes ndaj të pafuqishmëve, mospajtimit ndaj të keqes dhe ngri-

tjes mbi të parëndësishmen. Përveç kësaj ai duhet t'i respektojë të drejtat legjitime të të tjerëve, aq sa i respekton edhe të drejtat e veta. Mendja e tij duhet të jetë e preokupuar me ide konstruktive dhe me kërkesa serioze; zemra e tij duhet të rrahë në paqe dhe rehati, ndërsa këshilla e tij duhet të jetë e sinqertë dhe e përzemërt.

Muslimani është moralisht i obliguar që të jetë shembull i dalluar i ndershmërisë dhe përsosurisë, t'i plotësojë obligimet e tij dhe t'i zbatojë detyrat e tij në mënyrë korrekte, të kërkojë dituri dhe virtyt me të gjitha mjetet e mundshme që i posedon, t'i korigjojë gabimet dhe të pendohet për mëkatet e tij, të zhvillojë një kuptim të mirë të vetëdijes sociale dhe të ushqejë ndjenjë të përgjegjësisë njerëzore ndaj të varurve të tij, t'i furnizojë me çka u duhet pa kurrfarë ekstravagance, duke i plotësuar në këtë mënyrë edhe nevojat e tyre legjitime. Natyra dhe bota janë fusha të kërkesës dhe objekte të kënaqësisë për muslimanët. Ai duhet t'i përdorë elementet e tyre dhe t'i shfrytëzojë frytet e tyre, t'i lexojë si shenja të madhësisë së Zotit dhe ta ruajë bukurinë e tyre; t'i hulumtojë mrekullitë e tyre dhe t'i zbulojë sekretet e tyre. Por, nëse ai i përdor ato për fitim dhe për kënaqësi, duhet t'i shmanget zbrazëtisë dhe ekscesit. Si i deleguar përgjegjës i Zotit, ai duhet të jetë një besimtar i vetëdijshëm, çdoherë duhet të mendojë për të tjerët që e ndajnë botën me të dhe të cilët do t'i ndihmojnë të ketë sukses në të ardhmen.

Parimet morale të fesë islame disa herë merren si postulate pozitive që duhet të përmbushen, e disa herë si udhëzime negative të cilave duhet t'u shman-

gemi. Pavarësisht nga ajo a kuptohen ato në mënyrë negative apo pozitive, ato janë të krijuara që në qenien njerëzore të krijojnë një mendje të shëndoshë, një shpirt paqësor, një personalitet të fortë dhe një trup të shëndoshë. Pa dyshim këto janë kërkesa të nevojshme për një mirëqenie të përgjithshme dhe për një prosperitet të njerëzimit. Feja islame, përveç të tjerave, për t'i ndihmuar njeriut që t'i plotësojë këto kërkesa, i ka caktuar rregullat që vijojnë:

1. Ta dëshmojë Njeshmërinë e Zotit dhe pejgamberinë e Muhammedit a.s., në një mënyrë kuptimplotë dhe përkushtuese.
2. T'i falë namazet ditore rregullisht.
3. T'i paguajë obligimet fetare që janë të njohura si të dhëna islame për të varfërit (zeqat).
4. Ta agjërojë Muajin e bekuar të Ramazanit.
5. Të shkojë në haxh së paku një herë gjatë jetës së tij, (kuptohet, brenda mundësive materiale me të cilat disponon).

Problemet morale dhe sociale të këtyre obligimeve do t'i diskutojmë më vonë më hollësisht.

Përveç këtyre masave pozitive, ekzistojnë edhe masa të tjera që mund të quhen parandaluese apo të kujdesit. Për ta mbrojtur njeriun nga çmenduria dhe degjenerimi, nga dobësia dhe shfrenimi, nga turpi dhe joshja, feja islame i ka ndaluar disa gjëra që kanë të bëjnë me ushqimin, rekreimin dhe marrëdhëniet seksuale. Ndër ndalesat e këtij lloji janë kryesisht këto:

1. Të gjitha llojet e verërave, lëngjeve dehëse dhe pijeve alkoolike. (Kur'ani, 2:213; 4:43; 5:93-94);
2. Mishin e derrit dhe prodhimet e tij (proshuta, ushuji, sallama, etj.), si dhe mishin e kafshëve që i përdorin kthetrat apo dhëmbët për t'i vrarë viktimat e tyre (tigrat, ujqit, leopardët, etj.); të gjitha shpezët grabitqare (fajkonjtë, sorrat, shqiponjat, etj.), brejtësit, zvarranikët, krimbat dhe ngjashëm; si dhe të gjitha kafshët e ngordhura që nuk janë therë në mënyrë të duhur. (Kur'ani, 2:172-173; 5:4-6);
3. Të gjitha argëtimet e dëmshme dhe të kota si bixhozi. (Kur'ani, 2:219; 5:93-94);
4. Të gjitha marrëdhëniet seksuale jashtë martesës si dhe të gjitha sjelljet në të folurit, të ecurit, të pamjes dhe të veshurit që publikisht janë provokuese, që nxisin epshin dhe joshjen, që janë të turpshme apo të pahijshme. (Kur'ani, 23:5-7; 24:30-33; 70:29-31).

Zoti na njofton me këto akte të ndalesës që kanë për qëllim mirëqenien shpirtërore dhe psikike të njeriut, si dhe lehtësimet materiale dhe morale të njerëzimit. Ky nuk është një aksion arbitrar apo një instruksion i imponuar nga vetë Zoti. Përkundrazi, është një shenjë e interesimit të Zotit për mirëqenien e njerëzimit dhe një dëftim i kujdesit të madh të Tij ndaj njeriut.

Zoti nuk i ndaloi disa gjëra të caktuara për arsye se dëshiroi që t'ia marrë njeriut gjithë atë që është e mirë e prej së cilës ai ka fitim. Kjo ndodh kështu për

arsye se Zoti dëshiron ta mbrojë njeriun dhe t'i lejojë atij të zhvillojë një kuptim të drejtë rreth diskriminimit, për një shije të rafinuar për gjërat e mira të jetës dhe një interes të pandërprerë për vlerat e larta morale. Për t'u arritur kjo, njeriu duhet ta përqëndrojë vëmendjen në frymën dhe arsyen, shpirtin dhe trupin, vetëdijen dhe ndjenjat, shëndetin dhe pasurinë, psikikën dhe moralin. Prandaj këto ndalesa nuk janë privim por pasurim; nuk janë presion por disiplinë; nuk janë kufizim por ekspansion.

Që të përdëftojmë se të gjitha ndalesat janë akte të mëshirës e të urtësisë, lidhur me këtë duhet të përmendim dy parime islame. Së pari, rrethanat e çuditshme apo të papritura, rastet urgjente, nevojat dhe domosdoshmëritë i lejojnë muslimanit ta bëjë atë që në kushte normale është e ndaluar. Në periudhën kohore kur ekzistojnë këto rrethana, deri në atë masë që nuk mund t'i ikë situatës, muslimani nuk fajësohet pse nuk u përmbahet rregullave morale të Zotit (shih Kur'anin, 2:173; 5:4). Së dyti, Zoti e ka përkrahur edhe për vete Ligjin e mëshirës: *"Kush bën prej jush ndonjë të keqe pa dije, e mandej pas asaj (të keqe) pendohet dhe përmirësohet, s'ka dyshim se All-llahu është që falë shumë dhe është mëshirues."* (Kur'ani, 6:54).

Në një fragment të shquar tipik, Kur'ani i jep edhe bazat fundamentale për një sjellje morale të shëndoshë:

"O bijtë e Ademit, vishuni bukur për çdo namaz (lutje), hani dhe pini e mos teproni, pse Ai (All-llahu) nuk i do ata që e teprojnë (shkapërderdhin). Thuaj: 'Kush i ndaloi bukuritë dhe ushqimet e

mira që All-llahu i krijoi për robëritë e vet?’ Thuaj: ‘Ato janë në këtë botë për ata që besuan, e në Ditën e Kijametit janë të posaçme për ta. Kështu ia sqarojmë argumentet një populli që kupton.’ Thuaj: ‘Zoti im i ndaloi vetëm të këqijat e turpshme, le të jenë të hapta ose të fshehta, ndaloi mëkatin, ndaloi shtypjen e tjetrit pa të drejtë, ndaloi t’i mvishni All-llahut shok pa patur për të kurrfarë argumenti dhe ndaloi të thoni për All-llahun atë që nuk e dini se është e vërtetë’.” (Kur’ani, 7:31-33).

Natyra e moralit në fenë islame është aq e mbyllur dhe integrative sa menjëherë i kombinon besimin në Zot, ritet fetare, vërejtjet shpirtërore, sjelljen sociale, marrjen e vendimeve, kërkimet intelektuale, shprehitë e konsumimit, mënyrat e të folurit dhe të gjitha aspektet tjera të jetës njerëzore. Mund të diktohet toni moral në këto ajete të Kur’anit, për arsye se morali është pjesë përbërëse e fesë islame. Prandaj mësimet morale theksohen shpeshherë dhe përsëriten në kontekste të ndryshme të Librit të Shenjtë. Kjo edhe më tepër e vështirëson klasifikimin e këtyre mësimëve morale sipas civateve të tyre të Kur’anit. Çdo parim përmendet shumëherë në kontekste të ndryshme. Kjo paraqitet ose si një parim i vetëm i rëndësishëm, ose si një element i një sistemi të përgjithshëm të moralit; e që në vetvete është element i një supersistemi të tërë religjioz.

Lidhur me këtë, ajetet që vijojnë le të merren si zgjidhje përfaqësuese të Kur’anit të marra e të interpretuara nga përpjekjet njerëzore, të cilat, natyrisht se nuk mund ta japin në përgjithësi vizionin origjinal dhe komplet të këtij libri:

“Adhurone All-llahun e mos i shoqëroni Atij asnjë send, sillnu mirë ndaj prindërve, ndaj të afërmeve, ndaj jetimave, ndaj të varfërve, ndaj fqiu të afërt, ndaj fqiu të largët, ndaj shokut pranë vetes, ndaj udhëtarit të largët dhe ndaj robërve. All-llahu nuk e do atë që është kryelartë dhe atë që lavdërohet. Ata që vetë janë koprracë dhe i urdhërojnë njerëzit për koprraci, dhe e fshehin atë që ua ka dhënë All-llahu nga mirësitë e Veta. Ne kemi përgatitur dënim të turpshëm për jobesimtarët. Edhe ata që e japin pasurinë e tyre sa për sy e faqe të botës, e nuk e besojnë All-llahun as Ditën e Fundit. E ai që e ka shok djallin, ai pra është shok i shëmtuar.” (Kur’ani, 4:36-38).

“Thuaj: ‘Ejani t’ua lexoj atë që me të vërtetë ua ndaloi Zoti juaj: të mos i shoqëroni Atij asnjë send, të silleni mirë me prindërit, të mos i mbytni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë, sepse Ne ju ushqejmë juve dhe ata, të mos u afroheni mëkateve të hapta apo të fshehta, mos e mbytni njeriun sepse mbytjen e tij e ndaloi All-llahu, përpos kur është me vend. Këto janë porositë e Tij, kështu që të mendoni thellë. Mos iu afroni pasurisë së jetimit derisa ai ta arrijë pjekurinë, (mund t’i afroheni) vetëm në mënyrën më të mirë, zbatoni me drejtësi matjen dhe peshojën, Ne nuk e ngarkojmë asnjë njeri përtej mundësive të tij. Kur të flitni (të dëshmoni), duhet të jeni të drejtë edhe nëse është çështja për (kundër) të afërmit, dhe zotimin e dhënë All-llahut plotësone. Këto janë me çka Ai ju porositë kështu që të përkujtoni. Dhe se kjo është rruga (feja) Ime e drejtë (që e caktova për ju), pra përmbajuni kësaj, e mos ndiqni rrugë të tjera e

t'ju ndajnë nga rruga e Tij. Këto janë porositë e Tij për ju, ashtu që të ruheni'.” (Kur'ani, 6:151-153).

“All-llahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërmve, e ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon ashtu që të merrni mësim. Meqë keni premtuar, pra zbatoheni premtimin e dhënë ndaj All-llahut e mos i prishni betimet pasi i keni vërtetuar ato, duke qenë se All-llahun e bëtë garant tuajin. Vërtet, All-llahu e di se çka punoni... Kush bën veprë të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t'i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t'u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre.” (Kur'ani, 16:90,91,97).

“Ti (Muhammed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) në atë mënyrë që është më e mira. Zoti yt është Ai që e di më së miri atë që është larguar nga rruga e Tij dhe Ai di më së miri për të udhëzuarit.” (Kur'ani, 16:125)

“E kush është në rrugë më të mirë se ai që thërret në rrugën e All-llahut, që bën vepra të mira dhe që thotë: 'Unë jam prej muslimanëve'? Nuk janë të barabarta e mira dhe e keqja. Andaj (të keqen) ktheje në mënyrën më të mirë, se atëherë ai, me të cilin kishit njëfarë armiqësie, do të bëhet mik i afërt.” (Kur'ani, 41:33-34)

“Çka u është dhënë nga ndonjë send, ajo është kënaqësi në këtë botë, e ajo që është te All-llahu është shumë më e mirë dhe e përhjetshme, por për ata që besuan dhe që vetëm Zotit të tyre i mbështeten. Dhe ata që u shmangen mëkateve të mëdha e të

shëmtuara, dhe kur hidhërohen, ata falin. Edhe ata që i përgjigjen thirrjes së Zotit të tyre dhe e falin namazin rregullisht, dhe ata që konsultohen mes vete për punë të përbashkëta, e nga ajo që Ne ua japim ata e shpërndajnë. Edhe ata që kur i godet e padrejta, i kundërvihen. Ndëshkimi i të keqes bëhet me një të keqe në të njëjtën masë, e kush fal e bën pajtim, shpërblimi i tij është tek All-llahu. Vërtet, Ai nuk i do zullumçarët. E kush hakmerret për padrejtësitë që i janë bërë, ndaj të tillëve nuk ka ndonjë përgjegjësi. Përgjegjësia (ndëshkimi) është vetëm kundër atyre që u bëjnë njerëzve padrejt dhe kundër atyre që pa kurrfarë arsye bëjnë çrregullime në tokë. Për të tillët është një dënim i dhembshëm. Kush bën durim dhe fal, s'ka dyshim se ajo është virtyti më i lartë (i lavdishëm).” (Kur’ani, 42:36-43).

“Kush është që e ka për qëllim vetëm këtë botë, Ne atij që duam i japim në të aq sa duam, e pastaj atij i bëjmë të hyjë në xhehennem i nënçmuar e i përbuzur. E kush e ka për qëllim botën tjetër, duke qenë ai besimtar, përpiket për të ashtu si i takon asaj, angazhimi i tyre do të jetë i pranishëm (te Zoti). Ne secilit prej atyre i japim nga të mirat e Zotit tënd dhe dhënia e Zotit tënd nuk është e kufizuar. Shiko se si Ne i kemi dalluar disa prej të tjerëve, po dallimi në botën tjetër është më i madh dhe është përparësi më e madhe. E mos shoqëro me All-llahun ndonjë zot tjetër e të bëhesh i qortuar, i papërkrahur. Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuroni tjetërkë pos Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre ose që të dy i ka kapluar pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj

atyre as 'of' as 'oh', as mos u bë i vrazhdë ndaj tyre, po atyre thua ju fjalë të mira (të buta, respektuese). Dhe në shenjë mëshire shtri je pranë tyre kra h un për ulës e respektues dhe thua j: 'Zoti im! Mëshiroi ata të dy, sikurse më edukuan mua kur isha i vogël'. Zoti juaj e di më së miri atë që e keni në shpirtin tuaj. Nëse keni qëllime të mira, vërtet Ai u fal atyre që pendohen. Dhe jepi çdo të afërmi të drejtën që i takon, edhe të varfërit, edhe atij në kurbet, por mos shpenzo tepër e pa rrugë. Ata që shpenzojnë tepër (mastrafxinjtë) janë vëllezër (në veprim) të djajve, e djalli është përbuzës i madh i Zotit të tij. Nëse detyrohesh t'ua kthesh shpinën atyre (të afërmeve etj.), duke kërkuar mëshirën të cilën e shpreson nga Zoti yt (furnizim për t'i ndihmuar ata), atëherë thua ju atyre fjalë të mira (të lehta). Dhe mos e bën dorën tënde të lidhur për qafe (mos u bë koprrac), e as mos e shtrij në tërësi e të mbetesh i qortuar dhe duarthatë (nga shpenzimi i tepërt). S'ka dyshim se Zoti yt është Ai që furnizon me bollëk atë që do, dhe ia kufizon atij që do. Ai hollësisht e di për robtë e vet dhe i vështron. Ju mos i mbytni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë, se Ne ua sigurojmë furnizimin atyre dhe juve, e mbytja e tyre është mëkat i madh. Dhe mos iu afroni amoralitetit (zinasë), sepse vërtet ai është vepër e shëmtuar dhe është një rrugë shumë e keqe. Dhe mos e mbytni njeriun që All-llahu e ka ndaluar (mbytjen e tij), përveç me drejtësi (që e kërkon Sheriati). E kush mbytet pa të drejtë (pa faj), kujdestarit të tij Ne i kemi dhënë të drejtë (të kërkojë drejtësinë), e ai të mos kalojë kufirin në mbytje derisa ai është i ndihmuar (prej Zotit). Mos e përdorni pasu-

rinë e jetimit ndryshe vetëm në mënyrën më të mirë (për t'ia shtuar), derisa ai ta arrijë pjekurinë e vet. Premtimin zbatone, meqë për premtimin ka përgjegjësi. Masën mbushne kur matni (me enë) dhe peshoni me peshojë të drejtë (precize). Kjo është më e dobishme dhe ka përfundim më të mirë. Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri, pse të dëgjuarit, të pamurit dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi. Dhe mos ec nëpër tokë me mburrje, pse ti as nuk mund ta çashë tokën, as nuk mund ta arrishë lartësinë e maleve. E keqja e të gjitha këtyre është e urrejtur te Zoti yt. Këto janë nga urtësia që Zoti yt t'i shpalli ty. Mos shoqëro me All-llahun ndonjë zot tjetër, e të hidhesh në xhehennem i qortuar dhe i larguar." (Kur'ani, 17:18-39).

"Ne i patëm dhënë Llukmanit mençuri të përsosur (e i thamë): Të falënderosh All-llahun, e kush falënderon, e mira e atij falënderimi i takon atij, e kush refuzon (edhe ai e ka për vete), në të vërtetë All-llahu nuk ka nevojë (për falënderimin e tij) pse Ai vetë është i lavdishëm. (Përkujtoja popullit tënd) Kur Llukmani duke e këshilluar, birit të vet i tha: 'O djali im, mos i përshkruaj All-llahut shok, sepse idhujtaria është padrejtësia më e madhe!' Ne njeriun e kemi urdhëruar për (sjellje të mira ndaj) prindërve të vet, sepse nëna e vet atë e barti me mund pas mundi dhe pas dy vjetësh ia ndau gjirin. (E porositëm) Të jeshë mirënjohës ndaj Meje dhe ndaj dy prindërve tu, pse vetëm tek Unë është kthimi juaj. E nëse ata të dy tentojnë që ti të më përshkruash Mua shok, për çka ti nuk ke kurrfarë fakti, atëherë mos i respekto ata, po në çështjet e jetës së kësaj bote të

keshë mirëkuptim ndaj tyre, e ti ndiqe rrugën e atij që është i kthyer kah Unë, mandej kthimi juaj është tek Unë, e Unë do t'ju njoftoj për atë që keni punuar. O djali im, s'ka dyshim se edhe nëse ajo (vepra) peshon sa kokrra e lirit, e të jetë e fshehur në rrasë guri, ose në qiej apo në tokë, All-llahu do ta sjellë atë, se All-llahu është i butë dhe hollësisht i informuar. O djali im, fale namazin, urdhëro për punë të mira e ndalo nga të këqijat, përballo me durim çdo gjë që të godet, vërtet, këto janë nga çështjet më të preferuara. Dhe mos e shtrembëro fytyrën tënde prej njerëzve, mos ec nëpër tokë kryelartë, se All-llahu nuk e do asnjë mendjemadh e që shumë lavdërohet. Të jeshë i matur në ecjen tënde, ule zërin tënd, se zëri më i egër është zëri i gomarit.” (Kur’ani, 31:12-19).

“O ju që besuat, s'ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall) janë vepra të ndyta nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar. Shejtani nuk dëshiron tjetër, përveç se nëpërmjet verës dhe bixhozit të hedhë armiqësi midis jush, t'ju pengojë nga të përmendurit e Zotit dhe t'ju largojë nga namazi. Pra, a po i jepni fund (alkoolit e bixhozit)?” (Kur’ani, 5:90-91).

“Dhe me atë që të ka dhënë All-llahu kërko (ta fitosh) botën tjetër, e mos lë mangut atë që të takon nga kjo botë, dhe bën mirë ashtu siç të ka bërë All-llahu ty, e mos bën të këqija në tokë, se All-llahu nuk i do çrregulluesit.” (Kur’ani, 28:77).

Të gjitha këto zgjedhje të civateve nga Kur’ani mund të përputhen e të përkrahen me shumë civate të tjera të marra nga Kur’ani dhe nga Sunneti i Mu-

hammedit a.s. Megjithatë, këto vetvetiu janë të mjaftueshme për të dhënë themelin e një prioriteti të moralit në fenë islame. Këto parime të moralit islam janë të pandryshueshme në natyrën e tyre në të gjitha rrethanat. Zoti na i ka dhënë ato jo vetëm për t'i admiruar në mënyrë të thjeshtë, por edhe me qëllim që të jenë të fuqishme dhe efektive. Ato kanë për qëllim t'i ndihmojnë individit në zhvillimin e personalitetit të tij dhe në kultivimin e karakterit të tij në një mënyrë sa më të përgjithësuar; - ato po ashtu kanë për qëllim t'i përforcojnë mendimet e tij dhe t'i konsolidojnë përfytyrimet e tij me Zotin, burimin e të gjithë të mirës. Morali islam asnjëherë nuk ka qenë i krijuar për ta frikësuar apo për ta pasivizuar njeriun. Kjo mund të ilustruhet me një shembull. Nëse kundër një muslimani veprohet gabimisht, ai është i lirë të zgjedhë: ose të rezistojë e të përgjigjet në të njëjtën mënyrë, ose të falë e ta fitojë besimin te Zoti me rezultatet e veprave të tij. Ai e di se është i autorizuar t'i ndër marrë të dy llojet e aksionit, e po ashtu e di se për atë falja është zgjidhja më e mirë. Sipas kësaj, kur ai fal, ai e bën këtë me zgjedhjen e tij personale për dashurinë ndaj Zotit. Në mënyrë të ngjashme, kur ai shpagohet, faktikisht nuk e thyen ligjin apo nuk vepron në mënyrë të padrejtë; ai i mbron të drejtat e veta, një pikëpamje që vetvetiu është detyrë e shenjtë dhe u ndihmon autoriteteve të drejta të vendosin rend dhe drejtësi. Po të kërkonte feja islame një falje absolute siç besojnë disa teoretikisht, shumë njerëz të padisiplinuar do të bënin të këqija e do t'i kapërcenin të gjithë kufijtë e përcaktuar. Në mënyrë të ngjashme, po të kërkonte feja is-

lame vetëm shpagim, siç na mësojnë gabimisht disa besimtarë të tjerë, nuk do të kishte vend për mëshirë dhe durim, e as për reformë shpirtërore e për pjekuri morale, - rast në të cilin shumë vlera të mira të njeriut do të zhdukeshin e shumë potenciale morale asnjëherë nuk do të vinin në shprehje.

Përgjithësisht është e ditur se njerëzit e mësuar që të falin, pavarësisht nga rrethanat, sigurisht nuk mund t'i zbatojnë në praktikë mësimet e tyre, për arsye se kjo nuk është në interes të njerëzimit në përgjithësi, e as në interes të moralit në kuptimin specifik. Analogjikisht, njerëzit e mësuar që të praktikojnë shpagim të ashpër, kanë pak apo nuk kanë aspak respekt ndaj virtyteve njerëzore dhe kanë më pak kujdes për vlerat morale si ligje universale. Por feja islame, nxitësi hyjnor i natyrës njerëzore, i ka dhënë përgjigjet e sakta për problemet njerëzore. Për mëkatarët që kërkojnë edhe një rast për t'u penduar, e të cilët mund të përmirësohen nëse u garantohet falja, rekomandohet dhe preferohet falja e gabimeve. Megjithatë, kundër atyre që mund t'i keqkuptojnë motivet e faljes, apo që janë të detyruar (nga diçka) të marrin rrugë të gabuar, ndërmerret hakmarrja (shpagimi) në përmasa të njëjta. Sipas kësaj, pikëpamja e muslimanit në të dy rastet është e shëndoshë dhe e mirëfilltë. Në rast se ai fal, e gëzon Zotin dhe kontribuon në përmirësimin e fajtorit. Edhe kur shpagohet (hakmerret), ai e mbron të drejtën, vendos rend e drejtësi dhe ndihmon për shpagimin e së keqes. Tani, cili është morali i shëndoshë? Pikëpamja e njeriut që është hakmarrës i paskrupullt, apo pikëpamja e muslimanit që lë vend për mëshirë e

falje, e që i merr parasysh edhe rrethanat e parapara? Cili prej këtyre ka moral të shëndoshë? Personi që falë duke menduar se nuk ka të drejtë të hakmerret, apo muslimani që falë, edhe pse plotësisht është i vetëdijshëm se mund të hakmerret në mënyrë të ligjshme? Cila është falja e vërtetë? Ajo e cila rezulton nga një detyrim i jashtëm dhe ndalim për të mos vepruar ndryshe, ose ajo që rezulton nga liria për aksion? Nuk ka dyshim në atë se parimet morale të fesë islame janë të shëndosha, unike dhe të adaptueshme. Ato janë udhëzimet e Zotit, burimit të mirësisë dhe moralit.

Koncepti i Universit

Në fjalën e hyrjes shkurtimisht bëmë fjalë për pozitën e muslimanëve dhe për ardhmërinë e fesë islame në hemisferën perëndimore. Ndërsa këtu do të bëjmë fjalë për pozitën e njeriut në botën bashkëkohore, gjendjen e përgjithshme njerëzore dhe konceptin islam të Gjithësisë apo shikimin botëror. Kjo po ashtu do t'i përforcojë konceptet të cilat i shqyrtuam, do të zëmë ngojë disa ide të reja, duke i bashkuar dimensionet e ndryshme të kësaj teme në një kapitull përmbledhës.

Mjafton ta themi vetëm atë se gjendja e tani-shme njerëzore është alarmante. Kjo kërkon kujdes dhe përgjigje të veçantë nga njerëzit që udhëhiqen nga Zoti e që kanë vullnet të fortë. Mirëpo, kjo nuk duhet të na shpie kah mërzia dhe shqetësimi. Fryma

e shpresës është dhe çdoherë ka qenë pjesë përbërëse e fesë islame (shih, p.sh., Kur'anin, 12:87; 65:3).

Problemet dhe krizat e kohëve moderne nuk janë krejtësisht të përgjithshme apo krejtësisht të veçanta. Është e vërtetë se ato janë të rënda, komplekse dhe konfuze. Ndoshta kjo më tepër vlen për kohën e tashme se sa për të kaluarën. Megjithatë, ky dallim ndërmjet kësaj kohe dhe shekujve të kaluar më tepër është një dallim gradacioni se sa dallim i llojit. Kjo ndërlikueshmëri, që në gjendjen tonë bashkëkohore vazhdimisht rritet, mund të jetë e kushtëzuar në përmasa të mëdha nga një rritje e ngjashme apo e njëjtë e prirjeve dhe kapaciteteve tona.

Gjatë shumë shekujve, madje në shumë rajone të rruzullit tokësor, burimi kryesor i krizave të mëdha kanë qenë pikëpamjet jofleksibile, ekskluzive dhe jotolerante ndaj të panjohurës, të ndryshueshmes dhe ndaj të huajës. Ky orientim i nxiti racizmin, elitizmin, fanatizmin, paragjykimin dhe një mori tjetër pikëpamjesh të papëlqyeshme.

Pakkush mund ta kontestojë faktin se njerëzimi po ballafaqohet me një krizë të jashtëzakonshme. Kjo krizë e tanishme njerëzore sigurisht vjen nga mungesa e një baraspeshe serioze në hulumtimet tona të brendshme e të jashtme morale. Nuk ka gjë më të thjeshtë se sa të kërkosim mbajtje të një ekuilibri të një "rangu të mesëm", apo zhvillim të një kryqëzate për "mjetet e floririt". Por, është i vërtetë edhe fakti se s'ka gjë më të rëndë se arritja e këtij qëllimi. Në të kaluarën, deklaratat e tilla, siç është ajo se njeriu nuk mund të jetojë vetëm nga buka, ngandonjëherë ishin aq të shtrembëruara, që të kenë

një konotacion të mospërfilljes për mirëqenien materiale të njeriut. Në mënyrë të ngjashme, besimi në Zot ka qenë i keqkuptuar; më shpesh njerëzit mendonin se ky është një fatalizëm i pashpresë apo një refuzim kategorik i vullnetit të lirë të njeriut dhe vetëkuptimit të tij. Theksimi i tepërt i spiritualitetit dhe refuzimit vetvetiu e vuri theksin paraprak në termat materializëm, racionalizëm, “vullnet i lirë”, etj. Po të theksohet përtej kufijve të tij, spiritualiteti mund të kalojë në besëtytni dhe konfuzion. Në mënyrë analoge, një theksim i tillë mund ta kthejë materializmin në përtaci, vullnetin e lirë në makutëri dhe racionalizmin në zbrazëti. Historia intelektuale e dy-tre shekujve të fundit në mënyrë të haptë i demonstroi këto tendenca.

Në vitet e dhjetëvjeçarëve të fundit, shkalla spirituale lëvizte poshtë - lart. Në vitet gjashtëdhjetë dhe shtatëdhjetë, ngjarjet dhe lajmet e reja janë ato të hulumtimeve të pacytshme, të pakalueshme dhe gjithëpërfshirëse. Mjaft senzacionale janë edhe hulumtimet e pakalueshme në konstruksionin e brendshëm, intern të qenies, edhe pse mund të duken si të çuditshme, të kultit apo shqetësuese.

Rritja e këtyre dy llojeve të fundit, të pakalueshme dhe të pabarazueshme të hulumtimeve, është jashtëzakonisht alarmante. Arsyeja me siguri qëndron në faktin se këto dy tipe nuk varen nga njëri-tjetri, ndaj edhe nuk ndryshojnë. Nuk ekziston ndonjë reciprocitet i dukshëm, përcaktim dypolësh apo pleshmëri e dyanshme. Përkundrazi, ekzistenca e tyre lajthitëse, pa drejtpeshim të sigurt, paraqet një rrezik të vazhdueshëm për shumicën e njerëzve. Kjo

shumë lehtë mund të shpiejë drejt ambivalencës (dyvlefshmërisë) dhe konfuzionit, të cilat në anën tjetër mund t'i rrisin problemet e shoqërisë dhe ta vështirësojnë jetën e njeriut modern. Megjithatë, një vazhdimësi e tillë mund të ndryshohet nëse hulumtimet e mëtutjeshme shkencore si dhe kërkesat specifike morale pajtohen së paku deri në një pikë të caktuar. Njeriu nuk jeton vetëm nga buka. Kjo është më se e vërtetë. Por, është e vërtetë edhe ajo se ai nuk jeton vetëm nga lutjet. Ai është edhe gjallesë politike edhe gjallesë materialiste, por, edhe një hulumtues religjioz i së shenjtës.

Siç përmendëm edhe më parë, bota bashkëkohore është e stërmbushur me probleme të shumta. Por, po ashtu është e stërmbushur edhe me diagnozat kontradiktore dhe recetat se si të veprohet me këto probleme. Disa njerëz mendojnë sipas vargut të popullarizuar lirik: “Ajo që botës i duhet tani është dashuria...”, etj. Disa të tjerë kërkojnë një rilindje njerëzore, e disa njerëz krejtësisht të tjerë kthehen në marksizëm, në humanizëm, në satanizëm ose scien-tizëm⁹ si solucion i fundit. Edhe më të shpeshta janë pritjet se do të vijë ndonjë shpëtimtar i ardhshëm. Megjithatë, kjo listë nuk i merr parasysh indiferentët, të pashpresët dhe apatikët (të pandieshmit, të mpirët), të cilët në të vërtetë mund t'i kapërcejnë të gjitha grupet optimiste të bashkuara. Por, siç duket,

⁹ “Shkenca krishtere”, sektë fetare amerikane të cilën në vitin 1966 e themeloi Meri Beker-Edi e cila predikon se sëmundjet mund të shërohen me anë të besimit në Librin e Shenjtë (Biblën) dhe me anë të lutjeve sepse Zoti është i vetmi i vërtetë, kurse gjithçka materiale, madje edhe sëmundja, janë joreale. (botuesi)

nevoja më e madhe sot është nevoja për “kuptim”. Ç’është ajo që njeriut i duhet më së shumti? Ai është kuptimi i vetvetes dhe natyrës së tij, i potencialeve dhe përkufizimeve të tij, i vendit të tij në Gjithësi dhe i marrëdhënieve të tij me elementet e Universit.

Pyetja që parashtrohet në momentin e pikërishtëm është se si feja islame mund t’i ndihmojë njeriut që ta kuptojë vetveten, ta pasurojë veten e tij dhe ta qartësojë vizionin e tij të mjegulluar? Që t’i jepet përgjigje kësaj çështjeje, duhet të mbahen në mend konceptet themelore të fesë islame për të cilat bëmë fjalë - e me këtë do të mund t’i elaborojmë më tutje elementet e sistemit të saj të vlerave. Shpresojmë se kjo analizë do të tregojë se çfarë marrëdhëniesh kanë ato me njeriun modern në vështirësitë e tij bashkëkohore, dhe si ato mund t’i ndihmojnë që ta gjejë rrugëdaljen e vërtetë.

Parimi i “përmbajtjes” është shumë karakteristik për fenë islame. Sigurisht kjo më së miri shihet në atë se si feja islame e sheh natyrën njerëzore, kuptimin e jetës dhe idenë e Zotit. Feja islame nuk ia përshkruan gjithë këtë filozofisë së njëanshme “humaniste”, e cila pothuajse e hyznizon njeriun dhe nuk njih asgjë më të lartë se ai. Megjithatë, feja islame nuk përkrah gjykimin e njëanshëm se natyra njerëzore është trashëgimisht e prishur, e shkatërruar apo mëkatore, por përkundrazi, ajo nuk e pranon idenë se jeta s’është e mirë, se është brutale, mizore apo e shkurtër. Por, ajo po ashtu e mohon faktin se jeta është një qëllim në vete për kënaqësi pa ndonjë rregullsi speciale. Feja islame jetës i jep kuptim pozitiv, e duke i dhënë kuptim, i jep edhe qëllim. Ai

do ta kishte devaluuar jetën në tokë vetëm në relacion me jetën pas vdekjes. Ai nuk kujdeset ekskluzivisht për të tashmen dhe të pranishmen, hedonizmin momental¹⁰ apo për kënaqësi të përnjëhershme. Por, as nuk e tejkalon krejtësisht të pranishmen dhe të tashmen, me qëllim kërkimi të një parajse për jetën pas vdekjes. Natyrisht, një kërkim i tillë është përpjestimor, - ai e vlerëson çdo fazë të ekzistencës në pajtim me efektin e tij respektiv në mirëqenien e përgjithshme të njeriut. (Shih Kur'anin, 7:33; 17:18-21; 28:77; 57:20-21).

Në Kur'an ekziston një pjesë (2:27-39), që është shembull tipik edhe për shumë të tjera. Kjo pjesë përmban disa nga parimet themelore të fesë islame dhe nga pikëpamja islame e paraqet shikimin themelor të botës. Më të rëndësishmet nga këto janë parimet që vijojnë:

1. Bota është një entitet i krijuar nga vullneti i Krijuesit dhe Ai atë e mbështetë për qëllime kuptimplotë. Ngjarjet historike ndodhin në pajtim me vullnetin e Tij, duke qenë në pajtim me ligje të caktuara. Këto nuk i udhëheq vetëm një rast i lirë, ato nuk janë as obcionale e as nuk janë pasojë e incidenteve kaotike.

2. Njeriun po ashtu e ka krijuar Zoti, duke e deleguar që të jetë məkëmbësi i Tij në Tokë. Ai është i zgjedhur në këtë mënyrë me qëllim që ta kultivojë tokën, ta pasurojë jetën me dituri, me

¹⁰ Drejtim filozofik-etik i cili konsideron se përjetimi emocional dhe kënaqësia janë kulmi i mirësisë, dhe, që këtu, janë frymëzim, qëllim dhe motivacion i tërë angazhimit njerëzor. (botuesi)

virtyt, qëllim dhe kuptim. E për t'u arritur ky qëllim, çdo gjë në tokë e në qiej është krijuar për të, duke iu nënshtruar atij. Jeta në këtë planet nuk paraqet burg për njeriun; ardhja e tij në botë nuk është një dënim arbitrar për mëkatet e bëra më parë. E as që ai që i eksploatuar nga ndonjë botë tjetër, me qëllim që të vijë në këtë. Ekzistenca e tij nuk është vetëm e rastit, por as nuk është edhe një paraqitje e paplanifikuar.

3. Dituria është aftësi e gjithmbarshme e njeriut, duke qenë kështu pjesë përbërëse e personalitetit dhe qenies së tij. Kjo është dituri që e kualifikon njeriun për të qenë mëkëmbësi i Krijuesit të tij dhe duke i mundësuar të ketë respekt dhe afërsi edhe me engjëjt e Zotit.

4. Faza e parë e jetës në tokë nuk filloi me mëkat apo me përbuzje kundër Krijuesit. "Rënia" nga Kopshti i Adnit dhe ajo që ndodhi pas kësaj, - brejtja e ndërgjegjes së Ademit dhe Havës, pendimi i tyre, falja dhe mëshira e Zotit ndaj tyre, armiqësia ndërmjet njeriut dhe djallit - e gjithë kjo Krijuesit nuk iu duk gjë e çuditshme. Kjo as nuk ishte një aksident në vazhden e ngjarjeve. E gjithë kjo, aq më tepër, duhej të ketë ndodhur për t'u disiplinuar njeriu i parë, për t'i dhënë atij përvojën momentale të rënies dhe ngritjes, fitoret dhe disfatat morale, si dhe për t'i treguar atij për largimin dhe pajtesën me Krijuesin. Në këtë mënyrë njeriu do të jetë më i përgatitur dhe më i ndritur për të jetuar dhe për t'u ballafaquar me plot pasiguri dhe momente të dyshimta të jetës.

5. Hava nuk që pjesa më e dobët e çiftit të parë njerëzor. Ajo as nuk e shtyu Ademin të hajë nga

druri i ndaluar, e as nuk ishte vetëm ajo përgjegjëse për rënien nga Xhenneti i Adnit. Edhe Ademi edhe Hava njësoj u ngasën dhe që të dy kanë përgjegjësi në përmasa të njëjta; që të dy i brejti ndërgjegjja, u penduan, e më në fund të dy Zoti i bekoj duke i falur dhe duke i mëshiruar. Kjo është me rëndësi për arsye se e liron Havën nga mallkimi i saj dhe gjinisë së saj gjatë shekujve dhe e liron atë nga ajo se vetëm Hava qe përgjegjëse për rënien. Përveç asaj, kjo shumë qartë na tregon se besimi në inferioritetin moral të grave është i pabazë dhe se standardi i dyfishtë është tërësisht i paarsyetueshëm. Këtu, si edhe në vende të tjera, Kur'ani e bën shumë të qartë se që të dy, edhe burri edhe gruaja, në mënyrë të barabartë janë të aftë për virtyt dhe dobësi, janë të ndieshëm në përmasa të njëjta dhe kanë merita të barabarta.¹¹

6. Njeriu është një i dërguar i lirë i pajisur me vullnet të lirë. Ky është thelbi i humanitetit të tij dhe baza e përgjegjësisë së tij ndaj Krijuesit të tij. Pa vullnetin respektiv të njeriut, jeta do të ishte e pakuptimtë dhe marrëveshja e njeriut me Zotin do të ishte e kotë. Pa vullnetin e lirë të njeriut, do të humbej qëllimi i Zotit dhe njeriu do të ishte krejtësisht i paaftë për të pasur ndonjë përgjegjësi. Kjo, natyrisht, është e paparamendueshme.

7. Jeta e ka prejardhjen nga Zoti. Ajo nuk është as e amshueshme, e as një fund në vetvete, por një fazë kalimtare pas së cilës të gjithë do t'i rikthehen Krijuesit.

¹¹ Shih më lart konceptin e Mëkatit.

8. Njeriu është një i dërguar me përgjegjësi. Me gjithatë, përgjegjësinë për mëkat e ka vetëm mëkatari personalisht. Mëkati nuk është dukuri trashëguese, e ndryshueshme, apo e përgjithshme në natyrë. Çdo individ përgjigjet për veprat e tij. Dhe derisa njeriu mund të jetë i dyshimtë për korrupsion, ai është po ashtu i aftë për pendim dhe reformë. Kjo nuk do të thotë se feja islame më tepër do ta kishte preferuar individin se grupin. Individualizmi do të thotë shumë pak apo asgjë nëse largohet nga konteksti social. Kuptimi i kësaj të vërtete është se individ duhet të luajë role të ndryshme. Ai duhet t'i luajë ato në mënyrë që ta ruajë integritetin e tij moral, ta ruajë identitetin e tij, t'i nderojë të drejtat e Zotit dhe t'i zbatojë obligimet e tij sociale.

9. Njeriu është qenie e ndershme dhe me dinjitet të lartë. Dinjiteti i tij rrjedh prej asaj se ai është i frymëzuar me shpirtin e Krijuesit. Ajo që është më me rëndësi është fakti se ky dinjitet nuk përkufizohet në ndonjë racë, ngjyrë apo klasë të veçantë njerëzore. Kjo është e drejtë natyrore e çdo njeriu, qenies më të ndershme në tokë.

10. Kjo pjesë, më në fund, flet për rrënjët e thella të Njëshmërisë së Zotit dhe për unitetin e një-rëzimit. Në vazhdim ajo na tregon se virtytet më të larta të njeriut janë hyjësia dhe dituria, - e kur ato përfitohen, investohen për të në pajtim me udhëheqjen hyjnore, e kështu sigurohen fati i shkëlqyer dhe jeta e qetë e njeriut.

Kapitulli III PJESA PRAKTIKE E BESIMIT

- ❖ *Namazi (Salati)*
- ❖ *Agjërimi (Savm)*
- ❖ *Zeqati*
- ❖ *Haxhi*

Hyrje

Në këtë kapitull do të njoftohemi me parimet kryesore të besimit, sipas asaj që na e mëson feja islame. Këto janë: shehadeti, namazet, agjërimi, zeqati dhe haxhi. Mënyra se si Zoti i ka urdhëruar këto parime, është mënyra më e drejtë për aftësimin që t'u shërbejnë të gjitha qëllimeve shpirtërore dhe t'i kënaqin të gjitha nevojat njerëzore. Disa nga këto janë të përditshme, disa janë javore, disa mujore, kurse disa janë vjetore, ndërkaq disa të tjera kërkohen minimalisht vetëm një herë në jetën e njeriut. Me këtë ato i përfshijnë të gjitha ditët e javës, të gjitha javët e muajit, të gjithë muajt e vitit dhe të gjitha vitet e jetës, dhe ato, mbi të gjitha, gjithë vazhdimësisë jetësore i japin një kahe hyjnore.

Tashmë përmendëm se besimi pa veprim dhe praktikë nuk ka vlerë, së paku sa i përket fesë islame. Besimi, sipas natyrës së tij, është shumë i ndijshëm dhe mund të jetë shumë efektiv. Po të jetë jashtë përdorimit dhe praktikës, shumë shpejt mund ta humbë gjallërinë dhe fuqinë motivuese të tij. Mënyra e vetme e gjallërimit të besimit dhe arritjes së qëllimit të tij është zbatimi praktik i tij. Zbatimi praktik i jep besimit ushqim shpirtëror, ekzistencë dhe efektivitet. Përveç asaj, besimi e inspiron njeriun të jetë i qëndrueshëm në devotshmëri dhe i rregullt në zbatimin e tij. Kjo është kështu për arsye se marrëdhëniet ndërmjet besimit dhe zbatimit janë shumë të forta, e me këtë nënkuptohet edhe varshmëria

ndërmjet tyre. Njeriu që s'ka besim është njeri pa burim të vërtetë të inspirimit; e si pasojë e kësaj, është njeri që nuk ka as qëllime të vlefshme në jetë. Jeta e një njeriu të tillë është e pakuptimtë, ai jeton vetëm për një ditë të ardhme, - që në realitet nuk është kurrfarë jete. Në anën tjetër, njeriu që e pranon besimin (fenë), por nuk e praktikon atë, është njeri që e mashtron vetveten, - në atë rast ai i ngjason kallimtarit që e ka humbur rrugën.

Marrëdhënia ndërmjet besimit dhe zbatimit në fenë islame ndikon dukshëm në gjithë sistemin e religjionit, duke e manifestuar qëllimin e thellë të mësimin të tij. Feja islame nuk njih kurrfarë dallimi ndërmjet shpirtit dhe trupit, ndërmjet shpirtit dhe materies dhe ndërmjet religjionit dhe jetës. Ajo e pranon njeriun ashtu siç e ka krijuar Zoti dhe natyrën e tij e njih si të përpiluar nga shpirti dhe trupi. Ajo nuk e mohon natyrën e tij shpirtërore, sepse përndryshe njeriu do t'i ngjasonte ndonjë kafshe. Feja islame nuk i nënçmon nevojat fizike të njeriut, sepse përndryshe ai do të ishte engjëll, - por, ai as nuk është engjëll e as që mund të jetë. Sipas fesë islame, njeriu qëndron në qendër të rrjedhës së krijimit. Ai nuk është vetëm qenie shpirtërore, sepse qenie të pastra shpirtërore janë vetëm engjëjt, e ai nuk i tejkalon ata, pasi qenia e vetme që i tejkalon ata është Zoti. Ai nuk është as krejtësisht material apo fizik, për arsye se qeniet e vetme të kësaj kategorie janë kafshët dhe qeniet e tjera iracionale. Duke pasur një natyrë të tillë komplementare (të kombinuar), njeriu ka kërkesa dhe nevoja paralele: shpirtërore dhe materiale, morale dhe fizike. Religjioni që mund t'i

ndihmojë njeriut dhe ta afrojë atë sa më tepër kah Zoti, është religjioni që i merr parasysh të gjitha këto kërkesa dhe nevoja; ai religjion që e ngrit statusin shpirtëror dhe që u vë rregull dëshirave fizike. Kjo është feja islame. Shtypja e cilësdo anë të natyrës njerëzore apo prishja e drejtpeshimit, do të paraqiste një kundërthënie shpërdoruese të natyrës njerëzore, si dhe një qëndrim të papërgjegjëm të vetë natyrës në të cilën Zoti e krijoi njeriun.

Meqë feja islame garanton një njohje të plotë të natyrës njerëzore në vetë trajtën origjinale dhe normale të saj, si dhe pasi që ajo interesohet hollësisht për mirëqenien shpirtërore dhe materiale të njeriut, religjionin nuk e konsideron si një çështje personale apo si një entitet të ndarë nga vazhdimësia kontinuitive e përgjithshme e jetës. Me fjalë të tjera, religjioni nuk ka vlerë nëse mësimet e tij nuk lënë gjurmë të thella në vazhden personale dhe publike të jetës. Nga ana tjetër, jeta është e pakuptimtë nëse nuk udhëhiqet dhe nuk organizohet nga Ligji Hyjnor. Kjo shpjegon se feja islame e shtrinë kuptimin e organizimit të saj në të gjitha sferat e jetës: sjelljen individuale, punën dhe industrinë, ekonominë dhe politikën, marrëdhëniet kombëtare dhe ndërkombëtare etj. Kjo po ashtu na tregon se përse feja islame nuk e njeh “shekullarizimin” apo ndarjen e religjionit nga bashkëveprimet e përditshme të njeriut. Ndërvarshmëria ndërmjet religjionit të vërtetë dhe jetës kuptimplote ka rëndësi vendimtare. Ja përse feja islame hyn në të gjitha sferat e jetës: që t’i udhëheqë të gjitha aktivitetet njerëzore në një mënyrë të shëndoshë e të përgjithësuar, - gjë kjo që

është e pranueshme edhe nga Zoti dhe e mirëseardhur për njeriun.

Si rezultat i kësaj korrespondence të nevojshme ndërmjet religjionit të vërtetë dhe jetës së përditshme, feja islame nuk i takon doktrinës: “Gjashtë ditë për mua apo për botën, e një ditë për Zotin”. Kjo doktrinë, po menduam pak më gjatë, nuk na shpie kurrkund; e me këtë realitetin e religjionit e bën të zbehtë e të padukshëm. Përveç kësaj, kjo dëshmon edhe padrejtësinë ndaj Zotit nga ana e njeriut, - gjë që lë plagë të pashërueshme në shpirtin e njeriut. Mohimi serioz i nevojave shpirtërore dhe morale është shumë i rëndësishëm, madje edhe më i rëndësishëm se nevojat materiale. Në këtë mënyrë do të shkatërrohej natyra e njeriut ndërsa një mosbaraspeshë e tillë paraqet shenjë të degjenerimit. Në mënyrë analoge, nëse gjashtë ditë ia kushton fesë apo mendimit ekskluziv dhe një ditë vetvetes, sigurisht se puna nuk do të qëndrojë më mirë. Ende nuk do të kishim arritur te baraspesha. Rrjedha natyrore dhe logjike në atë rast, do të ishte ajo që e ofron feja islame. Të keshë natyrë komplementare dhe të qëndrosh në qendër të valës së krijimit, d.m.th., të biesh në pengesa serioze, është njësoj sikur ta mohosh shpirtin apo trupin, ta bësh njërën prej tyre të udhëheqë. Detyra më e rëndë e njeriut është t’i ushqejë që të dyja, duke arritur një baraspeshë në kuptim të një drejtësie dhe të një integriteti, si dhe në kuptim të një fuqie të mirëfilltë dhe të vërtetë. Me qëllim që t’i ndihmojë njeriut që ta japë këtë provim kaq të rëndë, feja islame do t’i japë parimet e rregullta të besimit të saj.

Namazi (Salati)

Qëllimi i namazit

Namazi është njëra ndër shtyllat kryesore të fesë islame, prandaj konsiderohet edhe si themel i fesë. Çdo musliman që nuk i kryen namazet e tij pa kurrfarë arsyeje, pa dyshim bën mëkat të madh e të shëmtuar. Ky mëkat është aq i madh sepse kjo nuk është vetëm kundër Zotit, gjë që është një veprim mjaft i keq, por është edhe kundër vetë natyrës së njeriut. Njeriu ka instinkt që t'i adhurojë qeniet e mëdha dhe të synojë drejt qëllimeve të larta. Qenia më e madhe dhe qëllimi më i ndritshëm nga të gjithë është Zoti. Mënyra më e mirë që te njeriu të kultivohet një personalitet i shëndoshë dhe të aktualizohen aspiratat e tij në një vijimësi të pjekur të zhvillimit, është feja islame. Mohimi i namazit paraqet shtypje e mohim të cilësive të mira në natyrën njerëzore dhe po ashtu mohim të paarsyetueshëm të së drejtës për të dashur e për të adhuruar, të së drejtës për të aspiruar e lartësuar dhe keqpërdorim të së drejtës për arritjen e së mirës me qëllime të mirëfillta. Një shtypje dhe mohim i tillë përbën një faj mjaft serioz dhe destruktiv. Këtu qëndrojnë rëndësia dhe vitaliteti i namazit në jetën e njeriut.

Çdoherë duhet të mbajmë mend se Zotit nuk i nevojitet lutja e njeriut, sepse Ai është i liruar nga të gjitha nevojat. Ai interesohet vetëm për prosperitetin dhe mirëqenien tonë në çdo kuptim. Kur Ai e thekson nevojën e namazit dhe na jep ndonjë detyrë, ka për qëllim të na ndihmojë; për arsye se çdo e mirë që

e bëjmë është në dobinë tonë, dhe çdo faj apo mëkat që e bëjmë, është kundër shpirtave tanë. Këtu po ashtu njeriu është në qendër të gravitetit dhe interesi i tij i përbashkët është kujdesi kryesor. Mirësia të cilën njeriu mund ta përfitojë nga namazi është e pakufishme dhe bekimi i lutjes nuk mund të pararendohet për nga madhështia. Kjo nuk është vetëm një “teori” apo një supozim konvencional, por është një e vërtetë fascinuese dhe një përvojë shpirtërore. Tani të japim një sqarim të namazit në Islam:

1. Ai e përforcon besimin në ekzistencën dhe në mirësinë e Zotit dhe e përcjell këtë besim në skutat më të thella e më të ndjeshme të shpirtit të njeriut.
2. Ai e gjallëron këtë besim dhe e bën më konstruktiv për kontinuitetin praktik të jetës.
3. Ai i ndihmon njeriut që t’i kuptojë synimet e tij natyrore dhe instiktive për madhësi dhe moral të lartë, për shkëlqesi dhe pjekuri të virtyteve.
4. Ai e pastron zemrën dhe e zhvillon mendjen, e kultivon vetëdijen dhe e forcon shpirtin.
5. I bashkon forcat e mira dhe i largon qëllimet dhe dispozitat e këqija të njeriut.

Po ta analizojmë namazin dhe ta studiojmë natyrën unike të tij, do të shohim se kjo nuk është vetëm një lëvizje fizike apo një recitim i zëshëm i Librit të Shenjtë. Namazi është formulë e papërshkrueshme e një meditimi intelektual dhe e një devocioni shpirtëror, formulë e një ngritjeje shpirtërore dhe ushtrim fizik; që të gjitha të kombinuara e të përfshira në një tërësi. Kjo është një përvojë ekskluzivisht islame, në të cilën çdo muskul i trupit

bashkohet me shpirtin për lartësimin dhe glorifikimin e Zotit. Përkufizimi i vërtetë i kuptimit të namazit është tejet i vështirë, por do të përpiqemi që këtë ta bëjmë me disa fjalë sqaruese:

1. Një mësim për disiplinë dhe fuqi të vullnetit.
2. Një ushtrim ndaj dashurisë së Zotit dhe ndaj të gjitha qëllimeve të vlefshme.
3. Një përkujtues vigjilent i Zotit dhe një shpallje konstante e mirësisë së Tij.
4. Një fryt i kultivimit shpirtëror dhe i shëndetshmërisë morale.
5. Udhëheqje drejt mënyrës më të lartësuar të jetesës.
6. Ruajtje e sigurt kundër parregullsisë dhe keqbërësisë, kundër devijimit të keq dhe gabimit.
7. Demonstrim i barazisë së vërtetë, i unitetit të fortë dhe i vëllazërisë.
8. Një shprehje falënderimi ndaj Zotit dhe nderimit të Tij.
9. Një kontinuitet i jetës në paqe të brendshme dhe stabilitet.
10. Një burim i pashtershëm i durimit dhe kurajos, i shpresës dhe i besimit.

Ja, ky është namazi dhe e gjithë kjo që e thamë është ajo që namazi mund ta bëjë për njeriun. Dëshmitari më i mirë për këtë thënie është vetë përjetimi i namazit dhe ajo që njeriu mund ta fitojë nga kënaqësitë shpirtërore të tij. Në atë rast, do të mund të dimë se sa i rëndësishëm është ai.

Kushtet e namazit

Pavarësisht se a është faltari mashkull apo femër, namazi është i obligueshëm për çdo musliman, që është:

1. I shëndoshë dhe përgjegjës.
2. Duhet të jetë i pjekur dhe në kohën e adoleshencës, zakonisht në moshën afër katërmbëdhjetëvjeçare. (Prindërit duhet t'i këshillojnë fëmijët të fillojnë me ushtrimin e namazit që në moshën shtatëvjeçare, e t'i detyrojnë me forcë në moshën dhjetëvjeçare).
3. I lirë nga ndonjë sëmundje serioze, femrat lirohen nga ky obligim gjatë kohës së të përmuajshmeve dhe nga kufizimet që dalin lidhur me lindjen e foshnjës (periudha e lehonisë). Periudha maksimale e moskryerjes së namazit në këto dy raste është dhjetë ose dyzet ditë. Në këto rrethana gratë lirohen krejtësisht nga namazi.

Namazi nuk plotësohet:

1. Nëse individi nuk ka abdest, gjë që do të shpjegohet më vonë;
2. Nëse nuk e pastron tërë trupin (në rastet kur ka nevojë), rrobat e veshura dhe vendin ku do ta kryejë namazin nga të gjitha llojet e ndotjes dhe të papastërtisë.
3. Nëse mënyra e veshjes së tij nuk është në rregull, në mënyrë që nuk përputhet me rregullat morale, e që synojnë mbulimin e pjesëve të turpshme të trupit. Për mashkullin, trupi duhet të

jetë i mbuluar së paku që nga kërthiza e deri nën gjunj. Për femrën duhet të jetë i mbuluar i gjithë trupi, përveç fytyrës, duarve dhe shputave të këmbëve. Për të dy gjinitë vlen ajo se duhet t'u largohen rrobave të tejdukshme.

4. Nëse nuk e shpreh qëllimin (nijetin) e namazit me zemër.
5. Nëse nuk kthehet në drejtim të Kibles apo Qabes në Mekke. Ekzistojnë mënyra të shumta për ta caktuar drejtimin e duhur. Nëse njeriu nuk ka mjete që e tregojnë këtë, atëherë ai duhet ta ndjekë gjykimin e tij më të mirë.

Llojet e namazit

Këto që vijojnë janë llojet e ndryshme të namazit:

1. Namazi i obligueshëm (farz) që i përmban namazet ditore, namazin e së premtes (xhumasë) dhe namazin e xhenazes. Moskryerja e këtyre namazeve, pa ndonjë arsye të fortë, është një lëshim serioz që i nënshtrohet dënimit.
2. Namazet, përpos atyre që janë të obligueshme, (vaxhibet dhe sunnetet), e që i përmbajnë lutjet që i shoqërojnë ato të obligueshmet; si dhe namazet e përbashkëta me rastin e dy festave të mëdha muslimane (Bajrameve). Moskryerja e këtyre obligimeve është një refuzim qëllimkeq dhe një sjellje qortuese.
3. Namazi i padetyrueshëm (namazi nafile), i cili i përmban të gjitha llojet e namazeve vullnetare në çdo kohë të ditës apo të natës. Dy periudha kanë përparësi të veçantë: pjesa më e vonshme e

natës, pikërisht para agimit dhe ajo para lindjes së diellit.

Kohët e namazeve

Çdo musliman, qoftë mashkull apo femër, duhet t'i falë pesë namazet ditore në kohën e caktuar për faljen e tyre, nëse nuk ka arsye ligjore për largim nga namazi, kombinim të namazeve të ndryshme apo vonesë kohore. Këto namaze janë:

1. Namazi i sabahut - i cili falet prej agimit deri para lindjes së diellit.
2. Namazi i drekës.¹² - Ky namaz falet pasi dielli të fillojë të lëvizë nga zeniti (pika më e lartë) e deri kur hija e objektit të shtrihet sa vetë objekti. Kjo kohë zgjat që nga ora 12 (respektivisht 13 me matjen verore të kohës), e deri në kohën e namazit të ikindisë. Diferenca kohore ndërmjet këtyre namazeve është rreth dy orë e gjysmë, respektivisht tri orë. Megjithatë, ekzistojnë edhe kalendarë të saktë që e tregojnë kohën e namazit. Por, nëse nuk kemi asnjë mjet në

¹² Muslimanët e zonës së kohës verore kanë disa vështirësi dhe paqartësi lidhur me kohën e duhur të namazit të përbashkët të së Premtes (Xhumasë). Ky problem mund të zgjidhet lehtë me lëvizjen e kohës së lutjes në mes orëve 13, 15 dhe 14, 30 gjatë tërë vitit. Në këtë mënyrë nuk do të ketë nevojë për ndërrim të kohës në verë e dimër. Ne ua rekomandojmë këtë vëllezërve tanë muslimanë me vendosmëri, me qëllim që ata këtë lutje ta inkuadrojnë në orarët e tyre, si një ndër angazhimet e tyre të përhershme. E njëjta gjë mund të bëhet edhe me namazet e përbashkëta të mesditës të së dielës.

disponim, duhet të udhëhiqemi nga gjykimi ynë më i mirë.

3. Namazi i ikindisë - fillon menjëherë pas mbarimit të kohës së namazit të drekës e vazhdon deri para perëndimit të diellit.
4. Namazi i akshamit. - Koha e këtij namazi fillon menjëherë pas perëndimit të diellit derisa të zhduket ngjyra e kuqe në horizontin perëndimor. Normalisht që për këtë nevojitet një periudhë kohore prej një orë e gjysmë.
5. Namazi i jacisë - fillon pasi që të zhduket ngjyra e kuqe e horizontit perëndimor (përafërsisht një orë e gjysmë pas perëndimit të diellit) dhe vazhdon deri në orët e hershme të mëngjesit.

Mund të vërejmë se feja islame i ka rregulluar kohët e namazeve në atë mënyrë që ushtrimi ynë shpirtëror në mënyrë të dukshme koincidon me ushqimin tonë fizik dhe e kombinon qetësinë e mendjes sonë me relaksimin e trupit. Namazi i hershëm i sabahut bëhet në kohën e rregullt të mëngjesit; falja e drekës koincidon me kohën e drekës; namazi i ikindisë bie në kohë të pushimit që e bën njeriu për të pirë kafe apo çaj; namazi i akshamit është përafërsisht në kohën e darkës dhe ai i jacisë koincidon me kafshatën e vonshme. Po ashtu mund të vërejmë se muslimani, duke i kryer këto lutje, gjithë ditës, në fillim, gjatë saj si dhe në mbarim të saj, i jep një vulë shpirtërore. Në këtë mënyrë ai e kombinon fenë me jetën, e ndjenë praninë e Zotit në vete gjatë gjithë ditës, i mbaron punët e tij ditore me një ndjenjë shpirtërore dhe kështu e ndërton presti-

gjin e tij moral me themele të forta. Përveç kësaj, në këtë mënyrë muslimani e zgjeron vitalitetin e tij shpirtëror në të gjitha aspektet e jetës; dhe religjioni e përfaqëson veten në të gjitha fushat e veprimtarisë. Ai bëhet efektiv në shitore dhe zyra, nëpër shtëpi dhe ferma, nëpër fabrika e plantacione. Ai e zgjeron dritën e vet në çdo rreth të punës dhe të afarizmit. Me të vërtetë, ky orar i lutjes është kaq i vlefshëm, për arsye se është vepër e Zotit dhe prodhim i fesë islame.

Çdoherë është e preferueshme që kryerja e namazit të bëhet në kohën e duhur; natyrisht, arsye-tim për moskryerjen e tij do të ishte ndonjë vonesë apo ndonjë shtyrje e papritur. Këto lutje janë testimet hyjnore. Dhurata për ata që e fitojnë këtë test është tepër e madhe dhe gëzimi e kënaqësia e tyre nuk mund të merren me mend. Gëzimi dhe kënaqësia që i ndjejnë ata, bashkë me nderin që u bashkangjitet, nuk mund të përshkruhen me fjalë. Në anën tjetër, mospjesëmarrja në këtë test është mëkat që dënohet. Ajo shkakton dënime serioze, privim shpirtëror, agoni mentale dhe izolim social.

Namazi i drekës dhe ai i ikindisë mund të falen në të njëjtën kohë, nëse njeriu udhëton apo është i sëmurë. E njëjta vlen edhe për namazet e akshamit dhe të jacisë.¹³

¹³ Në rastin e parë, bashkimi i namazeve është i një tipi të "avancuar". Namazi i ikindisë faktikisht falet para kohës së tij të caktuar, menjëherë pas namazit të drekës. Në rastin e dytë, kombinimi është i tipit të "vonuar". Namazi i akshamit falet pas kohës së tij të caktuar, por menjëherë para se të falet namazi i jacisë. Një bashkim i tillë i namazeve mund ta lehtësojë frikën e

Abdesti

Para se ta fillojë namazin, besimtari duhet të jetë i përgatitur psikikisht dhe i pastër. Është e nevojshme t'i lajë pjesët e trupit, të cilat përgjithësisht i ekspozohen pluhurit, fëlliqësirës apo çfarëdo qoftë ndotjeje. Ky veprim quhet ABDEST dhe preferohet të zbatohet në këtë mënyrë:

1. Të bëhet nijet se ky akt kryhet për qëllim të adhurimit dhe pastërtisë.
2. Duart duhet të lahen tri herë deri në nyje.
3. Goja tri herë duhet të shpërlahet me ujë, mundësisht me ndonjë brushë.
4. Duhet të shpërlahen vrimat e hundës me futjen e ujit në to, tri herë.
5. Duhet të lahet e gjithë fytyra tri herë me të dy duart, duke u përfshirë pika më e lartë e ballit dhe fundi i mjekrës prej veshit në vesh.
6. Duhet të lahet krahu i djathtë tri herë deri te pika e fundit e bërrylit, e pastaj në të njëjtën mënyrë veprohet edhe me krahun e majtë.
7. Duhet të bëhet mes'h koka me dorë të lagur, vetëm një herë.
8. Duhet të pastrohen pjesët e brendshme të veshëve me gishtat tregues dhe pjesët e jashtme të tyre me gishtërinjtë e mëdhenj. Kjo duhet të bëhet vetëm me gishtërinj të lagur.
9. Duhet të pastrohet qafa rreth e qark me duar të lagura.

muslimanëve, të cilët për shkaqe legjitime (p.sh., udhëtimi, ndërresat në punë, etj.), nuk mund t'i kryejnë namazet e tyre në kohën e duhur.

10. Duhet të lahen të dy shputat e këmbës deri në nyje, tri herë, duke filluar prej shputës së djathtë.

Në këtë fazë përfundon abdesti dhe njeriu që ka marrë abdest është i gatshëm që ta fillojë namazin. Kur kjo larje (abdest) është valide, personi mund të qëndrojë me atë sa të ketë mundësi dhe t'i falë disa namaze me radhë. Megjithatë, preferohet që marrja e abdestit të përsëritet sa më shpesh. Po ashtu preferohet që e gjithë kjo të kryhet në pajtim me rendin e sipërpërmendur, edhe pse pranohet edhe nëse dikush nuk i përmbahet këtij rendi. Larja e disa pjesëve të trupit (abdesti) në mënyrën siç e shpjeguem mjafton për namaz, nëse nuk prishet për çfarëdo qoftë arsyesh.

Prishja e abdestit

Abdesti prishet për shkak të:

1. Lirimeve natyrore, si p.sh., urinimi, jashtëqitja, lëshimi i gazrave etj.
2. Rrjedhjes së gjakut, qelbit, etj., nga cilado pjesë e trupit.
3. Vjelljes.
4. Gjumit.
5. Humbjes së vetëdijes së njeriut nga çfarëdo shkak, qoftë i brendshëm apo i jashtëm.

Me rastin e paraqitjes së cilësdo nga këto pengesa, abdesti duhet të përsëritet, që njeriu të jetë në gjendje ta kryejë namazin. Po ashtu, pas lirimeve natyrore duhet të përdoret uji; për arsye se mjetet e

tualetit mund të mos jenë të mjaftueshme për qëllimin e pastërtisë dhe lartësimin.

Tejemmumi

Tejemmumi ose përdorimi i dheut të pastër mund ta zëvendësojë abdestin e madje edhe larjen. Kjo lejohet në rastet vijuese:

1. Kur njeriu është i sëmurë dhe nuk mund ta përdorë ujin;
2. Kur ai nuk mund të gjejë ujë në sasi të mjaftueshme;
3. Kur përdorimi i ujit mund ta dëmtojë njeriun ose mund t'i shkaktojë ndonjë sëmundje;
4. Kur marrja e abdestit e pengon njeriun gjegjësisht nuk i jep rast të jetë i pranishëm në namazin e xhenazes apo të Bajramit, - gjë që nuk mund të zëvendësohet.

Në të gjitha këto raste është e lejuar të merret tejemmumi, i cili bëhet në mënyrën që vijon:

1. Përgatiti dhe shtriji të dy duart në tokë të pastër, rërë apo gurë.
2. Shkundi duart dhe pastroje fytyrën me to në të njëjtën mënyrë sikur kur të marrish abdest.
3. Përgatiti dhe shtriji përsëri në rërë duart dhe pastroje krahun e djathtë deri te bërryli me dorën e majtë dhe krahun e majtë me dorën e djathtë.

Tejemmumi është një demonstrim simbolik i rëndësisë së abdestit, e që është rrënjësor edhe për adhurimin edhe për shëndetin. Kur feja islame na

njoftoi për larjen e pjesërishme të trupit, njëherit na njoftoi edhe me formulën më të mirë higjienike, të cilën asnjë doktrinë tjetër shpirtërore apo recetë mjekësore nuk ka qenë në gjendje ta prodhojë.

Lehtësimet e posaçme gjatë marrjes së abdestit

Lidhur me abdestin feja islame ofron edhe disa lehtësime. Nëse njeriu pas abdestit mbath çorape të trasha apo meste, atëherë nuk është e domosdoshme që ato të zbathen nëse abdesti prishet. Në vend të zbathjes së tyre nga trupi, dora e lagur duhet t'i përshkojë edhe ato. Çorapet megjithatë duhet të zbathen, sepse këmbët duhet të lahen së paku një herë brenda njëzet e katër orëve. Nëse njeriu mbath meste, e nëse pjesa e poshtme dhe lëkura e tyre janë të pastra, atëherë vlen e njëjta gjë. Në mënyrë analoge, nëse ekziston ndonjë plagë në cilëndo pjesë të trupit që duhet të lahet gjatë abdestit, dhe nëse ka gjasa se do të jetë e dëmshme larja e asaj pjese të posaçme të trupit, atëherë lejohet edhe pastrimi mbi fashën e cila e mbulon plagën, - me anë të dorës së lagur.

Larja e tërësishme e trupit - Gusli

Duhet të lahet i gjithë trupi, bashkë me vrimat e hundës, gojës dhe kokën, para namazit në cilindo prej rasteve që vijojnë:

1. Pas marrëdhënieve seksuale.
2. Pas ëndrrave në të cilat arrihet ejakulimi seksual.

3. Në kohën e të përmuajshmeve të femrat.
4. Në fund të lehonisë, e cila maksimalisht zgjat dyzet ditë. Nëse ky obligim i gruas kryhet para se të kalojnë dyzet ditë, atëherë larja e trupit është e obligueshme.

Duhet të cekim se në fillim të larjes së trupit, qëllimi (nijjeti) duhet të jetë i qartë: se kjo bëhet për pastërtinë dhe adhurimin. Po ashtu, personi që e kryen larjen e trupit, qoftë kjo larje abdest apo gusël, duhet ta kombinojë këtë me disa thënie glorifikuese ndaj Zotit, si edhe me lutjen ndaj Tij për një udhëheqje të sinqertë. Megjithatë, nëse njeriu nuk i di thëniet e sakta, mund t'i thotë ato me fjalët e veta më të mira. Kjo është e mjaftueshme vetëm nëse dihet se këto fjalë i dedikohen Zotit dhe thuhet me sinqeritetin më të madh.

Thirrja për namaz - Ezani

Pasi që e merr abdestin, ashtu siç u shpjegua më lartë, faltari është i gatshëm për t'u falur. Kur vjen koha e namazit, është një praktikë e mirë, sipas haditheve të pejgamberit Muhammed a.s., të thirret ezani. Thirrësi i ezanit (muezini) drejtohet kah Kibla, i ngrit të dy duart te veshët e tij dhe i shqipton me zë të lartë fjalët që vijojnë:

1. All-Il=hu Ekber

الله اكبر

(All-llahu është më i Madhi)

-përsëritet katër herë

2. Eshhedu En L= il=he il-lall-Il=h **اشهد ان لا اله الا الله**
 (Dëshmoj se nuk ka hyjni, përveç All-llahut)
 -përsëritet dy herë
3. Eshhedu Enne Mu2ammeder-Res\lull-Il=h **اشهد ان محمد الرسول الله**
 (Dëshmoj se Muhammedi është I Dërguari i Zotit)
 -përsëritet dy herë
4. @ajje Ole-4-\$al=2 **حَى عَلَى الصلَاة**
 (Ejani në namaz)
 -përsëritet dy herë, duke e kthyer fytyrën kah e djathta
5. @ajje Ale-l-felah **حَى عَلَى الفلاح**
 (Ejani në shpëtim)
 -përsëritet dy herë, duke e kthyer fytyrën kah e majta
6. All-Il=hu Ekber. **الله اكبر**
 (All-llahu është më i Madhi)
 -përsëritet dy herë
7. L= il=he il-lall-Il=h **لا اله الا الله**
 (Nuk ka hyjni tjetër përveç All-llahut)
 -një herë

Kur thirret ezani i sabahut, muezini shton edhe një fjali pas fjalisë (5). Fjalja që duhet të shqiptohet është kjo:

- E4-4al=tu #ajrun Minen-nevm **الصلَاة خير من النوم**
 (Namazi është më i dobishëm se gjumi)
 -përsëritet dy herë

Pas kësaj thirrësi vazhdon me pjesët (6) dhe (7). Ky përjashtim bëhet vetëm në mëngjes, për arsye se është koha kur njerëzit flejnë dhe kanë nevojë për përkujtim të kohës së namazit.

Ikameti

Pasi që kryhet ezani, besimtarët janë të gatshëm ta fillojnë namazin me ftesën e quajtur I~+METUN. Fjalitë këtu janë të njëjta si te ezani, që u përmendën pak më lartë, me përjashtim të dy dallimeve:

- a) Ikameti kryhet më shpejtë dhe me zë më të ulët; dhe
- b) menjëherë pas pikës me numër (5), fjalia që vijon duhet të përsëritet dy herë:

~ad ~=meti4-4al=h

قد قامة الصلاة

(Namazi po fillon)

Pas kësaj, si zakonisht, vijojnë pjesët (6) dhe (7).

Procesi aplikativ i namazit

Pasi që besimtari e merr abdestin, pas ezanit dhe ikametit namazi fillon në këtë mënyrë:

1. Namazi i sabahut

Në fillim të këtij namazi falen dy rekate (sunnë). Pas këtyre vijojnë dy rekate të tjera që janë të obligueshme (farz). Që të dy rekatet, të obligueshme dhe vullnetare, falen në të njëjtën mënyrë, përveç se

kur bëhet nijjeti, duhet të dallojmë dy prej tyre. Ja se si vijon përshkrimi i tyre:

Akti I. Faltari qëndron me përulje dhe respekt, i drejtuar kah Kibla, i ngre duart te veshët dhe thotë: “E bëj nijjet faljen e sunnetit (farzit) të namazit të sabahut - All-llahu Ekber”. Pastaj i lëshon poshtë duart dhe e vë dorën e djathtë mbi të majtën pak më poshtë se kërthiza.¹⁴



Akti II. Pas kësaj, ai me zë të ulët thotë:

سبحانك اللهم و بحمدك و تبارك أسمك و تعالى جدك و لا اله
غيرك.

أعوذ بالله من الشيطان الرجيم. بسم الله الرحمن الرحيم

“Sub2=nekell-ll=humme, ve bi2amdike, ve
teb=rekesmuke, ve teo=l= xhedduke, ve l= il=he
gajruke.

¹⁴ Kjo pozitë e duarve është në pajtim me një shkollë juridike. Pozitat tjera i preferojnë shkollat tjera. Megjithatë, këto janë dallime tejet të vogla dhe nuk ndikojnë në validitetin e namazit. Në realitet, të gjitha dallimet e këtilla konsiderohen si çështje përshtatshmërie dhe lehtësimi, më tepër se pengesa apo ndalime.

Ep\ldhu bil-l=hii mineshej6=nirr-rraxh]m.

Bismil-l=hirr-Rra2m=nirr-Rra2]m.”

Kjo do të thotë: “I lavdishëm je o Zot! Falënderimet të qofshin Ty! Emri Yt është i bekuar, madhëria Jote është e paarritshme! S’ka hyjni tjetër përveç Teje! Mbështetem në mbrojtjen e All-llahut nga shejtani i mallkuar! Në emër të All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!”¹⁵


Akti III. Pas kësaj, me zë të ulët apo të dëgjueshëm ai e reciton kaptinën hyrëse të Kur’anit (suren el-Fatiha), e cila shoqërohet me cilëndo sure të Kur’anit. (Kjo kaptinë dhe shembujt e këtyre kaptinave të shkurtra, do të jepen më vonë në këtë pjesë të librit).

Akti IV. Pastaj, faltari thotë: “All-llahu Ekber” (Zoti është më i Madhi), duke e ulur kokën e tij poshtë në një kënd të drejtë, i afron shputat e dorës te gjunjtë e tij dhe thotë me zë të ulët:

“Sub2=ne Rabbijel O7]m”

سبحان ربى العظيم

¹⁵ Kjo pjesë rekomandohet, por nuk është absolutisht vendimtare për kompletimin e namazit në tërësi.



“I lavdishëm është Zoti im i Madh!” - (përsëritet tri herë). Kjo quhet ruku. Pas kësaj përsëri kthehet në pozitën qëndruese me fjalët:

سمع الله لمن حمده, ربنا لك الحمد

“Semioll-ll=hu Limen @amideh; Raben= Lel
@amd”

“Zoti dëgjon secilin që e falënderon Atë; Zoti ynë, falënderimi të takon vetëm Ty!” Kur thuhet kjo, duart mbeten anash.

Akti V. Faltari pastaj thotë: “All-llahu Ekber”, duke u përkulur në ashi mënyre që gishtërinjtë e të dy këmbëve, të dy gjunjë, të dy duart dhe balli i tij ta prekin tokën. Kjo pozitë quhet suxhud (sexhde), e cila shoqërohet me këto fjalë:

“Sub2=ne Rabbijel-aol=“

سبحان ربي الأعلى



“I lavdishëm është Zoti im, më i Larti - (përsëritet tri herë).

Akti VI. Pastaj pas tekbitit, bëhet një ndejë, që është një pushim i shkurtër në pozitën ulëse: pjesa e jashtme e shputës së majtë dhe gishtërinjtë e së djathtës, që janë në një pozitë të ngritur, e prekin tokën, kurse që të dy duart vendosen mbi gjunjë.



Pas kësaj vjen përkulja e dytë në tokë (suxhud), që përsëritet në mënyrën e njëjtë me thëniet e njëjta si në rastin e parë. Me këtë mbaron një rekat i namazit.

Akti VII. Pas rekatit të parë, besimtari ngrihet duke thënë: “All-llahu Ekber”, duke marrë pozitën qëndruese për rekatën e dytë dhe reciton “Fatihanë”, të përcjellur me ndonjë sure tjetër të Kur’anit, si në rekatën e parë.

Akti VIII. Kur besimtari e mbaron rukunë e dytë dhe dy sexhdet, njësoj si herën e parë, ai merr një pozitë ulëse si në ndejën ndërmjet dy sexhdeve dhe reciton Teshehudin me të dy pjesët e tij. (Kjo do të theksohet më vonë në këtë pjesë).

Akti IX. Më në fund, faltari e kthen fytyrën e tij në anën e djathtë, duke i thënë këto fjalë:

السلام عليكم ورحمة الله

“Es-selamu Olejkum ve Ra2metull-ll=h”

(Paqja dhe mëshira e All-llahut qofshin mbi ju). Pas kësaj ai e kthen fytyrën nga ana e majtë dhe i thotë të njëjtat përsëritje.

Kjo është mënyra se si kryhet namazi që përmban dy rekate, pavarësisht a është i obligueshëm (farz) apo jo (sunnat). Po që se e dimë se si ta kryejmë këtë namaz, për të gjithë të tjerët do ta kemi shumë më lehtë. Duhet po ashtu të theksojmë se çdo lëvizje apo fjalë në namazin islam, ka rëndësi tejet të madhe dhe është një simbolikë me një kuptim tejet të thellë.

2. Namazi i drekës

Ky namaz përmban katër rekate që quhen sunnet, katër që quhen farz dhe dy të tjera sunnet. Farzi i kësaj lutjeje falet në mënyrën që vijon:

- a) Dy rekatet e para falen në të njëjtën mënyrë si në rastin e namazit të sabahut. “Fatiha” dhe një sure tjetër e Kur’anit këndohen me zë të ulët. Rukutë dhe sexhdet kryhen në të njëjtën mënyrë.
- b) Kur këndohet Teshehudi, pas rekatit të dytë, faltari ndalet pas fundit të pjesës së parë të tij, me qëllim që të merret pozita e qëndrimit në këmbë.
- c) Pastaj ai e këndon vetëm “Fatihanë” në rekatën e tretë, pa shtuar asnjë sure tjetër të Kur’anit.
- ç) Kur e përfundon rekatën e tretë, përgatitet për të katërtin, duke e kënduar “Fatihanë” ashtu si në rekatën e tretë.
- d) Pas përkuljes dhe sexhdeve, ai e merr pozitën ulëse “Xhulus” dhe e këndon gjithë Teshehudin me të dy pjesët e tij.
- dh) Pas kësaj, ai i shqipton përshëndetjet e paqes në të djathtë e në të majtë.
- e) Falja e dy rekateve sunnet të fundit është e njëjtë me atë të namazit të sabahut.

3. Namazi i ikindisë

Ky namaz përmban katër rekate sunnet, pas të cilave vijnë edhe katër rekate farz. Që të gjitha këto kryhen në të njëjtën mënyrë si edhe në namazin e drekës, me zë të ulët.

4. Namazi i akshamit

Ky namaz përmban tre rekate farz që shoqërohen me dy sunnete namaz. Në dy rekatet e para ai mund të thuhet me zë. Falet në mënyrë të ngjashme si namazi i paraditës dhe i pasditës, por dallon nga ato sipas asaj që këtu është përjashtuar rekati i fundit, ndërsa ulja përfundimtare, e cila vjen pas recitimit të “Fatihasë”, përkuljes dhe sexhdeve, që të gjitha vijnë pas rekatit të tretë, e cila mbaron me shqiptimin e përshëndetjeve të paqes. Të dy rekatet e sunneteve falen në mënyrë të njëjtë si në namazin e sabahut.

5. Namazi i jacisë

Ky namaz përmban katër rekate farz, dy sunnet dhe tri të tjera që quhen “Vitr”¹⁶ (që janë më të larta se sunnetet dhe më të ulëta se ato farz). Dy rekatet e para nga katër të farzit thuhet me zë të lartë. Përveç kësaj, kjo pjesë kryhet njësoj si në namazin e drekës dhe të ikindisë. Të dy rekatet sunnet falen njësoj si në namazin e sabahut.

Sa u përket tri rekateve vitr, ato kryhen në mënyrë të ngjashme me ato të namazit të akshamit, me dy përjashtime: (a) në rekatit të tretë “Fatihë” përcillet me një sure të Kur’anit, dhe (b), gjatë qëndrimit para përkuljes në sexhde, faltari merr tekbir dhe i këndon këto fjalë:

¹⁶ Ekzistojnë dallime të vogla të interpretimit ndërmjet shkollave të ndryshme juridike. Disa nuk e kërkojnë “Vitr-in”, disa e kërkojnë në namazin e sabahut, me disa ndryshime të vogla. Megjithatë, ndjekja e cilësdo shkollë juridike është e pranueshme.

اللهم انا نستعينك و نستغفرك و نستهديك و نوّمن بك, و نتوب
إليك ونتوكل اعليك و نثنى عليك الخير كله, نشكرك و لا نكفرك
و نخلع و نترك من يفجرك. اللهم اياك نعبد و لك نصلى و
نسجد, و إليك نسعى و نحفد, نرجوا رحمتك و نخشى عذابك إن
عذابك بالكفار ملحق.

“All-Il=humme inn= neste[]nake, ve nestagfiruke, ve
nestehd]ke, ve nu'minu bike, ve net\bu ilejke, ve
netevekkelu alejke, ve nuthn] olejkel-3ajre kul-leh\,
neshkuruke, ve l= nekfuruke, ve na3lep ve netruku
men jefxhuruke. All-Il=humme ijj=ke nobudu, ve leke
nu4al-l] ve nesxhudu, ve ilejke neso= ve na2fidu,
nerxh\ ra2meteke ve na3sh= odh=beke. Inne
odh=beke bil-kuff=ri mul2i`.”

Kjo quhet “Duaja e Kunutit” dhe mund të inter-
pretohet në këtë mënyrë:

“O Zot! Ne vetëm prej Teje kërkojmë ndihmë,
prej Teje kërkojmë të na falësh dhe prej Teje kërkoj-
më të na udhëzosh! Ne Ty të besojmë, Ty me pen-
dim të drejtohem, në Ty mbështetemi! Ty të lavdë-
rojmë për begatitë Tuaja, të falënderojmë dhe nuk
jemi përbuzës ndaj Teje. Ne e mënjanojmë dhe e
braktisim atë, i cili gabon ndaj Teje.

O Zot! Ne vetëm Ty të adhurojmë, për Ty falim
namaz dhe Ty të biem në sexhde! Kah Ti nxitojmë,
Ty të duam dhe Ty të shërbejmë! Shpresojmë në më-
shirën Tënde dhe i frikohemi dënimit Tënd. Dënimi
Yt vërtet do t'i arrijë mosbesimtarët.”

Nëse Kunuti nuk mund të mësohet përmendsh,
është e mjaftueshme të këndohet çdo thënie e ngja-
shme me të, derisa ai të mësohet përmendsh. Të
gjitha sunnetet (namazet e sunneteve) duhet të kry-

hen individualisht, d.m.th. jo bashkërisht, përveç namazet e Bajramit dhe Vitrit në muajin e Ramazanit.

Sunnetet nuk kërkohen nga ndonjë person që i ka lëshuar disa farze. Në vend të kësaj, ai duhet t'i kompensojë namazet farz që nuk i ka falur. Po ashtu nuk duhet të falen sunnetet nëse koha e farzit veç ka kaluar. Kështu, nëse ndonjë personi i ka kaluar koha e cilitdo namaz, në mënyrë që ta kompensojë atë, ai duhet t'i falë vetëm farzet.

Nëse faltari nuk di t'i kryejë të gjithë namazet në gjuhën arabe, ai mund ta përdorë cilëndo gjuhë që i konvenon, nëse mund ta shprehë kuptimin e njëjtë si në gjuhën arabe. Me qëllim që ta lehtësojmë versionin arab, e japim edhe transliterimin e fjalëve.

Namazi i farzit është më i preferueshëm kur falet në mënyrë kolektive (xhemaat), i udhëhequr nga një imam. Tubimi është më i mirë kur mbahet në xhami, por mund të bëhet edhe në vende të tjera.

Namazi i përbashkët (me xhemat)

1. Namazin e përbashkët e udhëheq një imam nga mesi i besimtarëve të pranishëm. Ai duhet të zgjedhet sipas meritave të tij për dituri fetare dhe devotshmëri.

2. Në namazin e përbashkët imami qëndron para të tjerëve, kurse besimtarët e tjerë qëndrojnë pas tij në rreshta (safa) të drejtë, të gjithë të kthyer kah Kibla. Namazin e përbashkët mund ta kryejnë edhe vetëm dy veta: imami dhe një ithtar i tij.

3. Pas nijetit imami e këndon "Fatihanë" dhe pjesën plotësuese të Kur'anit me zë të lartë, si në na-

mazin e sabahut dhe në dy rekatet e para të namazeve të akshamit dhe të jacisë. Në kohën kur imami e këndon Kur'anin me zë të lartë, besimtarët dëgjojnë në meditim dhe përvullësi. Ata nuk e këndojnë "Fatihanë" ose ndonjë sure tjetër të Kur'anit pas imamit.

4. Kur imami e mbaron "Fatihanë", xhemati i tij thonë: "Amin". Kur imami ngrihet nga pozita përkulëse, ai thotë: "Semioll-llahu limen Zamideh", ("Zoti dëgjon secilin që e falënderon Atë"), e besimtarët thonë: "Rabben= Leke-l-2amd", ("Zoti ynë, i falënderuar qofsh").

5. Besimtarët duhet t'i ndjekin lëvizjet e imamit dhe të mos veprojnë kurrgjë para tij. Nëse cilido besimtar e tejkalon imamin në ndonjë lëvizje, lutja e këtij personi do të jetë e pavlefshme.

6. Namazi i përbashkët nuk është i vlefshëm nëse imami nuk e bën nijjet se e kryen namazin si imam i atij xhemati të cilit i prin. Besimtarët duhet po ashtu të bëjnë nijjet se e ndjekin atë imam në të njëjtin namaz.

7. Nëse ndonjë person vjen pas fillimit të namazit dhe i bashkangjitet xhematit, edhe pse mund të ketë humbur ndonjë rekat, ai duhet ta ndjekë imamin. Kur imami e mbaron namazin me shqiptimin e përvullësit të fundit, personi që ka ardhur më vonë nuk e shoqëron atë në këtë akt, por vazhdon që t'i kompensojë rekatet që i ka lëshuar. Kur një person i bashkangjitet namazit me xhemat në pozitën e përkuljes (ruku) para ngritjes, konsiderohet se ka qenë qysh prej fillimit të kësaj pjese të veçantë të namazit. Por, nëse ai i bashkangjitet namazit me

çfarëdo lloj pozite pas përkuljes (ruku), d.m.th., se e ka humbur rekatin e namazit, ndaj duhet ta kompensojë këtë individualisht, menjëherë pasi që imami ta mbarojë namazin.

8. Kurdo që të ketë mundësi për namaz të përbashkët, muslimani këtë nuk duhet ta lë pas dore. Namazi i përbashkët është një demonstrim i mirë i unitetit me qëllim dhe veprim, me një devotshmëri të shumëfishtë dhe përrulje para Zotit, me një solidaritet efektiv midis muslimanëve dhe me një rend publik e përgjigje reciproke.

Namazi i përbashkët islam është një përgjigje pozitive e problemeve më akute të njerëzimit. Ai është një përgjigje ndaj diskriminimit racor, ndaj dallimeve sociale dhe ndaj paragjykimeve njerëzore. Në shërbimin e përbashkët të Islamit nuk ekzistojnë mbreti apo i nënshtruar, i pasuri apo i varfëri, i bardhi apo i ziu, i klasës së parë apo i klasës së dytë, i prapavijës apo i frontit të parë, i fshehuri apo publiku. Të gjithë besimtarët ngrihen dhe veprojnë krah më krah në një mënyrë tejet të disiplinuar, pa ndonjë rëndësi të dallimeve botërore.

Namazi i Xhumasë

Deri më tani i kemi shqyrtuar namazet e përditshme. Tani do të vijmë te mënyra javore e namazeve të përbashkëta të së Premtes (Xhumasë). Ky namaz është i obligueshëm për çdo musliman nga i cili kërkohet të kryhen të gjitha llojet e namazeve të tjera; kështu që nuk ka arsyetim për moskryerjen e tij. Ky namaz bie në të premtën e çdo jave dhe është posaçërisht i rëndësishëm për arsye se:

1. Është rast i shënuar nga Zoti për muslimanët që ta shprehin devotshmërinë e tyre kolektive.
2. Është një takim për rikontrollimin e llogarive tona shpirtërore për javën e kaluar dhe përgatitje për javën e ardhshme, ashtu siç bëjnë njerëzit për çdo punë tjetër afariste.
3. Kjo është një marrëveshje e muslimanëve për risigurimin e tyre dhe për ripërsëritjen e bindjeve të tyre fetare, si dhe një solidaritet social në baza morale dhe shpirtërore.
4. Kjo tregon se si muslimanët i japin përparësi thirrjes së Zotit mbi të gjitha obligimet tjera.

Namazi i Xhumasë veçohet me këto karakteristika kryesore:

1. Koha e tij është e njëjtë me atë të namazit të drekës, dhe me këtë e zëvendëson këtë namaz.

2. Duhet të falet në një namaz të përbashkët të udhëhequr nga një imam. Këtë nuk mund ta kryejë vetëm një person.

3. Nëse cilido person e lëshon këtë namaz, nuk ka mundësi që ta zëvendësojë. Në vend të kësaj, ai duhet ta falë namazin e drekës, të cilin ky namaz edhe e zëvendëson.

4. Të gjitha llojet e punëve normale lejohen edhe të premtën, si në çdo ditë tjetër të javës. Muslimanët mund të vazhdojnë me obligimet e tyre të zakonshme, por me kusht që të vijnë për faljen e namazit të përbashkët në kohë. Pasi që të mbarojë ky shërbim, ata mund t'i vazhdojnë aktivitetet e tyre të përditshme.

5. Namazi i Xhumasë duhet të kryhet në xhami, nëse ekziston ndonjë e tillë në afërsi. Në të kundërtën, ky namaz mund të kryhet në çdo vendtubim tjetër, p.sh., nëpër shtëpi, ferma, parqe, etj.

6. Kur afrohet koha e lutjes, këndohet ezani. Pas kësaj falen katër rekate sunnet, individualisht me zë të ulët, njësoj sikur në namazin e drekës. Kur mbaron kjo pjesë, imami ngrihet duke qëndruar përballë xhematit dhe ju drejtohet me predikimin (hutben) e tij, që është pjesë përbërëse e namazit të Xhumasë. Kur flet imami kurrkush nuk duhet të flasë apo të lutet; të gjithë të pranishmit duhet të marrin pozitë ulëse dhe ta dëgjojnë predikimin në qetësi deri në fund.

7. Predikimi (hutbeja) përmban dy pjesë; secila prej tyre fillon me fjalë lavdërimi ndaj Zotit dhe me lutje për bekimin e peygamberit Muhammed a.s. Në pjesën e parë duhet të recitohen disa pjesë të Kur'anit, e po ashtu edhe të sqarohen, për arsye të këshillimit. Në fundin e pjesës së parë, imami pushon pak në pozitën ulëse, e pastaj ngrihet që ta kryejë pjesën e dytë të predikimit të tij. Në pjesën e dytë, imami veçanërisht përqëndrohet në lutjet për mirëqenien e përgjithshme të të gjithë muslimanëve.

8. Pas kryerjes së hutbes muezini bën ikamet dhe fillon namazi i Xhumasë, i cili i përngjan namazit të sabahut. Pas kësaj, falen individualisht edhe dy rekate sunnet me zë të ulët.

Katër rekatet sunnet dhe këto dy të fundit që i përmendëm tani, mund të falen edhe në shtëpi. Po ashtu ato mund të zëvendësohen edhe me disa namaze të obligueshme, të cilat dikush mund t'i ketë lë-

shuar në të kaluarën, e të cilat duhet të kompensohen.

Cilido pjesëmarrës në namazin e përbashkët javor, apo në namazet e Bajramit, duhet të bëjë gjithçka që të jetë i pastër dhe pedant. Edhe pse nuk ka ndonjë arsye të detyrueshme për larjen e tërësishme të trupit, këtu rekomandohet larja e këtillë - e cila njeriun e bën të freskët dhe më të këndshëm.

Rëndësia e namazeve të Bajramit

Bajrami ka kuptimin e festës dhe gëzimit që përsëritet. Namazi i Bajramit është shumë i rëndësishëm për të gjithë muslimanët. Ai i ka vlerat e lutjeve të përditshme, siç u shpjegua edhe më lartë, efektet e kuvendit javor (Xhumasë) dhe karakteristikat e mbledhjeve vjetore të muslimanëve. Ekzistojnë dy Bajrame. I pari është Bajrami i Ramazanit dhe bie në ditën e parë të Shevvalit, muajit të dhjetë të vitit musliman, që vjen menjëherë pas Ramazanit - e që është muaji kur u zbrit Kur'ani. I dyti quhet Bajrami i Kurbanit. Ky bie në ditën e dhjetë të Dhu-l-Hixhhes, muajit të fundit të vitit musliman, pas mbarimit të haxhit, e që është një akt tepër i devotshëm.

Festat (Bajramet) islame janë unike në çdo aspekt. Festa të ngjashme me to nuk ka në asnjë sistem të ndonjë religjioni tjetër, apo në ndonjë sistem sociopolitik. Përveç karakteristikave të tyre të larta morale dhe shpirtërore, këto dy festa islame kanë edhe vlera të tjera:

1. Çdo Bajram është një festim i përgjithshëm i arritjeve të çdo individi musliman në shërbim të Zotit. Bajrami i parë vjen pas një muaji të plotë të agjërimit “absolut”. Bajrami i dytë shënon mbarimin e haxhit në Mekke; që është një obligim në të cilin muslimani në mënyrë të sinqertë largohet nga obligimet e tij botore dhe i përkushtohet vetëm zërit të amshueshëm të Zotit.

2. Çdo Bajram është ditë falënderimi, kur të gjithë muslimanët tubohen në një atmosferë vëllazërore dhe të hareshme që ta shprehin falënderimin e tyre ndaj Zotit për ndihmën e Tij dhe për plotësimin e obligimeve të tyre shpirtërore para Bajramit. Ky lloj falënderimi nuk përkufizohet në devocionet shpirtërore dhe shprehjet me fjalë. Ai shkon edhe më tej se kjo, në mënyrë të manifestimit të tij me një formë të bukur të frymës shoqërore dhe humanitare. Muslimanët që e kanë kryer agjërimitin e Ramazanit, i shprehin falënderimet e tyre ndaj Zotit në mënyrë të shpërndarjes së të hollave dhe dhënies për të varfërit dhe për nevojtarët në festën e parë. Analogjikisht me këtë, muslimanët që e kanë kryer obligimin e haxhit në Mekke, si dhe ata që nuk kanë patur mundësi ta kryejnë këtë obligim, i therin kurbanet dhe mishin e tyre ua shpërndajnë të varfërve dhe nevojtarëve. Kjo shpërndarje e ndihmave dhe kurbaneve përbën pjesën kryesore të këtyre festave. Mënyra islame e falënderimit është një kombinim i përgjithshëm i devotshmërisë shpirtërore dhe bamirësisë njerëzore, e që është një kombinim që nuk gjendet askund tjetër pos në fenë islame.

3. Çdo festë është ditë përkujtimi. Muslimanët, madje edhe në kohët e tyre më të gëzueshme, bëjnë një fillim të freskët të ditës me një tubim kolektiv për adhurimin e Zotit. Ata i luten Atij dhe e madhërojnë emrin e Tij, që në këtë mënyrë ta shprehin falënderimin për të mirat e Tij. Përveç kësaj, ata i përkujtojnë të vdekurit me lutje për shpirtrat e tyre, i përkujtojnë të nevojshmit me zgjatjen e dorës për ndihmë, i përkujtojnë të pikëlluarit duke u shprehur simpati dhe kurajim, i përkujtojnë të sëmurët me anë të vizitave të kënaqshme dhe me dëshira për shërim të shpejtë, etj. Kështu, kuptimi i përkujtimit në këtë ditë të caktuar i kapërcen të gjithë kufijtë dhe mbërrin deri te të gjitha dimensionet më të thella të jetës njerëzore.

4. Çdo festë është një ditë fitoreje. Individidi që ka sukses në sigurimin e të drejtave dhe të zhvillimit të tij shpirtëror, e pranon festën me një shpirt fitimtar. Individidi që i zbaton obligimet e tij në mënyrë besimplote (që janë të shoqëruara me festën), është fitimtar. Ai me këtë dëshmon se dëshirat, lutjet dhe vetëkontrollin e vet i mban nën një komandë të fortë dhe se e kënaq shijen e një jete të disiplinuar. Posa t'i arrijë personi këto vlera, ai faktikisht e ka arritur fitoren më të madhe të tij, për arsye se personi që di ta kontrollojë vetveten dhe t'i disiplinojë dëshirat e tij, është i lirë nga mëkati dhe e keqja, nga frika dhe nga mburrja, nga e keqja dhe nga parregullsia, nga xhelozia dhe nga zilia, nga poshtërsimi dhe shkaqet e tjera të robërimit. Kështu, kur ai e pranon Bajramin që e shënon fitimin e kësaj lirie, ai në të vërtetë e

feston fitoren e vet; e me këtë, Bajrami bëhet Ditë Fitoreje.

5. Çdo festë është ditë korrjesh. Të gjithë punëtorët e mirë në shërbim të Zotit dhe të gjithë besimtarët e sinqertë i korrin frytet e veprave të tyre të mira në këtë ditë, pasi Zoti e garanton mëshirën dhe bekimin e Tij. Shoqëria islame, në anën tjetër, i korr dedikimet e duhura të vëllazërisë religjioze dhe përgjegjësisë sociale, që shpërblehen në formë të një dashurie reciproke, simpatie dhe kujdesi. Çdo anëtar i shoqërisë islame do të korrë disa fryte apo do të marrë pak të ardhura, në njërin apo tjetrën mënyrë. Zoti jep pa kurrfarë ndërprerjeje; Ai u jep më tepër posaçërisht atyre që sinqerisht kujdesen për mirëqenien e përgjithshme të bashkëbesimtarëve të tyre. Ata që nuk mund të japin do të pranojnë, bashkë me dhuntitë e mëdha të Zotit, nga kontributet e të privilegjuarve të tyre - bashkëbesimtarë. Edhe ata që kanë, edhe ata që s'kanë, do të jenë nën mbikëqyrjen e plotë të Zotit dhe dita do të jetë me të vërtetë ditë e të korrave të mira.

6. Çdo festë është ditë e faljes. Kur muslimanët mblidhen në tubimin e festës, ata të gjithë në mënyrë të përzemërt luten për falje dhe fuqi të besimit. Atyre që i afrohen Zotit, Ai u ka siguruar sinqeritet, mëshirë dhe falje. Në këtë mbledhje të pastër dhe në atë tubim të lartë shpirtëror, çdo musliman nëse tregon armiqësi apo ndjenja të këqija para çdonjërit nga vëllazërit besimtarë, do të turpërohet para vetes dhe para Zotit. Një musliman i vërtetë impresionohet thellë nga ky tubim vëllazëror dhe shpirtëror, dhe të gjitha ndjenjat e këqija, po t'i ketë pasur, i eliminon

me sukses. Si pasojë e kësaj, ai do të lëvizte njësoj si të tjerët, duke iu përgjigjur frymës së ditës, me qëllim të pastrimit të zemrës dhe shpirtit të tij. Në këtë rast ai do t'u falte atyre që i kanë bërë keq, për arsye se ai vetë do të lutej për faljen nga Zoti dhe do të bënte gjithçka që këtë ta fitojë. Fryma e kësaj mbledhjeje të lartësuar e të devotshme, do ta mësojë atë se nëse ua falë të tjerëve, edhe atij do t'i falet. Dhe kur do të falë, virtyti i të falurit mëshirshëm do të ushtrohet nga Zoti dhe gjerësisht do të shkëmbehet në mesin e muslimanëve. Kjo e shënon këtë ditë si ditë të faljes.

7. Çdo festë është ditë e paqes. Kur muslimani vendos paqe në zemrën e vet, duke iu nënshtruar Ligjit të Zotit dhe duke bërë një jetë të disiplinuar, ai në këtë mënyrë e lidhë marrëveshjen më të fortë për paqe me Zotin. Pasi që njeriu lidh paqe me Zotin, ai edhe vetë është në paqe dhe si pasojë e kësaj, me gjithë Gjithësinë. Kështu, kur ai e feston Bajramin në mënyrë të drejtë, ai faktikisht e feston lidhjen e marrëveshjes paqësore midis vete dhe Zotit dhe e shënon Bajramin si ditë paqeje.

Ky është kuptimi i drejtë i Bajramit islam: kjo është një ditë e paqes dhe falënderimit, ditë e të korrave të mira dhe e arritjeve të mëdha dhe ditë e përkujtimit festiv. Nga e gjithë kjo mund të përfundojmë se Bajrami islam është shumë më tepër se një festë e thjeshtë, për arsye se kjo është ditë e fesë islame dhe ditë e Zotit.

Namazi i Bajramit

1. Si të premtëve, çdo besimtar duhet të shkojë në namazin e përbashkët, i pastër, i rregullt dhe me botëkuptime të larta shpirtërore. Në xhami ose në vendin ku tubohen njerëzit, para se të fillojë namazi, së pari thuhet një lutje e caktuar verbale. Kjo njihet si Tekbir dhe gjendet në fund të kësaj pjese.

2. Koha e namazit të Bajramit është pas lindjes së diellit dhe para mesditës. Këtu nuk kërkohen as ezani e as ikameti. Namazi përmban dy rekate në të cilat imami e këndon “Fatihanë” dhe një pjesë tjetër të Kur’anit me zë të lartë.

3. Imami e bën nijjet faljen e namazit duke thërritur “All-llahu Ekber” (Zoti është më i Madhi). Pas kësaj ai e përsërit thënien e njëjtë tri herë, duke i ngritur duart e tij lart afër veshëve dhe duke i lëshuar poshtë anash, deri në fund të çdo lëvizjeje. Gjatë përfundimit të thënies së tretë, “Tekbirit”, ai e vë dorën e djathtë mbi të majtën nën kërthizë, si në lutjet e tjera. Besimtarët i ndjekin lëvizjet e imamit hap pas hapi dhe veprojnë njësoj siç vepron ai.

4. Në fund të rekatit të parë, imami ngrihet për të dytin, duke thënë “All-llahu Ekber”. Pas kësaj ai shton edhe tri thënie të këtilla, duke vepruar në të njëjtën mënyrë si në rekatën e parë; po ashtu edhe tubimi i besimtarëve e ndjek njësoj si në rekatën e parë.

5. Pasi mbarojnë dy rekatet e namazit, imami mban një predikim, që përmban dy pjesë me pushime të shkurtra midis tyre. Pjesa e parë fillon duke thënë “All-llahu Ekber” nëntë herë, kurse e dyta,

duke e kënduar të njëjtën thënie edhe shtatë herë. Pjesa tjetër e predikimit përmban shprehje të falënderimit dhe këshillimit, si ato të predikimit të së Premtes.

6. Në predikimin e Bajramit të parë të vitit, imami duhet ta drejtojë vëmendjen kah “Sadakatu-l-Fitri” (ndihmesa për të varfërit). Kjo është një taksë e obligueshme, në të cilën çdo individ musliman që ka mundësi duhet t’u japë së paku një shujtë të plotë ose vlerën e saj të varfërve. Nëse dikush varet nga ai, atëherë ai duhet ta bëjë këtë për çdonjërin nga të varurit e tij. Për shembull, nëse ai siguron për vetveten dhe për tre të varurit e tij, duhet si minimum të ndajë katër shujta të plota apo vlerën e tyre për të nevojshmit. Kjo sadaka është shumë më me vlerë dhe më e preferueshme nëse ndahet para namazit të Bajramit, në mënyrë që të varfërit ta presin atë ditë në një frymë festive e të kënaqur.

7. Në predikimin e Bajramit të dytë, imami duhet ta kthejë vëmendjen kah detyra e kurbanit. Në ditën e Bajramit të Kurbanit, çdo musliman që ka mundësi duhet të ofrojë diçka për Zotin. P. sh., për një shtëpi mjafton një dele apo një dhi. Është e preferueshme që kafsha e kurbanit të theret në ditën e Bajramit, menjëherë pas namazit. Megjithatë, nëse theret pas ditës së dytë apo të tretë, përsëri pranohet. Sa i përket mishit të kafshëve të therura, Kur’ani i jep këto udhëzime: “...hani prej tyre dhe ushqeni nevojtarin dhe atë që lyp.” (Kur’ani, 22:36).

Në të njëjtin vend, Kur’ani thotë se Zoti as nuk është i interesuar e as nuk e merr mishin e kurbaneve apo gjakun e tyre; por devotshmëria e besimtarëve të

Tij është ajo që Ai e pranon dhe për të cilën Ai është i interesuar.

Duhet të përsëritet se namazi i Bajramit nuk mund t'i zëvendësojë namazet e obligueshme të sabahut (Salatu-l-Fexhr), - e vetë ato përsëri, nuk mund të zëvendësohen me ndonjë namaz tjetër.

Tekbiri, i cili thuhet para dy Bajrameve dhe pas namazeve të përbashkëta që falen gjatë tri ditëve pas namazit të Bajramit të Kurbanit, quhet "Tekbiru-t-Teshrik". Kjo thuhet me sa vijon:

All-ll=hu Ekber (tri herë) الله اكبر

La il=he il-lall-ll=h. لا إله إلا الله

All-ll=hu Ekber (dy herë) الله اكبر

Ve lil-l=hil-2amd. و لله الحمد

All-ll=hu Ekberu Keb]ra. الله اكبر كبيرا

Vel-2amdulil-l=hi Keth]r=. والحمد لله كثيرا

Ve sub2=nall-ll=hi bukreten ve e4]l=.

و سبحان الله بكرة و اصيلا

L= il=he il-lall-ll=hu va2deh. لا إله إلا الله وحده

\$adaka vodeh, ve ne4are obdeh.

صدق وعده و نصر عبده

Ve eozze xhundeh\ ve hezemel a2z=be va2deh.

وأعز جنده وهزم الأحزاب و حده

L= il=he il-lall-ll=hu ve l= nobudu il-l= ijz=h,

لا إله إلا الله و لا نعبد إلا إياه

Mu3li4]ne lehud-d]ne ve lev kerihel-k=fir\n.

مخلصين له الدين و لو كره الكافرون

All-ll=humme 4al-li ol= Sejjidin= Mu2ammed,

اللهم صل على سيدنا محمد

Ve ol= =li Sejjidin= Mu2ammed, وعلی آل سیدنا محمد
 Ve ol= A42=bi Sejjidin= Mu2ammed,
 وعلی اصحاب سیدنا محمد
 Ve ol= en4=ri Sejjidin= Mu2ammed,
 وعلی انصار سیدنا محمد
 Ve ol= ezvaxhi Sejjidin= Mu2ammed,
 وعلی أزواج سیدنا محمد
 Ve ol= dhur-rijjeti Sejjidin= Mu2ammed,
 وعلی ذریة سیدنا محمد
 Ve sel-lim tesl]men keth]r=. و سلم تسلیمان کثیرا

Tekbiri do të thotë:

All-llahu është më i Madhi (tri herë).

Nuk ka hyjni pos All-llahut.

All-llahu është më i Madhi (dy herë) dhe falënderimi i takon Atij.

Me siguri All-llahu është më i Madhi.

Atij i takon falënderimi i begatshëm.

I lavdëruar qoftë Ai, ditë e natë.

Nuk ka hyjni veç All-llahut, të vetmit Zot të vërtetë.

Ai e plotësoi premtimin e Tij, e ndihmoi robin e Tij, e forcoi ushtrinë e Tij, kurse armiqve u shkaktoi disfatë. Nuk ekziston zot tjetër përveç All-llahut dhe nuk adhurojmë askë pos Tij, me sinqeritet dhe besnikëri në fenë e Tij, edhe pse mosbesimtarët mund të refuzojnë (mos t' u pëlqejë).

O Zot! Lartësoje dhe bekoje Muhammedin a.s.

Dhe bekoje popullin e Muhammedit a.s.

Dhe bekoi shokët e Muhammedit a.s.
Dhe bekoi ithtarët e Muhammedit a.s.
Dhe bekoi gratë e Muhammedit a.s.
Dhe bekoi pasardhësit e Muhammedit a.s.
Dhe mëshiroi të gjithë ata.

Shkurtimi i namazit

1. Kur një person udhëton me qëllim që të kalojë dyzet e tetë milje (ose tetëdhjetë e shtatë kilometra) apo më tepër larg shtëpisë së tij, duhet t'i shkurtojë namazet e tij të obligueshme prej katër rekateve në dy rekate. Ky ndryshim mund të zbatohet në namazin e drekës, të ikindisë, si dhe në atë të jacisë. Namazi i sabahut dhe ai i akshamit mbeten të pandryshuar.

2. Ky lehtësim mbetet efektiv madje edhe pasi udhëtari të mbërrijë në destinacionin e tij; nëse nuk ka për qëllim ta vazhdojë qëndrimin e tij atje pesëmbëdhjetë apo më shumë ditë. Përndryshe, ai duhet t'i falë namazet që mund të reduktohen në numrin e rekateve të tyre të plota.

3. Derisa ai udhëton nën këto rrethana, është i liruar nga namazet e sunnetit, përveç dy rekateve sunnet të namazit të sabahut dhe vitrit, i cili vijon pas namazit të jacisë.

Kohët kur namazet janë të ndaluara

Muslimani dhe muslimanja e kanë të ndaluar të falin, qoftë namaz farz apo sunnet, në këto periudha kohore:

1. Koha kur lind dielli.
2. Koha kur dielli është në zenitin e tij.
3. Koha kur perëndon dielli.
4. Gjatë periudhës së të përmuajshmeve dhe lehonisë te gratë.
5. Koha e papastërtisë, qoftë ajo e pjesërishtme apo e tërësishme.

Kompensimi për namazet e vonuara (kaza)

1. Është rregull i padiskutueshëm se çdo musliman, qoftë mashkull apo femër, duhet ta falë namazin në kohën e caktuar. Nëse ai nuk vepron kështu, e nëse nuk ka ndonjë arsye të mirëfilltë për vonesën e lutjes, pëson mëkati dhe dënohet.

2. Këtu bëjnë përjashtim gratë që i kanë të përmuajshmet dhe ato që janë në periudhën e lehonisë, por edhe çdokush tjetër që mund të jetë psikikisht i sëmurë apo pa vetëdije për një periudhë të caktuar. Megjithatë në çdo gjendje tjetër, çdo musliman(e) duhet t'i kompensojë lutjet e obligueshme (farzet) për të cilat është vonuar.

3. Kur personi i kompenzon lutjet e tij të vonuara, ai duhet t'i falë ato në mënyrën e tyre të përcaktuar; p.sh., nëse për atë kohë duhej të jetë namazi i shkurtuar, personi përsëri duhet ta falë atë si të tillë dhe anasjelltas.

4. Duhet të mbahet rendi ndërmjet lutjeve me vonesë dhe atyre të rregulltave; së pari duhet të falen ato të rregulltat - përjashtim bën rasti kur ato të vonuarat janë të shumta në numër dhe nuk mund të mbahen mend datat e sakta të tyre, apo kur koha me të cilën njeriu disponon nuk premtton kryerjen e të dy llojeve. Në këtë rast, së pari falet namazi në radhë e pastaj ai i vonuari. Sidoqoftë, muslimani duhet të jetë i sigurt se ka mbamendje të shëndoshë dhe se nuk ka lënë asnjë namaz pas dore.

Namazi i Teravisë

Ky namaz është karakteristik për muajin e Ramazanit. Ai zhvillohet menjëherë pas namazit të jacisë. Ky namaz përmban tetë deri më njëzet rekate, që falen dy nga dy me pushime të shkurtra në mes të çdo dy rekateve. Është e preferueshme që ky namaz të falet si namaz kolektiv dhe para vitrit, që është pjesa e fundit e namazit të jacisë.

Prishja e namazit

Çdo namaz bëhet i pavlefshëm apo anulohet me njërin nga këto veprime:

1. Të veprosh para imamit në cilindo akt apo lëvizje të namazit.
2. Të hash apo të pishë gjatë kohës së namazit.
3. Të flasësh apo të thuash diçka që është jashtë ciklit të caktuar të namazit.
4. Ta ndryshosh pozitën nga drejtimi i Mekkes.

5. Të bësh ndonjë veprim që dallohet ose ndonjë gjë tjetër që nuk përputhet me aktet dhe lëvizjet e namazit.
6. Të bësh çdo gjë që e prish abdestin, p.sh., të urinosh, ta kryesh nevojën, të lëshosh gazra, të derdhësh gjak, etj.
7. Të mos kryesh cilëndo pjesë të rëndësishme të namazit, si p.sh., qëndrimin, këndimin e Kur'anit, rukunë, suxhudin, etj.
8. Ta zbulosh trupin prej kërthize e deri te gjunjë gjatë kohës së namazit, të meshkujt, kurse të zbulosh çdo pjesë të trupit përveç duarve, fytyrës dhe shputave, të femrat.

Çdo namaz që priset në njërën nga këto mënyra, duhet të përsëritet në mënyrë të rregullt.

Namazi i xhenazes

1. Namazi drejtuar Zotit për një musliman që ka vdekur është detyrë e përgjithshme kolektive (Farzi Kifaje). Kjo don të thotë se disa muslimanë duhet ta falin këtë namaz, dhe sado qoftë numri i muslimanëve që janë të pranishëm në faljen e këtij namazi, kjo gjë është e mjaftueshme, kështu që muslimanët e tjerë lirohen nga përgjegjësia.

2. Kur vdes një musliman, i gjithë trupi i tij - duke filluar nga pjesët e eksponuara të larjes së pjesërishme të trupit (abdesti) - duhet të lahet dy-tri herë me sapun apo me ndonjë mjet tjetër të pastriimit, kështu që të pastrohet nga të gjitha papastërtitë e dukshme. Kur trupi lahet në tërësi, duhet të mbështillet me një apo me më tepër shtresa pëlhurë pam-

buku të bardhë, të cilat duhet t'i mbulojnë të gjitha pjesët e trupit.

3. Pas kësaj trupi i njeriut të vdekur vendoset në tabut dhe çohet deri te vendi i namazit, në xhami apo edhe në ndonjë vend tjetër të pastër. Trupi vihet në atë pozitë që fytyra të drejtohet kah Mekka.

4. Të gjithë pjesëmarrësit në namaz duhet të marrin abdest, nëse nuk e kanë ende të vlefshëm abdestin e mëparmë. Imami qëndron pranë tabutit (arkivolit), në drejtim të Kibles me besimtarët që radhiten pas tij.

5. Imami i ngre duart tek veshët dhe me zë të ulët bën nijjetin e namazit të xhenazes - për t'iu lutur Zotit për të vdekurin, duke thënë "All-llahu Ekber" (Zoti është më i Madhi). Besimtarët veprojnë ashtu siç i udhëheq imami dhe pas tij e vendosin dorën e tyre të djathtë mbi të majtën nën kërthizë, si në namazet e tjera.

6. Pas kësaj imami këndon atë që zakonisht këndohet edhe në namazet tjera; d.m.th., "Subhanekenë" dhe "Fatiha-në".

7. Në këtë fazë ai thërret "All-llahu Ekber" pa i ngritur duart dhe e këndon pjesën e dytë të Teshehudit (që nga "All-llahumme sal-li ala Muhammed" e deri në fund të salavateve).

8. Pas kësaj ai e bën tekbirin e tretë, duke thënë "All-llahu Ekber" pa i ngritur duart e tij dhe e bën lutjen e tij (duanë) me cilatdo fjalë që atij i konvenojnë, - megjithatë, më të preferueshme janë këto:

اللهم اغفر لحينا و ميثنا, و شاهدا و غائبا, و صغيرنا و كبيرنا, و ذكرنا و أنثانا, اللهم من احييته منا فأحيه على

الإسلام, و من توفيته منا فتوفه على الإيمان, اللهم لا تحرمنا
اجره و لا تفتنا بعده.

All-Il=hummagfir li2ajjin= ve mejjitin=, ve
sh=hidin=, ve g=ibin= ve sag]rin= ve keb]rin= ve
dhekerin= ve unth=n=.

All-Il=humme men e2jejteh\ minn= fe a2jihu
olel-Isl=m. Ve men teveffejteh\ minn= fe tevefeh\
olel isl=m. All-Il=humme l= ta2rimn= exhreh, ve l=
teftinn= bodeh.

“O Zot! Falja mëkatet të gjallëve dhe të vdekur-
ve tanë, atyre që janë të pranishëm dhe atyre që
s’janë, të rinjve dhe pleqve, meshkujve dhe femrave
tona.

O Zot! Kujtdo që t’i dhurosh jetë ndërmjet nesh,
ndihmoje që të jetojë në fenë islame, dhe kujtdo që
t’i shkaktosh vdekje, ndihmoje që të vdesë në fenë
islame.

O Zot! Mos na privo nga shpërblimi për durimin
tonë në humbjen e tij, dhe mos na sprovo pas tij.”

9. Pas kësaj pason tekberi i katërt (duke thënë
“All-llahu Ekber”), pa i ngritur duart lart vijon me
selamin përfundimtar (në të djathtë e në të majtë),
njësoj sikur edhe në namazet e tjera. Këtu duhet të
mbajmë mend se besimtarët e radhitur prapa në
rreshta e ndjekin udhëheqjen e imanit hap pas hapi
dhe i këndojnë vetë lutjet e njëjta me zë të ulët.

10. Pas mbarimit të namazit, trupi përgatitet për
varrosje, me fytyrë të drejtuar kah Kibla. Kur lësho-
het trupi poshtë, thuhet këto fjalë:

بِسْمِ اللَّهِ وَبِاللَّهِ وَعَلَىٰ مِلَّةِ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ

“Bismil-l=hi ve bil-l=hi ve ol= mil-leti Resulil-l=hi
4al-lall-ll=hu olejhi ve sel-lem.”

“Në emër të Zotit dhe me Zotin, dhe në hijen e ummetit të Resulull-llahut, mbi të cilin qofshin të gjitha bekimet dhe paqja e All-llahut”.

Përveç kësaj mund të thuhet çfarëdo lutje tjera të përshtatshme.

Nëse ai që ka vdekur është fëmijë i moshës më të re se ajo e adoleshencës, namazi është i njëjtë; me përjashtim të asaj se pas tekbitit të tretë në vend të lutjes së gjatë të besimtarëve, këndohet kjo lutje:

اللهم أجعله لنا فرطاً و أجعله لنا ظهراً و أجعله لنا شافعاً و
مشفعاً

“All-ll=humme xholhu len= fereban vexholhu lena 7uhren, vexholhu len= sh=fion ve musheffeo=.”

“O Zot! Bëje atë pararendës tonë të parë dhe le të jetë ai shpërblimi dhe pasuria jonë; le të jetë për ne lutës dhe pranoje lutjen e tij.”

I gjithë namazi i varrimit bëhet në pozitën duke qëndruar në këmbë. Kurdo që një xhenaze kalon pranë, qoftë i vdekuri musliman apo jomusliman, çdo musliman në shenjë respekti duhet të ngrihet në këmbë.

Mashkulli e bën larjen e xhenazes mashkull, kurse femra të xhenazes femër. Gruaja ka të drejtë ta lajë xhenazen e burrit të saj dhe një burrë apo një grua mund t'i lajë xhenazet e fëmijëve të vegjël. Gjatë larjes së të vdekurit, duart e atij që e lanë duhet të jenë të mbuluara me dorëza apo pëlhurë dhe pjesët sekrete të trupit të vdekur duhet të lahen pa u parë.

Varri duhet të ngrihet dhe të shënohet në mënyrë të thjeshtë. Trupi i vdekur duhet të mbështi-

llet me copë apo pëlhurë pambuku të bardhë, të materialit mesatar standard. Çdo ekstravagancë apo luks në ndërtimin e varrit apo në veshjen e trupit me rroba të bukura apo diç tjetër të ngjashme, nuk i takon fesë islame. Kjo konsiderohet si një veprim i rrejshëm dhe si humbje e kotë e mjeteve që mund të përdoren për qëllime më të mira.

Tradita e disa muslimanëve të Amerikës Veriore - për organizimin e një banketi të madh dhe të shtrenjtë me rastin e vdekjes së ndonjë personi - po ashtu bie ndesh me dispozitat e fesë islame - dhe paraqet harxhim të papërgjegjshëm të energjisë dhe të parave; të cilat, po të përdreshin për disa qëllime të tjera humanitare, do të sillnin dobi të mëdha.

Disa vërejtje të përgjithshme rreth namazeve

Siç theksuam edhe më parë, truri i muslimanit çdoherë duhet të jetë i preokupuar me përkujtimin e Zotit dhe gjuha e tij duhet të jetë e nxënë me lavdërimin dhe madhërimin e Tij. Përveç formave të sipërpërmendura të faljeve, ekzistojnë edhe shumë raste të tjera në të cilat peygamberi Muhammed a.s., e rekomandon faljen. Këto raste janë me sa vijon:

1. Koha kur bie shi me vërshimë.
2. Koha e thatësisë dhe mungesës së shiut.
3. Koha e zënies së diellit.

Në këto kohë muslimani këshillohet të kryejë sa më tepër rekate, të cilat mund të zgjasin sa të dëshirojë ai.

Ekzistojnë edhe disa kohë të tjera kur ai duhet të shqiptojë disa shprehje që nuk janë plotësisht të përbashkëta me format e caktuara të fjalëve të lutjes. Në raste të këtilla, ai shpreh falënderimin ndaj Zotit dhe mbiçmimin e të mirave të Tij, shpresën në Të dhe mbështetjen në ndihmën e Tij, kujtesën ndaj Tij dhe lutjet për mëshirën e Tij. Këto kohë janë me sa vijon:

1. Koha e lindjes së fëmijës.
2. Koha e martesës.
3. Koha kur njeriu shkon të flejë dhe kur ngrihet nga gjumi.
4. Koha kur njeriu del nga shtëpia dhe kur përsëri kthehet në të.
5. Koha kur hyhet dhe kur dilet nga banjoja.
6. Koha kur njeriu nisët në rrugë apo hyn në ndonjë qytet.
7. Koha kur ai kalëron apo vozit ndonjë mjet udhëtimi.
8. Koha kur ai hip në anije.
9. Në kohën e depresionit.
10. Kur qëndron përballë pasqyres.
11. Pas larjes së tërësishme të trupit apo pas marrjes së abdestit.
12. Kur i fiton frytet e para në korrje.
13. Kur i viziton varrezat.

Në çdonjërin nga këto raste muslimani duhet ta përkujtojë Zotin me shprehje të sakta e të plota - me çka duhet t'i shprehë ndjenjat dhe mendimet e tij.

Ekzistojnë disa lutje të caktuara për këto raste, por njeriu mund ta përdorë cilëndo që ta dijë, përdërisa ajo i dedikohet lavdërimit dhe përkujtimit të Zotit. Këtu do të japim disa shembuj specifike që mund të shfrytëzohen:

1. Para se të hajë apo para se të pijë diçka:

بِسْمِ اللَّهِ وَعَلَى بَرَكَاتِهِ

“Bismil-l=hi ve ol= bereketil-l=h.”

“Në emër të Zotit dhe me bekime nga Zoti.”

Është po ashtu praktikë e mirë që para ngrënies të recitohet “Fatiha”.

2. Kur mbaron së ngrëni:

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي أَطْعَمَنَا وَسَقَانَا وَجَعَلَنَا مُسْلِمِينَ

“El-2amdu lil-l=hil-ledh] a6omen=, ve se`=n= ve xheolen= muslim]n.”

“I gjithë falënderimi i qoftë All-llahut, i Cili na ka dhënë ushqim dhe pije, dhe i Cili na ka bërë muslimanë.”

3. Gjatë vizitës tek i sëmuri:

أَذْهَبِ الْبَاسَ رَبَّ النَّاسِ وَأَشْفِ أَنْتَ الشَّافِي لَا شِفَاءَ إِلَّا شِفَاؤُكَ

شِفَاءَ لَا يَغَادِرُ سَقْمًا

“Edhhebil-be'se rabben-n=s, veshfi ente-sh-sh=f]; l= shif=e il-l= shif=uke shif=en l= jug=diru se`am=.”

“Largoje sëmundjen, o Zot i të gjithë njerëzve! Dhe ktheje shëndetin, Ti je mjekuesi; nuk ka shërim përveç shërimit Tënd; dhuro shërim që nuk lë pasoja.”

*

* *

Tani është koha të flasim për “Fatihanë”, “Teshehudin” dhe për disa pjesë të tjera të shkurtra të Kur’anit.

1. El Fatiha

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ

الحمد لله رب العالمين، الرحمن الرحيم، مالك يوم الدين، إياك
نعبد و إياك نستعين، إهدنا الصراط المستقيم، صراط الذين
أنعمت عليهم غير المغضوب عليهم ولا الضالين، (أمين)

“Bismil-l=hir-ra2m=nir-ra2]m

El 2amdu lil-l=hi rabbil o=lem]n. Er-ra2m=nir-ra2]m.
M=liki jevmid-d]n. Ijj=ke nobudu ve ijj=ke neste[]n.
Ihdine4-4ir=tal-muste`]m. \$ir=6al-ledh]ne enomte
olejhim, gajril-magd\bi olejhim ve le5-5=l-l]n.”

(+m]n).

1. Falënderimi i takon vetëm All-llahut, Zotit të botëve!
2. Bamirësit të përgjithshëm, Mëshirëbërësit!
3. Sunduesit në Ditën e Gjykimit (përgjegjësisë-shpërblimit)!
4. Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm te Ti kërkojmë ndihmë!
5. Udhëzona (përforcona) për në rrugën e drejtë!
6. Në rrugën e atyre që i begatove me të mira, jo të atyre që kundër vetes tërhoqën hidhërimin, e as në të atyre që e humbën veten!” (Kur’ani, 1:1-7)

2. Teshehudi

a) Pjesa e parë

التحيات لله و الصلوات والطيبات السلام عليك ايها النبي و
رحمة الله و بركاته السلام علينا و على عباد الله الصالحين.
أشهد أن لا إله إلا الله و أشهد أن محمدا عبده و رسوله

“Et-te2ijj=tu lil-l=hi ve4-4alav=tu ve6-6ajjib=tu. Es-
sel=mu olejke ejjuhen-nejju ve ra2metull-ll=hi ve
berek=tuh\ . Es-sel=mu olejn= ve ol= [b=dil-l=hi4-
4=li2]n.

Eshhedu en l= il=he il-lall-ll=h ve eshedu enne
Mu2ammeden obduh\ ve res\luhu.”

“Përshëndetjet, bekimet dhe bamirësitë i takojnë
All-llahut. Paqja, shpëtimi, mëshira dhe bekimi qoftë
mbi ty, o I Dërguar i Zotit! Shpëtimi i Zotit qoftë
mbi ne dhe mbi të gjithë robërit e mirë të Zotit!

Unë me zemër besoj dhe me gojë dëshmoj që
nuk ka hyjni tjetër pos All-llahut, dhe se Muhamme-
di është rob dhe I Dërguar i Tij!’

(Kjo pjesë këndohet pas rekatit të dytë në çdo
namaz, që përmban tri apo katër rekate; - pastaj
besimtari ngrihet në këmbë për rekatën e tretë).

b) Pjesa e dytë

اللهم صل على محمد و على آل محمد كما صليت على إبراهيم
و على آل إبراهيم إنك حميد مجيد اللهم بارك على محمد و على
آل محمد كما باركت على إبراهيم و على آل إبراهيم إنك حميد
مجيد

“All-ll=humme 4al-li ol= Mu2ammedin ve ol= =lii
Mu2ammed kema 4al-lejte ol= lbr=h]me ve ol= =li
lbr=h]me inneke 2am]dun mexh]d.

All=humme b=rik ol= Mu2ammedin ve ol= =lii
Mu2ammed kem= b=rekte ol= Ibrah]me ve ol= =li
Ibrah]me inneke 2am]dun mexh]d.”

“O Zot! Mëshiroje Muhammedin a.s. dhe familjen e Muhammedit a.s., siç e mëshirove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit, sepse Ti je i denjë për falënderim e lavdërim.

Dhe bekoje Muhammedin a.s. dhe familjen e Muhammedit a.s., siç e bekove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit, sepse Ti je i denjë për falënderim e lavdërim.”

(Dy pjesët e fundit të “Teshehudit” këndohen në rekatën e fundit kur përfundon çdo namaz; dhe në fund të pjesës së fundit me selamin përfundimtar përfundon namazi. Vetëm pjesa e dytë këndohet në namazin e xhenazes pas tekbirit të tretë).

3. Pjesë (sure) të shkurtra nga Kur’ani

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ، اللَّهُ الصَّمَدُ، لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ،
وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ

a) “Bismil-l=hir-ra2m=nir-ra2]m

~ul huvall-ll=hu e2ad. All-ll=hu4-4amed. Lem jclid ve lem j\led. Ve lem jekun leh\ kufuven e2ad.”

“Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

Thuaj: Ai, All-llahu është Një!

All-llahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbësh-tetet) për çdo nevojë.

As s’ka lindur kë, as nuk është i lindur.

Dhe Atij askush nuk i është i barabartë.” (Kur’ani, 112:1-4).

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ
 وَالْعَصْر، اِن الْاِنْسَانَ لَفِیْ خُسْرٍ، اِلَّا الَّذِیْنَ اٰمَنُوْا
 وَعَمِلُوا الصّٰلِحٰتِ وَتَوٰصَوْا بِالْحَقِّ وَتَوٰصَوْا بِالصَّبْرِ

b) "Bismil-l=hir-ra2m=nir-ra2]m!

Vel-o4r. Innel-ins=ne lef] 3usr. Il-le-ledh]ne =men\
 ve omilu4-4ali2=ti ve tev=4av bil-2a`i ve tev=4av
 bi4-4abr."

*"Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!
 Pasha kohën!*

*Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të
 sigurt.*

*Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të
 mira, që porositën njëri-tjetrin t'i përmbahen të
 vërtetës dhe që e këshilluan njëri-tjetrin të jenë të
 durueshëm." (Kur'ani, 103:1-3).*

Një nga këto pjesë të shkurtra të Kur'anit
 këndohet pas "Fatihasë" në çdo dy rekatet e para të
 namazeve. Në rekatën e tretë dhe të katërt nuk kën-
 dohet asgjë përveç "Fatihasë".

Ekzistojnë pjesë shumë të lehta e të shkurtra të
 Kur'anit. Çdo musliman duhet të përpiqet të mësojë
 përmendsh sa më tepër pjesë të tij. Po ashtu duhet t'i
 lexojë dhe t'i studiojë udhëzimet e Kur'anit. Leximi
 i Kur'anit në vetvete është një formë e lartë e
 besimit dhe shprehje kuptimplote e devotshmërisë.

Agjërimi (Savm)

Karakteristikë tjetër e veçantë morale dhe shpirtërore e fesë islame është institucioni i përshkruar i agjërimit. I definuar fjalë për fjalë, agjërimi don të thotë të heqësh dorë “plotësisht” nga ushqimi, pijet, marrëdhëniet intime dhe nga pirja e duhanit, qysh para agimit e deri në rënien e muzgut gjatë gjithë muajit të Ramazanit; muajit të nëntë të kalendarit islam. Por, nëse e reduktojmë kuptimin e agjërimit islam në këtë kuptim tekstual, sigurisht do të bëjmë një gabim të rëndë.

Kur feja islame na njoftoi me këtë institucion të paluhatshëm, ajo planifikoi të rrisë një dru të përherëshëm me fryte të shumta dhe tejet të vlefshme. Tani do të japim një shpjegim të shkurtër të kuptimit shpirtëror të agjërimit në Islam:

1. Ai e mëson njeriun për parimin e dashurisë së sinqertë, sepse vetëm atëherë kur ai e zbaton agjërimin, këtë e bën për hir të dashurisë së thellë ndaj Zotit. Njeriu që e do Zotin, është njeri që me të vërtetë e di se ç’është dashuria.

2. Ai e furnizon njeriun me një kuptim kreativ të shpresës dhe të shikimit optimist ndaj jetës; për arsye se vetëm kur njeriu agjëron, mund të shpresojë në kënaqësinë e Zotit dhe ta kërkojë mëshirën e Tij.

3. Agjërimi e pasuron njeriun me një virtyt të çiltër dhe me një afërsi me Zotin; për arsye se kur agjëron, njeriu këtë e bën vetëm për hir të Zotit.

4. Ai e pajisë njeriun me një vetëdije vigjilente dhe të shëndoshë, për arsye se agjëruesi e mban agjërimin e tij edhe fshehurazi edhe publikisht. Në

agjërimin zakonisht nuk ekziston ndonjë autoritet më i madh për ta kontrolluar sjelljen e njeriut, për ta penguar kryerjen e agjërimit nga ana e tij. Ai e mban atë që ta kënaqë Zotin dhe ta kënaqë vetëdijen e tij me ndershmërinë dhe përpikmërinë e tij në vetvete dhe publikisht. Është më se e vërtetë se nuk ekziston mënyrë tjetër më e mirë për kultivimin e një vetëdijeje të pastër njerëzore.

5. Ia mëson njeriut durimin dhe zemërgjerësinë; për arsye se kur ai agjëron, i ndjen dhembjet e mërzi-së dhe të shqetësimit, por i duron dhe i përballon ato me përpjekje të mëdha. Në të vërtetë, ky shqetësim mund të jetë vetëm i përkohshëm, por nuk ka dyshim në atë se kjo përvojë e bën atë t'i kuptojë efektet dhe pasojat serioze të dhembjeve të tilla te të tjerët, të cilët mund të jenë të privuar nga të mirat elementare me ditë, me javë apo madje edhe me muaj të tërë. Rëndësia e kësaj përvoje në kuptimin social dhe humanitar qëndron në atë se një njeri i tillë është shumë më i shpejtë se çdokush tjetër në të kuptuarit dhe në të ndierit e asaj që e ndiejnë besimtarët e tjerë dhe mund t'u përgjigjet nevojave të tyre. Kjo është një shprehje e patundshme e zemërgjerësisë dhe mirëkuptimit të çiltër.

6. Ai është një mësim efektiv për një urtësi dhe për një fuqi të vullnetit. Njeriu që e kryen agjërimin e tij në mënyrë të drejtë, sigurisht është njeri që mund t'i disiplinojë dhe t'i mbajë nën kontroll pasionet dhe epshin e tij, dhe që mund ta ngrejë vetveten mbi ngasjet fizike. Ky është njeri me personalitet e karakter të fortë, njeri me fuqi të vullnetit dhe me një përcaktueshmëri e përpikëri.

7. Agjërimi e pajis njeriun me një shpirt të përballueshëm, e pajis me një mendje të pastër dhe me një trup të lehtë për të lëvizur e për të vepruar. E gjithë kjo është rezultat i pakontestueshëm i barkut të zbrazët e të lehtë. Udhëzimet mjekësore, ligjet biologjike dhe përvoja intelektuale i përgjigjen këtij fakti.

8. Agjërimi ia mëson njeriut mënyrën e kursimeve të mençura dhe të buxhetit të shëndoshë; për arsye se kur ai ushqehet normalisht në sasi më të vogla apo kur ushqehet më rrallë, harxhon më pak para dhe fuqi. Ky është një mësim shpirtëror i ekonomisë dhe buxhetit shtëpiak.

9. Ai e aftëson njeriun ta mbizotërojë artin e adaptimit të pjekur. Lehtë mund ta kuptojmë qëllimin posa të kuptojmë se agjërimi e bën njeriun ta ndryshojë gjithë rrjedhën dhe mënyrën e jetesës. Kur njeriu e bën këtë ndryshim, natyrisht e adapton vetveten në një sistem të ri dhe shkon më tutje me kënaqjen e ligjeve të tjera. Kjo, në kuptimin më të gjerë, zhvillon në të një kuptim më të mirëfilltë të adaptimit dhe një fuqi të vetëkrijuar për t'i kapërcyer pengesat e parapara të jetës. Një njeri që e vlerëson siç duhet adaptimin konstruktiv dhe kurajon, menjëherë do t'i çmojë efektet e agjërimin në këtë drejtim.

10. Agjërimi e pajisë njeriun me disiplinë dhe mbijetesë të shëndetshme. Kur një person e kryen rregullisht agjërimin në ditët përkatëse të Muajit të Shenjtë, është e sigurt se ai i cakton vetvetes një formë të lartë të disiplinës dhe një kuptim gjenial të rendit. Në mënyrë të ngjashme, kur ai e liron barkun dhe e lehtëson sistemin e tij të tretjes, ai me të

vërtetë e siguron trupin e tij; - mos ta përmendim shpirtin, të cilin e pastron nga e keqja; - gjë që rezulton nga rëndimi i tepërt i barkut. Përmes kësaj mënyre të lehtësimit, njeriu mund të jetë i sigurt dhe të jetojë i lirë nga parregullsitë e zakonshme; dhe po ashtu të jetë i sigurt se shpirti i tij do të vazhdojë të shkëlqejë në paqe dhe pastërti.

11. Agjërimi te njeriu e inicon frymën e vërtetë të përkatësisë sociale, të unitetit dhe të vëllazërisë, të barazisë para Zotit dhe para ligjit. Kjo frymë është një prodhim natyror i faktit se kur njeriu agjëron, ai ndjen se i bashkangjitet gjithë shoqërisë islame dhe kryerjes së detyrës së njëjtë në të njëjtën mënyrë, për motive dhe qëllime të njëjta. Asnjë sociolog nuk mund të thotë se ndonjëherë ka ekzistuar ndonjë periudhë historike, në të cilën do të gjendej diç që do të mund të krahasohej me këtë institucion të mirëfilltë të fesë islame. Njerëzit kanë kërkuar e janë ankuar për një përkatësi pranuese, për unitet, për vëllazëri, për barazi; por, sa i padëgjuar ka qenë zëri i tyre dhe sa i dobët ka qenë suksesi që e arritën ata! Ku mund t'i gjejnë ata qëllimet e tyre pa dritën udhëheqëse të fesë islame?

12. Agjërimi është një urdhër i Zotit për rivërtetim të vetvetes dhe për vetëkontroll, për ruajtjen e dinjitetit dhe lirisë njerëzore, për fitore dhe paqe. Këto rezultate asnjëherë nuk dështojnë të vetëmanifestohen si një realitet i gjallëruar në zemrën e personit, i cili e di se si agjërohet. Kur ai agjëron në mënyrë të duhur, është në gjendje ta kontrollojë vetveten, ushtron një komandë të plotë ndaj epsheve të veta, i disiplinon dëshirat e tij dhe u reziston presio-

neve qëllimkëqija. Me këtë, ai është në gjendje ta risigurojë vetveten, ta kthejë dinjitetin dhe integritetin e tij; e në këtë mënyrë, të lirohet nga kthetrat e së keqes. Kur njeriu e kryen dhe e zbaton gjithë këtë, ai ka vendosur një paqe të brendshme që është burim i paqes permanente me Zotin dhe, si rrjedhojë e kësaj, edhe me tërë Gjithësinë.

Disa mund të mos jenë të kënaqur nga kjo dhe ta bëjnë këtë vërejtje: Nëse kështu është rasti me institucionin islam të agjërimit dhe nëse ky është koncepti i fesë islame në këtë aspekt, atëherë muslimanët a nuk jetojnë në utopi? Ndaj një vërejtjeje të tillë mund të themi vetëm se muslimanët kanë jetuar dhe janë kënaqur në utopi në një periudhë të caktuar të historisë së tyre. Kuptimi i një utopie të tillë, që një fenomen i një arritjeje të veçantë në historinë njerëzore. Themi të veçantë, sepse asnjë religjion apo sistem tjetër social, përveç fesë islame, asnjëherë nuk ka qenë në gjendje t'i realizojë idealet e tij dhe t'i shndërrojë në realitet. Utopia e religjioneve dhe sistemeve tjera sociale, çdoherë ka mbetur në kategorinë e teorive apo të mendimit dëshirëplotë dhe të ëndrrave - ndonjëherë të qarta, ndonjëherë të turbullta, ndonjëherë të afërta, por në të shumtën e rasteve të largëta. Por "utopia" e fesë islame u kuptua dhe u praktikua me një kapacitet të plotë. Në kuptimin njerëzor dhe praktik, kjo don të thotë se "utopia" e fesë islame mund të rivendoset edhe një herë në këtë tokë, dhe se ajo mund të vendoset në baza të shëndosha dhe në parime praktike.

Shkaku pse utopia islame nuk është e realizueshme ditëve të sotme është i shumëfishtë dhe mund

të shpjegohet shumë lehtë. Me qëllim të përkufizimit tonë vetëm në trajtimin e agjërimit, mund të themi se shumë muslimanë, për fat të keq të vetë atyre, nuk agjërojnë apo, aq më tepër, janë tejet indiferentë ndaj kësaj çështjeje. Në anën tjetër, shumica e atyre që agjërojnë nuk e kuptojnë rëndësinë e vërtetë të këtij institucioni - dhe si rezultat i gjithë kësaj, shumë pak përfitojnë prej tij ose, në të vërtetë, nuk përfitojnë asgjë. Ja pse sot muslimanët në përgjithësi nuk i gëzojnë privilegjet e vërteta të agjërimit.

Edhe pas gjithë kësaj, dikush mund të thotë se ajo që u tha për agjërimin islam është po ashtu e vërtetë edhe për llojet e tjera të agjërimit, si p.sh., agjërimi i hebrenjve, i të krishterëve, apo agjërimi gadian, etj. Pse atëherë muslimanët i kanë të gjitha këto thënie arbitrare kur flasin për llojin e tyre të agjërimit?

Ne apelin tonë ua drejtojmë personave të tillë dhe të gjithë njerëzve. Është kundër parimeve tona fetare dhe kundër moralit tonë si muslimanë që ta defavorizojmë cilindo pejgamber të Zotit, ta mohojmë ndonjë të vërtetë, ose të falsifikojmë ndonjë religion hyjnor. Njerëzit e tjerë ndihen të lirë t'i bëjnë këto gabime dhe mëkate pa kurrfarë përgjegjësie, por ne muslimanët jo, sepse e dimë se posa të biem në këtë nivel kaq të ulët të moralit apo të pamoralit, ne automatikisht do të gjendemi jashtë radhëve të fesë islame. Po ashtu e dimë se institucioni i agjërimit është i vjetër sa edhe vetë njerëzimi dhe se atë e ka caktuar Zoti për njerëzit para fesë islame, ashtu siç e pat caktuar edhe për vetë muslimanët. Por, ne nuk e dimë - dhe nuk besojmë se shumica e njerëzve

e dinë - formën e saktë apo mënyrat me të cilat Zoti i caktoi llojet e tjera të agjërimit. Megjithatë, për hir të së vërtetës dhe kureshtjes, mund t'i lidhim e t'i sqarojmë të gjitha, duke e krahasuar këtë institucion të fesë islame me llojet tjera të agjërimit.

Agjërimi në një perspektivë krahasuese

1. Në religjionet dhe dogmat e tjera, në filozofitë dhe në doktrinat e tjera, ai që agjëron heq dorë nga lloje të caktuara të ushqimit, të pijes apo të substancave materiale; por ai është i lirë që në vend të tyre ta mbushë barkun me diç tjetër, e që po ashtu është e natyrës materiale. Në fenë islame gjatë agjërimit njeriu heq dorë nga të gjitha gjërat e natyrës materiale - nga ushqimi, pijet, pirja e duhanit, etj., në mënyrë që të fitojë kënaqësi shpirtërore dhe ushqim moral. Muslimani e zbraz barkun e tij nga të gjitha gjërat materiale, me qëllim që ta mbushë shpirtin e tij me paqe e bekime, ta mbushë zemrën e tij me dashuri e simpati, ta mbushë shpirtin e vet me fisnikëri e besim dhe ta mbushë trurin e tij me mençuri e vendosmëri.

2. Qëllimi i agjërimit në religjionet dhe filozofitë e tjera, pa dyshim është vetëm i pjesërishëm. Ai u përket ose qëllimeve shpirtërore, ose nevojave fizike, ose kultivimeve intelektuale, por asnjëherë të gjitha këtyre në mënyrë të përbashkët. Në fenë islame, për të gjitha këto përfitime e për shumë qëllime të tjera: sociale dhe ekonomike, morale dhe humanitare, private dhe publike, personale dhe të përgjithshme, të brendshme dhe të jashtme, lokale dhe na-

cionale - veprohet në mënyrë të kombinuar, siç përmendëm më lart.

3. Agjërimi joislam nuk kërkon më tepër se një privim të pjesërishëm nga disa gjëra të caktuara materiale. Nga ana tjetër, agjërimit islam shoqërohet me një devotshmëri dhe besim të veçantë, me një studim të posaçëm të Kur'anit, me një shoqërorizim dhe gjallërim të posaçëm dhe me një vetëdisiplinë të posaçme vetëzgjuese. Me këtë, muslimani që agjëron ndjehet krejtësisht ndryshe nga të tjerët. Ai është tepër i pastër, sa përbrenda aq edhe nga jashtë dhe shpirti i tij është aq i dëlirë, saqë ndjenë se është afër përsosurisë, pasi gjendet shumë afër Zotit.

4. Sa i përket diturisë sonë dhe autoritetit të përvojës së përditshme, filozofitë dhe religjionet e tjera e mësojnë njeriun se si nuk mund t'i arrijë qëllimet e tij morale apo të hyjë në mbretërinë e Zotit përderisa nuk e liron vetveten nga gjiri i çështjeve të përbotshme. Sipas kësaj, për njeriun do të ishte e nevojshme të largohet nga interesat e tij të përgjithshme botërore, t'i mohojë përgjegjësitë e tij njerëzore dhe ta rikthejë në vetvete ndonjë lloj të vetëorturimit apo të asketizmit të mprehtë, ku agjërimi është një ndër elementet kryesore. Agjërimi i këtij lloji me njerëzit e këtij lloji mund të përdoret - dhe është përdorur - si pretekst për ta mbuluar tërheqjen poshtëruese nga vija normale e jetesës. Megjithatë, agjërimi në fenë islame nuk është ndonjë veçim apo ndarje nga jeta, por një "kurorëzim" dhe bashkim i lumtur me të; ai nuk është tërheqje, por është një shtresim në mrekullinë shpirtërore; ai nuk është mohim, por një pasurim moral. Agjërimi islam

nuk e ndanë religjionin nga jeta e përditshme as nuk e ndanë shpirtin nga trupi. Ai nuk prish ndonjë rend, por përkundrazi, e harmonizon të njëjtin. Ai nuk shkrin asgjë, por bashkon e bashkangjet. Ai nuk çintegron, por ngre urë e shëron.

5. Madje edhe koha e agjërimit islam është një fenomen shumë interesant. Në rastet tjera, kjo kohë është e fiksuar me një kohë të caktuar të vitit në mënyrë tejet jofleksibile. Megjithatë, në fenë islame koha vjen me muajin e Ramazanit, muajin e nëntë të vitit. Kalendari islam është kalendar lunar dhe muajt radhiten sipas pozitive të ndryshme të Hënës. Kjo don të thotë se për një numër të kufizuar të viteve, agjërimi islam i përfshinë të katër stinët e vitit dhe lëvizë prapa e përpara ndërmjet verës e dimrit, nëpër vjeshtë e pranverë në një mënyrë rrotulluese. Natyra e kalendarit lunar është e tillë që muaji i Ramazanit, për shembull, bie në janarin e një viti dhe në dhjetorin e vitit tjetër; dhe në çdo kohë në mes të këtyre gjatë viteve që vijojnë. Në kuptimin shpirtëror, kjo don të thotë se muslimani e kënaq përvojën shpirtërore në stina dhe kushte të ndryshme klimatike dhe i ndjenë shijet shpirtërore në stina dhe kushte të ndryshme klimatike; disa herë në dimër gjatë ditëve të ftohta e të shkurtra, disa herë në ditët e gjata e të nxehta të verës, e disa herë edhe diku midis tyre. Mirëpo, kjo ndryshueshmëri e përvojave mbetet për të gjitha kohët një karakteristikë kujtimesh të këtij institucioni islam. Po ashtu, kjo qëndron si një shprehje e paluhatshme e gatishmërisë, e dinamizmit dhe e adaptimit nga ana e besimtarit musliman.

Periudha e agjërimit

Tanimë theksuam se periudha e agjërimit të obligueshëm është muaji i Ramazanit. Periudha ditore e kryerjes së këtij obligimi fillon para agimit dhe mbaron menjëherë pas perëndimit të diellit. Normalisht, ekzistojnë kalendarë të saktë që e tregojnë kohën e saktë, por kur mungojnë lehtësimet e tilla, agjëruesi duhet ta konsultojë anën dhe pozitën e diellit, si dhe gazetatat lokale, raportin e kohës, etj.

Agjërimi i Ramazanit është i obligueshëm për çdo musliman të përgjegjshëm e të aftë (Mukel-lef). Megjithatë, sipas haditheve të pejgamberit Muhammed a.s., ekzistojnë edhe kohë të tjera kur rekomandohet agjërimi. Në mesin e këtyre kohëve hyjnë të hënrat e të enjtet e çdo jave, disa ditë të çdo muaji në dy muajt që e paralajmërojnë ardhjen e muajit të Ramazanit, e ato janë Rexhebi dhe Shabani, gjashtë ditët pas Bajramit të Ramazanit etj. Përveç kësaj, është e preferueshme dhe e pëlqyeshme që të agjërohet cilëndo ditë të cilitdo muaj, përveç në ditët e Bajrameve dhe të premtëve, kur asnjë musliman nuk duhet të agjërojë. Megjithatë, duhet të përsërisim se agjërimi i vetëm i obligueshëm është ai i Ramazanit, që mund të zgjasë 29 apo 30 ditë, varësisht nga pozita e Hënës. Agjërimi është një nga shtyllat kryesore të fesë islame dhe çdo mosplotësim i këtij obligimi, pa ndonjë arsye të fortë e të qëndrueshme, është mëkat që seriozisht ndëshkohet.

Duke e ditur se Zoti mund t'i ndihmojë njeriut, Ai ka caktuar, si alternativë, edhe një agjërimit tregues për ata që e shkelin fjalën e dhënë. Analogjikisht, nëse dikush e shpall bashkëshorten e tij si të

ndaluar, njësoj siç është e ndaluar për të nëna e tij, - që është një zakon pagan paraislam - ai duhet të paguajë për moskujdesin dhe papërgjegjësinë e tij. Me qëllim që të shpëtojë e të falet për këtë mëkat, si alternativë, ai duhet të agjërojë dy muaj të plotë.¹⁷ (Kur'ani, 2:183-185; 5:92; 59:1-4).

Kush duhet të agjërojë

Agjërimi i Ramazanit është i obligueshëm për çdo musliman, qoftë mashkull apo femër, i cili i plotëson këto kritere:

1. Të jetë mentalisht dhe fizikisht i shëndoshë; që d.t.th., të jetë i aftë të agjërojë;

2. Të mos jetë i mitur, ta ketë arritur moshën e pjekurisë, që zakonisht është moshë 14 vjeçare. Fëmijët më të vegjël se kjo moshë duhet të inkurajohen ta fillojnë këtë praktikë të mirë në nivele të lehta; kështu që kur ta mbërrijnë moshën e pjekurisë

¹⁷ Është interesante se shpagimi për shkeljen e fjalës së dhënë është të ushqyerit apo të veshurit e dhjetë personave të varfër. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë ai që e ka bërë këtë duhet të lirojë një rob apo ta paguajë lirinë e tij. Nëse edhe kjo nuk është e mundur, atëherë zgjidhja e fundit është agjërimi treditör (Kur'ani, 5:89). Në rast të përdorimit të fjalëve pa menduar, kur flasim për atë traditë të papëlqyeshme paraislame, obligimi i parë është liri i robit apo pagimi për lirinë e tij. Nëse ai nuk mund ta bëjë këtë, atëherë duhet të agjërojë dy muaj të njëpasnjëshëm, para intimitetit me gruan e vet. Nëse nuk mund të agjërojë, atëherë duhet t'i ushqejë gjashtëdhjetë persona nevojtarë apo t'u ndajë të varfërve gjashtëdhjetë shujta mesatare. Ekzistojnë edhe raste të tjera ku ose kërkohet ose rekomandohet agjërimi, si zëvendësim për kërkesat që nuk mund të kryhen (Kur'ani, 58:1-4; kr. 2:196).

do të jenë mentalisht dhe fizikisht të përgatitur për kryerjen e agjërimit.

3. Të jetë i vendosur në vendbanim të përherëshëm, në qytet, në fermë, etj. Kjo don të thotë se personi nuk duhet të jetë në udhëtim më të gjatë se 50 milje (80 km).

4. Të jetë i sigurt se agjërimi nuk i shkakton as dëm fizik e as dëm mental, përveç reagimeve normale të urisë, etjes, etj.

Përrjashtimet nga agjërimi

Përrjashtim nga kriteret e përrmendura bëjnë me sa vijon:

1. Fëmijët nën moshën e pjekurisë.

2. Njerëzit jonormalë dhe që nuk dinë të japin llogari për veprat e tyre. Njerëzit që i takojnë këtyre dy kategorive lirohen apo përrjashtohen nga ky obligim dhe nuk ekziston kurrfarë detyrimi apo zëvendësimi tjetër për ta;

3. Pleqtë dhe plakat që janë tepër të moshuar e të dobët për ta kryer obligimin e agjërimit dhe t'i përrballojnë vështirësitë që dalin nga ai. Njerëzit e tillë lirohen apo përrjashtohen nga ky obligim; por duhet së paku t'i ofrojnë një muslimani të varfër e nevojtar një shujtë mesatare apo vlerën e saj për çdo ditë. Ky kompensim na e bën të ditur se kurdo që ata mund të agjërojnë, madje edhe vetëm një ditë të muajit, ata duhet ta bëjnë këtë dhe t'i kompensojnë ditët tjera. Përrndryshe, ata janë përrgjegjës për neglijencën e tyre.

4. Njerëzit e sëmurë, shëndeti i të cilëve mund të keqësohet seriozisht nëse agjërojnë. Ata mund ta anulojnë agjërimin gjatë kohës që janë të sëmurë deri në ditën kur të shërohen, kur edhe duhet ta fillojnë kompensimin e agjërimit ditë pas dite.

5. Njerëzit që janë në udhëtim e sipër në largësi më të madhe se 50 milje (80 km). Në këtë rast, këta njerëz mund ta prishin agjërimin përkohësisht vetëm gjatë udhëtimit të tyre dhe ta kompensojnë në ditët e mëvonshme, ditë për ditë. Sipas Kur'anit, për ta më mirë është të agjërojnë po të munden; pa shkaktuar pengesa të jashtëzakonshme.

6. Gratë shtatzënë, lehonat dhe ato që u japin gji foshnjave të tyre po ashtu mund ta prishin agjërimin, nëse mbajtja e tij e rrezikon jetën e tyre personale ose jetën e fëmijëve të tyre. Megjithatë, ato duhet t'i kompensojnë ditët e humbura të agjërimit më vonë, ditë për ditë.

7. Gratë në periudhën e të përmuajshmeve (maksimalisht dhjetë ditë) apo në periudhën e përku-fizimeve tjera (maksimalisht dyzet ditë). Për këto agjërimi është i ndaluar, madje edhe po qe se janë të afta dhe nëse kanë dëshirë. Ato duhet ta anulojnë agjërimin e tyre derisa të pastrohen, e pas kësaj ta kompensojnë ditë për ditë.

Duhet të kuptojmë se këtu, si edhe në të gjitha aktivitetet e tjera islame, qëllimi duhet të tregohet në mënyrë të qartë, se agjërimi bëhet me bindje dhe dëgjueshmëri ndaj Zotit, si përgjigje ndaj urdhrit të Tij dhe si shprehje e dashurisë së madhe ndaj Tij.

Agjërimi në cilëndo ditë të muajit të Ramazanit përjashton çdo ngrënie apo pirje me qëllim, pirjen e duhanit apo lëshimin në çdo marrëdhënie intime; po ashtu e përjashton edhe hyrjen e çfarëdo qoftë materieje përmes gojës në pjesët e brendshme të trupit. Nëse e gjithë kjo bëhet qëllimisht pa ndonjë shkak të arsyeshëm, atëherë dënimi është agjërimi i gjashtëdhjetë ditëve pa ndërprerje, apo si alternativë e dytë, të ushqehen në sasi të mjaftueshme gjashtëdhjetë persona të varfër, përveç kryerjes së agjërit të çdo dite me rend, përkundër asaj dite kur agjërimi është prishur.

Kur agjërimi priset në ditët tjera, përveç këtyre të muajit Ramazan, për shkaqet e lejuara që i përmendëm te pikat e “Përjashtimeve”, personi duhet ta kompensojë agjërimin më vonë, ditë për ditë.

Nëse dikush për shkak të harresës së paqëllimtë bën diçka që zakonisht do ta kishte prishur agjërimin, ky agjërim nuk anulohet por ende është në fuqi, me kusht që ai të mos e bëjë përsëri atë që e prish agjërimin në momentin kur ta kuptojë se ç’është duke bërë.

Me mbarimin e agjërit të Ramazanit, duhet të ndahet një sadaka e quajtur Sadakatu-l-Fitr (Sadakaja e kryerjes së agjërit).

Rekomandime të përgjithshme

Pejgamberi Muhammed ka rekomanduar në mënyrë të vendosur që sidomos gjatë muajit të Ramazanit të respektohen këto veprime:

1. Të hahet një ushqim i lehtë para fillimit të agjërimit (syfyrit).
2. Të hahen tri hurma dhe të pihet ujë menjëherë pas perëndimit të diellit, duke e thënë këtë lutje: “All-llahumme leke sumna, ve ala rizkike eftarna.” (O Zot! Për hir Tëndin agjëruam, e tani e prishim agjërimin(bëjmë iftar) me ushqimin që na e dhe Ti).
3. T’i bëni të ngrënat sa më të lehta sepse, siç ka thënë Pejgamberi, gjëja më e keqe që njeriu mund ta mbushë është barku i tij.
4. Të respektohen vizitat sociale dhe të përforcohen shërbimet humanitare.
5. Të falen namazet e teravisë.
6. Të shtohen studimi dhe këndimi i Kur’anit.
7. Të përmbahen njerëzit në durimin dhe përuljen më të madhe.
8. Njerëzit duhet të jenë jashtëzakonisht të kujdesshëm në përdorimin e shqisave, të mendjes e posaçërisht të gjuhës, të largohen nga bisedat e kota dhe nga thashethemet dhe t’u shmangen të gjitha veprimeve të dyshimta.

Zeqati

Një institucion tjetër dhe një shtyllë e rëndësishme e fesë islame është edhe zeqati. Me sa e dimë, fjala e Kur’anit “Zekah” nuk ka ekuivalent të saj në asnjë gjuhë tjetër. Kjo nuk është vetëm një formë e sadakasë, e të dhënave, apo e taksës. Kjo nuk është

as një shprehje e përzemërsisë. Kjo është diç që fitohet po të kombinohen të gjitha këto elemente, madje edhe shumë më tepër se kjo. Zeqati nuk paraqet vetëm marrje të përqindjes nga pasuria e dikujt, por është një pasurim i begatshëm dhe një investim shpirtëror. Ky nuk është vetëm një kontribut vullnetar për dikë apo për ndonjë shkak, e as nuk është ndonjë taksë shtetërore me të cilën mund t'ia dalë në krye ndonjë njeri i shkathët dhe i mençur. Ai në të vërtetë është një obligim që e urdhëron Zoti e të cilin, në interes të shoqërisë në përgjithësi e kryejnë muslimanët. Fjala e Kur'anit "Zekah" jo vetëm që i ngërthen në vete sadakanë, të dhënat, tatimet, përzemërsinë, taksën zyrtare, kontributet vullnetare, etj., por, kjo fjalë të gjitha këtyre ua bashkangjet edhe urtësinë e Zotit si dhe motivet shpirtërore e morale. Ja pse nuk mund të ekzistojë ekuivalenti i fjalës "Zekah", për arsye të origjinalitetit suprem të Kur'anit, librit hyjnor të Zotit.

Kuptimi i thjeshtë dhe i përpiktë i zeqatit është pastërtia. Kuptimi teknik i fjalës tregon sasinë vjetore të të ardhurave dhe të pasurisë, të cilën muslimani duhet ta ndajë në mesin e benifikuesve të mirëfilltë. Megjithatë, rëndësia fetare dhe shpirtërore e zeqatit është shumë më e thellë dhe shumë më simbolike. E njëjta gjë vlen edhe për anën e tij humanitare dhe shoqërore-politike. Tani do të japim disa nga efektet largpamëse të zeqatit:

1. Zeqati e pastron pasurinë e njerëzve me mjete dhe e pastron atë nga hiset që nuk i takojnë asaj, hiset - apo ato pjesë që duhet t'u ndahen nevojtarëve të mirëfilltë. Nëse zeqati mund të paguhet, duhet të

ndahet menjëherë një përqindje e caktuar e pasurisë në mënyrë të drejtë, për arsye se pronari më nuk gëzon posedim legal apo moral të asaj përqindjeje. Nëse ai nuk dëshiron ta bëjë këtë, sigurisht do të mbajë për vete diçka që nuk i takon atij. Ky do të ishte një korrupsion dhe një uzurpim i qartë në çdo pikëpamje; morale dhe shpirtërore, legale dhe komerciale. Kjo don të thotë se përqindja e mbajtur apo e tërhequr në mënyrë joligjore, e bën gjithë pasurinë të papastër dhe të rrezikshme. Por, në anën tjetër, nëse ndahen mjetet e të varfërve për ata që u takon në mënyrë të drejtë, atëherë ato pjesë të mbetura të tërësisë do të jenë të pastra dhe të ndershme. Kapitali i pastër dhe posedimet e ndershme janë parakushti kryesor i prosperitetit të vazhdueshëm dhe i çfarëdo bashkëpunimi të ndershëm.

2. Zeqati nuk e pastron vetëm pronësinë e kontribuesit, por po ashtu e pastron edhe zemrën e pranuesit nga zilia dhe xhelozia, nga marrëzia dhe nga inati, e në vend të kësaj, ai zgjon në zemrën e tij vullnet të mirë dhe dëshira të flakta për kontribuesin. Si rezultat i kësaj, shoqëria me të madhe do ta pastrojë dhe do ta lirojë vetveten nga lufta dhe nga dyshimi klasor, nga ndjenjat e këqija dhe nga mosbesimi, nga korrupsioni dhe nga çintegrimi, si dhe nga të gjitha të këqijat tjera të ngjashme.

3. Zeqati vështirësitë e të nevojshëmve dhe të anëtarëve të varfër të shoqërisë, i zvogëlon deri në minimum. Ky është një ngushëllim mjaft praktik për njerëzit që kanë më pak fat; por është edhe një thirrje e fortë për të gjithë për t'i përveshur mëngët për ta shtuar pasurinë. Kjo për nevojtarët do të thotë

se u jepet nga natyra si një masë e jashtëzakonshme; por përveç kësaj, edhe ata duhet të bëjnë diçka për vetveten dhe për të tjerët. Për kontribuesin kjo paraqet një thirrje për të fituar sa më tepër, që të mund të kontribuojë sa më shumë. Për të dyja palët, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kjo është një pasuri e hapur për një investim shpirtëror që kompenson me bollëk.

4. Zeqati është formë e shëndoshë e një sigurie të brendshme kundrejt zilisë vetjake dhe zënkave sociale, kundër fëlliqjes dhe kundër depërtimit të ideologjive përmbysëse. Ky është një instrument efektiv në kultivimin e frymës së përgjegjësisë sociale nga ana e kontribuesit dhe ndjenjës së sigurisë dhe të përkatësisë nga ana e pranuesit.

5. Zeqati është një manifestim i qartë i frymës shpirtërore dhe humanitare, i ndërvarshmërisë përkatëse ndërmjet individit dhe shoqërisë. Ky është një ilustrim i shëndoshë i faktit se, edhe pse feja islame nuk e pengon ndërmarrjen private e as që e dënon pronën private, ajo nuk e duron dot kapitalizmin ziliqar dhe vetjak. Zeqati është një shprehje e drejtë dhe e përgjithshme e fesë islame e cila përmban dhe pranon një vijë e marrëdhënie të urtë - mesatare, por efektive dhe pozitive ndërmjet individit dhe shoqërisë, ndërmjet qytetarit dhe shtetit, ndërmjet kapitalizmit dhe socializmit, ndërmjet materializmit dhe spiritualizmit.

Sasia e zeqatit

Çdo musliman, qoftë mashkull apo femër, që në fund të vitit ka vlerë të hollash në mbi tetëdhjetë

gramë ari, të gatshme apo në formë artikujsh tregtarë, duhet të japë zeqatë me një sasi minimale prej 2.5 për qind. Po të ketë personi sasi të gatshme të të hollave është shumë më lehtë. Megjithatë, kur personi disponon me pasuri në formë të mallit nga puna afariste apo në formë artikujsh tregtie, ai duhet ta vlerësojë pasurinë e tij në fund të çdo viti në pajtim me vlerën rrjedhëse dhe ta japë zeqatin në sasinë e njëjtë prej 2.5 për qind nga e gjithë vlera e pasurisë. Nëse investimi i tij është pronë e palujtshme, si ndërtesa me të ardhura dhe industri, atëherë sasia e zeqatit duhet të shkojë me sasinë e përgjithshme të të ardhurave, e jo me vlerën e përgjithshme të tërë pronësisë. Por, nëse ai i nxjerr ndërtesat dhe shtëpitë në shitje dhe tregti, atëherë sasia e zeqatit duhet të shkojë me vlerën e përgjithshme të gjithë pronësisë. Po ashtu, nëse dikush është kreditues dhe nëse njeriu që ka borxh është njeri i besueshëm, zeqati paguhet për sasinë që e ka lënë në besim, për arsye se ajo ende është pjesë e pasurisë së tij të garantuar.

Në të gjitha rastet, duhet të mbahet mend vetëm ajo se personi paguan vetëm për ribalancimin e tij të pastër. Së pari paguhen shpenzimet e tij personale, familjare, harxhimet e tij të nevojshme, kreditë e tij të nevojshme, kurse zeqati paguhet vetëm për ribalancimin e pastër.

Po ashtu duhet të mbahet mend se sasia prej 2.5 për qind është vetëm minimumi. Në kohë të jashtëzakonshme apo në kohë të shtimit të nevojave, sasia e zeqatit nuk kufizohet, sa më tepër që të jepet, aq më tepër do të përfitojnë ata që kanë nevojë. Ndarja

e zeqatit u shërben të gjitha qëllimeve për të cilat formohen shumë fonde të mbledhjes së të hollave. Fondi i zeqatit i zëvendëson të gjitha fondet tjera. Në mënyrë autentike është thënë se në kohën e historisë së administrimit islam, ka patur raste kur nuk ka pasur njerëz nevojare për ta pranuar zeqatin; çdo subjekt - qoftë musliman, i krishterë apo hebre - nga perandoria e gjerë islame ka pasur mjaft për t'i kënaqur nevojat e veta, kështu që të pasurit duhej ta depononin zeqatin në arkën shtetërore. Kjo na tregon se kur ligji i zeqatit zbatohet në mënyrë të drejtë, ai i zvogëlon nevojat e qytetarëve dhe e pasuron më tepër arkën shtetërore, deri në atë masë sa që të mos ketë më të varfër e të nevojshëm, madje derisa të paraqitet edhe teprica.

Fuqia e palujtshme e kësaj mase të interesit publik, i ka rrënjët nga fakti se ajo është një masë hyjnore, një urdhëresë nga vetë Zoti. Ky nuk është një problem personal apo një kontribut vullnetar; ai, në të vërtetë, është një obligim për plotësimin e të cilit njeriu i përgjigjet Zotit në mënyrë të drejtpërdrejtë. Pasi që zeqati është legjislatore e vetë Zotit, e cila i bashkangjitet interesit të përgjithshëm, asnjë muslimani nuk i lejohet që ta refuzojë këtë. Nëse ai nuk zbatohet në mënyrë të duhur, autoritetet kompetente të shtetit e marrin përsipër që në dobi të masave të gjera popullore, ta rivendosin e ta përforcojnë këtë institucion.

Ata që duhet ta pranojnë zeqatin

Kur'ani i Shenjtë i ka klasifikuar ata që duhet ta pranojnë zeqatin në mënyrën që vijon:

1. Muslimanët e varfër, për ta zbutur skamjen e tyre.
2. Muslimanët e nevojshëm, që të furnizohen me mjete, në mënyrë që të mund të fitojnë për jetesën e tyre.
3. Muslimanët e ri (të konvertuar), që t'u mundësohet vendosja dhe adaptimi si dhe t'u plotësohen nevojat e veçanta.
4. Muslimanët, robër të luftës, që të lirohen me pagesë të shumës së të hollave si shpërblim.
5. Muslimanët që kanë borxh, për t'u liruar nga kthimi i këtij borxhi në mënyrë të dhunshme.
6. Muslimanët e punësuar, të caktuar nga ndonjë guvernator musliman për mbledhjen e zeqatit, për t'ua paguar rrogën.
7. Muslimanët në shërbimin e tyre në udhë të Zotit, me mjete të hulumtimit apo të studimit, apo të propagandimit të fesë. Kjo pjesë ndahet për t'i mbuluar harxhimet dhe për t'u ndihmuar atyre që t'i vazhdojnë shërbimet e tyre.
8. Muslimanët në vend të huaj, që kanë nevojë për ndihmë.

Pranuesi nevojtar dhe i drejtë i zeqatit është ai që nuk ka mundësi t'i kënaqë nevojat e tij, apo ka më pak se shuma e paraparë në fund të vitit. Nëse personi posedon vlerë të hollash tetëdhjetë gramë ari e më shumë, ai duhet të jetë kontribues apo dhënës e jo pranues i zeqatit. Nëse një pranues e pranon

pjesën e tij dhe mendon se ajo është e mjaftueshme për nevojat e tij momentale me një bilanc prej shumë s të paraparë për dhënie, ai nuk duhet të marrë më tepër. Ai duhet të kthejë çkado që të jetë e tepërt dhe t'ua japë të hollat pranuesve të tjerë të mundshëm.

Zeqati mund t'u ndahet në mënyrë të drejtpërdrejtë individëve të njërës apo tjetrës nga klasët e përmendura, ose t'u shpërndahet organizatave humanitare që kujdesen për këta individë. Zeqati po ashtu mund t'u ndahet në formë të bursave studentëve dhe hulumtuesve premtues dhe të shkëlqyeshëm muslimanë, apo në formë ndihmash për organizatat për mbarëvajtje dhe institutet e shërbimit publik, të cilat i përkrahin rastet e tilla.

Një muslimani të paaftë apo invalid duhet t'i ndihmojë një musliman tjetër që është i aftë të fitojë. Kontribuesi duhet ta përdorë gjykimin e tij më të mirë në gjetjen e të benefikuarve më të mirë.

Taksat që ne ua paguajmë shteteve, nuk paraqesin zëvendësim të kësaj detyre fetare; zeqati duhet të ndahet nga taksat e tjera dhe të paguhet veçmas nga taksat e shtetit. Megjithatë, muslimanët e Amerikës Veriore mund të kenë lehtësime sa u përket ligjeve të taksave - për arsye se ato përmbajnë disa lehtësime në këtë drejtim. Ata duhet t'ua paguajnë zeqatin të varfërve të merituar dhe pastaj t'i deklarojnë këto shuma të paguara si të dhëna personale ligjore.

Kontribuesi, për arsye se kryen një detyrë të këtillë, nuk duhet të lakmojë vetëglorifikimin apo famën. Ai këtë duhet ta bëjë në mënyrë sa më të fshehtë, me qëllim që të mos bëhet viktimë e hipo-

krizisë apo pasionit për fodullëk, i cili i anulon të gjitha veprat e mira. Megjithatë, nëse zbulimi i emrit të tij apo shpallja e kontributit të tij mund t'i inkurajojë e t'i stimulojë të tjerët, atëherë lejohet edhe kjo.

Zeqati është po ashtu i obligueshëm edhe për kafshët dhe prodhimet bujqësore. Hiset dhe sasia e të hollave që duhet të paguhen për këtë qëllim ndryshojnë prej rastit në rast dhe kërkojnë një studim të hollësishëm. Për këtë, e këshillojmë lexuesin që t'u drejtohet burimeve të elaboruara të Sheriatit dhe fesë.

Haxhi

Shtylla e fundit dhe një ndër institucionet kryesore të fesë islame është haxhi në Mekke. Kryerja e haxhit është obligim, së paku një herë në jetën e njeriut. Kjo vlen për çdo musliman, qoftë mashkull apo femër, i cili është mentalisht, materialisht dhe fizikisht i aftë për këtë. Muslimani i një moshe përgjegjëse, që ka një shëndet mjaft të mirë dhe që është materialisht i aftë dhe i sigurt, duhet të shkojë në haxh së paku një herë në jetën e tij (apo të saj). Sigurimi financiar këtu nënkupton një posedim të mjaftueshëm të mjeteve për t'i mbuluar harxhimet e tij personale dhe të atyre që varen nga ai; po ashtu të ketë mjete të mjaftueshme për pagesën e borxheve të tij - po të ketë ndonjë borxh, derisa të niset për në haxh.

Udhëtimi apo kryerja e detyrës së haxhit është një karakteristikë tjetër e veçantë e fesë islame. Haxhin e caktoi Zoti për t'u shërbyer shumë qëllimeve, ndër të cilat do t'i përmendim:

1. Ai është tubimi më i madh vjetor i fesë, me çrast muslimanët arrijnë të njoftohen ndërmjet veti, t'i studiojnë punët dhe çështjet e tyre të përbashkëta dhe ta përparojnë mirëqenien e tyre të gjithmbarshme. Ai po ashtu është konferenca më e madhe dhe e rregullt e paqes që njihet në historinë e njerëzimit. Në vazhden e udhëtimit në haxh, tema dominante është paqja; paqja me Zotin dhe shpirtin e personit, paqja në mes veti dhe me kafshët, paqja me shpezët e madje edhe me insektet. Rreptësisht është e ndaluar prishja e paqes së dikujt apo të çfarëdo lloj krijese në çfarëdo forme.

2. Haxhi është demonstrim i përgjithshëm i universalitetit të fesë islame dhe një fakt i gjallë për vëllazërinë dhe barazinë e muslimanëve. Muslimanët mblidhen në Mekke nga të gjitha sferat e jetës, nga të gjitha nivelet dhe klasët, nga çdo kënd i rruzullit tokësor, që t'i përgjigjen thirrjes së Zotit. Ata të gjithë në mënyrë të njëjtë dhe të thjeshtë i zbatojnë rregullat e njëjta për një qëllim të njëjtë. Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me mbretëri, por lojalitet të të gjithëve ndaj Zotit. Këtu nuk ekziston aristokracia, por vetëm përrulësia dhe dashuria.

3. Haxhi praktikohet për ta dokumentuar përkushtimin e muslimanëve ndaj Zotit dhe gatishmërinë e tyre për t'i sakrifikuar interesat materiale për shërbimin ndaj Tij.

4. Kjo bëhet për t'i njoftuar haxhilerët me rrethin shpirtëror dhe historik të pejgamberit Muhammed a.s., me qëllim që ata prej kësaj të nxjerrin inspirime të thella dhe ta forcojnë besimin e tyre.

5. Kjo bëhet me qëllim të përkufizimit të ritualeve hyjnore që i kanë bërë Ibrahim dhe Ismaili, të cilët kanë qenë haxhilerët e parë në shtëpinë e parë të Zotit në tokë, d.m.th., Qabja në Mekke.

6. Haxhi është përkujtues i mbledhjes së madhe në Ditën e Gjykimit, kur njerëzit do të qëndrojnë të barabartë para Zotit, e do ta presin fatin e tyre të fundit, ku nuk do të ekzistojë superioriteti racor apo çfarëdo lloj superioriteti ose mbizotërimi tjetër. Kjo po ashtu na e përkujton faktin se vetëm Mekka në gjithë botën ekzistuese ka qenë e bekuar nga Zoti që të jetë qendra e monoteizmit qysh prej kohës së Ibrahimit a.s. dhe se ajo do të vazhdojë të jetë qendër e fesë islame, fesë së monoteizmit të pastër deri në amshim.

Shumë lehtë mund të vërehet se haxhi është akt i pasurimit shpirtëror dhe i përmirësimit e pajisjes morale. Ai është vazhdim i devotshmërisë së intensifikuar dhe e një përvoje të disiplinuar, është një tërësi e interesave humanitare dhe diturisë inspiruese; e të gjitha këto janë të vendosura në një institucion të vetëm të fesë islame.

Përshkrimi i rregullave dhe i hapave që duhet të ndërmerren gjatë haxhit merr mjaft kohë. Andaj për këtë edhe nuk do të bëjmë fjalë këtu. Për hollësitë e mëtutjeshme, lexuesi mund t'i konsultojë veprat më të përpunuara në këtë temë. Megjithatë, duhet të theksojmë se gjatë gjithë udhëtimit dhe zgjatjes së

haxhit, ekzistojnë udhëheqës të informuar që çdoherë me udhëzimet e duhura u ndihmojnë haxhilerëve.

Po ashtu duhet të theksojmë se gjatë gjithë rrugës dhe veprimit atje, dashuria dhe devotshmëria i janë drejtuar vetëm Zotit. Muslimanët shkojnë në Mekke për ta madhëruar Zotin, e jo vetëm për ta puthur gurin. Puthja apo prekja e Gurit të Zi në Qabe është një aktivitet obcional, e jo një obligim apo urdhëresë. Ata që e puthin apo e prekin Gurin e Zi, nuk e bëjnë këtë për arsye se besojnë në Gurin, apo sepse i shtojnë atij attribute besëtytnie. Ata i besojnë vetëm Zotit. E puthin apo e prekin, ose kthehen te Guri vetëm në shenjë respekti apo simboli të dashurisë ndaj peygamberit Muhammed a.s., i cili e vuri Gurin në themelin e Qabes kur sërish ngrihej ajo. Kjo ngjarje ka një rëndësi të posaçme meqë e përshkruan dhe e tregon Muhammedin a.s., si një njeri të destinuar për të krijuar dhe për të vendosur paqe. Kur Qabeja që në meremetim e sipër, disa vjet para ardhjes së fesë islame, Guri i Zi duhej të vendosej në themelet e saj. Udhëheqësit e fiseve patën një mos-pajtim mjaft të ashpër për atë se cili do të ishte ai që do ta kishte nderin ta ristauronte Gurin. Nga e gjithë kjo doli një problem shumë serioz, kur hijet e luftës qytetare filluan të paraqiten mbi vendin e shenjtë. Udhëheqësit e fiseve i shprehnin Gurit një nderim të madh, edhe pse ai nuk ishte gjë tjetër veç një copë guri i thjeshtë. Ky nderim kaq i lartë ndaj Gurit, mund të arsyetohet me faktin se ai në mënyrë të drejtpërdrejtë ishte i lidhur me peygamberin Ibrahim, Babëgjyshin e Madh të arabëve, dhe ndoshta ai që i

vetmi gur i vlefshëm që kishte mbetur qysh nga koha antike e godinës së shenjtë. Sido që të jetë, Guri, sa i përket fesë islame dhe sa u përket vetë muslimanëve, nuk ka vlerë aq të madhe.

Meqë udhëheqësit e fiseve nuk patën sukses ta zgjidhin konfliktin midis tyre, ata vendosën që i pari i cili do të hyjë aty, të vendosë për fatin e tij. Muhammedi që ai që erdhi i pari. Ai vendosi që ta mbështjellë Gurin me një copë pëlhurë dhe u tha udhëheqësve të fiseve ta mbajnë e ta rivendosin në atë mënyrë, që çdo udhëheqës të marrë pjesë në këtë. Ata qenë të kënaqur me këtë vendim të urtë, ndaj menjëherë e zbatuan. Në këtë mënyrë u ndërpre konflikti dhe u vendos paqja. Kjo është ana morale e tregimit për Gurin e Zi. Kështu, kur haxhilerët e puthin Gurin apo kur kthehen dhe e përshëndesin atë me nderim, ata këtë e bëjnë duke e përkujtuar Muhammedin, paqedashësin e mençur. Qëllimi mund të bëhet më i qartë edhe me anë të krahasimit. Është gjë e natyrshme për një patriot që kthehet nga emigrimi, apo për një ushtar që kthehet nga lufta, të bëjë disa gjëra e veprime për t'u kthyer atje sa më shpejtë. Për shembull, ai mund ta puthë tokën në kufi, apo t'i përqafojë me emocione të forta bashkëpatriotët e parë që i takon, apo ta shprehë admirimin e tij ndaj disa shenjave karakteristike të vendit të tij. Kjo gjë konsiderohet si normale dhe e çmueshme. Por, kurrkush nuk do të mendonte se patrioti apo ushtari e adhuron tokën, apo i hyjnizon bashkëpatriotët e vet, apo i shton disa attribute hyjnore tokës së tij. Sjellja e haxhilerëve duhet po ashtu të interpretohet në mënyrë të ngjashme. Qabeja në Mekke

është qendra shpirtërore e fesë islame dhe atdheu shpirtëror i çdo muslimani. Kur haxhiu arrin në Mekke, ndjenjat e tij u ngjasojnë atyre të patriotit, i cili vjen në shtëpi pas largimit nga vatani i vet; apo të ngjashme me ato të ushtarit që vjen nga ndonjë betejë tejet vendimtare. Ky nuk është një interpretim figurativ. Kjo përputhet me të vërtetat historike. Muslimanët e hershëm u dëbuan me dhunë nga shtëpitë e tyre, kështu që vite të tëra qëndruan larg atdheut. Atyre iu ndalua edhe e drejta e ardhjes në Qabenë e Bekuar, shtëpinë më të shenjtë të Zotit. Kur ata u kthyen nga emigrimi, Qabeja ishte destini mi i tyre kryesor. Ata plot gëzim hynë në tempullin e shenjtë, i shkatërruan të gjithë idhujt dhe pikturat që ekzistonin atje dhe i kryen ritet e haxhit.

Ky interpretim ndriçohet edhe me përvojën e veçantë të disa njerëzve të jashtëzakonshëm. Për shembull, një shkrimtar i njohur hungarez shkoi në shtetin e tij të okupuar dhe mori me vete një grusht dhe. Burime të shkruara na informojnë se shkrimtari e ka gjetur kënaqësinë e tij më të madhe në atë grusht dhe, që për atë ka qenë burim inspirimi dhe simbol i shpresës se më në fund do të kthehet në atdheun e tij të lirë.¹⁸

Në mënyrë analoge, një film dokumentar i quajtur “The Palestinians” (“Palestinezët”), i incizuar nga kompania CBS, u emetua në rrjetin televiziv më 15 qershor 1974. Në të u dha intervista me një afarist të pasur, i ikur nga terrori cionist në

¹⁸ E kam lexuar këtë artikull gjatë viteve pesëdhjetë, kështu që për fat të keq nuk mund ta përkufizoj burimin e vërtetë apo emrin e autorit.

Palestinë, në shtëpinë e tij në Bejrut me pajisje ekstravagante. Kur ia përkujtuan fatin dhe pasurinë e madhe që e pati në emigrim ai qeshi, duke bërë me shenjë drejt një kavanozi të vogël të mbushur përgjysmë me dhe. Ai tregoi se kur pat ikur e kish marrë me vete nga Jerusalemi, gjë që për të gjithmonë ka qenë më e vlefshme se çdo gjë që ka poseduar, dhe se do të jepte gjithçka vetëm të kthehet në atdheun e vet - në Palestinë. Gjëja më e rëndësishme në këtë intervistë ishte se familja e këtij njeriu ka qenë prej familjeve më autoritative dhe emocionet e tij duhej të ishin më të shprehura. Nuk është aspak e çuditshme të themi se ky njeri përfaqëson edhe shumë njerëz të tjerë të ngjashëm si ai, dhe se ajo "pasuri e vogël dheu" bëhet shumë e shtrenjtë, madje edhe një gjë e shenjtë në vitet që do të vijnë.

Në një mënyrë të prekshme, Agjencia amerikane e informimit "Associated Press", më 14 tetor 1973 raportoi se: "Bazat e fundit izraelite në anën lindore të Kanalit të Suezit u dorëzuan... dhe 37 trupa të stërlodhura izraelite lundruan në lundra dhe e kaluan kanalin në robëri... disa nga trupat egjiptiane, të emocionuara nga çlirimi përfundimtar i kësaj forte (vija Bar-Lev), i mbushën grushtat me rërë dhe filluan t'i fusin në gojë. Të tjerët e puthën tokën." (Dispatch Observer, f. 2A).

Më vonë, agjencia e njëjtë e lajmeve duke raportuar për robërit e luftës, sirianë që ktheheshin, tha se njeriu i parë që zbriti nga aeroplani "qëndroi në një mbajtëse dhe i tregoi këmbët e tij të gjymtuara...' Këmbët s'janë gjë. Ne jemi të gatshëm ta japim edhe shpirtin tonë...', - bërtiti ai. Pas kësaj, ai insistoi që ta

zbresin nga mbajtëset në tokë, me qëllim që ta puth-
te tokën.” (Dispach Observer, 2 qershor 1974, f. 3A)

Kjo është perspektiva njerëzore nga e cila duhet të shihet Guri i Zi. Kjo më së miri mund të kuptohet vetëm nëpërmjet përvojave të tilla njerëzore në rrethana të jashtëzakonshme.

Vërejtjet përfundimtare

Vizita e varrit të pejgamberit Muhammed a.s. në Medine, nuk është një obligim thelbësor në realizimin dhe kompletimin e haxhit. Megjithatë, është çdoherë e këshillueshme dhe vendosmërisht rekomandohet që kushdo që të shkojë në Medine, duhet ta vizitojë varrin e Pejgamberit - që t’i shpreh nderimet e thella ndaj mësuesit më të madh që e njeh njerëzimi.

Duhet të mbahet në mend se kulmi i haxhit shënohet me ofrimin e një sakrifice, apo me një kurban (blatim) në rrugë të Zotit, me qëllim festimi e plotësimi të kësaj vazhde devocionale dhe ushqimit të të varfërve, në mënyrë që të mund ta ndjejnë gëzimin universal të Ditës së Bajramit. Këtë detyrë nuk e kryejnë vetëm haxhilerët, por të gjithë muslimanët që kanë mjete në çdo kënd të botës.

Disa muslimanë kanë shtruar pyetje serioze lidhur me atë se sa kafshë janë therur gjatë kohës së haxhit për kurban dhe sa sasi të mëdha të mishit janë humbur. Në atë vapë tropike, mungesë të freskimit, të transportit joadekuat dhe të tepricës së mishit që rri me ditë pjesa më e madhe e tij është e papërdorshme. Kjo është një situatë e re me probleme të reja.

Muslimani i vetëdijshëm dëshiron të dijë se çka duhet të bëjë në këtë rast.

Nuk është e nevojshme që tani të fillohet me debate gjyqësore (ligjore) lidhur me mendimet e shkencëtarëve të nderuar fetarë, si të atyre klasikë, ashtu edhe të bashkëkohasve. Megjithatë, duhet të mbajmë mend se feja islame nuk toleron humbje të asnjë lloji apo shkalle dhe se ajo së pari i përgjigjet nevojës më të madhe dhe i lë vend “të keqes më të vogël”; se punon me një sistem të përparësive, nga ato më të rëndësishmet deri tek ato të parëndësishmet, e nga të padëshirueshmet më të vogla kah ato më të mëdha; dhe se është edhe e frytshme edhe adaptuese. Duke u bazuar në këto parime, problemi mund të zgjidhet lehtë. Solucioni rrjedh nga fryma e fesë islame, edhe pse mund të ndodhë që të ketë devijime lidhur me disa interpretime joadekuate. Solucioni mund të jepet në faza dhe në nivele të ndryshme.

Së pari muslimanët duhet të bëjnë gjithçka që është e mundur për t’i siguruar të gjitha lehtësimet për ftohje të mishit, me qëllim që të ruhet teprica e mishit, të konservohet apo të lihet në disponim të të varfërve brenda dhe rreth vendeve të shenjta, gjatë tërë vitit. Së dyti, po ashtu duhet të bëhen përpjekje për transportimin e tepricës së mishit muslimanëve të nevojshëm, kudo që të gjenden. Kafshët e kurbanit mund të theren në Mekke dhe mishi mund të konservohet dhe ngrihet, e pastaj të transportohet në cilëndo pjesë të botës ku ka muslimanë. Së treti, teprica e mishit mund të shitet, e të hollat të përdoren për qëllime sadakaje, në nivel lokal, rajo-

nal, kombëtar apo ndërkombëtar. Këto janë disa nga masat praktike të cilat duhet t'i përdorin muslimanët në mënyrë të bashkuar. Në ndërkohë dhe gjatë kohës kur ndërmerren hapa të këtillë, çdo musliman që e kupton se teprica e mishit do të shkojë kot, duhet ta shtyjë datën kur do ta therë kurbanin. Ai mund ta zgjedhë kohën dhe vendin e duhur, që të mos shkaktohet ndonjë humbje e panevojshme. Apo ai mund t'i paguajë paratë si sadaka për ndonjë shkak legjitim, e të cilat arrijnë shumën e çmimit të kafshës që do të duhej të sakrifikohej si kurban në ditët e haxhit.¹⁹

¹⁹ Ekziston një diskutim mjaft i çmuar në nivel të lartë, që e ka udhëhequr i ndjeri Imam i madh, Mahmud Sheltut në "*El-Fetava-në*" e tij (Kajro, Shtypi i Universitetit El-E'zher, 1959), f. 152-160. Me respekt të posaçëm nuk pajtohem me disa pika të asaj deklaratë. Megjithatë, nuk mund të themi se pikëpamja jonë është pozita e vetme e vërtetë islame; një sjellje e tillë do të ishte tendencioze dhe pa përgjegjësi. Por, ajo që mund të thuhet është kjo: Deri në masën që institucioni i Haxhit e mban jetën sociale, ai i takon lëmisë së Sheriatit (Ligjit islam), që quhet Mu'amelat (transaksionet-bashkëveprimet njerëzore). Kjo lëmi e ligjit e plotëson lëminë e ibadetit (çështjet e adhurimit dhe ritualet), ku zakonisht besohet se e ka vendin institucioni i Haxhit. Megjithatë, këta dy lëmenj janë të pandashëm dhe mund të thuhet se Haxhi - në një kuptim tejet të rëndësishëm - është pjesë e Mu'amelat-it. Duke e njohur këtë dimension shoqëror të Haxhit dhe po ashtu problemin praktik të harxhimit aq të madh të ushqimit të nevojshëm, të të hollave dhe të përpjekjeve, duhet t'i rishpjegojmë rregullat e sakrificës (kurbanit), në atë mënyrë që të mbetemi në harmoni me frymën e fesë islame dhe të mbajmë një nivel të caktuar e të plotë të arsyes, vetëdijes dhe realizmit. Lidhur me këtë, ne e ofrojmë interpretimin e lartpërmendur, me një lutje se do të jetë i pranueshëm nga Zoti dhe se do t'u ndihmojë të gjithë bashkëbesimtarëve tanë muslimanë.

Vërejtja e fundit ka të bëjë me problemin e kurbanit dhe të asaj se çka në të vërtetë simbolizon ai. Siç u theksua edhe në diskutimin e Bajrameve, mishi apo gjaku nuk e kënaqin Zotin. Shprehja e falënderimit ndaj Tij, përdëftimi i besimit në Të, përkujtimi i asaj ngjarjeje historike kur peygamberi Ibrahim u urdhërua që ta ofrojë djalin e tij si sakrificë, një urdhër ndaj të cilit babai dhe djali ishin të gatshëm të nënshtrohen pa kurrfarë dyshimi. Por, jeta e djalit u kursye dhe u zëvendësua me një dash. Ofrimi i kurbanit tanimë është bërë një festim vjetor, me qëllim të përkujtimit të këtij rasti dhe falënderimit ndaj Zotit për të mirat e Tij. Që moti kanë ekzistuar dy versione, sipas të cilëve njëri nga dy djemtë e Ibrahimit duhej të sakrifikohej, Ismaili apo Is'haku.

Muslimanët besojnë se Ismaili e jo Is'haku, që ai që duhej të sakrifikohej si përgjigje ndaj urdhrit të Zotit. Mirëpo, ai u zëvendësua me dash, pasi edhe ai edhe i ati ishin të gatshëm t'i binden urdhrit të Zotit. Ekzistojnë së paku njëzet argumente që e mbështesin këtë besim. Megjithatë, asnjë nga këto nuk ka për qëllim ta zvogëlojë rolin historik të Bijve të Izraelit, apo dritën dhe urtësinë që atyre ua dha peygamberi Musa a.s. Përkundrazi, Kur'ani këtë e dokumenton në shumë thënie të tij (p.sh. shih Kur'anin, 2:40,47; 7:137; 17:2; 40:53; 45:16).

Në mesin e këtyre argumenteve mund t'i numërojmë me sa vijon:

1. I gjithë konteksti i ngjarjes, ashtu siç është shënuar në Kur'an (37:101-113), nuk lë dyshim se Ismaili që djali që duhej të sakrifikohej nga babai i tij, si përgjigje ndaj urdhrit të Zotit.

2. Dhjata e Vjetër, që ekziston sot (Gjen. 21:5), thotë se Is'haku u lind kur babai i tij Ibrahim i kishte 100 vjet, kurse Ismaili u lind kur babai i tij i kishte 86 vjet (Gjen. 21:16). D.m.th., për një distancë kohore prej 14 vjetësh, Ismaili ishte djali i vetëm i babait të tij. Is'haku kurrë nuk qe në një pozitë të tillë. Megjithatë, Dhjata e Vjetër (Gjen. 22:2) thotë se Ibrahimit i është urdhëruar: "Merre tani djalin tënd, djalin tënd të vetëm Is'hakun... dhe sille atë në Tokën e Muriasë dhe ofroje atje për një ofrim të flaktë." Paraqitja e emrit të Is'hakut në këtë kontekst duket se është një shtim. Nuk dihet qartë se ku gjendej Toka e Muriasë, vetëm nëse nuk flitej në këtë mënyrë për kodrinën Merva në Mekke, gjë që e përmban versionin islam.

3. E gjithë ngjarja ndodhi në rrethinën e Mekkes. E dimë se Ismaili dhe nëna e tij e shoqëruan Ibrahimin në Mekke, u vendosën atje dhe i ndihmuan për ndërtimin e Qabes si një tempull i shenjtë. (Kur'ani, 2:124-130; 14:35-40).

4. Ndoshta fakti më i rëndësishëm në favor të besimit islam është se: versioni hebraiko-krishter shpie kah disa konkludime me plot vërejtje: (a) diskriminimi ndërmjet vëllezërve, vetëm për arsye se nëna e njërit ishte robëreshë, kurse nëna e tjetrit grua e lirë; (b) diskriminimi ndërmjet njerëzve për shkak të racës, besimit apo ngjyrës; (c) pretendimi për superioritet shpirtëror në emër të paraardhësve; dhe (ç) mohimi i legjitimitetit të fëmijës, nëna e së cilës është robëreshë. Të gjitha përfundimet dhe konkluzionet e këtilla janë të kundërta me frymën e fesë islame. Muslimanët duhet të mohojnë çdo gjë që i

shpie në atë rrugë. Statusi i paraardhësve të dikujt, bujaria apo fisnikëria e nënës dhe hijet e origjinës sociale apo të ngjyrës, nuk kanë kurrfarë lidhje me vlerat shpirtërore dhe humane të njeriut, së paku jo në sy të Zotit.²⁰

²⁰ Përveç këtyre vërejtjeve, shih po ashtu, A. Yusuf Ali, *"The Holy Qur'an, Text, Translation and Commentary"* (1946), f. 1204-1206; Ibn Kajjim el-Xhevzijje, *"Zad al-Ma'ad..."* (Bejrut) v. I, f. 15-17.

Kapitulli IV JETA E PËRDITSHME NË FENË ISLAME

❖ *Natyra e brendshme*

Jeta shpirtërore

Jeta intelektuale

❖ *Natyra e jashtme*

Jeta personale

Jeta familjare

Jeta sociale

Jeta ekonomike

Jeta politike

Jeta ndërkombëtare

Hyrje

Muslimanët me të drejtë thonë se feja islame nuk është thjesht vetëm një ideal abstrakt, i kuptuar vetëm për një adhurim të pakonsiderueshëm, apo një idhull i ngurtësuar që duhet vizituar nga adhuruesit herë pas here. Feja islame është kod i jetës, është një forcë e gjallë që manifestohet në çdo aspekt të jetës njerëzore. Muslimanët po ashtu thonë se individi është qendra e gravitetit dhe se është një instrument lansues që mund ta vendosë fenë islame, apo çdo sistem tjetër për këtë problem, në një aksion të plotë të nivelit të lartë. Ja pse feja islame fillon me individin dhe në mënyrë të paluhatshme lufton për cilësi e jo për sasi.

Le të fillojmë prej aty ku edhe fillon feja islame - prej individit. Le ta hulumtojmë natyrën e individit, e të zbulojmë se si e shikon feja islame këtë natyrë. Me qëllim të qartësimit të gjërave me sa është e mundur, pa hyrë në analiza filozofike apo në kundërtënie abstrakte, mund ta formulojmë njeriun si qenie që ka dy natyra, që e plotësojnë njëra-tjetrën, të cilat varen e ndërveprojnë midis veti. Këto janë natyra e brendshme dhe natyra e jashtme. Ose, mund të themi se njeriu ka një natyrë që ka dy kahe të ndara qartë, por që nuk mund të ekzistojnë pa njëra-tjetrën. Njëra është e brendshme e tjetra e jashtme. Natyra e brendshme e njeriut i takon Ruhut (shpirti, uni ose zemra) dhe Aklit (mendja, aftësia për të menduar, apo intelekti).

Në ilustrimin tonë të natyrës së brendshme të njeriut kemi të bëjmë me dy aspekte: 1-aspekti shpirtëror apo moral dhe 2-aspekti intelektual. Aktivitetet dhe bashkëveprimet tjera të njeriut do të klasifikohen si natyrë e jashtme e njeriut. Mbi të gjitha, është fakt i gjallë se njeriu nuk jeton vetëm nga buka.

Natyra e brendshme

Jeta shpirtërore

Feja islame e organizon jetën shpirtërore apo morale të njeriut në mënyrë që të mund ta furnizojë atë me gjithë ushqimin shpirtëror të nevojshëm për devotshmëri dhe drejtësi, për siguri dhe paqe. Udhëzimi islam për jetën shpirtërore të njeriut, kur aplikohet në mënyrë besnike, jep rezultate maksimale pozitive sa i përket zhvillimit dhe pjekurisë shpirtërore. Nocionet apo njësitë kryesore në këtë parashkrim të fesë islame janë:

1. Shehadeti
2. Namazi
3. Zeqati
4. Agjërimi
5. Haxhi
6. Dashuria ndaj Zotit dhe Të Dërguarit të Tij; dashuria për të vërtetën dhe për njerëzinë për hir të Zotit.

7. Shpresa dhe besimi në Zot në të gjitha kohët, dhe
8. Sakrifica për hir të Zotit me virtyte të jo-egoizmit të përhershëm.

Aspektet e ndryshme nga këto njësi tanimë i kemi trajtuar, kështu që këtu vetëm do të shtojmë se pa këto elemente themelore nuk mund të ketë besim të vërtetë sa i përket fesë islame.

Jeta intelektuale

Natyra intelektuale e njeriut, siç e përmendëm, ndërtohet apo përbëhet nga mendja, intelekti apo aftësia për të menduar e rezonuar. Feja islame këtij aspekti i kushton vëmendje të veçantë, duke e ndër-tuar strukturën intelektuale të njeriut në bazat më të shëndosha, që mund të klasifikohen me sa vijon:

1. Dituria e vërtetë e bazuar në dokumentime të qarta dhe në evidencë të paluhatshme të përfituar me anë të “përvojës” apo eksperimentimit, ose në të dyja. Lidhur me këtë, pa dyshim mund të thuhet se Kur’ani është autoriteti i parë që i bashkangjitet kërkesës kureshtare për dituri me anë të “përvojës” si dhe me anë të eksperimentit, meditimit dhe vëzh-gimit. Në të vërtetë, është detyrë e përhershme dhe e pamohueshme e çdo muslimani, qoftë mashkull apo femër, ta kërkojë diturinë dhe të vërtetën në kupti-min më të gjerë të fjalës. Natyra dhe e gjithë Gjithë-sia janë të hapura dhe janë pasuri të pashtershme të diturisë dhe të së vërtetës; kurse, Kur’ani qe libri i parë që na e tërhoqi vëmendjen drejt këtyre burime-ve të pasura të diturisë. Ai nuk i pranon “të vërtetat”

e trashëguara apo faktet që nuk kanë dokumentim dhe evidencë për t'i mbështetur. Me sa na është e mundur të dimë, Kur'ani ishte shkresa e parë, e cila në mënyrë të urtë tha "Pse?", dhe që kërkoi argument për çdo bindje dhe pretendim. (Kur'ani, 2:111; dhe 21:24).

Vetë Kur'ani është një thirrje (sfidë) e lartë intelektuale. Ai e thërret intelektin njerëzor të diskutojë për çdo të vërtetë kur'anore apo të krijojë diçka të ngjashme si Kur'ani. Hapeni cilindo kapitull të Kur'anit dhe do të gjeni thirrje për dituri nëpërmjet burimeve të pashtershme të natyrës. Devocioni ndaj diturisë së vërtetë, nga Islami kuptohet si devocion ndaj Zotit në një kuptim tejet kompensues.

2. Pjesa e dytë e kësaj pike është besimi në Zotin, në këtë burim të përhershëm të diturisë dhe zbulesë shpirtërore në fushat e panumërta të mendimit. Në fenë islame, besimi në Zotin është thelbi i gjithë strukturës religjioze. Por, me qëllim që ky besim në Zot të jetë i vlefshëm, feja islame kërkon që të bazohet në siguri të paluhatshme dhe në bindje të fortë. Kjo nuk mund të arrihet pa investimin e duhur të intelektit. Çdo mendje stagnuese apo indifereente dhe çdo vizion i kufizuar nuk mund ta arrijnë lartësinë e të vërtetës më supreme, Zotit, dhe nuk mund ta arrijnë thellësinë e vërtetë të besimit.

Feja islame nuk e njeh besimin po qe se ai predikohet me imitim të verbër dhe kur pranohet qorrazi apo pa e kuptuar. Ky fakt është shumë i rëndësishëm sa i përket jetës intelektuale të njeriut. Feja islame e kërkon besimin në Zot; Kur'ani ka thënie të shumta në të cilat bën thirrje për besimin në Zot.

Por, rëndësia e thënieve të tilla nuk është në vendosjen e tyre në dhomën e mësimit, e madje as në mendje. Rëndësia e thënieve të tilla është se ato përbëjnë një thirrje të ngrohtë dhe një apel urgjent për intelektin që të zgjohet e të mendojë, të analizojë e të meditojë. Është e vërtetë se Kur'ani e zbulon të vërtetën thelbësore për Zotin; por, po ashtu është e vërtetë se nuk do që njeriu të sillet si një trashëgimtar i lazdruar që vetë s'bën kurrfarë përpjekje. Ai na mëson se njeriu duhet ta rrisë pasurinë e tij intelektuale me anë të përpjekjeve serioze dhe fitimit të ndershëm, me qëllim që të jetë intelektualisht i sigurt. "Ajo që lehtë vjen, lehtë edhe shkon", e feja islame nuk e preferon besimin që vjen lehtë, për arsye se lehtë edhe mund të shkojë. Feja islame dëshiron që besimi në Zotin të jetë efektiv dhe i përhershëm, ta ndriçojë çdo kënd të zemrës së njeriut dhe të mbizotërojë në çdo aspekt të jetës së tij. Feja që vjen lehtë këtë nuk mund ta bëjë dhe feja islame nuk do të pranojë asgjë më pak.

Kur feja islame e kërkon besimin në Zot në bazë të diturisë dhe hulumtimit, i lë të hapura të gjitha fushat e mendimit para intelektit, i cili depërton derisa ka mundësi. Ajo nuk përmban kurrfarë kufizimesh kundër mendimtarit të lirë, i cili kërkon dituri me qëllim të zgjerimit të vizionit dhe mendjes së tij. Ajo e mëson atë t'u kthehet të gjitha metodave të diturisë, qofshin ato të pastra, racionale apo eksperimentale. Duke i bërë thirrje intelektit në këtë mënyrë, feja islame e tregon kujdesin e saj të lartë dhe besimin e thellë në aftësitë intelektuale të njeriut, duke dëshiruar që në këtë mënyrë ta lirojë mendjen e

tij nga prangat e forta dhe kufijtë e prekshmërisë. Ajo dëshiron që ta lartësojë individin dhe t'i japë atij vetëbesim dhe autoritet hyjnor, me qëllim që ta zgjerojë horizontin e tij në të gjitha fushat e të menduarit: fizik dhe metafizik, shkencor dhe filozofik, intuitiv dhe eksperimental, organik dhe ndryshe. Ja se si besimi në Zotin e ushqen intelektin dhe jetës intelektuale i jep prosperitet dhe produktivitet. Kur aktivitetet shpirtërore dhe intelektuale të njeriut organizohen në pajtim me mësimet e fesë islame siç përmendëm më parë, natyra e njeriut bëhet e shëndoshë dhe vitale. E kur njeriu në brendësi është i sigurt dhe i shëndoshë, atëherë jeta e tij e jashtme do të ketë natyrë të njëjtë.

Natyra e jashtme

Natyra e jashtme e njeriut është komplekse, e hollësishme, e gjerë, njësoj sikur edhe natyra e tij e brendshme. Duhet përsëri ta theksojmë faktin se shëndetshmëria e së parës, në përmasa të mëdha varet nga ajo e së dytës dhe anasjelltas, për arsye se natyra e përgjithshme e njeriut është një tërësi që përbëhet nga të dy aspektet. Edhe një herë, me qëllim që këtë problem ta kemi më të qartë, natyrën e jashtme të njeriut duhet ta klasifikojmë në disa pjesë dhe nënpjesë. Megjithatë, çdoherë duhet të mbajmë në mend se çdo parregullsi që ndodh në sistemin e natyrës së njeriut, mund të shndërrohet në destruktive dhe fatale. Fakt i rëndësishëm lidhur me këtë është ajo se edhe natyra e brendshme edhe ajo e

jashtme e njeriut mund të reagojnë dhe të bashkëreagojnë në mënyrë përgjegjëse; dhe se feja islame e ka zgjeruar fushëveprimin e saj hyjnor si në aspektet e brendshme ashtu edhe në aspektet e jashtme të jetës.

Jeta personale

Feja islame ka të bëjë me jetën personale të njeriut në atë mënyrë me të cilën siguron pastrimin dhe pastërtinë e njeriut; i jep atij një mënyrë të shëndoshë të të ushqyerit dhe ia tregon mënyrat e drejta të veshjes, të sjelljes, të zbukurimit, sporteve etj.

1. Pastërtia dhe pastrimi

Është urdhëresë islame që muslimani, para se ta falë namazin, duhet të marrë abdest. Natyrisht, përjashtim nga kjo do të bënte rasti kur ai ka marrë abdest më herët, por me kusht që ai të jetë ende i vlefshëm. Kjo larje e obligueshme ndonjëherë mund të jetë e pjesërishme e ndonjëherë e tërësishme, varësisht nga gjendja e tij apo e saj. Por, nëse përkujtohemi se muslimani duhet së paku të kryejë pesë namaze të obligueshme çdo ditë me zemër dhe mendje të pastër, me trup dhe me rroba të pastra, në baza dhe qëllime të forta, atëherë shumë lehtë mund ta kuptojmë efektin vital dhe rezultatet përparësuese të këtij akti të veçantë për njeriun. (krahaso Kur'ani, 4:43; 5:7).

2. Të ushqyerit

Për ta mbajtur zemrën e pastër dhe mendjen e shëndoshë, për të ushqyer një shpirt me aspirata dhe një trup të shëndetshëm, të ushqyerit duhet t'i kushtohet vëmendje e posaçme. Në të vërtetë, kjo është

pikërisht ajo që e mundëson feja islame. Disa persona sipërfaqësorë apo vetëmashtues, mund të pararendojnë se ushqimi dhe pija nuk kanë efekt të drejtpërdrejtë e të rëndësishëm për personin i cili rregullisht e mbush barkun e vet. Megjithatë, kjo sigurisht nuk është pikëpamje e fesë islame, e cila për këtë problem flet në mënyrë shumë më serioze. Parimi i përgjithshëm i fesë islame në këtë drejtim është: Të gjitha gjërat që janë të pastra në vete dhe të mira për njeriun, janë të lejueshme për ushqim, përderisa konsumohen në sasi të përmbajtura. Ndërsa, të gjitha gjërat që janë të papastra, të këqija apo të dëmshme, janë të ndaluara në të gjitha kushtet normale. Çdoherë ka vend dhe fleksibilitet për përjashtime kur hasen raste të nevojës absolute (Kur'ani, 7:157; shih pjesën për Moralin Islam, më lart).

Përveç këtij parimi të përgjithshëm, ekzistojnë edhe disa pije dhe haje të tjera që Zoti i ka ndaluar. Ndër to po i përmendim: mishi i kafshëve apo i shpezëve të ngordhura, mishi i derrat dhe i çdo kafshe tjetër që është therë në emër të çdokujt tjetër, me përjashtim të atij të Zotit (Kur'ani, 2:173; 5:4). Pijet që feja islame i konsideron të dëmshme dhe destruktive për shpirtin dhe moralin njerëzor, si dhe për mendjen dhe moralin e njeriut, janë përfshirë në ajetin kur'anor i cili i ndalon të gjitha llojet e pijeve dhe substancave dehëse dhe të gjitha llojet e bixhozit e lojërave të fatit. (Kur'ani, 5:93-94).

Ndalimi i këtyre lojërave dhe pijeve, në kurrfarë mënyre nuk është ndonjë veprim arbitrar apo ndonjë dekret diktatorial i Zotit. Në realitet, ky ndalim pikësepari është një intervenim hyjnor në interes dhe në

të mirë të njeriut dhe vetëm për hir të tij. Kur Kur'ani i përshkruan këto gjëra të ndaluara si të këqija, të papastra dhe të dëmshme, do të thotë se ai ka një sy vigjilent ndaj moralit dhe mençurisë së njeriut, ndaj shëndetit dhe pasurisë së tij, ndaj fisnikërisë dhe sjelljes së përgjithshme të tij; të gjitha këto janë mjete të vlefshme në respektimin e fesë islame. Shkaqet që qëndrojnë prapa këtij intervenimi hyjnor janë të shumta. Ato janë të natyrës intelektuale dhe shpirtërore, të asaj mentale dhe morale, të asaj fizike dhe ekonomike. Qëllimi i vetëm i të gjitha këtyre është që të tregojnë se si njeriu mund ta zhvillojë vetveten në pajtim me një jetesë të drejtë, që synon kah një bërthamë e shëndoshë e strukturës së një familjeje, të një shoqërie, e së fundi, të të gjithë njerëzisë. Mjekët e mirë të mjekësisë dhe shkencëtarët socialë, tani duhet të jenë të aftë t'i verifikojnë privilegjet e kësaj legjislature islame.

Feja islame është serioze dhe nuk ka kurrfarë kompromisi, si për cilësinë e ushqimit organik të njeriut, ashtu edhe për shëndetin e tij shpirtëror dhe ngritjen e tij intelektuale. Këtë pikë e vë në pah fakti se disa artikuj të ditës janë të ndaluar në lloj, siç përmendëm më parë, e disa të tjerë në gradë. Gjërat që janë të lejuara për muslimanët duhet të merren në sasi mesatare pa lëshim apo teprim (Kur'ani, 7:31). Pasi që t'i refuzojë të gjithë artikujt e ndaluar, muslimanin e thërret Zoti që të kënaqet me furnizimet e Tij të këndshme dhe t'i shprehë falënderim Furni-

zuesit të Mëshirshëm (Kur'ani, 2:168, 172; 5:90-91).²¹

3. Veshja dhe zbukurimi

Sa i përket veshjes dhe zbukurimeve, feja islame i merr parasysh në mënyrë tejet rigorozë parimet e rregullsisë, të modestisë, të ndershmërisë dhe të burrërisë. Çdo gjë që në të veshur dhe në të zbukuruar nuk është në pajtim me këto parime dhe që nuk përkon me vlerat e lartpërmendura, ndalohet në emër të fesë islame. Materiali i veshjes dhe mënyrat e veshjes që mund të provokojnë arrogancë apo mburrje të rrejshme dhe fodullëk, janë rreptësisht të ndaluara. Në të njëjtën mënyrë janë të ndaluara zbukurimet që mund ta dobësojnë moralin e mashkullit apo ta zvogëlojnë burrërinë e tij. Njeriu duhet t'i mbetet besnik natyrës së tij mashkullore të cilën Zoti e ka zgjedhur për atë dhe çdoherë duhet të qëndrojë larg nga të gjitha lojërat që mund ta rrezikojnë apo dobësojnë karakterin e tij. Ky është shkaku kryesor pse feja islame ia tërheq vëmendjen njeriut të mos përdorë disa mjete të veshjes e pëlhura si p.sh., mëndafshin e pastër dhe disa gjëra të çmueshme (si p.sh., floririn) për qëllime zbukurimi. Këto

²¹ Kjo përsëritje e pjesërishtme ka për qëllim që ta ritheksojë këtë problem, prandaj edhe mund të falet. Lidhur me diskutimin në përgjithësi, shihe Konceptin e Moralit më lartë, dhe po ashtu Ibrahim Kazim, M.D.: "*Medical Aspects of Forbidden Foods in Islam*" (Aspektet mjekësore të ushqimeve të ndaluara në Fenë islame), El-ITTIHAD (Lidhja e Studentëve Muslimanë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Kanadasë), 1391/1971, v. 8, n. I, f. 4-6. Ky artikull mbaron me një bibliografi të shkëlqyer të burimeve mjekësore dhe fetare.

sende i përkasin vetëm natyrës femërore. Bukuria e mashkullit nuk shihet në mbajtjen e stolive të çmueshme apo në veshjen e rrobave nga mëndafshi i pastër, por në moralin e lartë si dhe në natyrën dhe sjelljen e shëndoshë.

Megjithëse feja islame ua lejon femrave mbajtjen e gjërave që janë të ndaluara për meshkujt, meqë ato i takojnë vetëm natyrës femërore, ajo nuk i lejon gratë të bëhen të lira e të enden vërdallë. Ajo i lejon gruas t'i mbajë ato sende që i takojnë natyrës së saj, por në të njëjtën kohë ia tërheq vërejtjen që të mos bëjë asgjë që mund ta shkatërrojë atë natyrë. Mënyra në të cilën gruaja duhet të vishet, të zbukurohet, të ecë, madje edhe të shikojë, është një çështje shumë delikate; e feja islame i kushton rëndësi të veçantë këtij problemi. Pikëpamja e fesë islame lidhur me këtë përqëndrohet në mirëqenien e përgjithshme të të gjitha grave. Feja islame i këshillon burrat që posaçërisht t'u ndihmojnë grave ta mbajnë e ta zhvillojnë dinjitetin dhe nderin e tyre; të jenë larg thashethemeve të kota apo pëshpëritjeve e fjalëve qëllimkëqija dhe larg mendimeve të dyshimta. Kjo këshillë mund të shihet në këto ajete të Kur'anit:

“Thuaju besimtarëve t'i ndalin shikimet (prej haramit), t'i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre se kjo është më e pastër për ta. All-llahu është i njohur hollësisht për atë që bëjnë ata. Thuaju edhe besimtareve t'i ndalin shikimet e tyre, t'i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos i zbulojnë stolitë e tyre përveç atyre që janë të dukshme, le t'i vënë shamitë mbi kraharorin e tyre dhe të mos ua tregojnë bukuritë e tyre askujt tjetër përveç burrave

të tyre, baballarëve të tyre ose baballarëve të burrave të tyre, djemve të tyre ose djemve të burrave të tyre, vëllezërve të tyre ose djemve të vëllezërve të tyre, apo djemve të motrave të tyre, ose grave të tyre (që u përmendën) dhe robërshave që i kanë në pronësinë e tyre, ose shërbëtorëve nga meshkujt të cilët nuk ndiejnë nevojë për femrat ose fëmijët që nuk e kanë arritur pjekurinë për gra. Le të mos kërcasin me këmbët e tyre për t'i zbuluar fshehtësitë nga stolitë e tyre. Pendohuni të gjithë te All-llahu, o besimtarë, në mënyrë që të gjeni shpëtim.” (Kur’ani, 24:30-31).

Feja islame është shumë e ndjeshme sa i përket mënyrës së veshjes dhe zbukurimit. Është e qartë se edhe burri edhe gruaja duhet t’i përmbahen natyrës së tyre përkatëse, t’i ruajnë instinktët e tyre natyrore dhe t’i ushqejnë ato me modesti dhe me një moral të lartë. Thuhet se pejgamberi Muhammed a.s., ka thënë se Zoti i dënon ata burra që sillen apo veprojnë si gratë, e po ashtu edhe ato gra që sillen apo veprojnë si burrat. Megjithatë nuk duhet të harrojmë se feja islame nuk vë kurrfarë dallimesh në veshjet dhe zbukurimet që nuk janë të dëmshme apo janë normale. Në realitet Kur’ani gjërat e këtilla i quan dhurata të bukura të Zotit dhe i injoron ata të cilët i shohin ato gjëra si të ndaluara. (Kur’ani, 7:32-33).

4. Sportet dhe argëtimet

Po ashtu duhet të marrim parasysh se shumica e formave islame të adhurimit siç janë: namazi, agjërimi, haxhi, përmbajnë disa elemente të sportit, edhe pse të gjitha këto për nga natyra kanë qëllime shpirtërore. Por, kush do të mund ta mohonte ndërvar-

shmërinë e përhershme ndërmjet mendjes dhe moralit të njeriut? Megjithatë, kjo nuk është e gjithë ajo që feja islame e thotë lidhur me sportet e argëtimet. Çdo gjë që nxit një mendim të shëndoshë apo e freskon mendjen dhe çdo gjë që e rivitalizon trupin me qëllim që ta mbajë njeriun të shëndoshë, inkurajohet nga feja islame deri në atë masë sa të mos shkaktojë ndonjë mëkat, ose derisa nuk shkakton dëm, respektivisht, derisa nuk e pengon apo vonon kryerjen e obligimeve të tjera. Rregull e përgjithshme lidhur me këtë problem është thënia e pejgamberit Muhammed a.s., se që të gjithë besimtarët e Zotit kanë cilësi të mira, por më i forti është më i mirë se i dobëti. Po ashtu thuhet se ai i ka lejuar sportet dhe argëtimet, të cilat e ndërtojnë qëndrueshmërinë fizike dhe e përforcojnë moralin.

Do të ishte gabim i madh që sporteve dhe argëtimit t'u bashkangjesim diçka që nuk i takon as sportit e as argëtimit. Disa njerëz i konsiderojnë bixhozin dhe pirjen e alkoolit si sporte e argëtime, por pikëpamja e fesë islame nuk është e tillë. Jeta duhet të jetohet, ajo na është dhuruar për një qëllim të caktuar. Askush nuk duhet ta keqpërdorë atë, apo ta lërë të varet vetëm nga fati apo nga rasti. Sipas kësaj, kjo nuk mund të vlerësohet si moskonsiderim apo dhunim i të drejtave personale të njeriut, në momentin kur feja islame e zgjeron fushëveprimin e saj hyjnor për ta organizuar jetën, madje edhe në aspektet personale të saj. Për shkak se jeta është pasuria më e shtrenjtë e njeriut dhe se është caktuar për qëllime fisnike, feja islame ia ka treguar njeriut mënyrën se si ta jetojë atë sa më drejtë dhe me

kënaqësi. Ndërmjet masave që ndërmerren lidhur me këtë, mund ta përmendim ndalimin e bixhozit, i cili në të vërtetë më shumë e ngritë se sa e ulë tensionin. Është një keqpërdorim tejet i madh ta bësh jetën mjet të fatit dhe të rastit të lirë. Ai paraqet një devijim nga rrjedha normale e jetës; - faktikisht kjo ndodh nëse njeriu ia lë fatin e vet një rrote të çmendur të lojërave dhe i investon mundësitë dhe aftësitë e tij në lëvizjet e lojërave me rezultate të paparashikueshme. Që të mbrohet njeriu nga të gjitha këto pengesa mentale e të panevojshme dhe nga shkatërrimi nervor, dhe me qëllim që ta aftësojë atë që të jetojë një jetë natyrore, si në mjetet ashtu edhe në qëllimet e saj - feja islame i ka ndaluar të gjitha llojet e bixhozit.

Në mënyrë analoge, do të ishte turp të ikësh nga realiteti dhe t'i bësh një ofendim të madh cilësisë më të mirë të njeriut, d.m.th., mendjes - të lidhesh me zinxhirët e fortë të intoksikimit (helmimit, dehjes) apo të jepesh pas rrotës së prishur të alkoolit. Pasojat dhe tragjeditë e intoksikimit janë aq të mëdha, sa që nuk duhet të flitet më për to. Dita-ditës shuhen shumë jetëra, pikërisht si pasojë e intoksikimit. Shumë familje shkatërrohen, pikërisht për shkak të kësaj të keqeje. Shumë miliarda dollarë derdhen në konton e kanalit të pirjes për çdo vit. Për shkak të shprehive të pijes, shumë dyer janë mbyllur nga varfëria dhe mjerimi. Përveç shkatërrimit të shëndetit, depresionit të mendjes, topitjes së shpirtit, shterjes së pasurisë, çintegritit të familjeve, fyerjes së dinjitetit njerëzor, sabotimit të moralit, tërheqjes poshtëruese nga realiteti; çdonjëri nga të ashtuquajturit pirës

socialë, është një alkoolist potencial. Feja islame nuk mund t'i tolerojë këto të këqija apo ta lejojë njeriun t'i injorojë të gjitha kuptimet e jetës në këtë mënyrë tragjike. Ky është shkaku pse feja islame nuk i bën bashkë bixhozin dhe alkoolin me sportet dhe argëtimet tjera. Ajo i ka ndaluar të gjitha këto njëherë e përgjithmonë. Me qëllim që njeriu të mund ta çmojë më mirë këtë pikëpamje të fesë islame, ai mund t'i shfletojë gazetatat, raportet mjekësore, të vizitojë çdo agjenci të shërbimit social, apo të marrë pjesë në çfarëdo lloj procesi gjyqësor. Nga të gjitha problemet sociale, alkooli është më i rrezikshëm. Më se gjysmëmilion amerikanë çdo vjet shndërrohen në alkoolistë kronikë. Njëri nga çdo dhjetë apo dymbëdhjetë persona që fillojnë me pijen e parë, është kandidat potencial që të bëhet alkoolist. Të gjitha këto tragjedi të dhembshme dhe humbje të pakompensueshme, flasin shumë më tepër se çdo argument tregtar apo teologjik.

Jeta familjare²²

Ekzistojnë shumë definicione dhe përshkrime për familjen. Për qëllimin tonë, do ta përmendim definicionin që vijon. Familja është një bashkësi njerëzore sociale, anëtarët e së cilës janë të lidhur me anë të lidhjeve të gjakut, apo me anë të marrëdhënieve martesore (të bashkëshortësisë).

²² Ky diskutim është një shkurtesë e studimit të gjerë të autorit, "Struktura familjare në Islam" (botuar nga *Logos-A* më 1995, përkthyer nga Urim Poshka).

Lidhja familjare kërkon edhe pranim të dyanshëm të të drejtave dhe obligimeve, të cilat i përshkruan feja apo i detyron ligji, dhe po ashtu kërkohet që të gjitha këtyre t'u përmbahen të gjithë anëtarët e familjes. Sipas kësaj, të gjithë ata kanë disa angazhime të përbashkëta. Këto i takojnë identitetit dhe furnizimit, trashëgimit dhe këshillimit, dashurisë ndaj të rinjve dhe sigurisë për të moshuarit si dhe shtimit të përpjekjeve për sigurimin e kontinuitetit familjar në paqe.

Siç mund të shihet qartë nga e gjithë kjo, bazat e familjes në fenë islame janë lidhjet e gjakut, si dhe lidhjet martesore. Adaptimi, marrëveshja reciproke, klientësia, pajtimi privat për intimitet seksual dhe martesat e "ligjit të zakonshëm" apo "martesat e provës", nuk e përbëjnë familjen në kuptimin islam. Feja islame e ndërton familjen në baza të shëndosha, të cilat kanë aftësi të gjejnë një kontinuitet të arsyeshëm, një sinqeritet të vërtetë dhe një intimitet të pjekur. Themelet e familjes duhet të jenë aq të forta e të natyrshme, saqë të mund të ushqejnë reciprocitet të sinqertë e të vërtetë dhe falënderim moral në sasi të mjaftueshme. Feja islame thotë se nuk ekziston marrëdhënie më e natyrshme se sa ajo e gjakut, dhe se nuk ekziston shembull më i plotë i intimitetit seksual përveç atij në të cilin gërshetohen morali dhe kënaqësia.

Feja islame i njeh edhe virtytin religjioz, nevojën sociale dhe përparësitë morale të martesës. Mënyra normale e sjelljes për individin musliman është të jetë i orientuar drejt familjes dhe ta synojë krijimin e familjes së vet. Martesa dhe familja janë në

qendër të sistemit islam. Ekzistojnë shumë pjesë të Kur'anit dhe thënie të Pejgamberit, të cilat shkojnë aq larg saqë thonë se kur muslimani martohet, ai faktikisht e ka përsosur gjysmën e fesë së tij dhe le të jetë i dhënë pas Zotit e i kujdesshëm për gjysmën tjetër.

Shkencëtarët muslimanë e kanë interpretuar Kur'anin dhe kanë thënë se martesë është një obligim fetar, një ruajtës i moralit dhe një zotim shoqëror. Si obligim fetar, ai duhet të plotësohet, por si edhe të gjitha obligimet tjera të fesë islame, këtë mund ta gëzojnë vetëm ata që janë të aftë të ballafaqohen me përgjegjësitë që dalin nga vetë martesë.

1. Kuptimi i martesës

Pavarësisht nga ajo se çfarë kuptimesh njerëzit i përshkruajnë martesës, feja islame atë e shikon si një lidhje të fortë (mithakun galidh), një gjë që është mjaft tërheqëse për kuptimin e plotë të fjalës. Kjo është një lidhje e fortë me vetë jetën, me shoqërinë dhe me ekzistimin e suksesshëm të racës njerëzore të përmbushur me dinjitet. Kjo është një lidhje që partnerët e martesës e bëjnë mes vete, por edhe me Zotin. Në këtë lidhje gjejnë një plotësim dhe vetë-kuptim reciprok, dashuri dhe paqe, mëshirë dhe urtësi, mirëqenie dhe shpresë. E gjithë kjo është kështu për arsye se martesë në fenë islame fillimisht dhe në radhë të parë merret si një veprim i drejtë, si një veprim i devocionit të përgjegjshëm. Kontrolli seksual mund të jetë një ngadhënjim moral, riprodhimi një nevojë apo shërbim social, e shëndeti i mirë një gjendje e kënaqësisë shpirtërore. Megjithatë, këto vlera dhe qëllime të martesës do të kenë një

kuptim tjetër specifik të theksuar nëse u bashkangjitet ideja për Zotin, të marra po ashtu edhe si lidhje religjioze dhe të brendësuar si bekime hyjnore. Në të vërtetë, duket se kjo është pika kryesore e martesës në fenë islame. Me qëllim të parafrazimit të Kur'anit, kjo thirrje i dedikohet njerëzimit: *“O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqen) e saj, e prej atyre dyve u shtuan shumë burra e gra.”* (Kur'ani, 4:1). *“Dhe nga faktet (e madhërisë së) e Tij, është ajo që për të mirën tuaj Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe midis jush krijoi dashuri e mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë.”* (Kur'ani, 30:21). Madje edhe në momentet më të vështira të jetës në martesë dhe në mes të mospajtimeve dhe padive ligjore, Kur'ani i përkujton bashkëshortët për Ligjin e Zotit; i urdhëron ata të jenë të përzemërt me njëri-tjetrin, sinqerisht mirëbërës ndaj njëri-tjetrit dhe mbi të gjitha, të jenë të obligueshëm ndaj Zotit.

Duhet po ashtu të cekim se kushtet islame për martesën vlejné edhe për burrat edhe për gratë në mënyrë të barabartë. Për shembull, nëse beqaria nuk u rekomandohet burrave, ajo po ashtu vlen edhe për gratë. Me këtë njihet edhe fakti se nevojat e grave janë po ashtu legjitime dhe se seriozisht merren parasysh. Në të vërtetë, feja islame konsideron se martesë është normale dhe natyrore si për gratë ashtu edhe për burrat. Madje ajo mund të vlejë më tepër për gratë sepse i siguron ato, në mes tjerash, edhe me një sigurim relativ ekonomik. Përparësia e rëndësishme e grave, megjithatë, nuk e karakterizon

martesën vetëm si një bashkëpunim të thjeshtë ekonomik. Në të vërtetë, aspekti më i vogël kryesor i martesës në fenë islame është faktori ekonomik, pavarësisht se sa i fuqishëm mund të jetë. Transmetohet se Pejgamberi ka thënë se gruaja kërkohet si bashkëshorte për pasurinë e saj, për bukurinë e saj, për fëmijë dhe për prejdardhjes së saj, apo për vlerat e saj fetare; megjithatë, i bekuar dhe i kënaqur është ai, i cili e zgjedh bashkëshorten e tij për shkak të devotshmërisë së saj në krahasim me të gjitha të tjerat. Kur'ani, atyre që nuk janë të martuar dhe që janë të devotshëm, ua rekomandon martesën, edhe pse këta persona mund të jenë të varfër apo robër (Kur'ani, 24:32). Në anën tjetër, çfarëdo lloj dhurate të martesës t'i japë bashkëshorti bashkëshortes së tij dhe çkado që të ketë pranuar ajo para apo pas martesës, i takon vetëm asaj. Nuk ekziston një bashkësi e domosdoshme e pronës për burrat e për gratë. Përveç kësaj, mashkulli është ai që përgjigjet për mirëmbajtjen dhe sigurimin ekonomik të familjes. Ai duhet ta sigurojë gruan me ndihmë, të cilën ajo e ka pasur para martesës, dhe, sipas disa dijetarëve, ajo nuk ka obligim ligjor për t'i bërë punët e shtëpisë, edhe pse ajo mund ta bëjë këtë dhe zakonisht e bën, për këtë apo për atë arsye, p.sh., për bashkëpunim, ekonomi, etj.

2. Përhershmëria e martesës

Meqë feja islame e konsideron martesën si një lidhje shumë serioze, ajo ka caktuar disa masa për ta bërë lidhjen martesore sa më të përhershme. Të dy anët duhet të përpiqen t'i mbërrijnë kushtet e moshës së caktuar, pajtueshmërinë e përgjithshme, prikën e

arsyeshme (mehrīn), vullnetin e mirë, pëlqimin e lirë, kujdestarinë e përbashkët, qëllimet fisnike dhe intimitetin gjykimplotë. Kur të dy anët hyjnë në një kontratë martesore, qëllimi duhet të jetë i qartë që të jetë lidhje e përhershme, e lirë nga çdo caktim i rastit apo i përkohshëm. Për këtë shkak martesat e provës, martesat kohore dhe të gjitha martesat që shfaqen si eksperimentale, të rastit apo të përkohshme, feja islame i ndalon.²³ Në njërin ndër thëniet më të qarta të Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ves-sel-lem, ai ka deklaruar se të dënuar janë burrat dhe gratë të cilët kënaqen me ndërrimin e shpeshtë të partnerëve në bashkëshortësi, d.m.th., “shijuesit”, të cilët kënaqen me një partner për një kohë, pastaj atë e ndërrojnë me një tjetër, e pastaj edhe me një të tretë, e kështu me radhë. Megjithatë, insistimi në përhershmërinë e martesës nuk do të thotë se marrëveshja e martesës është plotësisht e pathyeshme. Kur’ani i konsideron muslimanët si një popull (ummet) i mesëm, dhe me të vërtetë feja islame është një religjion i “Mesit të Artë”, është një sistem i balancuar dhe i integruar në mënyrë të drejtë. Kjo është posaçërisht e qartë në rastin e martesës, të cilën feja islame nuk e konsideron as si shenjtësi e as si marrëveshje të thjeshtë qytetare. Në realitet, martesë në fenë islame është diçka unike me karakteristikat e posaçme edhe të

²³ Jemi të vetëdijshëm për argumentet komplekse dhe të koklavitura që i kanë përdorë disa muslimanë shi’itë sa i përket të ashtuquajturës Mut’ah martesë. E çmojmë dimensionin shkencor të këtij problemi, por në këtë rast, nuk shohim qëllim që ta ndjekim atë këtu. Lexuesit e interesuar lidhur me këtë mund t’i drejtohen diskutimit të detajizuar të tërë çështjes në librin e ardhshëm “*Struktura familjare në Islam*”.

natyrës së shenjtë edhe të asaj të kontratës. Është e vërtetë se alternativa e këtij ekstremiteti të rastit apo kohor nuk paraqet anën tjetër të pathyeshmërisë absolute të kontratës martesore. Kuptimi islam i kësaj është ai i barabarësisë dhe karakterizohet me një urtësi reale. Kontrata e martesës duhet të merret si serioze, si një lidhje e përhershme. Por, nëse nuk është në rregull për çfarëdo lloj arsyeje të vlefshme, mund të përfundohet me përzemërsi dhe nder, me barazi e paqe.

3. Marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve

Me devotshmërinë, si bazë të zgjedhjes dhe me plotësimin e sinqertë të kushteve të martesës, të dy palët duhet të jenë të kënaqura dhe ta çojnë jetën në martesë ashtu siç duhet. Megjithatë, feja islame shkon më larg se vetëm tregimi i sjelljes së burrave dhe grave. Ekzistojnë shumë thënie të Kur'anit si dhe të Sunnetit që kërkojnë përzemërsi dhe barazi, nënshtrim dhe dashuri, simpati dhe kujdes, durim dhe vullnet të mirë. Pejgamberi madje shkon aq larg saqë deklaroi se muslimani më i mirë është ai që sillet më së miri me familjen e tij; ndërsa lumturia më e madhe dhe më e bekuar në jetë është gruaja e mirë dhe e drejtë.

Lidhja martesore krijon role të reja për të dy palët. Çdo rol është një përmbledhje të drejtash dhe obligimesh të barabarta dhe përpjesëtuese. Roli i burrit faktikisht shihet në parimin e moralit, i cili thotë se është detyrë solemne ndaj Zotit që burri ta trajtojë gruan me përzemërsi, nder dhe durim; ta mbajë atë në lidhje martesore me fisnikëri, dhe po ashtu me fisnikëri ta lirojë nga lidhja martesore,

duke mos i shkaktuar asaj ndonjë të keqe apo pikëllim (Kur'ani, 2:229-232; 4:19). Roli i gruas mund të shihet në ajetin i cili thotë se gratë kanë të drejta aq sa kanë edhe obligime sipas barazisë së tyre, por burrat janë një shkallë mbi to (krahaso Kur'ani, 2:228). Këtë shkallë dijetarët muslimanë e interpretojnë me një pjesë tjetër të Kur'anit, e cila thotë: *“Burrat janë përgjegjës për gratë, ngase All-llahu ka graduar disa mbi disa të tjerë dhe ngase ata kanë shpenzuar nga pasuria e tyre...”* (Kur'ani, 4:34). Kjo shkallë mund të jetë e ngjashme me atë që sociologët e quajnë “udhëheqje instrumentale” apo autoritet i jashtëm në amvisëri, për arsye të ndarjes së punës dhe rolit të diferencimit. Megjithatë, kjo nuk e ka domethënien e një diskriminimi historik apo të superioritetit të njërës gjini ndaj tjetrës.²⁴

A. Të drejtat e gruas: Obligimet e burrit

Po t'i “përkthejmë” në zakone të sjelljes, këto parime i japin gruas disa të drejta të caktuara dhe paralelisht me këtë edhe disa obligime. Për arsye se Kur'ani dhe Sunneti i Pejgamberit grave u rekomandojnë përzemërsi, detyra e burrit është po ashtu të sillet me gruan në mënyrë të përzemërt. Pasojë specifike e kësaj dispozite hyjnore është përgjegjësia e tij për mbrojtjen e plotë të gruas, detyrë të cilën

²⁴ Kjo çështje shkallore është keqkuptuar nga muslimanët dhe jomuslimanët. Shumë më tepër për këtë çështje kemi thënë në librin “Struktura familjare në Islam”. Përfundimi ynë është se ky ajet nuk thotë se burrat janë më të mirë apo më të këqij se gratë. E as nuk do të thotë se kujt i përket shkëlqyeshmëria, por kjo vetvetiu identifikohet me burrërinë dhe femërinë.

duhet ta kryejë i kënaqur dhe i disponuar, pa hidhërim, fyerje apo qortim.

Komponentet e mirëmbajtjes - Mirëmbajtja nënkupton të drejtat e pacenueshme të gruas për strehim, veshje, ushqim si dhe kujdes dhe mirëqenie të përgjithshme. Vendi ku banon gruaja duhet të jetë adekuat dhe t'i sigurojë asaj një shkallë të arsyeshme të mëvetësisë, të konfortit dhe të pavarësisë. Më e rëndësishme është mirëqenia e gruas dhe stabiliteti i martesës. Ajo që vlen për vendin e banimit, vlen gjithashtu edhe për veshjen, ushqimin dhe për kujdesin e përgjithshëm. Gruaja ka të drejtë të vishet, të ushqehet dhe t'i shprehet kujdes nga ana e burrit, në pajtim me mundësitë e tij dhe me stilin e jetës së saj. Këto të drejta duhet të ushtrohen pa teprime apo shpirtligësi.

Të drejtat jomateriale - Të drejtat materiale të gruas nuk janë vetëm sigurimi dhe beneficionet e saj. Ajo ka të drejta të natyrës morale, të cilat janë njësoj obliguese dhe specifike. Burrin e urdhëron Ligji i Zotit që ta trajtojë gruan në mënyrë të barabartë, t'i respektojë ndjenjat e saj, duke treguar përzemërsi e kujdes. Burri nuk guxon t'i shfaqë gruas çfarëdo lloj përbuzjeje apo t'ia shkaktojë asaj ndjenjën e dyshimit dhe të pasigurisë. Një gjë e natyrshme që del nga ky rregull, është se asnjë njeri nuk guxon ta mbajë gruan me qëllim që t'i bëjë keq, apo me qëllim që t'ia marrë lirinë. Nëse ai nuk ndjen dashuri e as simpati ndaj saj, atëherë ajo ka të drejtë të kërkojë lirim nga lidhja martesore dhe kurrkush nuk mund t'ia pengojë rrugën për një jetë të re.

B. Obligimet e gruas: Të drejtat e burrit

Obligimi kryesor i gruas si partnere në marrëdhëniet bashkëshortore është t'i kontribuojë suksesit dhe lumturisë së martesës. Ajo duhet të kujdeset për rehatinë dhe mirëqenien e bashkëshortit të saj, nuk guxon ta ofendojë e as t'i ngacmojë ndjenjat e tij. Ndoshta asgjë nuk mund ta ilustrojë më mirë këtë të vërtetë se sa thënia e Kur'anit, e cila i përshkruan njerëzit e drejtë si njerëz që luten:

“Zoti ynë, na bën që të jemi të gëzuar me (punën) e grave tona dhe pasardhësve tanë, e neve na bën shembull për të devotshmit.” (Kur'ani, 25:74)

Kjo është baza në të cilën përfshihen të gjitha obligimet e gruas dhe baza nga e cila ato rrjedhin. Me qëllim që ky obligim themelor të plotësohet, gruaja duhet të jetë besimplote, e besueshme dhe e ndershme. Më konkretisht, ajo nuk guxon ta mashtrtojë bashkëshortin duke iu shmangur qëllimisht shtatzënisë, e ta privojë atë nga pasardhësit e tij legjitimë. Ajo po ashtu nuk guxon të lejojë që ndonjë person tjetër t'i afrohet asaj, që është e drejtë ekskluzive vetëm e burrit të saj, d.m.th., intimiteti seksual. Pasojë e kësaj është se ajo nuk guxon të pranojë apo të shërbejë meshkuj të panjohur në shtëpinë e saj, pa dijeninë dhe lejen e tij. Ajo nuk guxon as t'i pranojë dhuratat e të tjerëve, pa lejimin e tij. Kjo sigurisht është menduar me qëllim të evitimit të xhelozisë, dyshimit, thashethemeve, etj., dhe po ashtu, për ta ruajtur integritetin e të dy palëve. Prona e burrit është nën besimin e saj. Nëse ajo ka qasje në këtë pronë, ose nëse asaj i besohet ndonjë shumë e të

hollave, ajo duhet t'i përdorë ato në mënyrë të mençur. Ajo nuk guxon të japë hua apo depozit nga prona e bashkëshortit pa lejen e tij.

Sa i përket intimitetit, gruaja duhet ta bëjë vetveten të dëshirueshme, të jetë atraktive, përgjegjëse dhe e aftë për bashkëpunim. Gruaja nuk duhet ta refuzojë burrin e vet, sepse Kur'ani i çmon ata të lidhur në një harmoni të ndërsjellë. Natyrisht, kujdes i posaçëm i jepet shëndetit dhe rregullsisë. Përveç asaj, nuk lejohet që gruaja të bëjë çfarëdo qoftë që mund ta bëjë shoqërinë e bashkëshortëve më pak të dëshirueshme, apo të falënderueshme. Nëse ajo bën një gjë të tillë apo e mospërfill veten, burri ka të drejtë të ndërhyjë në lirinë e saj që ta përmirësojë situatën. Me qëllim që të sigurohet vetëplotësimi maksimal për të dy bashkëshortët, ai nuk guxon të bëjë çfarëdo qoftë që mund ta pengojë kënaqësinë e saj.

4. Marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve

A. Të drejtat e fëmijëve: Detyrat e prindërve

Pikëpamja e përgjithshme e fesë islame lidhur me fëmijët mund të shihet nga disa parime. Së pari, ekziston një urdhër hyjnor, i cili thotë se asnjë prind nuk guxon të dëmtohet nga fëmija i vet (Kur'ani, 2:233). Së dyti, duhet po ashtu që edhe prindërit të përpiqen që mos t'u shkaktojnë dëm fëmijëve të tyre. Kur'ani e thotë shumë qartë se prindërit nuk janë gjithmonë imunë nga teprimi i mbrojtjes apo neglijenca. Së treti, Kur'ani ka vënë disa pika udhëheqëse dhe ka theksuar disa fakte lidhur me fëmijët. Ai thekson se fëmijët janë gëzimi i jetës, si

dhe burimi i mburrjes, farë e zbrazëtisë dhe e sigurisë joreale dhe shatërvanë të dëshpërimit dhe shqetësimit. Por, ai megjithatë me mburrje e thekson gëzimin më të madh të shpirtit dhe kujdesin e prindërve nga besimi i tepruar, nga mburrja e rrejshme, ose nga veprat e këqija që mund t'i bëjnë fëmijët. Parimi fetar dhe moral i kësaj pozite është se çdo individ, prind apo fëmijë, drejtpërsëdrejti varet nga Zoti dhe në mënyrë të pavarur përgjigjet për veprat e tij. Asnjë fëmijë nuk mund ta shfajësojë prindin në Ditën e Gjykimit. As prindi, në anën tjetër, nuk mund të thotë diçka në emër të fëmijës së tij. Së fundi, feja islame është shumë e ndieshme sa i përket varësisë së drejtpërdrejtë të fëmijëve nga prindërit. Roli i tyre vendimtar në formimin e personalitetit të fëmijës shihet qartë në fenë islame. Në një thënie shumë sugjестive, Pejgamberi ka thënë se çdo fëmijë është lindur në mënyrën natyrore të *Fitrat-un* (d.m.th., gjendja natyrore e pastër islame), ndërkaq prindërit e tij më vonë e bëjnë atë hebre, të krishterë apo pagan.

Sipas këtyre pikave udhëheqëse dhe më specifike, një ndër të drejtat më të pacenueshme të fëmijës në fenë islame, është e drejta për të jetuar dhe për lumturi e trajtim të barabartë në jetë. Ruajtja e jetës së fëmijës është urdhëresa e tretë në Islam. (Shih Kur'anin, 6:151; kr. 17:23, etj.)

Një e drejtë tjetër e pacenueshme është e drejta e legjitimitetit, e cila thotë se çdo fëmijë duhet të ketë baba, dhe atë vetëm një baba. Një tjetër kompleks të drejtash është ai i socializimit, i ruajtjes dhe i kujdesit të përgjithshëm. Një ndër obligimet më të

rekomanduara që i parashtron feja islame është kujdesi i madh ndaj fëmijëve. Pejgamberi i donte fëmijët dhe e shprehte bindjen se bashkësia e tij muslimane dallohet nga bashkësitë e tjera për nga përziermërsia ndaj fëmijëve. Kujdesi për mirëqenien e tyre shpirtërore, për nevojat e edukimit dhe për mirëqenien e përgjithshme të tyre, është nder i rendit më të lartë. Interesimi dhe përgjegjësia për mirëqenien e fëmijës janë çështje me prioritet më të madh. Sipas këshillave të Pejgamberit, deri në ditën e shtatë pas lindjes fëmijës duhet t'i jepet një emër i mirë e i këndshëm, koka e tij duhet të qethet, e po ashtu duhet të kryhen të gjitha masat e tjera higjienike që i kërkon rritja e shëndetshme e fëmijës. Ky duhet të jetë një rast që duhet festuar e të shënohet me gëzim dhe kënaqësi.

Përgjegjësia dhe mëshirimi ndaj fëmijës ka rëndësi të madhe sociale dhe fetare. Pavarësisht nga ajo se a janë prindërit të gjallë apo jo, a janë të pranishëm apo jo, të njohur apo të panjohur, fëmijës duhet t'i jepet një kujdes optimal. Nëse ka kujdestarë apo kushërinj të afërt që mund të kujdesen për mirëqenien e fëmijës, ata duhet ta kryejnë këtë detyrë. Por, nëse nuk ka ndonjë kushëri apo njeri tjetër të afërt, atëherë kujdesi për fëmijën bëhet përgjegjësi e përgjithshme e gjithë bashkësisë muslimane, zyrtarëve të caktuar dhe e qytetarëve të tjerë.

B. Detyrat e fëmijëve: Të drejtat e prindërve

Marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve janë plotësuese. Prindërit dhe fëmijët në fenë islame janë të lidhur bashkë me obligime të përbashkëta e reciproke. Megjithatë, dallimi në moshë disa herë

është aq i madh saqë i bën prindërit të jenë fizikisht të dobët dhe mentalisht të pafuqishëm. Kjo shpeshherë shoqërohet me padurim, me humbje të energjisë, me sensitivitet të shtuar dhe ndoshta edhe me paragjykime. Kjo po ashtu mund të rezultojë me abuzim të autoritetit prindëror ose me tjetërsim të gjeneratave dhe ndjenja të këqija - kjo është diçka e ngjashme me atë që e quajmë “hendeku midis gjeneratave”. Sigurisht, duke u nisur nga këto aspekte, feja islame ka marrë parasysh disa fakte të rëndësishme, e që i ka kufizuar si parashikime themelore për marrëdhëniet e individit me prindërit e tij.

Fakti se prindërit janë të moshuar dhe që në përgjithësi besohet se kanë më tepër përvojë, nuk i vlerëson shikimet e tyre apo nuk i verifikon standardet e tyre. Analogjikisht me këtë, vetëm rinia nuk është burimi i vetëm i energjisë, i idealizmit apo i mençurisë. Në kontekste të ndryshme, Kur’ani citon shembuj ku prindërit kanë qenë në gabim në marrëdhëniet e tyre me fëmijët; por, po ashtu edhe shembuj ku fëmijët nuk i kanë vlerësuar drejt pozitat e prindërve të tyre. (Shih Kur’anin, 6:74; 11:42-46; 19:42-48).

Ndoshta më me rëndësi është fakti se adetet, folklori, traditat apo sistemi vlerësues i prindërve dhe vetëm standardet nuk e sendërtojnë të vërtetën dhe të drejtën. Në disa pjesë Kur’ani i kritikon ata të cilët ikin nga e vërteta vetëm për arsye se ajo për ta është diçka e re, apo për arsye se është e kundërt me vlerat e prindërve, apo e papërshtatshme për ta. Përveç asaj, Kur’ani thotë se nëse lojaliteti apo dëgjimi i prindërve mund ta tjetërsojë individin nga

Zoti, atëherë ai duhet të anojë kah Zoti, sido që të jetë. Është e vërtetë se prindërit meritojnë kujdes, dashuri, mëshirim dhe respekt të thellë. Megjithatë, nëse ata e kalojnë vijën e drejtë dhe ndërhyjnë në të drejtat e Zotit, atëherë duhet të tërhiqet një vijë kufiri dhe të mirëmbahet ajo.

Të gjitha këto çështje Kur'ani i rumbullakon me konceptin më të rëndësishëm - *Ihsan*, i cili e përcakton të drejtën, të mirën e të bukurën. Rezultatet praktike të konceptit *Ihsan* prindërve u japin një simpati dhe durim, një falënderim dhe mëshirim, respekt për ta dhe lutje për shpirtrat e tyre, duke i vlerësuar e nderuar lidhjet e tyre legjitime dhe duke i furnizuar me këshillim të sinqertë.

Një dimension tjetër themelor i *Ihsanit* është nderimi. Prindërit kanë të drejtë të presin dëgjim nga fëmijët e tyre, dhe po ashtu kanë të drejtë të presin vetëm një kthim të pjesërishëm nga fëmijët për atë që vetë e kanë bërë për ta. Por, nëse prindërit e kërkojnë atë që s'duhet apo kërkojnë në mënyrë të gabuar, mosdëgjimi dhe refuzimi bëhen jo vetëm të arsyetueshme, por edhe masa imperative. Pavarësisht nga dëgjimi apo mosdëgjimi, pikëpamja e fëmijëve ndaj prindërve nuk duhet të jetë një nënshtrim kategorik apo një kryeneçësi pa përgjegjësi.

Pjesa e fundit përbërëse e *Ihsanit*, që duhet të përmendet këtu, është se fëmijët përgjigjen për mirëmbajtjen dhe kujdesin që e bëjnë për prindërit. T'i furnizosh dhe të përpiqesh për mirëmbajtjen e prindërve nëse kanë nevojë për ndihmë, është një detyrë absolute fetare.

5. Aspekte tjera të jetës familjare

Trajtimi i “shërbëtorëve”, anëtarëve të tjerë të familjes, fqinjve dhe farefisit, është i lidhur ngushtë me jetën familjare. Për ata që mbajnë shërbëtorë, peygamberi Muhammed ka dhënë disa këshilla të mira. Pronarët duhet t’i trajtojnë shërbëtorët e tyre si vëllezër e jo si robër; sepse atij që me shërbëtorin e tij sillet si duhet, ka thënë Peygamberi, Zoti do t’ia bëjë vdekjen të ëmbël e të këndshme, një moment që zakonisht është i dhembshëm dhe i rëndë. Shërbëtorët duhet të gëzojnë drejtësi, përzemërsi, mëshirë, ushqim, veshmbathje, strehim dhe shpenzime tjera personale. Peygamberi shkon aq larg, saqë thotë se ata duhet të ushqehen dhe të vishen në të njëjtën mënyrë si pronarët e tyre dhe për këtë të gjithë pronarët t’i furnizojnë ata, si një pjesë e obligimit të tyre ndaj shërbëtorëve. Këta nuk duhet të keqtrajtohen, të mundohen apo të stërngarkohen me punë. Ky përcaktim theksohet me qëllim që të tregohet se sa feja islame e çmon njerëzimin dhe se si e çmon punën pa bërë thirrje për një luftë klasore, apo pa i dhënë ndonjë autoritet despotik klasës punëtore. Ajo që dikush është shërbëtor apo punëtor, aspak nuk ia zvogëlon të drejtat apo nuk ndikon në dinjitetin e tij si qenie njerëzore. As nuk e bën atë të varur nga opiumi i proletariatit utopik. Të gjithë qytetarët e një shoqërie të vërtetë muslimane qëndrojnë në një mbështetje të barabartë, sepse feja islame nuk e njeh sistemin klanor apo qytetarët e klasës së dytë. Superioriteti i vetëm që e njeh feja islame është ai i devotshmërisë dhe i veprave të mira në shërbim të Zotit (Kur’ani, 9:105; 49:13).

Zoti e ka urdhëruar njeriun që ta përcjellë ndihmën dhe përzemërsinë e tij te anëtarët e tjerë të familjes dhe te kushërinjtë, t'u shpreh atyre ndjenja të sinqerta të dashurisë dhe kujdesit të mirëfilltë. Është interesante të përmendim se fjala "farefisni" (el-erham), në gjuhë arabe është e derivuar nga një rrënjë, e cila do të thotë mëshirë (rahmetun). Përzemërsia ndaj një kushëriri apo njeriu të afërt të shpie një hap më afër xhennetit, gjë që është e ndaluar për ata që nuk i respektojnë detyrat e tyre lidhur me këtë. Përmasën e përzemërsisë dhe të trajtimit të përzemërt të kushërinjve dhe të të afërmeve, I Dërguari e ka përshkruar si një bekim hyjnor të jetës dhe të parashikimeve të njeriut. Kjo është një detyrë e shenjtë dhe duhet të kryhet për hir të Zotit, pavarësisht nga përgjigjja e të afërmit (Kur'ani, 2:177; 4:36; 16:90; 17:23-26).

Sipas pikëpamjeve të fesë islame, statusi i fqinjve është shumë i lartë. Të gjithë fqinjët gëzojnë një numër të madh privilegjesh të caktuara nga feja islame. Muhammedi a.s., në elaborimet e tij të mësimëve të Kur'anit, sa i përket kësaj pike thotë se kurrkush nuk mund të jetë besimtar i vërtetë, nëse fqinjët e tij nuk janë të sigurt e të mbrojtur nga ana e tij. Po ashtu, kurrkush nuk mund të jetë besimtar i vërtetë, nëse fqinjët e tij e kalojnë natën të uritur, përderisa ai e ka barkun plot. Pejgamberi ka thënë se ai që sillet më së miri me fqinjët e tij, do ta gëzojnë fqinjësinë e Zotit në Ditën e Ringjalljes. Dhuratat, gëzimet dhe vështirësitë që i sjell jeta, duhet të ndahen e të përjetohen bashkë me fqinjët. Në një deklaratë tjetër të tij, Pejgamberi thotë: "A e dini se cilat janë

të drejtat e fqiu? Ndhmoje nëse të kërkon ndihmë; jepi borxh nëse i nevojitet shprehi kujdes nëse është i brengosur kujdesu për të nëse është i sëmurë; shko në varrimin e tij nëse vdes; uroje nëse fiton ndonjë të mirë ngushëlloje nëse e godet ndonjë e keqe mos ia blloko hapësirën duke ndërtuar ndërtesë të lartë pa lejen e tij; mos e ofendo jepi një pjesë kur blen fryte dhe nëse nuk i jep, silli ato që i ke blerë qetazi në shtëpi dhe mos lejo që fëmijët e tu të dalin me to jashtë shtëpisë dhe të nxisin lakminë e fëmijëve të fqiu”. Përveç kësaj, Pejgamberi ka thënë se të drejtat e fqiu aq shumë theksoheshin nga engjëlli Xhibril, saqë ai (Pejgamberi) mendoi se fqinjët ndoshta do të merrnin pjesë në trashëgiminë e tij.

Jeta sociale

Jeta sociale (shoqërore) e një muslimani të vërtetë bazohet në parimet supreme dhe në të krijuarit e një kënaqësie të sigurt me prosperitet si për individin, ashtu edhe për shoqërinë. Dallimi klasor, klanet sociale dhe dominimi i individit mbi shoqërinë, apo edhe anasjelltas, janë gjëra të panjohura për jetën shoqërore në fenë islame. Në asnjë pjesë të Kur’anit apo të Sunnetit të pejgamberit Muhammed a.s., nuk përmendet superioriteti në emër të ndonjë klase, origjine apo të ndonjë pasurie. Në anën tjetër, ekzistojnë shumë ajete të Kur’anit dhe hadithe të Pejgamberit a.s., që ia përkujtojnë njerëzimit të vërtetat vitale të jetës, të vërteta të cilat në të njëjtën kohë shërbejnë si parime të strukturës sociale në jetën islame. Ndërmjet këtyre është e vërteta se njerëzimi paraqet një familje që rrjedh nga të njëjtit

prindër dhe se që të gjithë kanë aspirata dhe qëllime të përbashkëta.

Uniteti i njerëzimit shikohet në dritën e prindërve të përbashkët, Ademit dhe Havës. Çdo qenie njerëzore është anëtar i familjes universale, të themeluar nga Babai i Parë dhe nga Nëna e Parë, prandaj edhe është caktuar t'i gëzojë mirësitë e përbashkëta ashtu siç është caktuar që t'i ndajë përgjegjësitë e përbashkëta. Kur ta kuptojnë njerëzit se të gjithë ata u takojnë Ademit dhe Havës dhe se këta të dy ishin krijim i Zotit, atëherë nuk do të ketë vend për paragjykime racore, padrejtësi shoqërore, apo qytetarë të klasës së dytë. Njerëzit do të bashkoheshin në sjelljen e tyre sociale ashtu siç janë të bashkuar për nga natyra me lidhjen e prindërve të përbashkët. Në Kur'an dhe në Sunnetin e Muhammedit a.s., në mënyrë të përhershme përkujtohet ky fakt i rëndësishëm - uniteti i njerëzimit për nga natyra dhe origjina. Kjo është kështu me qëllim të eliminimit të mburrjes racore dhe pretendimeve për superioritet kombëtar apo etnik, dhe për ta shtruar rrugën për një vëllazëri të vërtetë (Kur'ani, 4:1; 7:189; 49:10-13).

Uniteti i njerëzimit nuk shihet vetëm në origjinën e tij, por edhe në qëllimet e tij të fundit. Sipas fesë islame, qëllimi i fundit i njerëzimit është Zoti. Ne rrjedhim nga Ai, jetojmë për Të dhe përsëri tek Ai do të kthehemi. Në të vërtetë, qëllimi i vetëm i krijimit, siç e përshkruan Kur'ani, është adhurimi dhe lartësimi i Zotit dhe shërbimi për shkakun e Tij, shkakun e së vërtetës dhe drejtësisë, të dashurisë e mëshirës dhe për shkakun e vëllazërisë dhe moralit (Kur'ani, 51:56-58).

Marrëdhëniet ndërmjet individit dhe shoqërisë bazohen në këtë unitet të origjinës dhe në këtë shkak të fundit, si bazë e jetës sociale në fenë islame. Roli i individit e plotëson atë të shoqërisë. Ndërmjet këtyre të dyve ekziston solidariteti shoqëror dhe përgjegjësia dykahëshe. Individit i përgjigjet për mirëqenien dhe për prosperitetin e shoqërisë së tij. Kjo përgjegjësi nuk i takon vetëm shoqërisë, por po ashtu edhe Zotit. Në këtë mënyrë, individit punon me një vetëdije të shëndoshë shoqërore dhe me një ndjenjë të çiltër të përgjegjësisë së domosdoshme. Roli i tij është që të kontribuojë sa më tepër për shoqërinë e tij dhe për mirëqenien e përgjithshme të saj. Në anën tjetër, shoqëria po ashtu i përgjigjet Zotit për mirëqenien e individit. Kur individit është i aftë, ai e luan rolin e kontribuesit, kurse shoqëria atë të të privilegjuarit. Si shpërblim ndaj kësaj, atij i jepet sigurim dhe kujdes, në rast se ai bëhet i paaftë. Në këtë rast ai do të jetë i privilegjuari, kurse shoqëria kontribuesi. Kështu detyrat dhe të drejtat korrespondojnë në një mënyrë tejet harmonike. Përgjegjësia dhe kujdesi janë të përbashkëta. Nuk ekziston shtet që mund ta dominojë individin dhe ta injorojë entitetin personal të tij. Analogjikisht, nuk ekziston individ apo klasë individësh që mund ta eksploatojë shoqërinë dhe ta korruptojë shtetin. Ekziston harmonia në paqe dhe në sigurim të përbashkët. Ekziston një ndërvarshmëri konstruktive ndërmjet individit dhe shoqërisë.

Përveç unitetit të njerëzimit në origjinë dhe qëllim të fundit dhe përveç kujdesit dhe përgjegjësive së përbashkët, jeta shoqërore në fenë islame

karakterizohet me bashkëpunim në mirësi dhe devotshmëri. Kjo shënohet me një njohje të plotë të individit dhe me të drejtat e shenjta të jetës, gjë që bëhet me rregull e me nder. Po ashtu, kjo shënohet me një rol efektiv që e luan individi në suazat e etikës dhe moralit shoqëror. Në një shoqëri islame individi nuk mund të jetë indiferent. Ai luan një rol aktiv në vendosjen e një morali të shëndoshë social me anë të pranimit të së mirës dhe luftimit kundër së keqes në çdo formë dhe me çdo mjet legjitim që e ka në disponim. Në këtë mënyrë, ai jo vetëm që e mund të keqen, por edhe u ndihmon të tjerëve që të veprojnë në të njëjtën mënyrë. Individi që ndihet indiferent ndaj shoqërisë së tij, është një mëkatar vetjak, ai ka probleme me moralin e tij, vetëdija e tij s'është në rregull dhe besimi i tij nuk e ka vlerën e duhur.

Struktura e jetës shoqërore në fenë islame është shumë e shëndoshë dhe e kuptueshme. Në mesin e elementeve kyç të kësaj strukture mund të numërohen dashuria e sinqertë e njeriut ndaj qenieve të tjera njerëzore, mëshira për të rinjtë, respekti ndaj të mosshuarve, inkurajimi i të dëshpëruarve, vizita e të sëmurëve, lehtësimi i barrës së të mjerëve, ndjenja e pastër e vëllazërisë dhe e solidaritetit shoqëror, respektimi i të drejtave të njerëzve të tjerë për jetë, pasuri e nder dhe respektimi i përgjegjësisë së përbashkët të individit dhe shoqërisë. Është gjë krejtësisht normale të takojmë thënie të Pejgamberit, siç janë këto që vijojnë:

“Kushdo që e lehtëson qenien njerëzore nga pikëllimi në këtë botë, Zoti do ta lirojë nga pikëllimi në Ditën e Gjykimit”.

“Çdokush që nuk ka mëshirë për të rinjtë dhe respekt për të moshuarit, nuk është nga ne muslimanët”.

“Askush nga ju nuk është besimtar i vërtetë, nëse nuk ia dëshiron vëllait të vet atë që ia dëshiron vetvetes”.

“Ai që i thërret të tjerët që të bëjnë mirë, është i njëjtë si edhe mirëbërësi dhe ashtu edhe do të shpërblehet; e kush ngjall të keqen është i njëjtë si edhe keqbërësi dhe ashtu edhe do të dënohet”.

Nga ana tjetër, në Kur'an mund të gjejmë këshilla dhe udhëzime hyjnore siç janë këto që vijojnë:

“O ju që besuat, kini frikë All-llahun me një sinqeritet të vërtetë dhe mos vdisni, pos vetëm duke qenë muslimanë (besimtarë)! Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (Fenë dhe Kur'anin) e All-llahut, e mos u përçani! Përkujtone nimetin e All-llahut ndaj jush, kur ju (para se të pranoni fenë islame) ishit të armiqësuar, e Ai i bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me dhuntinë e Tij aguat të jeni vëllezër. Madje ishit në buzë të greminës së xhehennemit, e Ai ju shpëtoi prej tij. Po, kështu All-llahu ua sqaron juve argumentet e veta që ju të gjeni të vërtetën e lumtur. Nga ju le të jetë një grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillë janë ata të shpëtuarit.” (Kur'ani 3:102-104).

“O ju që besuat! Zbatoni premtimet (obligimet)... Ndhimohuni në mes vete me të mira dhe në të mbara e mosni në mëkate e armiqësi. Kini dro dënimit të All-llahut, se me të vërtetë All-llahu është ndëshkues i fortë.” (Kur'ani, 5:1-2).

Parimet shoqërore të fesë islame mund të shihen edhe në predikimin e fundit të peygamberit Muhammed a.s., gjatë Haxhit të Lamtumirës. Duke iu drejtuar dhjetëra mijë haxhilerëve, në mes të tjerave ai tha:

“O njerëz! Dëgjoni ç’do t’ju them, sepse nuk e di se a do t’ju takoj në këtë vend pas këtij viti.

- O njerëz! Me të vërtetë gjaku juaj, pasuria juaj dhe nderi juaj janë të shenjta për ju derisa të takoheni me Krijuesin tuaj, ashtu siç është e shenjtë kjo ditë, në këtë muaj dhe në këtë vend. A kam qenë mjaft i qartë? O Zoti im, dëshmo...!

- Sa u përket grave tuaja, ju keni të drejta në to edhe ato kanë të drejta në ju... Ju porosis që ndaj grave të jeni të kujdesshëm, sepse ato janë nën betimin tuaj dhe nuk e kanë të lejuar që të bëjnë çfarëdo qoftë vetë... All-llahu ua ka dhënë gratë në amanet dhe ju ka lejuar që t’u afroheni. Frikësojuni All-llahut shkaku i grave dhe ndaj tyre bëhuni të kujdesshëm...!

- Gjakmarrja nga koha e xhahilijetit anulohet...

- E për robërit tuaj! Shihni t’i ushqeni me atë ushqim me të cilin ushqeheni edhe vetë, dhe vishni ata me të njëjtat rroba me të cilat edhe ju visheni; e nëse ata bëjnë ndonjë gabim, të cilin ju nuk mund ta falni, atëherë ndahuni nga ata, sepse ata janë shërbëtorë të Zotit dhe nuk duhet të trajtohen me urrejtje...!

- O njerëz! Besimtarët vërtet janë vëllezër, kurse pasuria e vëllait është e paprekshme, përveç nëse këtë ai e lejon vet...!

- Kush është i pranishëm le t'ia komunikojë atij që mungon. Me shpresë se ai, të cilit do t'i komunikohet, do ta mbajë në mend më mirë se ai që e ka dëgjuar...!

- Po ju lë amanet diç, për çfarë nuk do ta devijoni rrugën e drejtë, përderisa t'i përmbaheni: librin e All-llahut (Kur'anin) dhe sunnetin tim...!"

Jeta ekonomike

Jeta ekonomike në fenë islame po ashtu bazohet në disa themele të shëndosha dhe në disa udhëzime hyjnore. Puna e ndershme për jetesë nuk është vetëm obligim, por edhe një virtyt i lartë. Varshmëria e çdo njeriu të aftë, por që nuk përpiket, nga ndonjë njeri tjetër për jetesë është mëkat fetar, një ndalesë sociale dhe një poshtërim i turpshëm.

Zoti i jep njeriut mjaft që ta mbajë vetveten, e që të mos varet nga dikush tjetër. Feja islame i respekton të gjitha llojet e punës për jetesë deri në atë shkallë derisa nuk paraqiten parregullsi e gabime. Muslimani, me vetëdije të pastër dhe me nderim të duhur ndaj shoqërisë së tij, mund t'i përveshë mëngët dhe të fillojë çfarëdo lloj pune nga e cila mund ta furnizojë vetveten dhe të varurit e tij. Rrëfëhet se pejgamberi Muhammed a.s., ka thënë se për një njeri është shumë më mirë të marrë litarin, të prejë dru, t'i sharrojë dhe t'i shesë, për të fituar për ushqim dhe dhënien e sadakasë, se sa t'i lusë të tjerët duke pritur se a do t'i japin diçka apo jo. Sipas fesë islame, statusi i njerëzve-punëtorë të ndershëm nuk mund të ulet sipas llojit të punës që ata e bëjnë për të jetuar. Megjithatë, punëtorët nuk kanë kurrfarë kufi-

zimesh të caktuara për t'i rritur të ardhurat dhe standardet e tyre sa më lartë. Ata kanë kushte të barabarta në disponim dhe kënaqin një liri të prodhimit.

Çkado që të bëjë apo të fitojë individi me anë të mjeteve të tij të ligjshme, është pronë e tij private, të cilën as shteti e as kushdo tjetër nuk mund t'ia marrë. Si rikthim ndaj kësaj të drejte për pronë private, ai duhet të plotësojë disa obligime ndaj shoqërisë dhe t'i paguajë disa tatime shtetit. Kur të kryhet kjo, ai fiton të drejtë të plotë të mbrojtjes nga ana e shtetit dhe liria e tij për të prodhuar është e siguar dhe e garantuar. Nën sigurimin islam, kërcënimi i kapitalizmit të pangopur dhe i komunizmit destruktiv asnjëherë nuk manifestohet. Individi që punon e prodhon, përpiqet për prosperitetin e shtetit dhe nga ana tjetër, shteti përpiqet për sigurimin e individit. Konfliktet klasore zëvendësohen me bashkëpunim dhe harmoni, e ilaçi për frikën dhe dyshimin është sigurimi dhe besimi i dyanshëm.

Sistemi ekonomik i fesë islame nuk jepet në dritën e kalkulimeve aritmetike dhe vetëm në llogaritë kapaciteteve të prodhimit. Kjo, në realitet, bëhet në dritën e një sistemi parimor të kuptueshëm të moralit. Personi që punon për një person tjetër, për një firmë ose për ndonjë institut, është i urdhëruar nga Zoti që ta bëjë punën e tij me nder dhe efikasitet të madh. Pejgamberi ka thënë se nëse dikush prej jush zotohet të kryejë ndonjë punë, Zoti do të dojë ta shohë punën e bërë me rregull e efikasitet. Posa të kryhet puna, punëtori do të fitojë rrogë të mirë për shërbimet e tij. Nëse punëdhënësi nuk ia paguan rrogën punëtorit si duhet apo përpiqet t'i japë më

pak dhe tallet me të, atëherë, sipas Ligjit të Zotit, ky është një akt që duhet të dënohet.

Bashkëpunimet tregtare zënë vend të posaçëm në sistemin ekonomik të fesë islame. Tregtinë e ndershme e lejon dhe e bekon Zoti. Këtë mund ta bëjnë individë, kompani, agjenci, etj., por të gjitha punët dhe marrëdhëniet afariste duhet të përfundohen me sinqeritet dhe nder. Mashtrimi, fshehja e cilësisë së dobët të mallit shitës nga aksionarët, eksploatimi i nevojave të blerësve, monopoli i mallrave me detyrimin e çmimeve të një personi, janë akte mëkatore që i nënshtrohen dënimit të ligjit islam. Nëse dikush dëshiron të bëjë jetë të qetë e të rregullt, këtë duhet ta bëjë nëpërmjet rrugëve të ndershme dhe me përpjekje të sinqerta. Përndryshe, nuk është vetëm kjo, por çdokush që ka paragjykime jolegjitime do të jetë, sipas Pejgamberit, i djegur në zjarrin e xhehennemit në Ditën e Gjykimit. Me qëllim që të luftojë kundër gënjeshtërisë dhe eksploatimit, feja islame kërkon nder në punë, ua tërheq vëmendjen gënjeshtarëve, e inkurajon punën e ndershme dhe e ndalon përdorimin apo marrjen e kamatës si rikthim për dhënien e të hollave nevojtarëve. Kjo na tregon se njeriu në mënyrë të drejtë e posedon vetëm atë për të cilën punon dhe se eksploatimi i nevojave të njerëzve të tjerë është afetar, jonjerëzor dhe amoral. Në Kur'an, Zoti xh.sh., thotë:

“Ata që e hanë kamatën, ata nuk ngrihen ndryshe vetëm se si ngrihet ai i çmenduri nga të prekurit e djallit. Këtë, ngase ata thanë: ‘Edhe shitblerja nuk është tjetër, por njësoj sikurse edhe kamata!’ e All-llahu e ka lejuar shitblerjen, por e ka

ndaluar kamatën. Atij që i ka arritur këshillë (udhëzim) prej Zotit të tij dhe është ndalë (prej kamatës), atij i ka takuar e kaluara dhe çështja e saj mbetet te All-llahu, e kush e përsërit (pas ndalimit), ata janë banues të zjarrit, ku do të mbeten përgjithmonë. All-llahu e zhduk kamatën dhe e shton lëmoshën, All-llahu nuk e do asnjë besëpreme e mëkatar.” (Kur’ani, 2:275-276).

“Ai e ngriti edhe qiellin dhe Ai vuri drejtësinë. Që të mos kaloni kufirin në drejtësi. Edhe ju mbani me drejtësi peshojën, e mos lini mangu në peshojë!” (Kur’ani, 55:7-9).

Kjo bëhet me qëllim që njeriu të kthehet në drejtësi dhe thjeshtësi në të gjitha bashkëpunimet dhe veprimet e tij. E ardhmja e gënjeshtarëve është e errët, ndaj fati i tyre është i zi. Ja se si e sqaron Kur’ani këtë problem:

“Të mjerët ata që mangu masin e peshojnë. Ata që kur masin prej njerëzve, për vete e plotësojnë. E kur u masin të tjerëve ose u peshojnë, u lënë mangu. A nuk e dinë të tillët se kanë për t’u ringjallur? Në një ditë të madhe. Në ditën kur njerëzit ngrihen (prej varrezave) për të dalë para Zotit të botëve.” (Kur’ani, 83:1-6).

Përveç kësaj, ekzistojnë shumë hadithe të peygamberit Muhammed a.s., të cilat të gjithë mashtruesit, eksploatuesit, monopolizuesit dhe njerëzit e pandershëm afaristë, i përjashtojnë nga grupi i të gjithë muslimanëve të vërtetë. Çdo punë afariste që ka të bëjë me padrejtësinë, me mashtrimin apo me eksploatimin e fuqisë dhe djersës punëtore është rreptësisht e ndaluar dhe e fshirë nga ligji, madje edhe pas

kryerjes së saj. Qëllimi kryesor i legjislaturës ekonomike dhe komerciale islame është që të sigurohen të drejtat e individit dhe të mbështetet solidariteti i shoqërisë, të njihet bota afariste me moralin e lartë dhe të inkuadrohet Ligji i Zotit edhe në sferën e prodhimit. Është shumë logjike dhe e kuptueshme se feja islame duhet të merret me aspekte të këtilla, për arsye se kjo nuk është thjeshtë vetëm një formulë shpirtërore, por një sistem komplet i jetës në të gjitha sferat e saj.

Pronarët dhe pasanikët vazhdimisht përkujtohen se ata në realitet janë thjesht vetëm ndërmjetës të përcaktuar nga Zoti, që t'i mbajnë e t'i kontrollojnë pasuritë e tyre. Nuk ekziston asgjë në fenë islame që mund ta ndalojë muslimanin nga mbajtja e pasurisë dhe nga përpjekjet për përmirësime materiale nëpërmjet mjeteve ligjore dhe kanaleve të drejta e të sinqerta. Pronari i gjithmbarshëm dhe real i të gjitha sendeve është vetëm Zoti, për të Cilin çdo pronar është vetëm një ndërmjetës, një i besuar i thjeshtë. Ky nuk është vetëm një fakt jetësor, por po ashtu ka edhe një rëndësi tejet të madhe për sjelljen njerëzore. Kjo e bën pronarin gjithmonë të gatshëm që të harxhojë në rrugë të Zotit dhe të kontribuojë për shkaqe të vlefshme. Kjo e bën atë që të përgjigjet ndaj nevojave të shoqërisë së tij, duke i dhënë atij një rol të rëndësishëm, e detyron atë që të kryejë në këtë mënyrë një mision të shenjtë. Kjo e mbron atë nga egoizmi, nga marrëzia dhe nga padrejtësia. Në fenë islame ky është koncepti i vërtetë i pronësisë dhe ky është statusi i vërtetë i pronarëve. Kur'ani e konsideron posedimin e pasurisë si një test provues, e jo si

një shkëlqesi virtytesh, bujari të privilegjuar apo si mjet eksploatimi. Zoti thotë: *“Ai është që ju bëri sundues (zëvendës) në tokë (pas shkatërrimit të atyre që ishin më parë) dhe i lartësoi në një shkallë më të lartë disa nga ju mbi të tjerët, për t’ju sprovuar në atë që ua dha. All-llahu është ndëshkues i shpejtë, është që falë e mëshirues.”* (Kur’ani, 6:165).

Përveç kësaj, Kur’ani i rrëfeu njerëzimit bisedën interesante ndërmjet Musaut dhe popullit të vet. Kjo bisedë zhvillohet në këtë mënyrë:

“Popullit të vet Musai i tha: ‘Kërkoni ndihmë prej All-llahut dhe kini durim. S’ka dyshim se toka është e All-llahut, ia lë në trashëgim atij që do nga robtë e Tij, e ardhmja e lumtur është për të devotshmit’. Ata (populli i Musait) thanë: ‘Ne ishim të shtypur para se të na vije ti, e edhe pasi na erdhe’. Ai (Musai) tha: ‘Është shpresë se All-llahu do ta shkatërrojë armikun tuaj (Faraonin), e juve do t’ju bëjë ta zëvendësoni në këtë vend, e do t’ju shikojë se si ju veproni’.” (Kur’ani, 7:128-129).

Kjo bisedë ndërmjet Musaut dhe popullit të tij nuk e nënkupton në asnjë mënyrë njohjen e ndonjë gjeniu të privilegjuar të njerëzimit në llogari të origjinës racore apo të identitetit etnik. Kjo as nuk do të thotë se Kur’ani në mënyrë të plotë i arsyeton sjelljet dhe konceptet e ithtarëve të Musaut në shekujt e mëvonshëm. Natyra e tekstit është mjaft qortuese dhe kritike për dyshimtarët - ajo e siguron të vërtetën se çdo gjë në tokë i takon Zotit, i Cili e shpërndanë atë ndërmjet shërbëtorëve të Tij, në formë të amaneteve të trashëguara dhe objekteve të sprovës. Këtë pikë Kur’ani e analizon thellësisht. Për shembull, ai

thotë: *“Vetëm i Tij është sundimi i qiejve dhe i tokës dhe vetëm tek All-llahu kthehen të gjitha çështjet... Besoni All-llahut dhe Të Dërguarit të Tij dhe jepni nga ajo që Ai u bëri trashëgues në të, se ata që besuan prej jush dhanë për hir të Zotit, ata kanë shpërblim të madh... E, ç’keni ju që nuk jepni për në rrugën e All-llahut, kur dihet se All-llahut i mbesin trashëgim qiejt e toka?...”* (Kur’ani, 57:5,7,10).

Ndryshe nga komunizmi, feja islame e zëvendëson superioritetin totalitar artificial të shtetit komunist me superioritetin privilegjuar të Zotit, dhe teorinë komuniste të mirëqenies klasore me moral të shëndoshë, përgjegjësi dhe bashkëpunim të përbashkët. Në anën tjetër, ajo jep garanci të fortë kundër kapitalizmit dhe eksploatimit të pamëshirshëm nga ana e pronarëve. Sistemi ekonomik i fesë islame garanton një njohje të plotë të entitetit të “pavarur” të individit dhe të aspiratave të tij natyrore për punë dhe posedime. Përsëri, kjo në Gjithësi njeriun nuk e bën krejtësisht të pavarur nga Zoti. Kjo nuk e privon njeriun nga kapitali i tij, e as nuk i privon punëtorët nga prodhimi i lirë. Ajo e pranon njeriun ashtu siç është krijuar dhe punon me të paralelisht, duke bërë lirime edhe për aspiratat e tij instinktive edhe për fuqinë e tij të kufizuar. Njeriu është njeri dhe ai duhet të pranohet si i tillë. Ai nuk është zot apo gjysmë-zot që t’i përshkruajë vetes fuqi absolute dhe pagabueshmëri të padyshimtë. Por, ai as nuk është një entitet i parëndësishëm. Ai duhet të njihet vetëm në statusin e tij të vërtetë dhe natyra e tij nuk duhet të ekzagjerohet apo të zvogëlohet. Ai nuk është as mbi e as jashtë Gjithësisë, por është një pjesë e siste-

mit të tërë; dhe ai është një element në krijimin e tërësishëm të Gjithësisë.

Edhe pse njeriu duhet të punojë, është i lirë të prodhojë, të fitojë e të posedojë, fakti se ai është vetëm një i besuar, siguron përdorimin e drejtë të posedimeve të tij, d.m.th., të asaj që i është besuar. Ai ka autoritet të fitojë, të investojë dhe të harxhojë. Megjithatë, gjatë kryerjes së këtyre veprimeve ai udhëhiqet nga parimet e larta, të cilat e shpëtojnë të mos dështojë. Një shembull mund të jetë i mjaftueshëm për ta ilustruar këtë pikë. Punëtorët nuk janë përfundimisht të lirë për t'i harxhuar të hollat e tyre apo të bëjnë ç'të duan me pronat e tyre. Ekzistojnë disa rregulla të harxhimit që duhet ndjekur. Me fjalët e Kur'anit, Zoti e urdhëron pronarin t'i plotësojë obligimet financiare ndaj njerëzve - punëtorëve të tij, duke mos e tepruar me harxhimet e tij private. Kur'ani çdoherë ia përkujton faktin se Zoti është furnizuesi i vërtetë dhe poseduesi aktual. Ja se si shprehet për këtë Kur'ani:

“Dhe jepi çdo të afërmi të drejtën që i takon, edhe të varfërit, edhe atij në kurbet, po mos shpenzo tepër e pa rrugë. Ata që shpenzojnë tepër (mastraf-xhinjtë) janë vëllezër (në veprim) të djajve, e djalli është përbuzës i madh i Zotit të Tij. Nëse detyrohesh t'ua kthesh shpinën atyre (të afërmeve, etj.), duke kërkuar mëshirën të cilën e shpreson nga Zoti yt (furnizim për t'i ndihmuar ata), atëherë thuaju atyre fjalë të mira (të lehta). Dhe mos e bën dorën tënde të lidhur për qafe (mos u bë koprrac), e as mos e shtrij në tërësi, e të mbetesh i qortuar dhe duarthatë (nga shpenzimi i tepërt). S'ka dyshim se Zoti yt është Ai

që furnizon me bollëk atë që do, dhe ia kufizon atij që do. Ai hollësisht e di për robtë e Vet dhe i vështron.” (Kur’ani, 17:26-30).

Jeta politike

Si jeta sociale dhe ajo ekonomike, ashtu edhe jeta politike në fenë islame, bazohet në themele të shëndosha shpirtërore dhe morale. E gjithë kjo udhëhiqet nga udhëzimet hyjnore. Sistemi politik i fesë islame në strukturën, funksionin dhe qëllimin e tij është unik. Ai nuk është as pragmatik e as instrumentalist. Ai nuk është një teokraci ku një klasë njerëzish pretendon të drejta hyjnore, trashëguese apo ndryshe; dhe posedon, mbi të gjithë qytetarët tjerë, përtej përgjegjësisë. Ky sistem as që nuk është një proletariat, ku disa punëtorë të uritur për hakmarrje do të mund ta merrnin fuqinë në duart e tyre. Madje, ai nuk paraqet as demokraci në kuptimin e saj të popullarizuar, ajo është diçka që ndryshon rrënjësisht nga këto që i përmendëm. Me qëllim që ta njohim e ta çmojmë pikëpamjen politike të fesë islame, duhet ta dimë se ajo bazohet në parimet që vijojnë:

1. Çdo vepër e muslimanit-individ apo e grupit të individëve, duhet të jetë e inspiruar dhe e udhëhequr nga Ligji i Zotit dhe nga Kur’ani, i cili e paraqet kushtetutën që e ka zgjedhur Zoti për robtë e Tij të vërtetë: *“E kush nuk gjykon sipas asaj që All-llahu e zbriti, të tillët janë mëkatarë të dalë jashtë rrugës së Zotit.”* (Kur’ani, 5:47) *“Është e vërtetë se ky Kur’an udhëzon për atë rrugë që është më se e vërteta.”* (Kur’ani, 17:9).

2. Udhëheqja sovrane në shtetin islam nuk i takon udhëheqësit, e as vetë njerëzve. Ajo i takon All-llahut xh.sh., dhe që të gjithë njerëzit e ushtrojnë atë me besimin ndaj Tij, me qëllim që Ligji i Tij të jetë shprehje e vullnetit të Tij. Udhëheqësi apo sov-rani është vetëm një figurë ekzekutuese e zgjedhur nga njerëzit që t'u shërbejnë atyre në pajtim me Ligjin e Zotit. Ky është themeli i shtetit islam, i cili përpu-thet me pikëpamjen e përgjithshme të fesë islame për Gjithësinë, Krijues i së cilës është Zoti dhe në të cilën Ai është sovrani i vetëm. Në Kur'an gjejmë ajete siç janë këto:

"I madhëruar është Ai, që në dorën e fuqisë së Tij është i tërë sundimi dhe Ai ka fuqi mbi çdo send." (Kur'ani, 67:1); ose *"All-llahu ju urdhëron që t'u jepni amanetin të zotëve të tyre dhe kur të gjykoni, ju urdhëron të gjykoni me të drejtë midis njerëzve. Sa e mirë është kjo që ju këshillon. All-llahu dëgjon dhe sheh si veproni."* (Kur'ani, 4:58).

3. Qëllimi i shtetit islam është të vendosë drejtësi dhe t'i furnizojë të gjithë qytetarët me siguri dhe mbrojtje, pavarësisht nga ngjyra, raca apo besimi, e në pajtim me kushtet e Zotit në kushtetutën e Tij, në Kur'anin. Pyetja e minoriteteve religjioze apo racore nuk vihet në rend të ditës përderisa ata i nën-shtrohen ligjit dhe janë qytetarë paqedashës. Kur'ani thotë:

"O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të All-llahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shman-geni drejtësisë; bëhuni të drejtë, sepse ajo është më

afër devotshmërisë. Kini dro All-llahun se All-llahu di hollësisht për atë që veproni.” (Kur’ani, 5:8; dhe krahaso me 4:135).

“All-llahu largon dëmet e idhujtarëve ndaj atyre që besuan... Ata të cilët kur Ne u mundësojmë vendosjen në tokë, e falin namazin, japin zeqatin, urdhërojnë për të mirë dhe largojnë prej të keqes. All-llahut i takon përfundimi i çështjeve.” (Kur’ani, 22:38,41).

4. Shtetin islam, i formuar për qëllimet e sipërpërmendura dhe për fuqizimin e Ligjit të Zotit, nuk mund ta kontrollojë asnjë parti politike e platformës joislame, apo nuk mund t’u nënshtrohet fuqive të huaja. Ky shtet, që ta ushtrojë autoritetin e duhur në emër të Zotit dhe në emër të kauzës së Tij, duhet të jetë i pavarur. Kjo rrjedh nga parimi se musliman është ai që i nënshtrohet vetëm Zotit dhe i shpreh lojalitet Ligjit të Tij, duke u ofruar bashkëpunim dhe përkrahje atyre që e ushtrojnë këtë ligj dhe i zbatojnë dispozitat e tij. Sipas fesë islame, për një popull musliman është e pakuptimtë të kërkojë përkrahje nga ndonjë parti politike me platformë joislame, apo t’i dorëzohet ndonjë qeverie joislame me origjinë dhe qëllime të huaja; për shkak se: *“All-llahu kurrësi nuk u mundëson jobesimtarëve mbizotërim të plotë mbi besimtarët.”* (Kur’ani, 4:141). *“Kur thirren besimtarët për gjykim ndërmjet tyre te All-llahu dhe te I Dërguari i Tij, e vetmja fjalë e tyre është të thonë: ‘Dëgjuam dhe respektoam!’ ...Atyre nga mesi i juaj, të cilët besuan dhe bënë vepra të mira, All-llahu u premtoi se do t’i bëjë zotërues në atë tokë ashtu si i pat bërë zotërues ata*

që ishin para tyre dhe fenë të cilën Ai e pëlqeu për ta, do ta forcojë, e në vend të frikës Ai do t'ju dhurojë siguri. Ata më adhurojnë Mua e nuk më shoqërojnë asgjë.” (Kur’ani, 24: 51,55). “All-llahu ka përcaktuar (shkruar në Levhi Mahfudh): ‘Unë dhe Të dërguarit e Mi, patjetër do të ngadhënjëjmë!’ All-llahu është i fortë, ngadhënjyes. Nuk gjen popull që e beson All-llahun dhe Ditën e Gjykimit, e ta dojë atë që kundërshton All-llahun dhe Të Dërguarin e Tij, edhe sikur të jenë ata (kundërshtarët) prindërit e tyre, ose fëmijët e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre. Ata janë që në zemrat e tyre (Ai) ka skalitur besimin dhe e ka forcuar me shpirt nga ana e Tij dhe ata do t’i shpjerrë në xhennete, nëpër të cilët rrjedhin lumenj...” (Kur’ani, 58:21-22).

5. Cilido sundues nuk është sundues sovran mbi të gjithë njerëzit. Ai është një nëpunës reprezentativ i zgjedhur nga populli, kurse autoriteti i tij vjen nga bindja ndaj Ligjit të Zotit - Ligj ky i cili i lidhë sunduesit dhe të sunduarit me një kontratë, e cila thotë se Zoti është mbikëqyrësi i të gjithëve. Marrëveshja politike e fesë islame nuk lidhet vetëm ndërmjet administrimit dhe popullit. Kjo lidhet me kombinimin e këtyre në një anë dhe Zotit në anën tjetër - e kjo moralisht është e vlefshme derisa ana njerëzore i plotëson obligimet e saj ndaj asaj hyjnore. Sunduesit, të cilët populli i ka zgjedhur që të udhëheqin sipas fjalëve të Zotit, janë të autorizuar për përkrahje dhe bashkëpunim nga populli, përderisa janë të udhëhequr nga fjalët e Zotit. Nëse masa popullore apo cilido anëtar i shoqërisë nuk ua jep përkrahjen dhe nuk bashkëpunon me administruesit e tillë të

shtetit, atëherë veprimi i tillë konsiderohet si një ofendim pa përgjegjësi ndaj administruesve si dhe një veprim kundër vetë Zotit. Analogjikisht, nëse administruesit apo udhëheqësit e shtetit shtrembërojnë nga rruga e Zotit, ose nuk veprojnë sipas Ligjit të Tij, atëherë kjo jo vetëm që është ofendim e faj, por nuk mund të ketë të drejtë për përkrahje dhe lojalitet nga populli. Kur'ani thotë:

“O ju që besuat, bindjuni All-llahut, respektoni Të Dërguarin dhe përgjegjësit nga ju. Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashtrone atë te All-llahu (te libri i Tij) dhe te I Dërguari, po qe se i besoni All-llahut dhe Ditës së Fundit. Kjo është më e dobishmja dhe përfundimi më i mirë.” (Kur'ani, 4:59).

Bindja ndaj atyre që kanë autoritet, kushtëzohet nga bindja e vetë atyre ndaj Ligjit të All-llahut xh.sh. dhe haditheve të Të Dërguarit të Tij. Në njërin nga thëniet e tij përfundimtare, Muhammedi a.s., ka thënë se nuk mund të ketë bindje apo lojalitet ndaj ndonjë qenieje njerëzore, sunduesit apo dikujt tjetër, nëse ata vetë nuk e dëgjojnë Zotin dhe nëse nuk i përmbahen Ligjit të Tij. Pasardhësit e hershëm të Muhammedit a.s., e kuptuan këtë parim në mënyrë shumë të qartë dhe i deklaruan thëniet e tyre të para politike, në të cilat thuhej se ata duhej t'i ndihmonin popullit përderisa ai i nënshtrohet Zotit, dhe se edhe populli nuk do t'i dëgjonte ata nëse nuk i nënshtroheshin Zotit.

6. Sunduesit dhe udhëheqësit duhet të zgjedhen nga qytetarët më të dalluar në bazë të meritave të tyre të virtytit, të përputhshmërisë dhe kompetencës.

Origjina racore apo prestigji familjar dhe statusi financiar nuk i bëjnë kandidatët as më tepër e as më pak të kualifikuar për postet e larta publike. Ato as nuk i fshehin e as nuk i reklamojnë meritat e individit. Çdo kandidat duhet të vlerësohet sipas meritave të tij personale, prej të cilave prestigji familjar, pasuria, raca dhe mosha, etj., nuk kanë ndonjë rol të rëndësishëm. Kandidatët duhet të zgjedhen me anë të deklaramit publik, me anë të zgjedhjeve të përgjithshme, apo ata mund t'i zgjedhin dhe t'i autorizojnë udhëheqësit publikë, të cilëve, në të vërtetë, u është besuar udhëheqja me anë të pajtimit të shoqërisë në fusha të ndryshme. Sipas kësaj, një shtet islam mund të ketë këshilla përfaqësues apo qeveri komunale sado që të dëshirojë. E drejta e zgjedhjes apo seleksionimit dhe sjellja në udhëheqjen e pushtetit me anë të Ligjit të Zotit, duhet të kenë për qëllim interesin më të mirë të shoqërisë në përgjithësi. Pejgamberi Muhammed ka thënë: "Kushdo që një njeriu ia beson një post publik, ndërsa në shoqërinë e tij ekziston ndonjë njeri më i mirë se ai i besuari, e ka tradhtuar besimin (amanetin) e Zotit, të Pejgamberit të Tij dhe të muslimanëve." Në kuptimin politik, kjo do të thotë se zgjedhësit nuk mund të jenë indiferentë, duke folur nga pikëpamja morale, për ngjarjet publike dhe se ata duhet të jenë të kujdesshëm dhe t'i hulumtojnë kushtet e zgjedhjeve. Vetëm në këtë mënyrë shteti mund të ketë sigurinë dhe shtetësinë përgjegjëse, e kjo është diçka që u mungon shumë shteteve demokratike moderne.

7. Pasi që ta bëjnë njerëzit zgjedhjen e tyre nëpërmjet seleksionimit të sunduesit të tyre, çdo qy-

tetar ka të drejtë ta kontrollojë, me mjetet e tij, sjelljen e administrimit dhe udhëheqjes së shtetit dhe të pyesë se si shkon procesi i punëve publike, kurdoherë që të shohë se diçka nuk është në rregull. Nëse ky administrim dhe udhëheqje e shtetit e tradhton besimin (amanetin) e Zotit dhe të opinionit publik, atëherë ata nuk kanë të drejtë të gjenden në zyrat shtetërore. Ky administrim duhet të zëvendësohet me një tjetër dhe është përgjegjësi e çdo qytetari të shikojë se a bëhet e gjithë kjo në interes të popullit. Sipas kësaj, pyetja e pushtetit trashëgues apo e qeverisë jetëgjatë është e pazbatueshme për një shtet islam.

8. Edhe pse sunduesin e zgjedh populli, përgjegjësia e tij e parë është ndaj Zotit, e pastaj edhe ndaj popullit. Posti i tij nuk është vetëm simbolik dhe roli i tij nuk është abstrakt. Ai nuk është një kukull e pandihmë, funksioni i së cilës është të nënshkruajë dokumente dhe ta zbatojë vullnetin publik, pavarësisht nga ajo se a është kjo në rregull apo jo. Ai duhet t'i ushtrojë fuqitë e tij aktuale në emër të popullit, për interesin e tyre më të mirë në pajtim me Ligjin e Zotit, për arsye se ai ka një përgjegjësi të dyfishtë. Në njërin anë ai duhet t'i japë llogari Zotit për sjelljen e tij, dhe, në anën tjetër, ai u përgjigjet njerëzve që i kanë shprehur besim. Ai duhet të japë llogari të plotë para Zotit se si e trajton popullin e vet dhe përfaqësuesit e tij. Por, edhe bashkëpunëtorët edhe njerëzit e tij po ashtu duhet të japin llogari të plotë se si ata së bashku e kanë trajtuar Kur'anin dhe Ligjin e Zotit, të cilit Ai i ka dhënë një fuqi detyruese. Sunduesi ka një përgjegjësi të madhe ndaj popullit të tij, në kuptim të asaj se ai duhet të udhë-

heqë sa më mirë me punët e tyre për interesin e tyre të përbashkët, dhe veprimi i tij sipas Ligjit të Zotit rrjedh nga varshmëria e tij e drejtpërdrejtë nga Zoti. Sipas kësaj, sistemi politik i fesë islame ndryshon nga sistemet dhe doktrinat e tjera që i njeh njerëzimi; dhe sunduesi nuk duhet të udhëheqë me njerëzit e tij vetëm sipas dëshirave të tyre personale. Ai duhet t'u shërbejë atyre duke e bërë drejtësinë një ligj të përgjithshëm, duke e bërë dëgjueshmërinë e tyre të paluhatshme ndaj Zotit sovran të Gjithësisë një funksion të rregullt të shtetit dhe duke e bërë moralin e shëndoshë një udhëheqje bujare të administrimit të shtetit.

9. Edhe pse Kur'ani është Kushtetuta e shtetit islam, Zoti i ka urdhëruar muslimanët që t'i kryejnë punët e tyre të zakonshme me anë të metodave konsultative. Kjo lë vend edhe për këshillat legislative edhe për organet konsultative, si në nivelin lokal ashtu edhe në nivelin kombëtar e ndërkombëtar. Çdo qytetar i shtetit islam duhet ta ofrojë këshillën e tij më të mirë për problemet e zakonshme. Me qëllim që të sigurohet ky obligim në një mënyrë praktike e aplikative, sunduesit duhet të kërkojnë këshillime nga njerëzit e mësuar e që kanë përvojë në shtet. Por, kjo në asnjë mënyrë nuk e hedh poshtë të drejtën e qytetarëve të zakonshëm, të cilët duhet të flasin kurdo që t'u jepet rasti.

Në këtë mënyrë, çdo qytetar i shtetit islam ka një obligim, sa i përket sjelljes së tij në udhëheqjen e çështjeve publike, në njërin apo tjetrin kapacitet, dhe atë duhet ta plotësojë në mënyrë të përkujdesshme, qoftë drejtpërdrejt apo tërthorazi. Në historinë isla-

me ekzistojnë dokumente autentike në të cilat mund të shihet se si njerëzit e zakonshëm (burrat dhe gratë) i merrnin në pyetje, i këshillonin dhe i konsultonin udhëheqësit kryesorë dhe halifët. Parimi i konsultimit të dyanshëm është aq i rëndësishëm në fenë islame, sa që njeriu detyrohet të flasë në mënyrë më të sinqertë e më efektive për interesin më të mirë të shoqërisë. Metodatat konsultative në politikë apo në ndonjë fushë tjetër për atë problem, nuk janë vetëm një formulë demokratike e pushtetit, por edhe një urdhëresë religjioze e një detyrë morale, që duhet të kryhet në relacion me udhëheqësit, si dhe në relacion me të udhëhequrit. Përveç zbatimit të vazhdueshëm të këtij parimi, Pejgamberi ka thënë se dhënia e këshillës së mirë është një ndër rolet themelore të fesë. Qëllimi i një këshille të tillë është të sqarohet se Ligji i Zotit është zbatuar, se janë respektuar të drejtat e qytetarëve dhe se obligimet e tyre janë të kryera. Me qëllim që të zvogëlohet ngritja e politikës profesionale dhe që të luftohen politikanët “nëntokësorë” të platformave oportuniste, duke folur për autoritetin e Zotit, Pejgamberi ka thënë se kushdo që të flasë - qoftë kjo në formë të këshillës apo në cilëndo formë tjetër - duhet të flasë për gjëra të mira e të drejta; përndryshe, më mirë është të mos flasë fare. Kjo bëhet që t’u tërhiqet vërejtja këshilltarëve kundër shmangieve vetjake apo kundër joshjeve (nxitjeve) egoiste. Me këtë duhet të garantohet se këshilla është dhënë me qëllime më të sinqerta dhe në interesin më të mirë të popullit; sepse për këtë ka dhënë autorizim Zoti, dhe për shkak se e gjithë kjo bëhet në emër të Tij, me qëllim të mirëqenies së përgjith-

shme. Kërkimi i këshillës nga ana e sunduesit, apo drejtimi dhe kërkimi i saj nga populli, nuk është një zgjidhje që bëhet vullnetarisht. Ky në të vërtetë është një artikull i besimit, një urdhëresë religjioze. Vetë Muhammedi a.s., edhe pse ishte i mençur, i pagabueshëm dhe jovetjak, nuk ishte mbi maksimumin e as nuk përjashtohej nga kjo rregull. Zoti e udhëzon atë në këtë mënyrë:

“Ti ishe i butë ndaj tyre, ngase All-llahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do të shkapërderdheshin prej teje, andaj ti falju atyre dhe kërko ndjesë për ta, e konsultohu me ta në të gjitha çështjet, e kur të vendosësh, atëherë mbështetu në All-llahun, se All-llahu i do ata që i mbështeten.” (Kur’ani, 3:159).

Duke i numëruar karakteristikat e besimtarëve, Kur’ani në mënyrë të qartë thekson këshillimin e dyanshëm si një shprehje e besimit. Besimtarë janë ata, të cilëve:

“Çka u është dhënë nga ndonjë send, ajo është kënaqësi në këtë botë, e ajo që është te All-llahu është shumë më e mirë dhe e përjetshme, por për ata që besuan dhe që vetëm Zotit të tyre i mbështeten. Dhe ata që u shmangen mëkateve të mëdha e të shëmtuara, dhe kur hidhërohen, ata falin. Edhe ata që i përgjigjen thirrjes së Zotit të tyre dhe e falin namazin rregullisht, dhe ata që konsultohen mes vete për punë të përbashkëta, e nga ajo që Ne ua japim ata e shpërndajnë. Edhe ata që kur i godet e padrejta, i kundërvihen.” (Kur’ani, 42: 36-39).

10. Në sistemin politik të fesë islame çdo qytetar duhet ta gëzojë lirinë e besimit dhe të vetë-

dijes dhe lirinë e mendimit e të shprehjes. Ai është i lirë t'i zhvillojë potencialet e tij dhe ta zgjerojë fitimin e tij, të punojë e të garojë, të fitojë e të posedojë, t'i përdëftojë e mohojë sendet, në pajtim me mendimin e tij të ndershëm. Megjithatë, liria e tij nuk është e as nuk mund të jetë absolute; sepse, përkundrazi, ajo mund të shkaktojë kaos dhe anarki. Atë e garanton Ligji i Zotit dhe është nën fuqinë e të njëjtit Ligj. Përderisa përputhet me këtë Ligj, gjithçka bëhet privilegj i drejtë i çdo qytetari individual; por, nëse i kalon kufijtë e Ligjit apo kur hyn në konflikt me interesin e përgjithshëm, atëherë kjo mund të kalojë në shkelje të Ligjit të Zotit; - dhe në atë rast duhet të kontrollohet. Individu është pjesë e tërë Gjithësisë, kështu që veprimet e tij duhet të përputhen me Ligjin dhe rendin e Zotit, Ligjin, me anë të të cilit udhëhiqet e tërë Gjithësia. Në anën tjetër, ai është anëtar i bashkësisë apo kombit të tij dhe duhet t'i harmonizojë të drejtat dhe interesat e tij me ato të të tjerëve, në mënyrë të favorizimit të dyanshëm. Nëse individ ka pikëpamje të pavarur për ndonjë problem të çështjeve publike, e në ndërkohë sheh se shumica mendon ndryshe, ai, që ta mbajë solidaritetin dhe bashkëpunimin, duhet së fundi të anojë kah pikëpamja e shumicës, me kusht që vendimi i shumicës të mos jetë i kundërt me Ligjin e Zotit. Megjithatë, në procesin e formimit të mendimit publik, ai është i autorizuar ta shprehë mendimin e tij personal dhe pa kurrfarë pengesash apo prishjeje të atmosferës, t'i bindë të tjerët për atë që mendon. Kur bëhet e qartë se shumica ka zgjedhur një drejtim tjetër, atëherë ai detyrohet t'i bashkangjitet mendimit të saj, për arsye

se problemi që është në shqyrtim më nuk i takon vetëm një individ apo vullneti tjetër, por ka edhe implikime të jetës publike në përgjithësi.

11. Udhëheqja e pushtetit në shtetin islam është një besim i tërësishëm shoqëror, në të cilin administruesit dhe udhëheqësit janë të përbetuar në fjalën e Zotit; dhe janë në pajtim me fjalën e popullit në përgjithësi. Kushdo që e përfaqëson Zotin në postin më të lartë, duhet të jetë besnik ndaj autoritetit të besuar dhe duhet të jetë besimtar i Zotit, i Cili është Sovrani Suprem i Shtetit. Dhe pasi shumica e njerëzve janë muslimanë, secili që synon postin e kryetarit apo të halifit, duhet të jetë musliman i vërtetë. Këto masa merren me qëllim që t'i shërbejnë interesit të përbashkët dhe me qëllim që t'i plotësojnë të gjitha obligimet e shtetit ndaj Zotit si edhe ndaj qytetarëve. Këto masa po ashtu ndërmerren që t'i sigurojnë e t'i respektojnë të drejtat e të ashtuquajturave pakica religjioze ose racore.

Për fat të keq, ky lloj sundimi i fesë islame, është keqkuptuar e keqtrajtuar. Ky lloj i sundimit nuk është diskriminues ndaj minoriteteve; por, përkundrazi, i mbron të drejtat e tyre. Kushdo që dëshiron të jetë qytetar i ligjshëm i shtetit islam, është i mirëseardhur në të dhe me përgjegjësi i ndanë me të tjerët detyrat dhe prerogativet e një shtetësie. Nëse ai nuk është musliman, statusi i tij nuk zvogëlohet apo ai nuk kalon në qytetar të rendit të dytë, përderisa i nënshtrohet ligjit të përgjithshëm të shtetit dhe me përgjegjësi i ushtron të drejtat e tij. Për shembull, nëse ai dëshiron, mund ta paguajë tatimin fetar (zeqatin) dhe taksat e tjera fetare, si qytetarët musli-

manë, për mbajtjen e shtetit dhe si shpërblim për sigurimin dhe mirëqenien e tij. Por, nëse ai mendon se pagimi i taksës islame është një poshtërim dhe ulje e dinjitetit, duke prekur ndjenjat e tij në dëm të së vërtetës vetëm pse ai nuk është musliman, ai mund t'i paguaj taksat në forma të tjera të njohura si "tagra" apo *Xhizje*. Me këtë ai fiton edhe një zgjidhje tjetër, që nuk e kanë as vetë muslimanët. Si shpërblim për kontributet e tij, nga ana e zyrtarëve të shtetit dhe të shoqërisë, atij i jepet një mbrojtje dhe siguri i plotë.

Analogjikisht, nëse një qytetar i tillë dëshiron ta udhëheqë jetën e tij personale të martesës, ndarjes, ushqimit, trashëgimisë, etj., sipas Ligjit islam, atëherë atij duhet t'i njihet e t'i pranohet kjo dëshirë dhe të respektohen të drejtat e tij. Por, nëse dëshiron t'i udhëheqë këto punë sipas mësimeve fetare të tij, ai është absolutisht i lirë për këtë dhe askush nuk guxon t'i uzurpojë të drejtat e tij që kanë të bëjnë me këtë. Sipas kësaj, sa u përket problemeve personale apo sentimentale, ai mund t'u kthehet mësimeve të tij religjioze personale apo t'i nderojë rregullat shoqërore. Megjithatë, sa u përket problemeve publike dhe çështjeve të përgjithshme, ai duhet t'i përkulet Ligjit të shtetit - Ligjit të Zotit. Çkado që të zgjedhë, atij i takojnë siguri dhe mbrojtja si çdo qytetari tjetër. E gjithë kjo nuk është vetëm një ëndërr e një mbretërie hyjnore, që ende nuk ka ardhur në fuqi. Ky është mësimi i Kur'anit, zbatimi i Muhammedit a.s., dhe kjo mbahet mend në historinë islame. Për shembull, thuhet se Umer ibn el Hattabi, halifi i dytë pas Muhammedit a.s., një herë ka kaluar

afër një vendi ku ka gjetur një hebre plak në një gjendje të mjerë. Umeri ka pyetur për njeriun, e pas kësaj ka kuptuar se në çfarë gjendje ka qenë ai. Në një mënyrë keqardhëse, ai njeriut i tha: “Ne mblo-dhëm tagra (taksa) nga ti kur ishe i aftë. Tani je i refuzuar e i lënë pas dore. Sa i padrejtë paska qenë Umeri me ty!” Pasi që ai e përfundoi këtë vërejtje, për njeriun e moshuar filloi të vijë një pension i rregullt sipas urdhrit, që hyri në fuqi menjëherë. Umeri dhe sunduesit e tjerë e pranuan orientimin e tyre politik nga duart e Muhammedit a.s., të cilin e kishte udhëzuar Zoti. Këto mësimë në Kur’an janë paraqitur në këtë mënyrë:

“All-llahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi - me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja; All-llahu i do ata që mbajnë drejtësinë. All-llahu ju ndalon t’u afroheni vetëm atyre që ju luftuan për shkak të fesë, që ju nxorën prej shtëpive tuaja dhe që ndihmuan dëbimin tuaj; ju ndalon të miqësoheni me ta. Kush miqësohet me ta, të tillët janë dëmtues të vetvetes.” (Kur’ani, 60:8-9).

Më në fund, të themi se është gabim kategorik të krahasohet shteti islam dhe nevoja e tij për kryetarin musliman, me shtetin shekullar, ku teoretikisht kryetari i shtetit mund t’u takojë edhe minoriteteve. Ky krahasim është i gabuar për disa arsye. Së pari, thotë se shekullarizmi, sadoqoftë sipërfaqësor, është më i shëndoshë se ideologjia islame. Një supozim apo përdëftim i tillë është tendencioz. Së dyti, siç përmendëm më parë, detyrat dhe të drejtat e kryetarit të shtetit islam janë krejtësisht të kundërta me ato të

shtetit shekullar. Së treti, fryma moderne shekullare në të shumtën e rasteve është një rikthim apologjetik, gjë që nuk përputhet me fenë islame. Përveç kësaj, kryetari i shtetit shekullar nëse eventualisht ekziston një kryetar i tillë i vërtetë, mund t'i takojë minoritetit racor, etnik apo religjioz. Por, pothuajse pa kurrfarë dyshimesh, ai duhet t'i bashkangjitet partisë më të madhe. Me këtë vazhdimisht majoriteti politik e zëvendëson majoritetin religjioz, e që shumë pak ka të bëjë me përmirësimin e statusit të minoriteteve. Përveç kësaj, i gjithë argumenti shekullar supozon që kryesia e shtetit është një e drejtë dhe privilegj, që mund t'i besohet apo t'i mohohet individit. Qëndrimi i fesë islame është krejtësisht ndryshe. Në fenë islame, udhëheqja shtetërore së pari dhe kryesisht është një obligim, një zotim i dhembshëm, një përgjegjësi e vështirë. Prandaj, do të ishte e palejueshme sikur feja islame t'ua impononte këtë detyrë jomuslimanëve.

Jeta ndërkombëtare

Jeta ndërkombëtare në fenë islame mund të shihet në marrëdhëniet ndërmjet shtetit apo popullit islam dhe shteteve apo popujve të tjerë. Si edhe aspektet tjera të jetës islame, edhe ky i ka rrënjët nga udhëheqja hyjnore dhe shkon sipas modelit që e ka dhënë Zoti. Kjo bazohet në këto pika themelore:

1. Në besimin e paluhatshëm, në unitetin e njerëzimit sa i përket origjinës, statusit të njeriut dhe qëllimit të tij. (Kur'ani, 4:1; 7:189; 49:13);

2. Në respektin e duhur ndaj interesave dhe të drejtave të njerëzve të tjerë për jetë, nder dhe pronë-

si, derisa nuk cenohen të drejtat e muslimanit. Kjo është kështu për arsye se uzurpimi, kundërvajtja, e keqja, etj., që të gjitha këto janë rreptësisht të ndaluara. (Kur'ani, 2:190-193; 42:42);

3. Në paqen si kahe normale e marrëdhënieve, bashkë me ndërrimin e misioneve të vullnetit të mirë dhe me përpjekjet e përbashkëta e të ndershme në interes të njerëzimit, ku të gjithë njerëzit ndajnë pjesë dhe sasi të barabarta. (Shih më lart Kur'anin, 8:61);

4. Në mostolerimin e fyerjes dhe cenimit të marrëdhënieve ndërkombëtare. Nëse dikush i shkel të drejtat e shtetit islam, apo nëse dikush e prish paqen e tij, e rrezikon sigurinë e tij apo e eksploaton politikën e tij paqedashëse, shteti duhet menjëherë ta mbrojë vetveten dhe t'i shkatërrojë të gjitha përpjekjet e asaj natyre. Vetëm këtu, në rrethana të këtilla, feja islame e arsyeton luftën. Megjithatë, madje edhe në kushte të këtilla ekzistojnë disa parime morale që duhet të respektohen me qëllim që ta kufizojnë qëllimin e luftës, ta shkurtojnë atë në kohë dhe që ta përdorin vetëm kur ajo është më se e nevojshme. Ligji i luftës dhe i paqes në fenë islame bazohet në parime të larta morale, që janë unike, të kuptueshme dhe të shëndosha. Kjo meriton një studim të veçantë të juristëve dhe të moralistëve, gjë që nuk mund ta përmbledhim edhe në këtë punim. Megjithatë, duhet të vërejmë se feja islame nuk e lejon as luftën agresive, e as nuk e bën shkatërrimin e të korrave (të lash-tave), të kafshëve, të shtëpive etj. Feja islame nuk lejon vrasjen e grave që nuk luftojnë, të fëmijëve dhe të njerëzve të moshuar; ajo nuk lejon as torturi-

min e të burgosurve luftarakë dhe nuk i imponon mësimet e veta ndaj atyre që kanë pësuar disfatë. Lufta e fesë islame është vetëm një masë mbrojtëse, derisa padrejtësia, e keqja dhe agresioni ekzistojnë në botë. (Kur'ani, 2:190-195, 216-218; 22:39-41);

5. Në bazë të plotësimit të obligimeve të ndërmarra nga shteti islam, dhe në bazë të nderimit të marrëdhënieve të lidhura ndërmjet shtetit islam dhe shteteve të tjera, realizohen të drejtat e dyanshme. Kjo vlen vetëm nëse partitë e tjera u mbeten besnike obligimeve të tyre dhe nëse i nderojnë marrëveshjet e tyre. Në rast të kundërt, marrëveshjet apo obligimet nuk do të jenë të vlefshme. (Kur'ani, 5:1; 8:55-56, 58; 9:3-4);

6. Në bazë të mbrojtjes së paqes së brendshme dhe sigurimit, dhe kontribuimit të përhershëm për mirëkuptimin njerëzor dhe vëllazërinë universale në një nivel ndërkombëtar.

Këto janë burimet inspiruese që e përbëjnë jetën ndërkombëtare në një shtet islam. Shteti islam nuk jeton vetëm për vete apo për subjektet e tij. Ai ka një qëllim më të madh dhe një detyrë të rëndësishme në fushën ndërkombëtare. Sipas urdhëresës nga parimet e fesë islame, ky shtet duhet të përpiqet për prosperitetin dhe përparimin e qytetarëve të tij në çdo aspekt jetësor; dhe sipas urdhëresës së njëjtë, ai duhet të japë kontribute të vlefshme për njerëzimin në përgjithësi. Në këtë mënyrë mund të kontribuohet për marrëdhëniet shoqërore në kuptimin më të gjerë të fjalës. Shteti islam, për interes të njerëzimit në nivel ndërkombëtar, duhet të luajë një rol të rëndësishëm në arsimimin, ekonominë, industrinë, politikën, etj.

Këtë rol e ka inicuar vetë Muhammedi a.s., ndërsa e kanë përkrahur pasardhësit e tij.

Para se ta përfundojmë këtë kapitull, duhet të theksojmë se e gjithë ajo që e përmendëm deri më tani bazohet në parimet e vërteta e të shëndosha të fesë islame, që drejtpërsëdrejti dalin nga Kur'ani dhe Sunneti i Muhammedit a.s. Kjo është feja islame të cilën Muhammedi a.s., dhe ithtarët e tij besnikë e praktikuan dhe e zbatuan në mënyrë të shkëlqyer. Kjo nuk është feja islame e ndonjë teologu apo juristi të posaçëm, apo e ndonjë sunduesi. Në të vërtetë, shkrimtari beson se kjo është feja e mirëfilltë islame, vërtet ashtu siç duhet të jetë.

Po ashtu duhet të mbajmë mend se sistemi jetësor islam është unik andaj edhe dallohet nga të gjitha sistemet e tjera ideologjike. Pavarësisht nga ajo se a e marrim këtë nga pikëpamja shpirtërore, morale, intelektuale, kulturore, politike apo ekonomike, mund të shohim se për këtë mënyrë të jetesës janë të dallueshme disa karakteristika të posaçme. Për ta ilustruar këtë, do të përmendim disa shembuj:

1. Burimi i ideologjisë islame ndryshon nga burimet tjera. Atë nuk e ka krijuar njeriu. Ai nuk është produkt i politikanëve subversivë apo i ekonomistëve hakmarrës. Ai nuk është as vepër e moralistëve pragmatikë apo e industrialistëve vetjakë. Në të vërtetë, ky burim është vepra e Zotit, arti i të pakufishmit i krijuar për interesin më të mirë të mbarë njerëzimit. E nga natyra e tij, respektohet dhe nderohet nga të gjithë besimtarët besnikë. Meqë është i lirë nga të gjitha misteret e pazgjithshme, nga rezer-

vat sekrete dhe nga prerogativet e dhunshme, ai është i kuptueshëm për çdo mendje të shëndoshë.

2. Qëllimet e ideologjisë islame po ashtu janë të ndryshme nga ato të ndonjë ideologjie tjetër. Qëllimi i kësaj ideologjie nuk është zotërimi me botën apo ekspansioni fizik. Në realitet, ajo anon kah nënshtrimi i botës vullnetit të Zotit dhe kufizimin e përqëndrimin e botës sipas Ligjit të Zotit. Qëllimi i saj kryesor është ta gëzojë Zotin e ta kultivojë njeriun në atë mënyrë që të mund t'i ndihmojë për dëgjueshmërinë e zbatimin e Ligjit të Krijuesit dhe të jetë një i dërguar besnik i Zotit. Ajo vepron në të gjitha aspektet jetësore për ta arritur këtë qëllim; ajo tenton të krijojë te njeriu një mendje të pastër, shpirt të dëlirë, vetëdije të gjallë, trup të shëndoshë dhe ndjenja përgjegjëse. Një person me cilësi të këtilla nuk mund të mos i nënshtrohet Zotit dhe ta jetojë mënyrën më të shëndoshë të jetesës. Sipas kësaj, qëllimet e ideologjisë islame janë shumë larg karakterit të tyre të thjeshtë njerëzor e kohor.

3. Ideologjia islame i ka të gjitha elementet dhe forcat që e bëjnë atë të kuptueshme, praktike, të urtë dhe fleksibile. Origjina e saj hyjnore i zbulon vetëm parimet themelore e të domosdoshme, duke ia lënë qëllimin themelor intelektit njerëzor, detajet dhe përmirësimet e nevojshme. Sido që ta marrim, mund të shohim se ideologjia islame përbëhet nga parimet e kuptueshme, praktike, që janë marrë nga burime të mirëfillta. Ato kuptohen lehtë për arsye se flasin për aspektet më themelore të jetesës; janë praktike për arsye se praktikohen dhe përkthehen në realitetet prej një kohe në një tjetër; mesatare e të urta, për

arsye se nuk janë në anën e individit kapitalist apo të proletariatit; ato nuk merren ekskluzivisht me gjërat botërore apo vetëm me ato shpirtërore; ato nuk janë të kufizuara as në këtë botë e as në jetën e ardhme. Ato e shënojnë gjysmën e rrugës ndërmjet të gjitha ekstremizmave të mundshëm dhe paraqesin udhëheqje të një jete mesatare e stabile. Përveç këtyre parimeve, ekziston një sasi e madhe e fleksibilitetit në gjetjen e detajeve në rajone dhe mosha të ndryshme. Ky fleksibilitet në të vërtetë është domosdoshmëri, për arsye se ideologjia është vepër e Zotit, dhe edhe në të, si edhe në të gjitha veprat e Tij, ekziston një qëllim e cak i lartë për mendjen dhe përpjekjet njerëzore.

Kapitulli V SHFYTYRIMET RRETH FESË ISLAME

- ❖ *1. Lufta e Shenjtë (Xhihadi)*
- ❖ *2. Isai, biri i Merjemes*
- ❖ *3. Poligamia*
- ❖ *4. Martesa dhe shkurorëzimi*
- ❖ *5. Pozita e gruas në fenë islame*

Hyrje

Ky kapitull do të trajtojë disa aspekte të fesë islame që i harruan disa muslimanë, kurse disa të tjerë madje edhe i shfytyruan. Këtu do të përpiqemi t'i prezentojmë këto aspekte në dritën e tyre të vërtetë dhe t'i pasqyrojmë në mënyrë sa më reale. Gjatë kësaj përpjekjeje, të themi se nuk do të jemi apologetikë pasi kjo nuk i nevojitet fesë islame. As nuk kemi për qëllim ta kënaqim, ta dënojmë apo ta largojmë dikë, për arsye se gjërat e tilla nuk i toleron feja islame por, ajo kërkon një mendim të drejtpërdrejtë e vepër të shëndoshë. Sipas kësaj, qëllimi ynë këtu është ta hulumtojmë të vërtetën për aspektet e këtilla, sërish t'ia prezentojmë ato mendjes joislame; dhe ta lëmë çdokë ta shohë të vërtetën, e pastaj vetë të vendosë, ashtu siç bëjnë krijesat me arsye të shëndoshë dhe përgjegjësi racionale.

Muslimanët që jetojnë në botën perëndimore dhe që janë të njoftuar me letërsinë perëndimore, shpeshherë konfrontohen me çështje të çuditshme dhe vërejtje marramendëse që i shkaktuan disa njerëz nga Perëndimi. Çështjet rreth "Luftës së Shenjtë" "Fesë islame antijezusiane", "poligamisë", "shkurorezimit", "statusit të gruas në fenë islame", etj., janë më të shpeshtat e më të përsëriturat. E gjithë ajo që do ta prezentojmë këtu është në shërbim të së vërtetës dhe të gjitha përpjekjet që të gjitha çështjet të analizohen në mënyrë të drejtë, bëhen për hir të njerëzve të ndershëm e të pafajshëm.

1. Lufta e Shenjtë (Xhihadi)

A thua vallë Islami u përhap me anë të shpatës? A ishte emblema muslimane “Kur’ani apo shpata?”. A ishin muslimanët imperialistë dhe të dhënë pas fuqisë botërore apo plaçkës? Disa njerëz japin përgjigje pozitive në këto pyetje, disa të tjerë negative, ndërsa disa të tretë s’mund të vendosin, janë konfuzë apo përtojnë të përgjigjen. Mirëpo, ku qëndron Kur’ani? Çka zbulon historia e Muhammedit a.s. lidhur me këtë? Sigurisht se ky është një imperativ për çdo person të ndershëm që e respekton të vërtetën dhe dinjitetin njerëzor, që ta zbulojë të vërtetën dhe atë t’ua rrëfejë të tjerëve.

Kur’ani, pavarësisht nga ajo se a duam ne apo jo, na bën të qartë se lufta është nevojë e ekzistencës, është një e vërtetë jetësore, përderisa në botë ekzistojnë padrejtësia, dhuna, ambiciet tendencioze dhe thëniet arbitrare. Kjo ndoshta tingëllon çuditshëm. Por, a nuk e mban mend historia se njerëzimi - qysh prej agimit të hershëm të historisë e deri më tani - ka vuajtur nga luftërat lokale, qytetare dhe të përgjithshme? Dhe, a nuk është po ashtu fakt i gjallë se më shpesh, vendet fitimtare hyjnë në konflikte për fitimet e tyre dhe për statusin e armiqve të tyre, që i kanë fituar nëpërmjet luftërave apo thirrjeve për luftë? Madje edhe sot e kësaj dite, në shumë vende të krizës në botë, njerëzimi jeton me një frikë të vazhdueshme nga lufta. A mund mos t’i vërejë këto fakte jetësore Zoti? Apo, a nuk mund të merret Kur’ani me këtë çështje në një mënyrë realiste dhe efektive? Sigurisht se jo! Ja pse feja islame e njeh

luftën si një mjet të ligjshëm dhe të arsyeshëm për vetëmbrojtjen, rikthimin e drejtësisë, lirisë dhe të paqes. Kur'ani thotë:

“Juve u është bërë obligim lufta, ndonëse ju e urreni atë. Por, mund që ju ta urreni një send, e ai është shumë i dobishëm për ju, dhe mund që ju ta doni një send, e ai është shumë i dëmshëm për ju. All-llahu e di (fundin e çdo sendi) e ju nuk e dini.” (Kur'ani, 2:216). *“Dhe sikur All-llahu të mos i mbronte njerëzit me disa prej disa të tjerëve, do të shkatërrohej toka, po All-llahu është bamirës i madh ndaj njerëzimit.”* (Kur'ani, 2:251); *“E sikur All-llahu të mos i zbrapste disa me disa të tjerë, do të rrënoheshin manastiret, kishat, havrat e edhe xhamitë që në to përmendet shumë emri i All-llahut.”* (Kur'ani, 22:40).

Feja islame edhe pse ka pikëpamje realiste, ajo asnjëherë nuk e toleron agresionin as nga ana e saj e as nga ndonjë anë tjetër; ajo nuk e përkrah fillimin e luftërave agresore. Zoti i ka urdhëruar muslimanët të mos hyjnë në armiqësi, të kundërshtojnë çdo akt të agresionit, duke ua ndaluar shkeljen e të drejtave të të tjerëve. Lidhur me atë që u tha deri më tani, siç bëmë edhe në kapitullin e kaluar, do të japim disa vargje të Kur'anit që kanë rëndësi të posaçme. Zoti thotë:

“Dhe luftoni në rrugën e All-llahut kundër atyre që ju sulmojnë e mos e teproni se All-llahu nuk i do ata që e teprojnë (e fillojnë luftën). Dhe luftoni ata kudo që t'i zini, dëboni prej vendit ata sikurse ju dëbuan ata juve. Provokimi (fitneja) është më i rëndë se vrasja. Mos i luftoni ata pranë Xhamisë së

Shenjtë (Qabes) deri që ata t'ju luftojnë juve aty, e nëse ju sulmojnë, atëherë sulmoni edhe ju ata. I këtillë është ndëshkimi ndaj pabesimtarëve. E nëse heqin dorë (nga provokimi), All-llahu është Ai që fal dhe që mëshiron. Luftoni ata (idhujtarët) derisa të zhduket propagandimi i idhujtarëve dhe derisa të aplikohet feja vetëm për All-llahun. E në qoftë se ndalen (nga propaganda dhe lufta), atëherë braktisne armiqësinë, përveç atyre që janë zullumqarë.” (Kur'ani, 2:190-193).

Lufta nuk është njëri ndër qëllimet e fesë islame, as nuk është pjesë e drejtimit normal të muslimanëve. Ajo është mjete i fundit që përdoret vetëm në rrethana të jashtëzakonshme; kur të gjitha masat e tjera dalin të pasuksesshme. Ky është statusi i vërtetë i luftës në fenë islame. Feja islame është religjion i paqes; kuptimi i saj është paqe; njëri ndër emrat e Zotit është paqe; përshëndetjet e përditshme të muslimanëve dhe të engjëjve janë paqe; xhenneti është shtëpia e paqes; mbiemri “musliman” do të thotë paqësor. Paqe është natyra, kuptimi, emblema dhe qëllimi i fesë islame. Çdo qenie duhet ta gëzojë paqen e fesë islame dhe përzemërsinë e muslimanëve paqësorë, pavarësisht nga dallimet religjioze, gjeografike apo racore, derisa nuk ekziston agresioni kundër fesë islame apo muslimanëve. Po të jenë jomuslimanët paqësorë me muslimanët, apo madje po të jenë indiferentë ndaj fesë islame, atëherë nuk do të ketë bazë për shpallje të luftës kundër tyre. Nuk ekziston luftë religjioze e muslimanëve me të cilën do të bëhej imponimi i Islamit ndaj jomuslimanëve; për arsye se po të mos vijë feja islame nga

bindjet e thella, nga brendia, atë nuk do ta pranojë Zoti, e as besimtarët e saj nuk do të mund ta predikojnë. Nëse ekziston ndonjë religjion apo kulturë që garanton një liri paqësore për religjionin, kjo është feja islame dhe vetëm feja islame. Për këtë pikë, Kur'ani flet kështu:

“Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota. E kush nuk i beson të pavërtetat e i beson All-llahut, ai është kapur për lidhjen më të fortë, e cila nuk ka këputje. All-llahu është dëgjues i dijshtëm.” (Kur'ani, 2:256).

Madje edhe në propagandimin e fesë islame, jo vetëm që është e ndaluar që muslimani të përdorë forcë, por është i urdhëruar t'i përdorë metodat më paqësore. Zoti i tha Muhammedit a.s.:

“Ti (Muhammed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira. Zoti yt është Ai që e di më së miri atë që është larguar nga rruga e Tij dhe Ai di më së miri për të udhëzuarit.” (Kur'ani, 16:125).

“Ihtarët e librit mos i polemizoni ndryshe (kur i thirrni në fenë tuaj), vetëm ashtu si është më së miri, përveç atyre që janë mizorë dhe thujuni: ‘Ne i besuam asaj që na u zbrit neve dhe që ju zbriti juve dhe se Zoti ynë dhe Zoti juaj është një, dhe se ne i jemi dorëzuar Atij’.” (Kur'ani, 29:46).

Tani kur kuptuam se qëllimi i fesë islame është paqja dhe pasi muslimanët dhe Kur'ani janë deklaruar për paqe, atëherë pse Muhammedi a.s., shpallte luftëra dhe jepte urdhra për betejë? Pse Kur'ani thotë “vritni” dhe luftoni kundër tyre? Që ta hulumtojmë

këtë çështje që duket e lehtë, duhet të përmendim disa fakte historike që i kanë shoqëruar muslimanët në luftërat kundër pabesimtarëve.

Pas pranimit të përgjegjësisë nga Zoti, Muhammedi a.s., thirri një tubim publik, në të cilin të pranishmëve u tregoi për atë që e ka pranuar, duke u apeluar të largohen nga idhujtaria e tyre e të besojnë në Një Zot të Vërtetë. Apeli i tij i parë paqësor dhe logjik hasi jo vetëm në rezistencë, por edhe në tallje e përqeshje. Ai vazhdimisht përpiqej t'ua prezentojë njerëzve të tij thirrjen e bekuar, por pati shumë pak sukses. Për disa vjet ai u detyrua të tërhiqet në predikim të fshehur, sepse nuk i lejohej që lirisht ta propagandojë fenë islame, me qëllim që t'ua shpëtojë jetën ithtarëve të tij të paktë dhe t'i lehtësojë vuajtjet e tyre. Kur i erdhi udhëzimi nga Zoti që ta predikojë haptas fenë e tij, u shtuan persekutimet dhe torturat ndaj muslimanëve. Megjithatë, sa më shumë shtoheshin persekutimet, aq më tepër shtoheshin edhe numri i muslimanëve. Pabesimtarët i përdorën të gjitha llojet e shtypjes dhe të mundimeve për ta heshtur thirrjen e Zotit. Por, sa më tepër që ata vepronin në këtë mënyrë, aq më i fortë qëndronte Muhammedi a.s., me ithtarët e tij. Kur pabesimtarët dështuan ta luhasin besimin e besimtarëve me anë të kërcënimeve, presionit, konfiskimit të pronës, etj., ata kundër muslimanëve organizuan një bojkot të rreptë, një fushatë tmerruese të izolimit. Për disa vjet muslimanët ishin të detyruar të mbesin vetëm brenda një rrethi të vogël shoqërueshish, pa pasur mundësi të predikojnë, të shesin, të blejnë, të martohen apo të kontaktojnë me cilindo nga banorët e Mekkes. Por

prapëseprapë edhe kjo nuk e luhati besimin e muslimanëve. Bojkoti vazhdoi derisa vetë pabesimtarët u lodhën nga ai dhe u detyruan që të heqin dorë.

Mbarimi i bojkotit nuk do të thoshte se erdhi paqja apo parandjenja e qetësisë nga ana e pabesimtarëve. Përkundrazi, keqtrajtimet dhe persekutimet marrin një hov më të madh; por, e gjithë kjo ishte e kotë përse i përket problemit musliman. Më në fund, pabesimtarët mbajtën një tubim pas dyerve të mbyllura për të diskutuar se çfarë duhet të bëjnë që ta zhdukin fenë islame dhe Muhammedin a.s., njëherë e përgjithmonë. U mor një vendim i përbashkët, me të cilin duhej të zgjedhej nga një njeri nga çdo fis, e të vritet Muhammedi a.s., në shtratin e tij. Misioni i Muhammedit a.s., nuk e pat fatin që të përfundojë në atë mënyrë. Pas kësaj, Zoti e udhëzoi atë që ta lëshojë Mekken, vendlindjen e tij të dashur dhe të migrojë në Medine, ku do të ribashkohej me muslimanët e tjerë të atij vendi dhe me emigrantët më të hershëm, të cilët kishin ikur nga Mekka në Medine (shihe Kur'anin, 8:30; 9:40). Kjo qe ngjarja e madhe e Hixhretit (622) apo e emigrimit, me të cilën edhe filloi historia islame dhe sipas së cilës llogaritet edhe kalendari islam.

Pasi ikën nga Mekka, muslimanët qenë të detyruar nga një varg rrethanash t'i lënë pas të gjitha pronat e tyre, madje edhe familjet e tyre. Posa u vendosën në Medine, Muhammedi a.s., e rifilloi predikimin e tij paqedashës dhe thirrjen e tij të shenjtë për fenë islame. Disa nga vendasit u përgjigjën pozitivisht ndaj thirrjes së Zotit dhe menjëherë u bënë anëtarë të ligjshëm të bashkësisë islame. Të tjerët nuk e

hodhën poshtë fenë islame, por i mbajtën besimet e tyre tradicionale. Për arsye se Muhammedi a.s. u përcaktua për paqe plot dinjitet dhe për reformë, ai nënshkroi marrëveshje me jomuslimanët, duke u siguruar atyre liri dhe siguri, dhe, për herë të parë, në zemrën e tyre krijoi një vetëdije shoqërore-kombëtare në vend të besnikërisë së kufizuar fisnore.

Derisa Muhammedi a.s., ishte i zënë me këto reforma, duke u përpjekur për ta organizuar bashkësinë islame në Medine dhe për ta themeluar shoqërinë në baza stabile e paqësore, ku muslimanët dhe jomuslimanët do të jetonin bashkë, - armiqtë në Mekke nuk pushonin së vepruari. Urrejtja e tyre ndaj muslimanëve shtohet gjithnjë e më tepër, ndërsa përcaktimi i tyre për ta eliminuar fenë islame rritej dita-ditës, kështu që ndërmorën taktikë të re, i riformuluan planet e tyre dhe filluan t'i zbatojnë. Ata vendosën t'u shkaktojnë trazira muslimanëve, si nga brenda ashtu edhe nga jashtë. U organizuan fushata luftarake dhe plaçkitëse për ta sulmuar Medinen dhe për të sjellë në Mekke gjithë atë çka mund të grabitej. Jomuslimanët e Medines u bënë tepër ziliqarë për popullaritetin e fesë islame dhe për frymën e re të vëllazërisë në mesin e muslimanëve, gjë të cilën ata aspak nuk e kishin përjetuar, e as që nuk do të kishin dashur ta përjetonin. Kështu, armiqtë në Mekke shpejtuan ta shfrytëzojnë këtë situatë dhe filluan t'u shkaktojnë muslimanëve më tepër probleme të brendshme. Përgjigjja e jomuslimanëve ziliqarë në Medine ndaj asaj që ndodhte në Mekke manifestohet shpejtë, kështu që në Medine situata u bë mjaft serioze dhe e tensionuar.

Tani muslimanëve u kanosej rreziku armiqësor nga të dyja anët: edhe nga jomuslimanët e Medines edhe nga ata të Mekkes. Ata u gjendën në një situatë që nuk mund t'i duronin më as persekutimet e as kërcënimet. Ata ndaheshin nga familjet e tyre me përdorimin e forcës. Pronat e tyre u konfiskuan dhe gjaku u derdh. Ata u detyruan ta lënë vendlindjen e tyre të dashur në tri valë të migrimit: dy në Abisini dhe një në Medine. Duruan kështu në një periudhë kohore që zgjati plot trembëdhjetë vjet. Me taktikën e re të armiqve nga Mekka, për muslimanët nuk mbetej gjë tjetër përveç të presin zhdukjen e tyre përfundimtare në një masakër të përgjithshëm, ose ta mbrojnë veten nga dhuna dhe persekutimet.

Kjo sigurisht që një paradoks. Feja islame erdhi t'u sigurojë atyre dinjitet dhe fuqi, liri dhe siguri dhe t'i lidhë me Zotin, burimin suprem të së mirës dhe ndihmës, të fuqisë dhe paqes. Dhe ja, ata ende ishin të pandihmë e torturoheshin me të madhe. Feja islame i mësoi ata ta rivendosin paqen, të urdhërojnë për të drejtën e të ndalojnë të keqen, t'i përkrahin të shtypurit dhe t'i çlirojnë të nënshtruarit dhe të dëshmojnë se sa i besueshëm dhe ndihmues është Zoti për shërbëtorët e Tij. Por, si mund ta bënin të gjithë këtë, kur ata vetë ishin të shtypur, të nënshtruar ndaj terrorit dhe të pandihmë?

Ajo që ata i habiti më së tepërmi që Kur'ani, i cili nuk thoshte gjë lidhur me këtë problem e nuk jepte udhëzime specifike për atë se ç' duhej të bënin. Por, ky konfuzion i këtillë nuk zgjati shumë, për arsye se Zoti e lehtësoi pikëllimin e tyre me një vendim hyjnor për zgjidhjen e problemeve të tyre dhe të

gjithë atyre që do të mund ta gjenin veten në një situatë të ngjashme. Ja se si Zoti e shpalli vendimin e Tij:

“All-llahu largon dëmet e idhujtarëve ndaj atyre që besuan, se All-llahu nuk e do asnjë tradhtarë e bukëpërmbystë. Atyre që po sulmohen me luftë, u është dhënë leje të luftojnë, për shkak se u është bërë padrejtë, e All-llahu ka fuqi për t’u ndihmuar atyre (muslimanëve). (U lejuan të luftojnë) Ata, të cilët vetëm pse thanë: ‘All-llahu është Zoti ynë!’, u dëbuan prej shtëpive të tyre pa kurrfarë të drejte. E sikur All-llahu të mos i zbrapste disa me disa të tjerë, do të rrënoheshin manastiret, kishat, havrat e edhe xhamitë që në to përmendet shumë emri i All-llahut. E All-llahu patjetër do ta ndihmojë atë që ndihmon rrugën e Tij, se All-llahu është shumë i fuqishëm dhe gjithnjë triumfues. (Ai i ndihmon) Ata, të cilët kur Ne u mundësojmë vendosjen në tokë, e falin namazin, japin zeqatin, urdhërojnë për të mirë dhe largojnë prej të keqes. All-llahut i takon përfundimi i çështjeve.” (Kur’ani, 22:38-41).

Me këtë leje nga Zoti u ndalua çfarëdo persekutimi apo dhune ndaj muslimanëve. U paraqit njëfarë qëndrese nga ana e tyre për përtëritjen e qetësisë, për ta fituar paqen dhe lirinë e tyre, për t’u bashkuar me familjet e veta dhe për ta marrë prap pasurinë e tyre. U zhvilluan disa beteja me pabesimtarët qëllimkëqij, të cilët në mënyrë flagrante e refuzonin paqen dhe lirinë e muslimanëve. Megjithatë, muslimanët asnjëherë nuk kanë bërë agresion; ata asnjëherë nuk shkatërruan shtëpia, të lashta, furnizime ushqimi, etj.; apo nuk vranë as fëmijë, as gra, as njerëz të moshuar

e invalidë, etj. Muslimanët iu përmbajtën këtyre ligjeve dhe mbetën brenda kufijve të Zotit. Kjo ishte një gjë që s'ishte përjetuar më parë e as që është përjetuar më vonë. Muslimanët duhej të jetonin në këto rrethana; dhe ata në fund e arritën qëllimin dhe fitoren, vetëm me parimet dhe udhëzimet e Zotit.

Është shkruar apo është thënë shumë për muslimanët “e egër”, të cilët dolën nga shkretëtirat e thata dhe të zjarra të Arabisë dhe që i ngadhënjyen protektoratet romake dhe persiane, madje që hynë edhe ndër muret e Evropës. Shumë sish kanë qenë të mendimit se muslimanët u motivuan nga vullneti religjioz që sa më shumë ta përhapin fenë islame me anë të forcës. Ka të tjerë që mendojnë se ky mendim është naiv, për arsye se feja islame - nga natyra e saj - nuk e pranon dhunën, madje edhe po t'u ishte dhënë me dhunë njerëzve të okupuar nuk do të zgjaste shumë, dhe jomuslimanët do të ishin të likuiduar nga religjionet e okupuara. Historia është dëshmitare e faktit se kudo që arriti feja islame, aty mbijetoi - me përjashtim të Spanjës, për shkaqe të caktuara - dhe se kudo që shkuan ngadhënjyesit muslimanë, ata jetuan bashkë me vendasit jomuslimanë. Aq më tepër, ata thonë se kurrkush nuk mund të fusë me forcë në kokën e dikujt diçka siç ishte feja islame, dhe atë person ta gjejë aq të ndershëm dhe të sinqertë në besimin e tij, siç ishin muslimanët e konvertuar në tokat e reja. Do të duhej diç më tepër se përdorimi i dhunës për të bërë muslimanë aq të mirë nga njerëz të mundur, dhe nevojitet më tepër se shtypja që ata të njëjtit ta ushqejnë dhe ta përkrahin religjionin “e dhunshëm”.

Një ecuri tjetër mendimesh doli nga disa që dëshironin ta quajnë veten intelektualë, apo kritikë e autoritete të shkëlqyera. Ata nuk janë të kënaqur me mendimin naiv se feja islame është përhapur me anë të forcës. Përhapjen e fesë islame ata e shpjegojnë me luftërat agresive, që i lansuan muslimanët që po mbyteshin në vapën e Arabisë, dhe thjeshtë, këta ishin të motivuar nga nevojat dhe rrethanat ekonomike. Këto luftëra dhe ekspansione nuk ishin religjioze apo shpirtërore; por, thjeshtë vetëm rezultat i nevojave të tepërta. Kjo mund të na tregojë se arabët nuk kanë pasur aq shkallë të lartë të dashurisë dhe të sakrificës, apo atë se pas vdekjes së Muhammedit a.s., ihtarët që mbetën pas tij, si dhe ata pas tyre, e humbën interesin e tyre ndaj religjionit, duke vrapuar menjëherë që t'i kënaqin dëshirat e tyre momentale. Kjo po ashtu do të thotë se feja islame, për këta luftëtarë muslimanë, nuk është e aftë për të nxjerrë nga gjiri i vet një trimëri e vullnet. Këtu mund të ketë implikime të shumëllojshme dhe "intelektualët" e këtillë nuk dinë se cilin mendim ta përkrahin më parë.

Ekziston edhe një mendim tjetër, të cilin e kanë pranuar disa njerëz, që thonë se luftërat muslimane jashtë Arabisë janë zhvilluar për shkak të plaçkitjes dhe sulmeve ziliqare. Ata nuk mund të shohin ndonjë motiv apo diç tjetër te muslimanët, përveç etjes për gjak dhe dëshirës për luftë. Ata refuzojnë të shohin çfarëdo lloj virtyti në fenë islame dhe po ashtu refuzojnë t'i barazojnë muslimanët me ndonjë motiv më të lartë.

Diskutimi midis këtyre seksioneve të ndryshme është mjaft serioz dhe ndonjëherë merr formën e diskutimit akademik. Problemi qendror apo më i rëndësishëm është aty se asnjë nga këta kritikë nuk ka bërë përpjekje serioze që ta kuptojë gjithë këtë çështje dhe nuk është përpjekur ta prezentojë të vërtetën në një mënyrë të ndershme. Prandaj askush nga ata nuk ka shikimin e nevojshëm dhe kurajon morale për ta nxjerrë versionin e vërtetë të rastit në fjalë. Sa rëndë e sa keq do të ndihen kur do të zbulojnë se kanë udhëhequr gabimisht dhe kanë dezinformuar me miliona njerëz! Sa serioze do të jetë përgjegjësia e tyre kur do të kuptojnë se sa faj të madh kanë bërë kundër së vërtetës, kundër muslimanëve dhe kundër ithtarëve të vet!

Është e pamundur që këtu ta prezentojmë në detaje pikëpamjen e fesë islame për çdo luftë apo çdo betejë. Megjithatë, ekzistojnë disa pika kryesore të cilat, kur do t'i përmendim, do të japin një ide të mirë për gjithë problemin në përgjithësi.

1. Duhet të mbahet në mend se Muhammedi a.s., të cilin e dërgoi Zoti si mëshirë për gjithë njerëzimin, u përpoq t'u afrohet sunduesve në territoret e afërta, duke i ftuar ata që ta përqafojnë fenë islame dhe ta ndajnë mëshirën e Zotit. Po ashtu duhet të mos harrojmë se ata jo vetëm që e refuzuan thirrjen e tij të mëshirshme, por edhe shpallën luftëra të hapura kundër muslimanëve. Në kohën kur jetoi ai, ushtarët romakë dhe persianë i kaluan kufijtë muslimanë nëpërmjet sulmeve të shumta. Kështu, në kohën e vdekjes së tij, muslimanët, kundër vullnetit të tyre, ishin në luftë me fqinjët e tyre.

Një gjendje e këtillë ende vazhdoi dhe çdo gjë që ndodhi më vonë në gjeneratat e pastajme, duhet të analizohet në kontekst të këtyre incidenteve fillestare. Kjo do të thoshte se e gjithë bota krishtere, duke e marrë parasysh këtu edhe Spanjën dhe Francën, ishte në luftë me botën e posakrijuar islame. Ekspansioni i muslimanëve në Evropë po ashtu duhet të shihet në dritën e këtyre rrethanave. Fakti se e gjithë bota krishtere vepronte si një fuqi, dokumentohet me autoritetin e paluhatshëm të papatit romak ndaj të krishterëve. Kjo po ashtu mund të dokumentohet edhe me mobilizimin e përgjithshëm të fuqive krishtere kundër fesë islame gjatë kryqëzatave të Mesjetës, e madje edhe gjatë 15 viteve të para të shekullit tonë.

Kështu pra, kur Roma ndërmoi luftë kundër fesë islame, muslimanëve nuk mund t'u mohohet drejta për të luftuar në çdo fushëbetejë - qoftë ajo në Palestinë, Itali apo në Hungari. Kjo i detyroi ata të shkojnë në Spanjë dhe në Francën Jugore. Ata nuk mund të lejonin të jenë të rrethuar nga të gjitha anët nga fuqitë e mëdha siç ishin Roma dhe Persia. Por, as nuk mund të lejonin të asgjësoheshin nga faqja e dheut. Nga Roma vinin urdhra për vrasjen e Muhamedit a.s., dhe për sjelljen e kokës së tij para gjyqit mbretëror; kjo që diçka që romakët paganë ua kishin bërë pionierëve të hershëm të krishterë. Megjithatë, duhet të pranojmë se disa luftëra në shekujt e vonshëm nuk patën kurrfarë lidhje me fenë islame, edhe pse zhvilloheshin nga vetë muslimanët. Ato nuk bëheshin për përhapjen e fesë islame. Ato motivoheshin nga disa shkaqe lokale apo, thënë më mirë, per-

sonale. Agresioni është agresion pavarësisht a bëhet nga muslimanët apo kundër tyre; dhe pikëpamja e fesë islame ndaj agresionit është e qartë dhe e pandryshueshme. Sipas kësaj, po të ketë pasur ndonjë agresion në këto luftërat e mëvonshme, ai nuk mund të arsyetohet nga feja islame, e as të jetë i pranueshëm nga Zoti.

2. Askush nga kritikët e zënë ngojë nuk përpiqet ta kuptojë natyrën dhe rrethanat e këtyre shekujve të hershëm. Mediumet e komunikimit masiv në atë kohë nuk ekzistonin. Nuk kishte as shtyp, as radio, as televizion, e madje as shërbim të rregullt të postës. Nuk kishte asnjë mënyrë për informim apo predikim publik, përveç me anë të komunikimit personal. Nuk kishte respekt për jetën apo pronën, për nderin apo për marrëveshjet midis individëve e as respekt për popujt më të dobët. Nuk kishte siguri e as shprehje të lirisë. Kushdo që do të mbronte ndonjë qëndrim bujar, apo kushdo që të vinte me besime jo të popullarizuara, poshtërohej e persekutohej. Kjo u zbulua nga historia e Sokratit, filozofit grek, për pionierët e krishterë dhe nga muslimanët e hershëm. Shumë emisarë të cilët kishin për detyrë t'ua dorëzojnë mesazhet speciale sundimtarëve dhe shtetarëve të ndryshëm, asnjëherë nuk u kthyen të gjallë. Ata u vranë me gjakftohtësi apo u burgosën nga nikoqirët e tyre.

Muslimanët e Arabisë ishin të detyruar të ballafaqohen me të gjitha këto pengesa dhe të punonin në rrethana të këtilla. Ata kishin t'i dërgonin njerëzimit një porosi, ata kërkonin t'i kontribuonin njerëzimit e të gjejnë një formulë për shpë-

timin e tij. Kur'ani thotë se njerëzit me mençuri dhe predikim më të bukur duhet të ftohen në rrugën e Zotit, dhe gjatë kësaj, të diskutohet në mënyrë mirëdashëse. Por, kush ishte i përgatitur ta dëgjojë thirrjen e Zotit për paqe? Është fakt i gjallë se shumë jobesimtarë i largoheshin dëgjimit të Pejgamberit që të mos bienin nën ndikimin e predikimit të tij paqësor. Ata madje rezistuan me forcë kundër thirrjes paqësore të fesë islame. Përvoja e hershme e Arabisë i mësoi muslimanët se më efektive është të jeshë paqësor dhe i qetë dhe në të njëjtën kohë të jesh i gatshëm; se mund të lëvizish në paqe vetëm atëherë kur je mjaft i aftë ta ruash paqen tënde; dhe se zëri yt paqësor më mirë do të jehojë kur do të jeshë i aftë t'i rezistosh shtypjes, e me këtë ta eliminosh atë.

Tani, me urdhrin e Zotit, ata duhej ta njoftonin botën me fenë islame, por nuk ekzistonte kurrfarë sistemi telekomunikativ, as shtypi e as ndonjë medium tjetër masiv i komunikimit. E vetmja gjë që ende ishte në disponim ishin kontaktet e drejtpërdrejta dhe personale, që nënkuptonte se ata duhej t'i kalonin kufijtë e shtetit. Por, këtë nuk mund ta bënin vetëm në grupe të vogla dhe të paarmatosura. Kështu, ata duhej të lëvizin në grupe të mëdha që në plotkuptimin e fjalës do të paraqitnin një ushtri unike. Ata i kaluan kufijtë në drejtime të ndryshme e në kohë të ndryshme. Ajo që ndodhi pas kësaj meriton një konsideratë të posaçme. Në disa krahina vendasit i pritën mirë, ata vendas që qenë të nënshtruar dhe të shtypur nga Roma dhe Persia. Në disa krahina të tjera, ata duhej së paku t'ua ofrojnë fenë islame atyre që ishin të gatshëm ta pranojnë - e të tillë kishte

shumë. Ata që nuk dëshironin ta pranojnë fenë islame, duhej të paguanin tagra të njëjta me vetë taksën islame (zeqatin). Shkaqet pse kërkohet një taksë e këtillë ishin: (1) Ata dëshironin të jenë të sigurt se paguesit e taksave të tyre e dinin se ç'bënin; dhe se feja islame iu ofrua, por ata e refuzuan me vullnetin dhe dëshirën e tyre; (2) Për arsye se ata e morën mbi vete obligimin për ta mbrojtur tagrapaguesin dhe t'ia garantojnë atij sigurinë dhe lirinë në të njëjtën mënyrë si vetë muslimanit, sepse çfarëdo lloj rreziku që t'i kanosej atij, paraqiste rrezik edhe për bashkëvendasin musliman; dhe, me qëllim që ta mbronin muslimanin, ata duhej ta siguronin lirinë edhe për jomuslimanin; (3) Për shkak të situatës së re, nevojitej përkrahja dhe bashkëpunimi në të gjithë sektorët, qoftë nga muslimanët apo nga jomuslimanët; prej të parëve përmes zeqatit, kurse prej të tjerëve përmes taksave të tjera, mjete këto që harxhoheshin për interesin e shoqërisë; dhe (4) Ata donin të jenë të sigurt se ai (që paguan taksën) nuk është armik i tyre dhe i vëllezërve të rinj të tyre, dhe se nuk do të shkaktojë trazira për bashkëvendasit e tij muslimanë.

Ata që nuk e pranuan fenë islame dhe refuzuan t'i paguajnë taksat e duhura, në bashkëpunim me sektorët tjerë për përmbajtjen e gjendjes së tyre, bënë keq ndaj vetvetes. Ata që nga fillimi iu kthyen drejtimit armiqësor dhe parapanë të shkaktojnë trazira, jo aq për muslimanët e ardhur, sa për muslimanët bashkëvendas që posa e kishin pranuar fenë, si dhe për ata që filluan t'i paguajnë tagrat. Në kuptimin nacional kjo pikëpamje ka qenë e rrezikshme; në kuptimin njerëzor e keqe; në kuptimin

social e pakujdesshme; dhe në kuptim ushtarak - provokative. Por, në një kuptim praktik, asaj i duhej edhe shtypje, jo aq shumë për ata që kishin ardhur sa për hir të shtetit në të cilin jetonin këta tradhtarë. Ky ishte rasti i vetëm kur forca përdorej që t'u kthehet rezonimi njerëzve të tillë, dhe më në fund, t'i kuptojnë përgjegjësitë e tyre; ose si muslimanë duke e pranuar lirisht fenë islame, ose si qytetarë lojalë-tagrapagues, të aftë të jetojnë me bashkëvendësit e tyre muslimanë dhe t'i ndajnë me ta të drejtat dhe obligimet e njëjta.

3. Do të ishte e këshillueshme që këta kritikë ta studiojnë Kur'anin me qëllime të ndershme, kështu që të shohin se çka thotë ai lidhur me luftën dhe paqen. Ndoshta edhe më mirë do të ishte që ata ta studionin statusin e njerëzve të "ngadhënjyer" dhe kushtet në të cilat kanë jetuar para dhe pas kontaktit të tyre me muslimanët. Çka do të thonë po të zbulojnë se vendasit u kanë bërë muslimanëve thirrje urgjente që të mbrohen nga ligji nënshtrues romak e persian? Çka do të mendojnë nëse rastësisht zbulojnë se "ngadhënjyesit" muslimanë kanë qenë të mirëpritur përzemërsisht nga njerëzit e zakonshëm si edhe nga patriarkët religjiozë, të cilëve mbrojtja dhe administrimi musliman u qenë të mirëseardhur? Si do të mund ta shpjegojnë fenomenin se disa nga njerëzit "e ngadhënjyer" jo vetëm që i pritën përzemërsisht muslimanët "invadues", por po ashtu luftuan në anën e tyre kundër dhunës e nënshtrimit? Si do t'i paramendonin prosperitetin, lirinë dhe progresin e rajoneve "të invaduar" nën fenë islame, në krahasim me atë që kishte mbretëruar aty më parë?

Tani nuk jemi duke zgjidhur ndonjë pikëpamje të veçantë rreth kësaj çështjeje apo nuk sjellim ndonjë përfundim të nxituar. Vetëm besojmë se duhet të mendojnë seriozisht lidhur me këtë çështje. Hulumtimet lidhur me këtë sigurisht do të jenë interesante dhe shumë të rëndësishme. Ndoshta këtë më mirë mund ta kuptojë një mendje perëndimore, nëse i gjithë problemi analizohet në dritën e kushteve që mbizotërojnë në botën e sotme. Kujdesi i madh i Aleancës Perëndimore për Berlinin, thirrjet e të shtypurve gjithkrah, ankthi i koreanëve jugorë, frika e laotianëve, çështja e NATO-s, punët e SEATO-s, jostabiliteti i satelitëve komunistë - e gjithë kjo mund t'i ndihmojë mendjes perëndimore t'i kuptojë ngjarjet e atyre shekujve të largët dhe politikat aktuale të muslimanëve të atyre ditëve.

4. Ideja se luftërat muslimane në botën e jashtme qenë të motivuara nga nevojat ekonomike të arabëve, po ashtu meriton kujdes të posaçëm. Edhe pse ata që mendojnë kështu janë shumë të sigurt, mund të shihet se nuk e kanë studiuar rastin pak më seriozisht. A mendojnë ata sinqerisht se vetëm nevojat ekonomike qenë shkaqet që muslimanët me urgjencë t'i kalojnë kufijtë e tyre arabë? Në çfarë bazohen ata kur supozojnë se Arabia - me qendrat e saj të vjetra afariste, fushat dhe oazat - nuk qe më e aftë të prodhojë për muslimanët? A kanë studiuar pak më seriozisht se sa kanë marrë për vete muslimanët "invadues", se sa shpërndanin në mesin e popullit nën sundimin e tyre dhe se sa kanë dërguar prapa në administrimin qendror në Medine, apo në Damask, në Bagdad apo në Kajro? A i kanë kraha-

suar të ardhurat e territoreve “të invaduar” para dhe pas fesë islame, dhe a kanë zbuluar se a ishin apo jo “invaduesit” vetëm aventurierë të interesuar vetëm për çështje biznesi? A kanë pasur ndonjë arsye të besojnë se këta muslimanë merrnin më tepër se sa jepnin, apo se merrnin më tepër se sa kishin depouar, apo se fitonin më tepër se sa investonin? A kanë hasur në ndonjë evidencë të dokumentuar se shteti qendror në Arabi ka pranuar ndonjë taksë nga protektoratet e tij “të ngadhënjyera”, të cilat nevojiteshin për zhvillimin e po këtyre protektorateve; dhe nëse kjo është e vërtetë, sa kanë pranuar dhe a ishte për këtë e vlefshme aventura në botën e panjohur? A kanë marrë diku ndonjë informatë të saktë ku thuhet se Arabia ka pasur privilegj apo përparësi në shpenzimet për programet zhvilluese në krahasim me krahasinat “e invaduar”? Më në fund, a ndjeu Arabia, papritmas, rrezikun nga “shpërthimi i popullsisë”, që i detyroi muslimanët të ndërmarrin luftëra ekspansioniste dhe hulumtime ekonomike?

Përpjekjet për t'i interpretuar kontaktet e muslimanëve me jomuslimanët në suaza të nevojave ekonomike, mund të tingëllojnë çuditshëm dhe të vlefshme për simpati; por e gjithë kjo nuk përmban në vete më tepër nga e vërteta, apo nuk lidhen mendimet e tilla me hulumtimet e vërteta shkencore. Rezerva e fundit që mund të bëhet sa i përket kësaj përpjekjeje, është larg nga ajo që të jetë e mjaftueshme apo complete. Edhe shumë duhet të bëhet në fushën e hulumtimit, kërkimit, analizës dhe të krahasimit. Derisa të bëhet kjo, asnjë kritik nuk ka të drejtë morale t'i deklarojë supozimet e tij teorike si

të vlefshme apo të plotfuqishme. Kjo paraqet edhe një thirrje tjetër mirëdashëse të fesë islame për të gjithë kritikët që të fillojnë më seriozisht ta hulumtojnë të vërtetën.

5. Nuk duhet t'i marrim aq seriozisht ata njerëz që mendojnë se luftërat muslimane janë zhvilluar kot së koti. Çka mund të jetë më paparashikuese apo më stereotipe se një mendim i tillë? Kjo është të rënët shkurt në fushën e hulumtimeve shkencore dhe një rrugë pak më e lehtë për të ikur nga problemet intelektuale dhe morale; por, po ashtu është edhe shumë larg nga e vërteta. Pyetjet e njëjta të pikave 3 dhe 4 më lartë, mund t'i përsërisim edhe një herë, vetëm për të parë se sa pre (plaçkë) morën "ekspansionistët muslimanë", apo sa kthyen në Arabi dhe se sa njerëz të tyre u kthyen nëpër shtëpitë e veta me plaçkë. Mos ta përmendim lulëzimin, rilindjen dhe prosperitetin e territoreve "të plaçkitura" nën të njëjtit "plaçkitës". Nuk do t'i përmendim as persekutimet e rënda dhe humbjet e mëdha jetësore dhe të pronësisë në anën e muslimanëve, apo provokimet dhe kërcënimet që u bëheshin atyre. Kjo në realitet është një thirrje ndaj atyre që mendojnë se duhet të bëhen studime më të kujdesshme dhe të sillen përfundime më me përgjegjësi. Megjithatë, ata duhet të mbajnë mend se sado që të kenë plaçkitur muslimanët, kjo ka qenë shumë më pak në krahasim me humbjet që i kanë pësuar nga konfiskimet, uzurpimet, persekutimet dhe veprimet tjera provokative të ndërmarra mbi ta nga kampet armiqësore.

Pavarësisht nga ajo se a e pranojnë kritikët e niveleve të ndryshme këtë lloj pikëpamjeje, mbetet

fakt i gjallë se feja islame është religjion i paqes në kuptimin më të plotë të këtij termi; se lufta e padrejtë asnjëherë nuk kishte vend në mësimet e saj; se agresionin ajo asnjëherë nuk e ka toleruar dhe se feja islame asnjëherë nuk u përhap me anë të dhunës, se shpërdorimi asnjëherë nuk ka qenë i falur nga Zoti apo i pranueshëm nga feja islame; dhe se kushdo që e keqtrajton apo që e interpreton gabimisht fenë islame, i bën keq vetvetes dhe shokëve të vet më tepër se sa fesë islame. Për arsye se ky është religjion i Zotit dhe i rrugës së drejtë të Tij, ai i kapërceu kushtet më të vështira dhe përsëri do të jetë urë e sigurt për një amshueshmëri të lumtur. Nëse këta kritikë dyshojnë në këtë fakt, le ta rilexojnë Kur'anin dhe le ta freskojnë kujtesën e tyre të historisë.

E vërteta se pas përhapjes së fesë islame vijoi një prosperitet ekonomik dhe një rilindje kulturore në rajonet “e okupuara”, nuk do të thotë se muslimanët ishin kategorikë për fitime ekonomike dhe për plaçka ushtarake. Madje edhe këto fitime dhe plaçka së bashku u bënë shtytëse në periudhat e mëvonshme të historisë islame; - por kjo nuk do të thotë se feja islame anon kah lufta e jo kah paqja dhe se muslimanët e pëlqejnë më tepër plaçkën e luftës. Ekzistojnë shpjegime më të mira. Njëri nga këto duhet t’u jetë shumë i qartë atyre që e njohin diskutimin klasik të etikës protestante dhe të frymës perëndimore, ku Protestantizmi, bashkë me faktorët e tjerë, shpjeu kah ngritja e kapitalizmit modern. Asnjë rezonim më serioz nuk do të kishte thënë se protestantët e zhvilluan etikën e tyre që të kenë prosperitet ekonomik, apo atë se kapitalizmi modern ende varet nga etika protestante.

2. Isai, biri i Merjemes

Një ndër problemet më kontradiktore në historinë njerëzore është çështja e Isait. A ishte ai krejtësisht hyjnor apo ishte krejtësisht njeri, apo ndoshta ishte gjysmëhyjnor e gjysmënjeri në të njëjtën kohë? A ishte ai i vërtetë apo ishte edhe një pretendues i rrejshëm? A u lind në një mënyrë të rregullt me nënë e baba si çdo fëmijë tjetër? A u lind në dimër apo në verë? Shumë pyetje si këto ende janë të paqarta në mesin e të krishterëve dhe jokrishterëve. Argumentet dhe konfliktet në lidhje me problemet e këtilla kanë ekzistuar qysh prej kohës së Isait e gjer më sot. Në mesin e të krishterëve janë paraqitur shumë dominime dhe mospajtime për disa aspekte të parëndësishme të këtyre pyetjeve. Këtë e dinë edhe të krishterët edhe të tjerët. Por, ku qëndron feja islame? A mund të ofrojë ajo ndonjë interpretim të saj me qëllim që t'i zgjidhë këto çështje konfuze?²⁵

Para se ta fillojmë diskutimin rreth problemeve të lartpërmendura, duhet të na jenë të qarta tri pika. Së pari, një musliman nuk e ka vështirë të vendosë

²⁵ Ende nuk ekziston pajtimi për çfarëdo qoftë që është e rëndësishme në jetën e Isait: si, kur dhe ku u lind, jetoj, pranoi porosinë e tij, ku vdiq dhe ku u varros; a ka bërë me të vërtetë “çudira” dhe të çfarë lloji; a u ngrit, ku u ngrit dhe kur u ngrit nga të vdekurit. Mungesa e vendit dhe karakteri shpifës dhe femohues i argumenteve, na detyrojnë që diskutimin tonë ta kufizojmë nga këto pyetje provokative. Për një shqyrtim kritik dhe bibliografi të shkëlqyer, shih Qani Muhammed Berekatull-llah “*Jesus Son of Mary, Fallacy and Factuality*” (Isai, biri i Merjemes - gabimet dhe faktet). Philadelphia: Dorrance & Company, 1973.

për pikëpamjen e fesë islame ndaj Isait; mendja e tij është e përgatitur, vetëdija e tij është e pastër dhe besimi i tij është i shëndoshë. Së dyti, konceptet e muslimanit për Zotin, religjionin, peygamberinë, shpalljen dhe për njerëzimin e bëjnë që ai ta pranojë Isain jo vetëm si një fakt historik, por edhe si njërin ndër peygamberët më të dalluar të Zotit. Duhet ta mbajmë mend këtu se pranimi i Isait nga ana e muslimanëve është një njësi themelore e besimit në fenë islame dhe se muslimani asnjëherë nuk guxon ta nënçmojë Isain. Muslimani nuk guxon ta mohojë Isain, siç nuk guxon ta mohojë asnjë nga peygamberët e tjerë të Zotit. Së treti, ajo që do ta përmendim këtu, plotësisht përputhet me atë që e thotë e na e mëson Kur'ani. Edhe pse në mes të krishterëve mjaft jo të popullarizuara, besimi dhe të dhënat e fesë islame rreth Isait nuk kanë për qëllim ta zvogëlojnë rolin e tij, ta nënçmojnë karakterin e tij, apo ta degradojnë personalitetin e tij të madh. Përkundrazi, këto pikëpamje islame e përshkruajnë Isain në mënyrë të respektueshme dhe i japin atij një status të lartë, ashtu siç e ka bërë edhe Vetë Zoti. Në të vërtetë, muslimani e nderon Isain më tepër se shumë të krishterë. Por, nuk duhet ta keqkuptojmë pikëpamjen e fesë islame. Kjo nuk duhet të kuptohet si kënaqje, lajkë apo kompromis. Ajo duhet të merret si e vërtetë në të cilën muslimani beson në mënyrë të paluhatshme dhe kështu do të vazhdojë të besojë. Kjo është e vërteta e së kaluarës, e së sotmes dhe e vërteta e të nesërmes.

Rrethanat në të cilat u lind dhe u rrit Isai meritojnë një kujdes të posaçëm. Njerëzit ku u

dërgua ai kishin disa karakteristika të posaçme, në mes të cilave mund të përmendim: (1) ata i shpifnin dhe i keqinterpretënin shpalljet e Zotit në kuptim, fjalë, etj.; (2) ata i refuzonin disa nga peygamberët e tyre, duke e marrë parasysh këtu edhe Isain dhe vranë disa prej tyre; dhe (3) ata ishin të papërgjegjshëm në relacion me pasurinë e tyre. Kur'ani thotë:

“E sa herë që ju erdhi ndonjë I dërguar me çka nuk u pëlqeu juve, a nuk u bëtë kryelartë dhe disa prej tyre i përgënjeshtruat e disa i mbytët?” (Kur'ani, 2:87)

“All-llahu ka dëgjuar fjalën e atyre që thanë: ‘All-llahu është i varfër e ne jemi të pasur!’ Ne do të shënojmë atë që thanë ata dhe që i mbytën peygamberët pa kurrfarë faji, e do t’ju themi: ‘Vuane mundimin e djegies së zjarrit!’” (Kur'ani, 3:181).

“Në të vërtetë All-llahu pat marrë zotimin e Beni Israilëve... Për shkak se ata e thyen zotimin e tyre, Ne i mallkuam ata, dhe zemrat e tyre i bëmë të forta (të shtangura). Ata i ndryshojnë fjalët (në Teurat) nga domethënia e tyre dhe braktisën një pjesë me të cilën ishin urdhëruar.” (Kur'ani, 5:12-13).

Kjo që natyra e dytë e njerëzve të cilët që dërguar Isai. Sa i përket datës së lindjes së tij, të krishterët nuk kanë qenë të aftë të përcaktohen për ndonjë kohë apo vit të caktuar. “Astrologët ende nuk kanë gjetur ndonjë shpjegim specifik për Yllin e Bethlehemit...’ As viti i lindjes së Krishtit e as stina e vitit kur ai (Ylli) u paraqit nuk dihen me siguri’... Historianët thonë se viti më i hershëm ka qenë 11 para Krishtit, ndërsa më i vonshmi 4 pas Krishtit...” Po ashtu “...derisa koha e vitit kur ndodhi lindja

ende nuk dihet me saktësi, sigurisht kjo ka ndodhur në pranverë; për këtë ka më tepër gjasa se sa të ketë ndodhur në dhjetor...” (Mrs. Simone Daro Gossner, nga U.S. Naval Observatory, e cituar nga f. 12 e The Edmonton Journal të 23 dhjetorit, 1960).

Sido që të ketë qenë, pyetja më e rëndësishme për muslimanin është si u lind Isai. Deri në kohën e Isait u panë tri lloje të krijimit, në çdonjërin prej të cilëve fuqia, dituria dhe mençuria e Zotit, Krijuesit - u treguan në mënyrë të qartë. Së pari u krijua një qenie njerëzore pa ndikimin fizik apo pa praninë e ndonjë nëne apo babai të njohur - e ky ishte Ademi. Së dyti, u krijua një qenie njerëzore pa ekzistencën apo paraardhjen fizike të ndonjë nëne apo të ndonjë paraardhësi tjetër të gjinisë femërore - e kjo ishte Hava. Asaj i parapriu Ademi, për të cilin thuhet se është babai simbolik apo figurativ i njerëzimit. Së treti, u krijuan me miliona njerëz me anë të intimitetit normal ndërmjet nënës dhe babait. Shumë humtues dhe njerëz seriozë kanë menduar se a thua ka pasur mundësi për një lloj të katërt të krijimit, e ky do të ishte krijimi i qenies njerëzore pa ndikimin fizik të ndonjë babai të llojit njerëzor. Këtë mundësi sigurisht e ka shndërruar në realitet vetë Zoti me krijimin e Isait; ndoshta me qëllim që ta kompletojë llojin e katërt të krijimit të mundshëm dhe me qëllim që ta ilustrojë fuqinë e Krijuesit në çdo formë dhe trajtë të mundshme. Lindja e Isait nga Merjemja e devotshme ishte një vepër mrekulluese, një akt nga vetë vullneti i Zotit. Zgjedhja e këtij lloji të krijimit mund të çmohet si e urtë dhe mjaft interesante. Si duket, mjekësia ka qenë mjaft e popullarizuar në

njërën apo në mënyrën tjetër, në një rajon apo edhe në ndonjë tjetër. Bashkëkohasit e Isait devijuan mjaft nga rruga e Zotit dhe po ashtu ishin kokëfortë. Atëherë Zoti ua tregoi fuqinë e vet në një formë të re të krijimit. Ai u tregoi se fuqia e Tij është e pakufishme dhe se shpëtimi i tyre mund të vijë me një nënshtrim ndaj Tij dhe besim në Të. Ilustrimi u prezentua në manifestimin e gjallë të krijimit të Isait. Kjo ndoshta ishte një parapërgatitje e çudive që Isai më vonë do t'i kryente me ndihmën e Zotit, çudi, të cilat, më tepër apo më pak ishin të natyrës mjekësore.

Duhet të theksojmë se ky interpretim hipotetik i lindjes së Isait nuk është i bazuar as në Kur'anin e as në Sunnetin e Muhammedit a.s. Këto katër forma, që logjikisht janë të mundshme dhe ajo se lindja e Isait e përbën të katërtën - finalen, janë pikëpamjet e autorit dhe hipotezat e tij personale. Kjo pikëpamje personale nuk ka kurrfarë ndikimi nga çiltërisa e Kur'anit apo nga hadithet e Muhammedit a.s. Pavarësisht nga ajo se a është kjo hipotezë e vlefshme, ajo nuk ndikon në besimin e muslimanit në Kur'anin e Shenjtë dhe në thënien e tij se lindja e Isait është vullnet mrekullues dhe vepër e Zotit. Sidoqoftë, vlen më hollësisht të flitet rreth këtij problemi.

Nëse dikush dëshiron ta quajë Isain djalë të Zotit apo Zot, për arsye se ai u krijua pa paraprirjen e babait njerëzor, dhe nëse kjo është e vërtetë, e njëjta edhe më tepër do të duhej të vlejë edhe për Ademin, i cili nuk kishte as nënë e as baba. Nëse çështja e atërisë së Zotit interpretohet në një kuptim figurativ, atëherë kjo duhet t'i parashtrohet edhe

mbarë njerëzimit, posaçërisht atyre që u dalluan në shërbimin ndaj Zotit Suprem! Qeniet njerëzore janë krijim i shkëlqyer i Zotit dhe në njëfarë kuptimi, fëmijët e Tij. Pavarësisht nga ajo se a interpretohet atëria e Zotit fjalë për fjale apo figurativisht, do të ishte shumë vetjake që kjo t'i mvishet vetëm Isait, e të mos merret parasysh Ademi në interpretimin e parë, dhe mbarë njerëzimi në të dytin. Kur'ani e shpall lindjen e Isait në këtë mënyrë:

“E, përmendju në këtë libër (tregimin për) Merjemen kur ajo u largua prej familjes së saj në një vend në Lindje. Ajo vuri një perde ndaj tyre, e Ne ia dërguam asaj Xhibrilin, e ai iu paraqit asaj njeri në tërësi. Ajo tha: ‘Unë i mbështetem të Gjithëmëshirshmit prej teje, nëse je që i frikësohesh Atij (pra më lë të lirë)!’ Ai (Xhibrili) tha: ‘Unë jam vetëm i dërguar (melek) i Zotit tënd për të dhuruar ty një djalë të pastër (pejgamber)’. Ajo tha: ‘Si do të kem unë djalë kur mua nuk më është afruar njeri (nuk jam e martuar), e as nuk kam qenë e pamoralshme’. Ai (Xhibrili) tha: ‘Ja, kështu ka thënë Zoti yt; ajo për Mua është lehtë, e për ta bërë atë (djalin e krijuar pa baba) argument për njerëzit e edhe mëshirë nga ana e Jonë. Kjo është çështje e kryer!’ Ajo e barti atë (Isain), andaj (me të në bark) u izolua në një vend të largët. E dhembja (e lindjes) e mbështeti atë te një trup i hurmës. Ajo tha: ‘Ah sa mirë ka qenë për mua të kisha vdekur para kësaj e të isha e harruar që moti!’ E prej së poshtmi atë e thirri (Xhibrili): ‘Mos u brengos, Zoti yt bëri pranë teje një përrockë (uji)’ E ti shkunde trupin e hurmës se do të bien ty hurma të freskëta. Ti pra ha dhe qetë-

sohu, dhe nëse sheh ndonjë prej njerëzve thuaj: 'Unë kam vendosur heshtje për hir të Gjithëmëshirshmit, andaj asnjë njeriu sot nuk i flas!' Dhe duke e bartur në gjirin e saj shkoi me të te të afërmit e vet, e ata i thanë: 'Oj Merjeme, ke bërë një punë shumë të keqe!' Oj motra e Harunit, babai yt nuk ishte njeri i prishur e as nëna jote nuk ka qenë e pamoralshme! Atëherë ajo u dha shenjë kah ai (Isai). Ata thanë: 'Si t'i flasim atij që është foshnjë në djep?' Ai (Isai) tha: 'Unë jam rob i All-llahut, mua më ka dhënë (ka caktuar të më japë) librin dhe më ka bërë pejgamber. Më ka bërë dobiprurës kudo që të jem dhe më ka porositur me namaz (falje) e zeqat për sa të jem gjallë! Më ka bërë të mirësjellshëm ndaj nënës sime, e nuk më ka bërë kryelartë e as të padëgjueshëm! Selami (shpëtimi prej All-llahut) është me mua ditën kur u lindi, ditën kur të vdes dhe ditën kur të dal (prej varrit) i gjallë!' Kjo është (fjalë) e vërtetë rreth Isait, birit të Merjemes në të cilin ata shkaktojnë dyshime. Nuk i takoi (nuk ka nevojë) All-llahu të ketë ndonjë fëmijë, i pastër është Ai, kur dëshiron një send Ai vetëm i thotë atij: 'Bëhu!', ai menjëherë bëhet. (Isai i tha popullit të vet) Dhe se All-llahu është Zoti im dhe Zoti juaj, pra adhuronie Atë, kjo është rrugë (fe) e drejtë." (Kur'ani, 19:16-36; krahaso edhe 3:42-64; 4:171-172; 5:17, 72-75; 25:2; 43:57-65).

Misioni të cilin Zoti ia besoi Isait nuk ishte shpëtim nëpërmjet sakrificës së gjakut, por shpëtim me anë të virtytit, udhëzimit të drejtë dhe vetëdisiplinës, me anë të shpejtimit të funksionimit të mendjeve të prapambetura dhe zbutjes së shpirtit të fortë.

Kjo u bë me qëllim të vendosjes së religjionit të vërtetë të Zotit dhe përtëritjes së shpalljeve të Tij, që kanë qenë të lëna pas dore dhe të keqtrajuara. Kur Isai iu drejtua këtyre mendjeve të prapambetura dhe shpitrave të ashpër, ai jo vetëm që e predikoi fjalën e Zotit, por po ashtu solli disa shenja konkrete dhe shfaqti disa “çudi” për ta përkrahur misionin e tij. Zoti e furnizoi Isain me argumente logjike, shpirtërore dhe “mbinatyrore”, me qëllim që t’ua tregonte këtyre njerëzve zemërgurë rrugën e vërtetë e të drejtë të Zotit. Sa i përket misionit të Isait dhe natyrës “mrekulluese” të dëshmive të tij, Kur’ani thotë:

“Përkujto kur engjëjt i thanë: ‘Oj Merjeme, All-llahu të përgëzon me fjalën e vet (me lindjen e një fëmije si rezultat i fjalës së Zotit). E që duke qenë në djep (foshnjë) u flet njerëzve, e edhe si i rritur e që është nga të përsosurit’. Ajo tha: ‘Zoti im, si mund të kem unë djalë e mua s’më ka prekur njeri (nuk jam e martuar)?’. Ai (All-llahu) tha: ‘Ja, kështu, All-llahu krijon çka të dojë. Kur Ai vendos për një çështje vetëm i thotë: Bëhu! Ajo menjëherë bëhet’. Ai (All-llahu) ia mëson atij librin (besimin), urtësinë, Teuratin dhe Inxhilin. Dhe, të dërguar te Bijtë e Israilit: unë kam ardhur nga Zoti juaj me argument, unë nga balta ju bëj diç si shpendi, i fryej atij dhe ai me lejen e All-llahut bëhet shpend, unë i shëroj të verbërit, leprozët dhe unë me lejen e All-llahut i ngjall të vdekurit: unë ju tregoj për atë që e hani dhe për atë që e depononi në shtëpitë tuaja. Vërtet, ky është fakt për ju nëse jeni besimtarë. Dhe (kam ardhur) që t’ua vërtetoj Teuratin që e keni para duarsh, t’ua lejoj disa që u ishin ndaluar

juve, kam ardhur me argument nga Zoti juaj, pra kini frikë All-llahun dhe më dëgjoni mua. All-llahu është Zoti im dhe Zoti juaj. Adhuronie Atë; kjo është rrugë e drejtë!’” (Kur’ani, 3:45-51).

“All-llahu (atë ditë) i thotë: ‘O Isa, bir i Merjemes, përkujtoi të mirat e mia ndaj teje dhe ndaj nënës sate, kur të fuqizova me shpirtin e shenjtë (Xhibrilin), e ti u fole njerëzve (kur ishe) në djep dhe (kur ishe) i pjekur (si burrë), kur ta mësova ty librin e urtësinë, Teuratin e Inxhilin, kur me lejen Time formova nga balta si formë shpeze e i fryve asaj dhe me urdhrin Tim u bë shpezë, kur i shërove të verbërin dhe leprozin me dëshirën Time, kur me urdhrin Tim i nxore (të gjallë) të vdekurit, kur i zbrapa Beni Israilët prej teje (që deshën të të mbysin) atëherë kur u erdhe me argumente, e disa prej tyre që nuk besuan thanë: ‘Kjo (mrekullia e Isait) nuk është tjetër vetëm se magji e qartë!’ Dhe kur i frymëzova Havarijunët (i urdhërova): ‘Të më besoni Mua dhe Të Dërguarin Tim!’ Ata thanë: ‘Ne besuam, e ti dëshmo se ne jemi muslimanë’ Dhe (përkujto) kur Havarijunët thanë: ‘O Isa, bir i Merjemes, Zoti yt a mund të na zbresë një tryezë nga qielli?’ (Isai) Tha: ‘Kini frikë All-llahun nëse jeni besimtarë!’ (Ata) Thanë: ‘Ne dëshirojmë të hamë nga ajo dhe të na binden (edhe më shumë) zemrat tona dhe të vërtetojmë bindshëm se na e the të vërtetën e të bëhemi dëshmues të saj!’ Isai, biri i Merjemes, tha: ‘O All-llah, Zoti ynë, zbritna nga qielli një tryezë, të na jetë festë (gëzim) për ne dhe për ata (që vijnë) pas nesh, të jetë argument prej Teje, dhe dhurona se Ti je furnizuesi më i mirë!’ All-llahu tha: ‘Unë atë ua

zbres, e kush prej jush mohon pastaj, Unë atë e dënoj me një dënim që nuk e dënoj asnjë nga njerëzit' Dhe kur All-llahu tha: 'O Isa, bir i Merjemes, a ti njerëzve u the: 'Më besoni mua dhe nënën time dy zota pos All-llahut!?' (Isai) Tha: 'Larg asaj të mete je Ti (o Zoti im). Nuk më takon mua të them atë që s'është e vërtetë. Ta kisha thënë unë atë, Ti do ta dije. Ti e di çka ka në mua, e unë nuk di çka ka në Ty. Ti je më i dijsmi i të fshehtave!' Unë nuk u kam thënë tjetër atyre, pos asaj që Ti më urdhërove; ta adhuroni All-llahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj, dhe sa isha ndër ta, kam qenë përcjellës i tyre, e pasi që më more mua, Ti ishe roje (dhe dëshmues) i tyre. Ti je dëshmitar për çdo send.' (Kur'ani, 5:110-117).

Këto ajete vetëm i përforcojnë edhe shumë ajete të tjera të ngjashme me këto, që gjenden në gjithë Kur'anin në tërësi. Të gjitha këto e theksojnë faktin se Isai asnjëherë nuk ka thënë se është zot apo i biri i Zotit; dhe se ai ka qenë vetëm shërbëtor dhe peygamber i Zotit, siç ishin ata para tij. Kur'ani e thekson këtë fakt në mënyrën që vijon:

"Ne vazhduam gjurmët e tyre (të peygamberëve) me Isain, birin e Merjemes, vërtetues i Teuratit që kishin më parë. Atij i dhamë Inxhilin, që është udhëzim i drejtë dhe dritë, që është vërtetues i Teuratit që kishin pranë, që ishte udhëzues dhe këshillues për të devotshmit." (Kur'ani, 5:46).

"Bënë kufr (mohuan të vërtetën) ata që thanë: 'All-llah është ai, Mesihu, biri i Merjemes'. E vetë Mesihu, (Isai) tha: 'O Beni Israilë, adhurone All-llahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj, sepse ai që i përshkruan Zotit shok, All-llahu ia ka ndaluar (ia ka

bërë haram) atij xhennetin dhe vendi i tij është në zjarr. Për mizorët nuk ka ndihmës'. Gjithashtu bënë kufër ata që thanë: 'All-llahu është i treti i treve'. S'ka në Gjithësi tjetër pos një All-llahu, e nëse nuk pushojnë nga ajo që thanë (tre zotëra), do t'i kapë dënim i dhembshëm ata që nuk besuan prej tyre. E pse të mos pendohen dhe të kërkojnë te All-llahu falje, kur All-llahu dihet se falë shumë, është mëshirues? Mesihu, biri i Merjemes, nuk është tjetër vetëm se I Dërguar; para atij pati shumë Të Dërguar. Nëna e tij ishte e drejtë (e ndershme). Që të dy ata ishin që ushqeheshin (si njerëzit e tjerë). Ja si u sqarohen atyre argumentet dhe shih pastaj se si ia kthejnë shpinën të vërtetës!... Thuaju: 'O ithtarë të librit, mos e teproni në fenë tuaj jashtë të vërtetës dhe mos shkoni pas pasioneve të një populli të mëparshëm që ka humbur, që ka shkaktuar humbjen e shumë të tjerëve dhe që u largua në tërësi prej rrugës së drejtë'." (Kur'ani, 5:72-75, 77; krahaso 4:171-172).

Fillimi i Isait ka qenë kontradiktor. I tillë që edhe fundi i tij. Midis kësaj, ai ishte i qëndrueshëm në kryerjen e misionit të vet, i përforcuar nga libri i Zotit, urtësia, nga shenjat e pastra dhe nga Shpirti i Shenjtë. Megjithatë, të paktë ishin ata që e pranuan Isain me gjithë zemër. Edhe pse mjaft tolerant dhe paqësor, Isai nuk mund ta toleronte hipokrizinë e Bijve të izrailit dhe dashurinë e tyre ndaj fjalës së ligjit, në disfavor të frymës së saj. Ata e refuzuan Isain dhe përgatitën komplot për vdekjen e tij të llahtarshme. Ata e kishin traditë që të refuzojnë disa nga pejgamberët, e disa nga ata t'i vrisnin. Isai nuk

bënte përjashtim nga ky ligj. Ata desh e vranë atë në kryq. Në të vërtetë, ata besuan se e kanë kryqëzuar. Ky rrëfim u dramatizua deri në këtë pikë dhe zija religjioze u bë e shenjtë për të krishterët, ashtu siç u bë vajtimi për hebrenjtë.

Komploti që planifikuar për ta kryqëzuar Isain; u shfaq një ekzekutim në kryq - dikush me të vërtetë u kryqëzua. Por ky nuk ishte Isai, që dikush tjetër të cilin e kryqëzuan në vend të tij.

Sa i përket vetë Isait, Zoti erdhi kur ai që në rrezik dhe e shpëtoi nga armiqtë e tij. Zoti misionin e tij në tokë e kurorëzoi me shpëtimin e tij nga vdekja e llahtarshme dhe me ngritjen e tij lart në qiell. A ka qenë i ngritur me anë të mjeteve të shkëlqesisë, apo ka qenë i ngritur i gjallë me trup e shpirt, ose pas vdekjes së tij të natyrshme vetëm shpirti i tij, nuk ka shumë rëndësi në pikëpamjet islame. Kjo nuk është një pjesë e besimit, për arsye se për muslimanin është e rëndësishme dhe vendimtare vetëm ajo që e shpalli Zoti; e Zoti shpalli se Isai nuk u kryqëzua por u ngrit lart tek Ai. Kur'ani e shpjegon fundin e Isait me sa vijon:

“Ithtarët e librit (jehuditë) kërkojnë prej teje t’u sjellësh një libër (të plotë) nga qielli. Po ata patën kërkuar prej Musait edhe më tepër e i patën thënë: ‘Dëftona Zotin sheshas’ (ta shohim me sy) e për shkak të mizorisë së tyre i kapi rrufeja. Mandej edhe pasi që iu patën shfaqur atyre mrekulli të qarta, ata e adhuruan viçin. Ne ua patëm falur atë, e Musait i dhamë argumente të forta. Ne ngritëm mbi ta (bregun) Tur’in pse ishin zotuar (ta pranojnë Teuratin), e u patëm thënë: ‘Hyni në derë (të Bejtul

mukadesit) të përulur dhe u patëm thënë: 'Mos e thyeni të shtunën' (mos gjuani peshk). Ashtu Ne patëm marrë prej tyre besë të fortë. Dhe për shkak të thyerjes së besës së dhënë, mohimit të ajeteve (shpalljes) të All-llahut, mbytjes së pejgamberëve pa kurrfarë të drejte dhe thënies së tyre: 'Zemrat tona janë të mbuluara' (me perde). Jo, por për shkak të mohimit të tyre All-llahu ua vulosi ato (zemrat), e nuk besojnë prej tyre vetëm pakkush. Edhe për shkak të mosbesimit dhe thënies së tyre shpifëse kundër Merjemes; madje për shkak të thënies së tyre: 'Ne e kemi mbytur Mesihun, Isain, birin e Merjemes, Të Dërguarin e All-llahut'. Po ata as nuk e mbytën as nuk e gozhduan (nuk e kryqëzuan në gozhda), por atyre u përngjau. Ata që nuk u pajtuan (rreth mbytjes së) tij, janë në dilemë për të (për mbytje) e nuk kanë për të kurrfarë dije të saktë, përveç një iluzioni. E ata me siguri nuk e mbytën atë. Përkundrazi, All-llahu e ngriti atë pranë vetes, All-llahu është i plotfuqishëm, i dijshtëm.' (Kur'ani, 4:153-158; krahaso 3:52-59).

Feja islame e mohon doktrinën e kryqëzimit të Isait nga ana e armiqve të Zotit, e po ashtu i mohon edhe themelet e kësaj doktrine. Ky refuzim bazohet në autoritetin e vetë Zotit, ashtu siç thuhet edhe në Kur'an, dhe po ashtu bazohet në refuzim më të thellë të sakrificës së gjakut dhe në shlyerjen famullitare të mëkateve. Feja islame mëson se Mëkati i Parë i Ademit u fal, pasi ai vetë e shlyu atë me dënimin që e përjetoi; se çdo mëkatar, nëse nuk e fal Zoti, vetë do të jetë përgjegjës për mëkatet e veta; dhe se kurrkush nuk mund t'i shlyejë mëkatet e tjetërkujt. Me-

gjithatë, disa nga sektet më të hershme të krishtere, nuk besonin se Isain e kanë vrarë në kryq. Basilidianët besonin se në vend të tij kanë kryqëzuar tjetër njeri. Doketi thotë se Isai asnjëherë nuk ka pasur trup të vërtetë fizik apo natyror, por vetëm një trup të dukshëm dhe se kryqëzimi i tij ishte i dukshëm, e jo real. Ungjilli i Marsionitit (rreth 138 pas Krishtit) mohonte se Isai ndonjëherë ishte lindur dhe thoshte se ai thjeshtë është paraqitur në formë njerëzore. Ungjilli i Shën Barnabasë, përkthimi i të cilit në anglishte gjendet në Bibliotekën Shtetërore të Vjenës dhe një version arab i të cilit gjendet në botën arabe, e përkrah teorinë e zëvendësimit në kryq.

Sa i përket fundit të Isait, muslimani mendon në të njëjtën mënyrë siç mendon edhe për fillimin e tij. Muslimani beson se Isain as nuk e kanë vrarë e as nuk e kanë kryqëzuar, por vetë Zoti e ka ngritur lart me nder e mëshirë. Mendja e muslimanit është e pastër sa i përket gjithë kësaj çështjeje. Kur'ani i ka zgjidhur të gjitha mosmarrëveshjet për të, njëherë e përgjithmonë. Besimi se Isai qe kryqëzuar shpie në një numër pyetjesh të domosdoshme. Disa nga këto pyetje mund t'i japim edhe këtu:

1. A përshtatet kryqëzimi i Isait (i pranuar nga kishat krishtere) me drejtësinë, mëshirën, fuqinë dhe urtësinë e Zotit?

2. A është e drejtë për anën e Zotit, apo për çdokë lidhur me atë çështje, ta detyrosh dikë të pendohet për mëkatet apo të këqijat e të tjerëve, mëkate për të cilat ai që pendohet nuk di gjë?

3. A përputhet me mëshirën dhe urtësinë e Zotit besimi se Isain e patën poshtëruar dhe vrarë në atë mënyrë siç flitet?

4. A është plotësimi i premtimit të Zotit (t'i mbrojtë shokët dhe të dashurit e Tij) se Isai u bë aq i vetmuar saqë armiqtë e Zotit e kishin shumë lehtë për ta kapur? A duhet kjo të merret si plotësim i obligimeve të dikujt apo si parapërgatitje për nderimin e fjalëve të dikujt?

5. A është e arsyeshme dhe në rregull të besohet se Zoti, falësi më i madh, nuk ishte i aftë t'ia falë Ademit dhe fëmijëve të tij Mëkatin e Parë dhe se Ai i mbajti në dyshim dhe në gjendje të paraçmendurisë derisa Isai ka ardhur ta bëjë shpagimin me gjakun e tij personal?

6. A paraqitet në ndonjë fe tjetër kryqëzimi dhe sakrificimi i gjakut, përveç te besimet pagane të grekëve, romakëve, indianëve dhe persianëve të hershëm, etj. ?

7. A ekziston ndonjë figurë tjetër, që mund të barazohet me Isain në historinë njerëzore, përveç figurave fiktive të Bakusit, Apollos, Adonisit, Horusit dhe zotave të tjerë të virgjër?

8. A nuk paraqet një pikëpamje të re krahasimi i fjalëve, që i përshkruhen Isait me ato të Bakusit, i cili ka thënë se ai qe alfa dhe omega e botës dhe se pat ardhur ta shërojë njerëzimin me gjakun e vet? A mundet ngjashmëria e këtyre fjalëve, me ato që i përshkruhen Isait në vitet e mëvonshme, të stimulojë një vullnet të ri për hulumtimin e së vërtetës për gjithë çështjen në përgjithësi?

9. Çka patën autoritetet romake kundër Isait? Ai nuk i kanosej kontrollit të tyre. Në të vërtetë, ai u bëri shumë të mira personaliteteve të tyre udhëheqëse. Ai i mësoi ithtarët e tij t'ia lënë Qesarit atë që i takon atij dhe t'ia lënë Zotit atë që i takon vetëm Zotit. Ai ishte një predikues paqësor dhe u dha ndihmë të madhe autoriteteve romake për ta mbrojtur ligjin dhe rendin në tokë. Pse atëherë do ta kishin kryqëzuar atë dhe ta humbin një qytetar të tillë të drejtë e të sjellshëm?

10. Sa dihet për karakterin e udhëheqësit romak, Pilatin? A i kishte ai marrëdhëniet në rregull me hebrenjtë bashkëkohas, të cilët iu drejtuan Romës kundër tij? A nuk e shprehnin sjelljet dhe sundimi i tij në Judejë urrejtjen ndaj tyre? A nuk merrte edhe ryshfet? Për çfarë arsye atëherë duhej të veproje sipas vullnetit të tyre dhe të vendosë rend në mesin e tyre? Pse të mos e pranonte ryshfetin e një adhuruesi të pasur të Isait, siç ishte Jozefi nga Armathea? Ky Jozef, sipas Lukës, qe shumë i pasur dhe shumë i interesuar për Isain; e përveç kësaj, ishte një këshilltar që nuk i dha pajtim Këshillit për mendimin lidhur me kryqëzimin e Isait. A nuk mund të përpiqej së paku në fund, me anë të ryshfetit ndaj udhëheqësit të korrumpuar, ta shpëtojë Isain nga kryqëzimi pasi nuk e bëri këtë në zyrën e Këshillit?

11. Sa dishepuj ishin dëshmitarë të kryqëzimit të Isait dhe çfarë ishin reagimet e tyre? A mund të jetë e vërtetë ajo që e thotë Mateu (26:56), se të gjithë dishepujt e braktisën atë dhe ikën? A është ky kriter i integritetit dhe karakterit të dishepujve të mëdhenj nga një mësues i madh? Vetëm për Gjonin e

dashur thuhet se ka qenë i pranishëm në atë skenë. Por, sa zgjati kjo prani dhe sa kohë i duhej njeriut të dënuar me vdekje të vdesë në kryq ato ditë? Sipas disa burimeve të mirëfillta (shih artikullin për Kryqin, "The Chambers' Encyclopedia", 1950), zgjatja kohore për vdekjen e të dënuarit qe dy-tri ditë. Por, pse në rastin e Isait kjo zgjati dy-tri orë, e jo dy-tri ditë? Dhe pse "vdiq" në kryq përderisa dy shokët e tij të tjerë shpëtuan? Çka ndodhi me errësirën që e kaploi gjithë Tokën për tri orë gjatë periudhës së kryqëzimit? (Matheu, 27:45; Marku, 15:33; Luka, 23:44). A mund të ketë ndodhur zëvendësimi gjatë kësaj periudhe të errësirës?

12. Sa ishin të njoftuar me Isain ushtarët romakë që erdhën ta çojnë atë te kryqi? Sa ishin të sigurt se ky qe njeriu i vërtetë që duhej të kryqëzohet? A kishin ndonjë interes të posaçëm për ta identifikuar Isain në kohën e festimeve publike dhe në kohën kur ishte e pranishme frika nga trazirat publike?

13. A mund të paramendojë një besimtar se Isai (i cili ishte njëri ndër pesë të dërguarit më të determinuar e më të qëndrueshëm të Zotit), do t'i kishte folur Zotit, ashtu siç thuhet se i ka folur, me ton fajësimi apo shqetësimi? A është në rregull për një peygamber të dalluar, siç është Isai, t'i thotë Zotit në kohën e sprovës se Zoti e ka braktisur atë? A duhet kjo të merret si një model apo parapërgatitje për t'iu drejtuar Zotit apo si një reagim ndaj përvojave sprovuese?

14. A ishte Zoti, i gjithëmëshirshmi, falësi më i madh dhe më i larti, i paaftë t'ua falë mëkatet njerëzve përveç përmes një kryqëzimi kaq të tmerrshëm

dhe poshtëruet të atij, i cili jo vetëm që ishte i pafajshëm, por që i qe dedikuar shërbimit dhe kauzës së Tij në një mënyrë më se të sinqertë? A është e gjithë kjo aplikim i mëshirës dhe faljes së Zotit dhe reflektim i drejtësisë dhe dashurisë së Tij?

Një studim i rrethanave të kësaj kohe, i sjelljes së autoriteteve botërore, i reagimeve publike, i konceptit të Zotit, i statusit të njeriut, i qëllimit të religjionit dhe jetës - një studim i të gjitha këtyre do të mund të provokonte mendime interesante, të ngjashme me ato që i përmenda unë. Derisa të gjendet një shpjegim i mjaftueshëm i pyetjeve të tilla, besimtarët nuk mund të jenë të qetë dhe nuk mund të gëzojnë një paqe të vërtetë në mendjet e tyre. Sipas kësaj, do të ishte e këshillueshme që të interesuarit për të bërë studime dhe hulumtime të përqëndrohen pak më tepër në këtë drejtim.

Megjithatë, sa u përket muslimanëve, pyetjet e tilla nuk parashtrohen asnjëherë; dhe konfuzionet e këtilla janë irelevante, për arsye se feja islame në mënyrë decidive thotë se Isai as nuk u kryqëzua e as nuk u vra, por u ndërrua dhe iu dërgua Zotit. Në letërsinë krishtere thuhet se Isai është paraqitur pas kryqëzimit; disa dishepuj janë dëshmitarë për këtë. Paraqitja e tij është më se e mundur dhe kjo nuk bie në konflikt me pikëpamjet islame. Po të ishte e vërtetë se ai është paraqitur, atëherë muslimani do të kishte besuar se kjo paraqitje e tij nuk ka ndodhur pas vdekjes në kryq, por pas strehimit, të cilin ai e pat marrë me urdhrin e Zotit - si një hap të planit të Zotit për ta shpëtuar dhe për të luftuar kundër kompleteve të armiqve të tij. Në vend të kryqëzimit dhe

poshtërimin, siç kishin planifikuar armiqtë e tij, ia lartësuan pozitën dhe e nderuan edhe më tepër, ashtu siç e pat planifikuar vetë Zoti.

Madhështia e Isait dhe dallimi e njohja e rolit të tij sipas muslimanëve, nuk rrjedh nga besimi i krishterë se ai qe kryqëzuar për arsye të mësimave të tij dhe për t'i shpague mëkatet njerëzore. Po të ishte valid ky besim i popullarizuar, atëherë do të duhej të themi se sakrifica e Isait për shpëtim ka qenë e kotë, për arsye se në atë mënyrë mëkati nuk do të eliminohet. Madje edhe mund të themi se ekzistojnë me mijëra heronj të mëdhenj si Isai; të cilët vdiqën në promovimin e kauzave (qëllimeve) të tyre, qofshin ato të vlefshme apo jo. Këta mund t'i gjejmë çdokund, në mesin e gjermanëve, aleatëve, komunistëve, në mesin e zyrtarëve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në mesin e luftëtarëve fetarë, të atyre që luftojnë për liri, etj. Sipas kësaj, nëse kjo vdekje e llahtarshme do t'i hyjësonte të vdekurit, atëherë njërezimi do të kishte zotëra dhe hyjësi të shumta dhe do të ishte arbitrare që një hyjësi e tillë t'i përshkruhet vetëm Isait, duke mos i përfillur heronjtë e shumtë të tjerë të cilët vdiqën në situata të ngjashme.

Muslimani nuk ballafaqohet me një paradoks të tillë. Ai beson se madhështia e Isait vijon nga fakti se atë e ka zgjedhur Zoti dhe e ka mësuar se si ta japë porosinë e Tij, e ka mësuar se si të jetë peygamber me karakter dhe personalitet të fortë, që të jetë i sinqertë edhe nga natyra e jashtme dhe nga ajo e brendshme, që të luftojë kundër hipokrizisë dhe falsifikimit, që të dallohet qysh prej fillimit në kohën e lindjes së tij dhe më në fund në kohën e ngritjes së

tij; dhe e mësoi të jetë shenjë për njerëzit dhe mëshirë nga Zoti. Paqja qoftë mbi të dhe mbi të gjithë peygamberët e tjerë!

Natyra e këtij diskutimi nuk na lejon t'i analizojmë më hollësisht thëniet kur'anore lidhur me Isain dhe misionin e tij. Ajo që e dhamë këtu është vetëm një pjesë elementare. Për studim dhe hulumtim më të hollësishëm, lexuesi mund t'i drejtohet vetë Kur'anit. Me qëllim që t'ia lehtësojmë punën, këtu do t'i shënojmë shkurtimisht kaptinat (suret) dhe ajetet relevante kur'anore:

<i>Kaptina</i>	<i>Ajeti</i>
2	87, 136, 253
3	42-59, 84
4	156-159, 171-172
5	17, 46, 72, 75, 78, 110-118
6	85
9	30-31
19	1-40
23	50
33	7
42	13
43	57-65
57	27
61	6, 14

3. Poligamia (martesa me më shumë se një bashkëshorte)

Nëse diskutojmë më drejtë, fjala poligami nënkupton shumësinë e bashkëshortëve apo të bashkëshorteve. Më specifikisht, nëse një burrë ka më tepër se një grua në të njëjtën kohë, atëherë për këtë përdoret termi poligjini. Pasi lexuesi mesatar nuk bën ndonjë dallim të madh ndërmjet termave poligami dhe poligjini, do t'i përdorim të dy në mënyrë të ndryshueshme. Kur e përmendëm poligaminë në këtë kontekst, ajo e ka domethënien e poligjinisë në kuptimin adekuat të termit. Në anën tjetër, nëse një grua ka më tepër se një burrë, atëherë kemi të bëjmë me poliandri. Nëse bëhet fjala për një përzierje të shumë burrave dhe grave, atëherë kjo quhet grup ose martesë grupore.

Tre llojet themelore të martesës shumëbashkëshortore i kanë praktikuar pak a shumë shoqëri të ndryshme në kohë të ndryshme dhe në rrethana të ndryshme. Modeli më i zakonshëm është poligamia (martesa me më shumë bashkëshorte), edhe pse është ende e kufizuar vetëm në një pakicë të vogël të një popullate të dhënë, për arsye të shkaqeve të ndryshme. Ky është i vetmi model të cilin e lejon feja islame. Dy të tjerët, feja islame absolutisht i ka ndaluar.

Megjithatë, nuk është e vërtetë se Judaizmi dhe Krishterimi çdoherë kanë qenë monogamikë, apo se në mënyrë kategorike i janë kundërvënë poligamisë. Ky është fakt që mund të vërtetohet edhe sot. Disa shkencëtarë të dalluar hebrenj (si p.sh., Goitein, f.

184-185), na kanë informuar se emigrantët poligamikë hebrenj, autoriteteve izraelite u shkaktojnë vështirësi, por edhe i turpërojnë. Pozita e predikuesve të krishterë është e njohur mirë. E njëjtë është edhe pikëpamja e priftërinjve afro-aziatikë, të cilët janë për poligjini në vend të pabesimit, kurvërisë (zinasë) dhe tradhtisë bashkëshortore. Vetëm në Shtetet e Bashkuara, numri i atyre që i ndërrojnë partnerët është me qindra mijë.

Do të ishte mjaft interesante të hulumtohet korelacioni ndërmjet monogamisë rreptësisht formale dhe shpeshtësisë së prostitucionit, homoseksualitetit, jolegjitimitetit, jobesnikërisë dhe lirisë së përgjithshme seksuale. Dokumentet historike të civilizimeve greko-romake dhe hebraiko-krishtere na zbulojnë më tepër fakte në këtë drejtim, se sa çfarëdo historie sociologjike familjare.²⁶

Po të kthehemi në rastin e fesë islame do të shohim se në botën perëndimore ka shumë njerëz, të cilët mendojnë se muslimani është një njeri i cili posedon shumë epshe fizike, kështu që është i lirë të ketë edhe shumë gra legjitime dhe jolegjitime, pa kurrfarë kufizimesh. Shumë njerëz të tjerë në mes tyre habiten kur shohin se muslimani është i martuar

²⁶ S. D. Goitein, *Jews and Arabs: Their Contacts Through Ages* (Hebrenjtë dhe arabët: Kontaktet e tyre ndër shekuj) - New York: Schocken Books, 1964; L. T. Hobhouse, *Morals in Evolution: a Study of Comparative Ethics* (Morali në Evolucion: Një studim i Etikës Krahasimtare) - London: Chapman and Hall, 1951; E. A. Westermarck, *A Short History of Marriage* (Historia e shkurtër e martesës) - New York: The Macmillan Co., 1926.

vetëm me një grua apo ka mbetur i pamartuar. Ata mendojnë se muslimani ka liri të plotë për të ndërruar gra dhe se kjo është e lehtë si të kaluarit prej një apartamenti në një tjetër, apo madje edhe si ndërrimi i rrobave. Kjo pikëpamje keqësohet pjesërisht me disa filma dhe me disa tregime të lira, e pjesërisht me sjelljen pa kurrfarë përgjegjësie të disa individëve muslimanë. Rezultati që me domosdoshmëri rrodhi nga kjo situatë, ishte se barrierat stacionuese i penguan me miliona njerëz t'i shohin dritat e shkëlqyera të fesë islame dhe filozofinë e saj shoqërore. Për shkak të njerëzve të tillë, do të përpiqemi të lëshohemi më thellë rreth kësaj çështjeje nga pikëpamja e fesë islame, pas së cilës gjithkush do të jetë i lirë t'i nxjerrë përfundimet e veta.

Poligamia si e tillë ka qenë mjaft e praktikuar në mbarë historinë njerëzore. Atë e praktikuan edhe pejgamberët si Ibrahim, Jakupi, Davudi, Sulejmani, etj.; mbretërit dhe pushtuesit; njerëzit e zakonshëm nga Lindja e Perëndimi, si në kohët e vjetra ashtu edhe në këto moderne. Madje edhe në ditët e sotme, këtë e praktikojnë muslimanët dhe jomuslimanët e Lindjes dhe të Perëndimit në forma të ndryshme, disa prej të cilave janë jolegale dhe hipokrite, disa sekrete, kurse disa të tjera publike. Nuk nevojiten hulumtime të shumta për të zbuluar se ku dhe si një numër i madh i njerëzve të martuar kanë dashnore private, ose mbajnë të dashura rezerve, apo i vizitojnë shpesh dashnoret e tyre, apo thjeshtë shkojnë me gra të huaja, të mbrojtur nga ligji. Pavarësisht nga ajo se a ju pëlqen kjo moralistëve apo jo, mbetet fakt i gjallë se poligamia praktikohet mjaft dhe se mund

të shihet dhe gjendet në të gjitha periudhat e historisë njerëzore. Gjatë kohës së shpalljeve biblike, poligamia u pranua dhe u zbatua në përgjithësi. Atë e pranuan në pikëpamje religjioze, sociale dhe morale, pa kurrfarë vërejtjeje. Ndoshta kjo është edhe arsyeja pse vetë Bibla nuk merret me këtë çështje - pra, për arsye se kjo në atë kohë ishte gjë e zakonshme. Bibla këtë as nuk e ndalon, nuk e rregullon, e madje as nuk e kufizon. Disa njerëz tregimin e dhjetë virgjërave të Biblës, e kanë interpretuar si një sanksion (vendim) për të pasur dhjetë gra në të njëjtën kohë. Tregimet e pejgamberëve biblikë, të mbretërve dhe të patriarkëve lidhur me këtë, janë të pabesueshme.

Kur Muhammedi a.s., e riprezentoi fenë islame, poligamia ishte e zakonshme dhe i kishte lëshuar rrënjët shumë thellë në jetën shoqërore. Kur'ani as nuk e injoroi këtë e as nuk e refuzoi, por as nuk e la të vazhdojë e pakontrolluar apo e pareduktuar. Kur'ani nuk mund të qëndronte indiferent rreth kësaj çështjeje e as nuk mund ta toleronte kaosin që mund të shkaktohej nga poligamia. Ashtu siç bëri edhe me traditat tjera sociale dhe me zbatimet që ishin në fuqi, Kur'ani filloi ta organizojë dhe ta pastrojë institucionin, në mënyrë që t'i çrrënjosë traditat e tij të këqija dhe t'i sigurojë përfitimet dhe anët pozitive. Kur'ani këtu intervenoi për arsye se e gjithë kjo duhej të jetë një situatë reale dhe nuk do të duhej të lejojë një kaos në strukturën familjare, e cila është njëra ndër shtyllat kryesore të shoqërisë. Intervenimi privilegjues dhe shërues i Kur'anit na njoftoi me këto rregulla:

1. Martesa me më shumë bashkëshorte është e lejueshme në disa kushte dhe në rrethana të caktuara. Ky është një lejim i kushtëzuar, e jo një pjesë e besimit apo një çështje e domosdoshmërisë.

2. Ky lejim është i vlefshëm me maksimum prej katër grash. Para fesë islame nuk ka ekzistuar kurrfarë kufizimi apo siguri e çfarëdo lloji.

3. Nëse merret gruaja e dytë apo e tretë, edhe ajo i gëzon të gjitha të drejtat dhe privilegjet që i gëzon edhe gruaja e parë. Ajo (e dyta apo e treta) është plotësisht e autorizuar për gjithçka që është e autorizuar edhe e para. Parakusht i poligamisë dhe kusht që duhet ta plotësojë çdokush që ka më tepër se një grua, është barazia në trajtimin e grave dhe përzemërsia me to. Kjo barazi varet nga vetëdija e brendshme e individit që ka të bëjë me të.

4. Ky lejim është një përjashtim ndaj vazhdës së zakonshme. Ai është kthimi i fundit për t'i zgjidhur disa probleme sociale dhe morale dhe për të mos pasur punë me vështirësi më të mëdha. Me një fjalë, kjo është një masë e jashtëzakonshme dhe si e tillë duhet të përkufizohet në atë kuptim.

Pjesa e Kur'anit lidhur me këtë çështje thotë:

“Në qoftë se frikoheni se nuk do të jeni të drejtë ndaj bonjakeve, atëherë martohuni me ato gra që ju pëlqejnë: me dy, tri e me katër. E nëse i frikoheni padrejtësisë (ndaj tyre), atëherë vetëm me një, ose (martohuni) me ato që i keni nën pushtetin tuaj (robëreshat). Ky (përkufizim) është më afër që të mos gaboni.” (Kur'ani, 4:3).

Ky fragment u shpall pas Betejës së Uhudit, ku u vranë shumë muslimanë e që lanë mjaft gra të veja

dhe fëmijë, për të cilët duhej të kujdeseshin muslimanët që kishin mbetur gjallë. Martesa ishte njëra ndër mënyrat e mbrojtjes së këtyre grave të veja dhe të këtyre fëmijëve jetima. Kur'ani ua tërhoqi vëmendjen në këtë mënyrë dhe ofroi këtë zgjidhje për t'i mbrojtur të drejtat e jetimave dhe për t'i mbrojtur rojtarët nga dëmtimi i të varurve të tyre.

Feja islame martesën me më shumë bashkëshorte nuk e la pas dore, për arsye se po të kishte vepruar ashtu, ajo do të kishte mbetur vetëm si teori kështu që njerëzit do ta mohonin zbatimin e saj, ashtu siç bëhet sot në mesin e shumë njerëzve të tjerë, ku ligjet dhe standardet e të cilëve nuk e lejojnë poligaminë. Feja islame erdhi që të rforcohet, të jetohet, të praktikohet; e jo të qëndrojë në dyshim dhe të konsiderohet vetëm si një teori e thatë. Ajo është realiste dhe nga pikëpamja e saj ndaj jetës është shumë praktike. Pikërisht kjo është njëra ndër arsyet pse ajo lejon një poligami të kushtëzuar dhe të kufizuar, për arsye se po të ishte në interes të të gjithë njerëzimit që institucioni i këtillë të mos ekzistonte, atëherë Zoti sigurisht do ta urdhëronte ndalimin e tij. Por, kush mund të dijë më mirë se Ai?

Ekzistojnë shkaqe të shumta pse feja islame e lejon poligaminë. Nuk duhet shkaqet e tilla t'i paramendojmë apo të japim hipoteza. Ato janë të vërteta dhe mund të shihen çdokund, çdo ditë. Le t'i hulumtojmë disa nga këto shkaqe:

1. Në disa shoqëri gratë e tejkalojnë numrin e burrave; kjo posaçërisht është e saktë në rajonet industriale dhe komerciale; e po ashtu edhe për shtetet pjesëmarrëse në luftëra. Po të jetë shoqëria mus-

limane në këtë kategori dhe po ta ndalonte feja islame poligaminë dhe ta kufizonte martesën vetëm me një bashkëshorte, çka do të bënin të pamartuarat? Ku dhe si do ta gjenin partnerin e dëshiruar? Ku dhe si do të gjenin simpatinë, kuptimin, përkrahjen dhe mbrojtjen? Pasojat e këtij problemi nuk janë vetëm fizike, por ato janë edhe morale, sentimentale, emocionale dhe natyrore. Çdo grua normale - pavarësisht se a është afariste, a punon në shërbim të jashtëm apo në ndonjë zyrë informative - digjet nga malli për shtëpinë dhe për familje të veten. Ajo ka nevojë për dikë të cilin do ta dojë, që do të kujdeset për të. Ajo dëshiron që kjo të realizohet si në mënyrë sociale ashtu edhe në mënyrë familjare. Madje edhe nëse këtë e shikojmë vetëm nga aspekti fizik, pasojat janë mjaft serioze dhe nuk mund t'i injorojmë ato; përndryshe, komplekset psikologjike, sulmet nervore, urrejtja sociale dhe jostabiliteti mental, do të ishin aq legjitime, saqë do të na tregonin se problemi ende nuk është zgjidhur. Evidencat klinike për këtë janë alarmante.

Këto dëshira natyrore dhe aspirata sentimentale duhet të realizohen. Këto nevoja për t'i takuar dikujt, për t'u kujdesur për dikë dhe nga dikush, duhet të kënaqen në këtë apo në mënyrë tjetër. Gratë në një situatë të këtillë zakonisht nuk e transformojnë natyrën e tyre apo nuk jetojnë një jetë të ngjashme me engjëjt. Ato besojnë se kanë çdo të drejtë t'i gëzohen jetës dhe ta mbajnë për vete pjesën e tyre. Nëse këtë nuk mund ta arrijnë në një mënyrë ligjore ose normale, ato çdoherë gjejnë kanale të tjera, edhe pse këto janë të rrezikshme dhe të përkohshme. Janë

të pakta gratë që mund të jetojnë pa shoqërinë e përhershme dhe permanente të burrit. Shumica dërrmuese e grave të pamartuara në një shoqëri, i gjejnë mënyrat e veta për t'u takuar me burrat. Ato marrin pjesë në ahengje të ndryshme, në organizimin e koktejeve gazmore, marrin pjesë në kontratat afariste, udhëtojnë në drejtime të ndryshme, etj. Rezultati i kësaj gjuajtjeje dëshpëruese nuk është çdoherë në rregull apo moralisht i shëndoshë. Ndonjë burrë i martuar mund t'i drejtohet ndonjë gruaje, dhe ajo do të kishte dashur ta përfitojë legalisht ose në ndonjë mënyrë tjetër. Po ashtu, ndonjë grua mund ta tërheqë ndonjë burrë, i cili mund të jetë i demoralizuar apo i deprimuar për çfarëdo lloj shkak. Një burrë i tillë do të tentojë të ketë marrëdhënie intime me të, haptaz apo fshehtas, në një mënyrë normale apo ndryshe, në një formë legale ose vetëm sipas ligjit të zakonshëm. Kjo sigurisht do të ketë efekte të dëmshme në jetën familjare të njeriut të martuar dhe do të jetë shkatërruese për moralin e tij dhe moralin e shoqërisë. Gratë do të ishin të lëna pas dore dhe të injoruar, fëmijët do të liheshin anash, shtëpitë do të prisheshin, etj.

Gruaja që takon një shok të gjinisë së kundërt, në rrethana të tilla, nuk ka sigurim, as dinjitet, apo çfarëdo lloj të drejtash. Shoku i saj apo dashnori i saj potencial mund të jetë me të, mund ta mbajë atë dhe t'i japë dhurata dhe mund t'ia shprehë të gjitha ndjenjat e një romantizmi të pasionuar. Por çfarë sigurimi ka ajo për këtë? Si mund ta ndalojë ajo mashkullin që mos të ikë e ta braktisë atë, në kohën kur prania e tij i është më se e nevojshme dhe më se

e dëshirueshme? Çka do ta pengojë atë që ta ndërprejë këtë dashuri sekrete? Vetëdija? Ligji? Asgjë nuk mund të ndihmojë; kur e filluan këtë lloj të intimitetit, moralit i dhanë një grusht vdekjeprurës; kur e kthyen këtë marrëdhënie kundër rregullativave të Zotit dhe njeriut, ata e paralizuan vetëdijen. Ligji i shoqërisë nuk njeh ndonjë intimitet tjetër përveç atij me gruan personale. Sipas kësaj, mashkulli mund të kënaqet me këtë shoqëri të lehtë sado që të dojë dhe kur të ftohet, mund të shkojë të takojë ndonjë grua tjetër e ta përsërisë tragjedinë e njëjtë pa përgjegjësi apo obligime paraprake nga ana e tij.

Gruaja që e ka përjetuar këtë përvojë ndoshta ende mund të jetë atraktive, apo e dëshirueshme. Ndoshta madje mund të kërkojë edhe burrë tjetër dhe përsëri ta përsërisë të njëjtën situatë. Por, a do t'i japë e gjithë kjo sigurim, dinjitet, apo edhe ndonjë të drejtë tjetër? Ajo do të vrapojë në të njëjtin rreth të prishur, duke shpresuar se gjatë gjithë kohës do të gjuajë ndonjë person të ri. Barra e saj sa shkon e rëndohet, posaçërisht po të ketë edhe ndonjë fëmijë. Më në fund, përsëri atë do ta harrojnë. Kjo nuk pajtohet me dinjitetin njerëzor apo me ndërlikueshmërinë e femrës. Çdo grua që gjendet në këtë situatë ose do të dëshpërohet tepër, ose do të bëhet hakmarrëse e pamëshirshme, ose shkatërruese e moralit.

Në njërën anë, askush nuk mund të shtiret se të gjithë meshkujt e martuar janë të gëzuar, të suksesshëm dhe të kënaqur me martesën e tyre. Pavarësisht nga ajo se a është faji i tij apo i gruas së tij, burri i pakënaqur do të kërkojë ndonjë shoqëri tjetër dhe do të kërkojë ndihmë nga dikush tjetër. Kjo është lehtë

për të, kur gratë janë më tepër në numër se burrat. Nëse ai nuk mund ta gjejë atë grua nëpërmjet kanaleve të ndershme, ai do të përfitojë me anë të mjeteve të tjera, që implikojnë rezultat të intimiteteve jomorale dhe të panjerëzishme, të cilat mund të shkojnë edhe deri te jolegjitimiteti, aborti dhe pengesat tjera të pafundme. Këto ndoshta janë fakte të hidhura dhe të shëmtuara, por janë probleme të vërteta dhe akute. Ato duhet të zgjidhen në atë mënyrë që ta sigurojnë individin, qoftë ai mashkull apo femër, në mënyrë që ta mbrojë shoqërinë.

Zgjidhja që e ofron feja islame në këtë drejtim është leja për një burrë të pakënaqur që të marrë një grua të dytë, dhe të jetojë haptaz me të në një mënyrë të përgjegjshme, me një plotësim të barabartë të të gjitha obligimeve si për gruan e parë, ashtu edhe për të dytën. Analogjikisht, kjo u ndihmon grave të pamartuara t'i kënaqin nevojat e tyre, t'i realizojnë dëshirat e tyre dhe t'i plotësojnë aspiratat e tyre legjitime dhe nevojat natyrore. Kjo u jep atyre leje që të bashkohen me burrat me anë të martesës dhe t'i kënaqin të gjitha të drejtat e privilegjet ndaj të gjitha grave ligjore. Në këtë mënyrë feja islame nuk përpiqet të tërhiqet nga çështja dhe ta injorojë këtë problem. Kjo është mjaft reale, e haptë, e drejtpërdrejtë dhe praktike. Solucioni që e ofron feja islame është ligjor, i ndershëm dhe bamirës. Feja islame e sugjeron këtë solucion për arsye se ajo asnjëherë nuk mund ta tolerojë hipokrizinë në marrëdhëniet njerëzore. Ajo nuk mund ta pranojë si legale e morale pikëpamjen e një burri që me anë të ligjit është i martuar me një grua, kurse në realitet, ka një

qëllim të pakufizuar për intimitete dhe marrëdhënie të fshehta. Në anën tjetër, kjo është krejtësisht e kundërt me prostitucionin dhe nuk mund ta falë atë. Dënimi ndaj atyre që i bashkangjiten prostitucionit (qofshin ata meshkuj apo femra), merret si një dënim i rreptë e serioz, dhe ai i pushtërve është i barabartë me atë, sikur t'i copëtosh në më tepër se njëqind pjesë. Duke e ndaluar hipokrizinë, tradhtinë dhe prostitucionin, feja islame e sheh zgjidhjen e vetme në lejimin legal të poligamisë. Ja, kjo është e gjithë ajo që e ka bërë feja islame lidhur me rregullativat dhe kushtet e përmendura.

Nëse disa njerëz mendojnë se kjo është e papranueshme, ata duhet t'u kthehen alternativave të tjera, të cilat feja islame nuk i pranon apo nuk i favorizon posaçërisht. E nëse disa njerëz të tjerë mendojnë se mund ta kontrollojnë vetveten dhe mund të ushtrojnë vetëdisiplinë në çdo aspekt, atyre nuk u duhet poligamia. Gjëja më e rëndësishme e fesë islame është ruajtja e dinjitetit dhe e sigurisë së individit, si dhe mbrojtja e integritetit dhe moralit të shoqërisë.

Tani dikush mund ta pyesë vetveten se cila është zgjidhja më e mirë për një shoqëri të llojit të këtillë. A është e rekomandueshme që ta lejosh kaosin dhe sjelljen e papërgjegjshme që t'i shkatërron bazat themelore të shoqërisë, apo të kthehesh e ta pranosh solucionin islam? A është në interes të shoqërisë t'i injorosh problemet akute të saj, ta tolerosh hipokrizinë dhe jorregullsinë, apo t'i ndalosh prostitucionin dhe intimitetin e fshehtë? A është e shëndoshë t'i frenosh dëshirat legjitime dhe përmasllimin natyror të burrit dhe të gruas për shoqëri; - një

frenim, i cili në të vërtetë nuk mund të jetë efektiv dhe që mund t'i çojë ata kah veprimet jolegale dhe jonormale? Pavarësisht nga ajo se a e shqyrtojmë këtë pyetje nga pikëpamja sociale, morale, humanitare apo shpirtërore, do të kuptojmë se është shumë më mirë për një shoqëri që t'u lejohej individëve të saj të bashkohen në një bazë legale dhe në një mënyrë të përgjithshme, me mbrojtjen e ligjit dhe nën kontrollin e autoriteteve përkatëse.

Madje edhe nëse e shikojmë çështjen nga pikëpamja feministe, do të vërejmë se feja islame me këtë zgjidhje ia siguron gruas nderin e duhur, i siguron të drejtat dhe integritetin e saj, e njeh dëshirën e saj legjitime për shoqëri të rregullt, i jep vend asaj në shoqëri dhe e favorizon me mundësi që ta dashurojë dikë që është i shtrenjtë për të; dhe po ashtu, të jetë e dashur. Kjo ndoshta nuk do të tingëllonte mirë për një grua që tanimë ka burrë dhe që nuk lejon të shohë ndonjë grua tjetër t'i afrohet bashkëshortit dhe mbrojtjes së saj, apo ta ndajë me të përkrahjen dhe përzemërsinë e tij. Por, cila është ndjenja e grave të tjera që nuk kanë burra e as shokë të duhur? A duhet vetëm ta injorojmë ekzistencën e tyre dhe të besojmë se ato nuk kanë të drejtë për kurrfarë lloj sigurimi dhe kënaqësie? Si do të ndihej një bashkëshorte e si do të reagonte po të ishte në një pozitë të ngjashme me atë të grave, të cilave u mungon shoqëria e burrave? A nuk do të dëshironte t'i përkasë dikujt, të jetë e respektuar dhe e mirënjohur? A nuk do të pranojë një gjysmë gote apo një gjysmë burri, nëse nuk mund ta ketë atë plotësisht? A nuk do të ishte e kënaqur me pak mbrojtje e

siguri, në vend që të jetë e privuar nga e gjithë kjo? Çka do t'i ndodhë asaj dhe fëmijëve të saj, nëse bashkëshorti i dashur është atraktiv për gratë e "tepertha" në një koktej apo festim të përbashkët? Çfarë do të ndodhë me të, nëse ai e lë familjen e vet apo i refuzon përgjegjësitë e tij që të ketë kohë dhe mundësi parashikimi për një atraksion të ri? Si do të ndihej ajo po të merrte vesh se njeriu i vetëm i jetës së saj ka lidhje me disa gra të tjera dhe fshehtas mban një grua tjetër, apo se ka edhe një dashnore tjetër? Një njeri i tillë nuk paraqet vetëm humbje, por edhe kërcënim. Ai është njeri i degjeneruar dhe i dobët. Pranoni! Por, a do t'i ndihmojë ky mallkim cilitdo qoftë të ngatërruar në këtë "lojë"? Vetëm gratë - bashkëshortja legale si dhe gruaja jolegale - janë ato që vuajnë nga një situatë e këtillë. Por, a nuk është më mirë për të dy gratë ta ndejnë në mënyrë të barabartë përkrahjen dhe kujdesin e burrit, si dhe të kenë të drejtë të barabartë për shoqërinë e tij dhe që të dyja t'i mbrojnë ligji? Në të vërtetë, një burrë i tillë nuk është më bashkëshort vetëm i një gruaje. Ai në atë rast është një hipokrit i keq, pasi e keqja më është bërë dhe shpirti është lënduar. Me qëllim që të mbrohen të dyja anët, të luftohet pandershmëria, të pengohen dëmet e tilla dhe të shpëtohen shpirtrat nga lëndimet, feja islame në mënyrë qëllimplote ndërhyjnë dhe e lejon burrin e martuar të martohet edhe një herë, nëse ka arsye të forta e të domosdoshme.

2. Në disa raste të martesës, gruaja mund të mos jetë e aftë të lindë fëmijë për shkaqe të ndryshme. Për të pasur një jetë familjare në plotkuptimin e

fjalës dhe të kontribuosh në ruajtjen e llojit njerëzor, prania e fëmijëve është fundamentale. Përveç asaj, ky është një ndër qëllimet kryesore të martesës; dhe burri për nga natyra e tij dëshiron të ketë fëmijë, ta ruajë emrin e tij dhe t'i përforcojë lidhjet familjare. Në një situatë të ngjashme me këtë, burri ka tri alternativat që vijojnë: (1) Ta harrojë atë dhe t'i asgjësojë dëshirat e tij natyrore për fëmijë; (2) Të ndahet nga gruaja e tij pa fëmijë nëpërmjet procesit normal të ndarjes, kurvërisë apo ndryshe; dhe (3) Të adoptojë fëmijë dhe t'ua japë emrin e tij.

Asnjëra nga këto alternativa nuk përputhet me pikëpamjen e përgjithshme të fesë islame ndaj jetës dhe natyrës. Feja islame as nuk e inkurajon e as nuk e aprovon shtypjen e dëshirave legjitime dhe aspiratave natyrore. Ajo ndihmon për t'i kuptuar këto aspirata dhe dëshira në një mënyrë legale dhe normale, për arsye se shtypja apo asgjësimi në një rast të tillë, nuk është pjesë e sistemit të saj. Ndarja në këto rrethana nuk është e arsyeshme, sepse gruaja s'ka faj që nuk mund të lindë fëmijë. Përveç kësaj, ndarja është gjëja më e papranueshme në sytë e Zotit dhe lejohet vetëm kur nuk ka alternativë tjetër. Në anën tjetër, bashkëshortja mund të ketë nevojë për përkrahje dhe shoqëri nga burri i saj. Do të ishte e panjerëzishme ta lejosh atë të shkojë kur ka nevojë dhe është e deprimuar; duke e marrë parasysh atë se nuk mund të lindë.

Adoptimi po ashtu nuk vjen në konsiderim, për arsye se feja islame urdhëron se çdo fëmijë duhet të thirret sipas emrit të babait të vërtetë; e nëse s'dihet ky emër, atëherë duhet të quhet vëlla në besim

(Kur'ani, 33:4-5). Kjo, natyrisht, nuk do të thotë se një fëmijë të cilit nuk i dihet babai apo përkujdesësi, duhet të vuajë nga deprivimi apo mungesa e dashurisë prindërore. Larg asaj! Ajo do të thotë se adoptimi, siç praktikohet sot, nuk është mënyra për t'i dhënë atij fëmijë një jetë të sigurt dhe prosperuese. Askush nuk mund ta zëvendësojë nënën dhe babain e vërtetë. Ngjarjet që ndodhin çdo ditë, procedurat dhe rastet e komplikuar nëpër gjykata dhe mosmarrëveshjet familjare, e përdëftojnë atë se adoptimi nuk është zgjidhja e qëlluar e problemit. Sot nëpër gjykata kemi raste të shumta ku prindërit e vërtetë e kërkojnë kthimin e fëmijëve të tyre, të cilët i kanë adoptuar familje të huaja dhe i kanë njoftuar me rrethana të ndryshme? Për sa kohë një nënë dhe një baba mund ta shohin fëmijën e tyre në një shtëpi të huaj? Sa mund t'u besojnë ata prindërve artificialë në rritjen e fëmijëve të tyre në mënyrë të duhur dhe a mund t'ua japin kujdesin e duhur? Si do të ndihet fëmija kur vetë nesër apo pasnesër do të marrë vesh se prindërit e tij të vërtetë kanë hequr dorë prej tij dhe se ai tërë jetën ka pasur prindër jo të vërtetë? Si do të reagojë ai kur do të zbulojë se prindërit e tij të vërtetë nuk dihen, apo se nëna e tij atë e ka dorëzuar për shkak të frikës, varfërisë, apo për shkak të turp-it dhe pasigurisë? Sa e duan fëmijën anëtarët e tjerë të familjes që atë e adopton? A dëshirojnë ata që fëmija i huaj ta marrë emrin e tyre dhe t'i trashëgojë pronat për të cilat ata vetë janë trashëgues potencialë? Si do të ndihen ushqyesit e mbajtësit e rinj kur prindërit e vërtetë do ta kërkojnë kthimin e fëmijës së tyre, apo kur vetë fëmija do të dëshirojë t'u kthehet prindërve

të vërtetë? Këtu mund të ketë mjaft komplikime. Institucioni pa dyshim nuk është i shëndetshëm dhe mund t'u bëjë shumë dëm fëmijëve, prindërve, qoftë atyre jo të vërtetë apo të vërtetë, farefisit tjetër të familjes adoptuese dhe shoqërisë në përgjithësi. Adoptimi është njëri ndër shkaqet kryesore, që i inkurajon shumë njerëz të zhvillojnë intimitete dhe aktivitete të papërgjegjshme. Kjo dukuri po komercializohet në ditët e sotme. Ekzistojnë disa njerëz që i japin fëmijët e tyre "në shitje" apo tregti, siç na tregojnë mass-mediumet. Kjo nuk ndodh në xhunglat aziatike apo afrikane, por mu këtu në Kanada dhe në Amerikë (si dhe në mbarë botën civilizuese). Për arsye të gjithë kësaj, feja islame nuk e pranon këtë institucion, apo nuk e lejon zbatimin e tij në mesin e muslimanëve (shih Kur'anin, 33:4-6).

Meqenëse këto tri alternativa nuk pranohen për arsyet që i zumë ngojë, feja islame i ofron zgjidhjet e saj. Ajo, njeriun që është në atë situatë, e lejon të rimartohet, t'i plotësojë nevojat e tij natyrore dhe në të njëjtën kohë ta mbajë gruan që s'ka fëmijë, e cila sigurisht ka nevojë për burrin më tepër se kurrë. Ky, përsëri është një lejim që mund ta ndër marrë një njeri i dëshpëruar, në vend të adoptimit, shkurorezimit apo ndrydhjes jonatyrore të aspiratave të tij. Ky është rasti tjetër kur rimartesa është zgjidhja më e mirë dhe më efektive; është një rrugëdalje tjetër nga një situatë e rëndë, me qëllim që t'u ndihmohet njerëzve të jetojnë një jetë normale dhe të sigurt në çdo aspekt.

3. Ekzistojnë raste dhe kohë kur gruaja është e paaftë t'i plotësojë obligimet e saj martesore. Ajo

ndoshta nuk mund të jetë shoqe e mirë dhe e përzmërt sa duhet, apo ndoshta sa dëshiron edhe ajo vetë të jetë. Ajo mund të jetë në gjendje kur nuk mund t'ia ofrojë tërë dashurinë burrit të vet, nuk mund t'ia ofrojë as kënaqësinë dhe kujdesin e duhur. E gjithë kjo mund të ndodhë dhe ndodh në realitet. Nuk është gjithmonë faji i gruas; mund ta ketë fajin edhe vetë natyra. Mund të jetë çështja e ndonjë sëmundjeje të gjatë, ose ndonjë periudhë e kufizimit apo ndonjë nga periudhat e rregullta. Këtë, përsëri, të gjithë burrat nuk mund ta durojnë apo ta ushtrojnë vetëkontrollin, apo të adoptojnë ndonjë mënyrë engjëlllore të sjelljes. Disa burra bien në rrjetën e amoralitytetit, mashtrimit, të hipokrizisë dhe tradhtisë. Ekzistojnë raste të shumta kur disa burra dashurohen në kunatat e tyre, apo në dadot (kujdestaret e fëmijëve të tyre), apo në shërbëtoret që vijnë të kujdesen për familjen gjatë sëmundjes së gruas apo gjatë periudhës së kufizimit (lehonisë). Ka ndodhur shumë shpesh që në kohën kur gratë kanë pasur operacione të rënda të lindjes, burrat e tyre kanë pasur dashuri të reja me gra të tjera. Motra apo shoqja e zonjës së tillë të sëmurë, është aktorja më e shpeshtë e një drame të tillë. Ndoshta ajo do të vinte t'i ndihmojë motrës së saj të sëmurë apo shoqes së saj të dashur, me të gjitha qëllimet bujare, për t'ia ruajtur përkohësisht fëmijët; e prej këtij çasti punët mund të ndërlikohen. Kur në shtëpi ka një grua të sëmurë apo të shtrirë në spital, atëherë burri ndihet i vetmuar dhe i deprimuar. Gruaja tjetër që gjendet në shtëpi, pavarësisht a është motra e gruas apo shoqja e saj, etj., e ka si pjesë të ndihmës së saj t'i shprehë burrit pak

simpati dhe kuptim, që mund të jenë të sinqerta dhe të ndershme, por që mund të marrin edhe kahe krejtësisht tjetër. Disa burra dhe disa gra e shfrytëzojnë këtë rast të thjeshtë të simpatisë, duke e keqpërdorur deri në aktin e fundit. Rezultati është një zemër e thyer aty apo këtu, nga njëra anë, por edhe një familje e shkatërruar, nga ana tjetër.

Problemet e këtij lloji nuk janë të imagjinuara e as të rralla. Ato janë të zakonshme ndërmjet njerëzve. Gazetat shpeshherë flasin për problemet e këtilla. Dosjet e gjykatave po ashtu janë dëshmi për këtë të vërtetë. Veprimi i burrit në këtë drejtim mund të quhet i prishur, amoral, i çrregullt, etj. Kjo është më se e vërtetë! Por, a ndihmon kjo? A e ndryshon kjo faktin apo natyrën njerëzore? Akti më është kryer dhe krimi bëhet e përsëritet; e si pasojë, ky problem akut kërkon një zgjidhje praktike e të rregullt. A duhet që përpiluesit e ligjit të jenë të kënaqur me vetveten se këto akte i kanë caktuar si të dëmshme? A duhet që të lejojnë që ndershmërinë dhe besueshmërinë ta zëvendësojnë hipokrizia dhe amoraliteti? Ndalimi dhe dënimi i duhur nuk i kanë larguar disa burra nga krimi apo nuk e kanë zgjuar vetëdijen e tyre. Përkundrazi, ato kanë bërë vend edhe për hipokrizinë, tradhtinë e fshehtë dhe papërgjegjësinë, para të cilave ligji dhe përpiluesit e tij janë të pafuqishëm.

Mirëpo, feja islame nuk mund të jetë e pafuqishme. Ajo nuk mund të bëjë kompromis me standartet morale ose t'i tolerojë hipokrizinë dhe tradhtinë. Ajo nuk mund ta zhgënjejë vetveten apo njeriun me kënaqësi të rrejshme ose të pretenduara. Feja islame nuk mund as ta mohojë ekzistencën e problemit apo

thjeshtë të kthehet në dënimin dhe ndalimin e tërësishtëm, sepse kjo madje as nuk e zvogëlon lëndimin. Me qëllim që njeriu të shpëtojë nga kjo e keqe që i vie nga vetvetja e tij, e me qëllim që të mbrohet edhe gruaja e futur në këtë lojë - pavarësisht a është ajo bashkëshortja apo shoqja e fshehtë - të mbrohet nga komplikimet e panevojshme, të ruhet integriteti moral i shoqërisë; dhe me qëllim që të zvogëlohet keqbërësia, feja islame e ka lejuar poligaminë duke pasur parasysh rezervat dhe kushtet e përmendura më sipër. Kjo duhet të aplikohet si një masë e jashtëzakonshme dhe sigurisht është shumë më e shëndetshme se monogamia nominale (formalisht e emëruar), dhe nga relacionet e papërgjegjshme ndërmjet burrit dhe gruas. Burrat dhe gratë, të cilët e gjejnë vetveten në situatë të rëndë, mund t'i drejtohen këtij solucioni. Por, nëse ekziston ndonjë frikë nga padrejtësia e dëmi nga të dyja anët, atëherë monogamia është ligji i vetëm.

4. Vetë natyra kërkon disa gjëra dhe disa veprimë, veçanërisht nga burri. Burri është ai, i cili sipas rendit udhëton shumë për punë afariste, është larg shtëpisë së tij për periudha të ndryshme kohore, në udhëtime të gjata apo të shkurtra, në shtet dhe jashtë tij. Askush nuk mund ta marrë përgjegjësinë që me siguri të thotë se të gjithë burrat në rrethana të tilla do të qëndrojnë besnikë e të pastër. Përvoja na tregon se shumica e burrave bëjnë akte jomorale me gra të huaja gjatë periudhës së mungesës së tyre nga shtëpia, e cila mund të zgjasë me muaj apo me vite të tëra. Disa njerëz janë të dobët dhe nuk mund t'u rezistojnë madje as gjërave që zakonisht janë të

rezistueshme. Si rezultat i kësaj, ata bien në mëkat dhe shkaktojnë shqetësime në familje. Ja, ky është një rast tjetër ku mund të aplikohet poligamia e kufizuar. Për një burrë të tipit të këtillë, është shumë më lehtë të ketë një shtëpi të dytë me një grua të dytë legale, se sa të jetë i lirë për të bërë akte jomorale dhe të papërgjegjshme. Kjo madje është më mirë edhe për vetë bashkëshorten, kur më ajo e di se burri i saj është i lidhur me rregullativa legale dhe me parime morale në intimitetin e tij me një grua tjetër, pasi bashkëshortja me siguri do të jetë më pak e irrituar, se sa nëse i shoqi intimitetin e vet e kënaq ndryshe. Është krejt e natyrshme se gruaja nuk dëshiron që burrin e vet ta ndajë me dikë tjetër. Por, kur ballafaqohet me situatën, kur burri ka zgjidhjen të jetë ose legalisht i përgjegjshëm dhe moralisht i lidhur, apo i lidhur amoralisht dhe ilegalisht me dikë tjetër, sigurisht se ajo do ta kishte zgjedhur alternativën e parë dhe do ta kishte pranuar situatën si të tillë. Megjithatë, nëse ajo dëmtohet apo nëse asaj i cenohen të drejtat, atëherë ajo çdoherë mund t'i drejtohet ligjit, dhe nëse kjo është në interesin e saj më të mirë - të shkurorëzohet nga burri i saj.

Duke e aplikuar në këtë rast poligaminë islame, integriteti i burrit, dinjiteti i gruas së dytë dhe vlerat morale të shoqërisë do të jenë më të ruajtura. Këto raste nuk kërkojnë përpunim të mëtutjeshëm. Ato janë elemente faktike të jetës së përditshme. Sa më të rralla që të jenë ato, aq më i rrallë është edhe zbatimi i poligamisë në mesin e muslimanëve. Muslimanët që i kthehen poligamisë janë shumë më të

rrallë se burrat dhe gratë jobesnike që jetojnë në shoqëritë monogamike.

Edhe pse është e mbarsur me rrezik dhe një gjë e lidhur me mjaft parakushte, siç shpjeguar edhe më sipër, poligamia është shumë më e mirë se neglijenca dhe tradhtia, hipokrizia dhe pasiguria, amoraliteti e parregullsia. Kjo u ndihmon burrave dhe grave t'i zgjidhin problemet e tyre të vështira në një bazë reale dhe të përgjegjshme. Kjo i sjell deri në minimum shumë komplikime psikologjike, natyrore dhe emocionale të jetës njerëzore. Kjo është një masë kujdesi që aplikohet për interesin më të mirë të të gjitha palëve të interesuara. Megjithatë, ajo nuk është pjesë e besimit në fenë islame e as nuk është urdhër; por është vetëm leje nga Zoti, një zgjidhje e disa nga problemet më të rënda në marrëdhëniet njerëzore. Muslimanët mendojnë se poligamia legale dhe e kushtëzuar është e preferueshme edhe për gjëra të tjera që i ndërmarrin njerëzit sot - njerëzit të cilët janë kryelartë për martesën nominale të tyre dhe për monogaminë sipërfaqësore. Qëndrimi i muslimanit është ky: në rrethana normale monogamia jo vetëm që është e preferueshme, por është edhe rregull. Përndryshe, poligamia mund të merret parasysht dhe të aplikohet nëse është e nevojshme.

Me qëllim që ky diskutim të jetë më i kompletuar, duhet t'i analizojmë edhe martesat e Pejgamberit Muhammed a.s. Këto martesat nuk paraqesin problem për një musliman, i cili e kupton karakterin ideal të Pejgamberit dhe rrethanat në të cilat u lidhën martesat e tij. Por, shumë shpesh kjo paraqet problem për jomuslimanët që ta kuptojnë

personalitetin e Pejgamberit, e si pasojë e kësaj shkaktojnë përfundime të gabueshme dhe të papjekura, që nuk i përkasin fesë islame e as Pejgamberit a.s. Këtu as nuk do t'i japim përfundimet tona, e as nuk do t'i demantojmë përfundimet e të tjerëve. Por, do të prezentojmë disa fakte dhe do t'ia lëmë lexuesit të gjykojë vetë.

1. Institucioni i martesës gëzon një status të lartë në fenë islame. Kjo rekomandohet në mënyrë decide dhe është themelore për jetesën e shëndoshë të shoqërisë.

2. Muhammedi a.s., asnjëherë nuk ka thënë se është i pavdekshëm apo hyjnor. Kohë pas kohe, e theksonte faktin se ai qe njeri i vdekshëm i zgjedhur nga Zoti për t'ia përcjellur njerëzimit porosinë e Zotit. Edhe pse qe unik dhe i dalluar në jetën e tij, ai jetoj dhe vdiq si njeri. Martesa sipas kësaj, për të qe një gjë e natyrshme, e jo ndonjë femohim apo mallkim.

3. Ai jetoj në një klimë jashtëzakonisht të nxehtë, ku dëshirat fizike bëjnë presion të fortë mbi njeriun; ku njerëzit e zhvillojnë pjekurinë fizike shumë herët dhe ku një kënaqje e lehtë ishte gjë e zakonshme në mesin e njerëzve të të gjitha klasave. Megjithatë, Muhammedi a.s., asnjëherë nuk iu afrua grave derisa nuk i pat mbushur njëzet e pesë vjet, atëherë kur u martua për herë të parë. Në mbarë Arabinë ai qe i njohur për karakterin e tij të padyshimtë dhe e quanin *el Emin (besnik)*, një titull që ishte simbol për standardin më të lartë të jetës morale.

4. Martesa e tij e parë në këtë fazë jashtëzakonisht të vonshme për atë vend u bë me Hatixhen, e cila

ishte pesëmbëdhjetë vjet më e vjetër se Muhammedi a.s. Ajo e para e inicoi marrëveshjen e martesës, ndërsa ai e pranoi propozimin e martesës edhe pse ajo qe më e vjetër dhe dy herë e mbetur vejushë. Në atë kohë ai, po të ishte i pasionuar apo i dhënë pas anës fizike, do të mund të gjente vajza shumë më të bukura dhe bashkëshorte më të reja.

5. Me këtë grua ai jetoi deri në moshën pesëdhjetëvjeçare dhe me të i pat të gjithë fëmijët, me përjashtim të Ibrahimit. Ai jetoi me të derisa ajo e kaloi moshën gjashtëdhjetepesëvjeçare dhe gjatë jetës së saj ai asnjëherë nuk pati ndonjë martesë tjetër apo intimitet me tjetërkënd, përveç me gruan e tij të vetme.

6. Kur e proklamoi porosinë e Zotit, atëherë i kishte mbi pesëdhjetë vjet, e ajo mbi gjashtëdhjetë e pesë. Persekutimet dhe rreziqet ishin gjithmonë të pranishme tek ai dhe tek ithtarët e tij. Në vllugun e këtyre trazirave i vdiq gruaja. Pas vdekjes së saj ai mbeti pa grua për një periudhë kohore. Pas kësaj u paraqit Sevda-ja, e cila kishte emigruar me burrin e saj në Abisini në vitet e hershme të persekutimeve. Gjatë kthimit, burri i saj vdiq, e ajo kërkonte mbrojtje. Gjëja më e natyrshme për të ishte t'i drejtohet Pejgamberit a.s., për misionin e të cilit pat vdekur bashkëshorti i saj. Pejgamberi ia ofroi mbrojtjen e tij dhe u martua me të. Ajo nuk ishte posaçërisht e re apo e bukur dhe e përzemërt. Ajo qe një vejushë e zakonshme me një natyrë të shpejtë dhe të lirë. Më vonë në të njëjtin vit, Pejgamberi a.s., kërkoi për martesë një vajzë të vogël shtatëvjeçare, Aishen, vajzën e mikut të tij Ebu Bekrit. Martesa nuk u bë

deri në një kohë pas migrimit në Medine. Motivet e këtyre dy martesave mund të kuptohen se janë gjithçka, përveç atyre të epsheve dhe të tërheqjes fizike. Megjithatë, ai jetoi me të dy gratë e tij për pesë-gjashtë vjet, deri në moshën e tij pesëdhjetegjashtëvjeçare, duke mos marrë asnjë grua tjetër.

7. Nga mosha e tij pesëdhjetegjashtëvjeçare e deri në atë të gjashtëdhjetën, Pejgamberi lidhi nëntë martesa të njëpasnjëshme. Në tri vitet e fundit të jetës së tij ai nuk u martua më asnjëherë. Shumica e martesave të tij u lidhën në një periudhë kohore pesëvjeçare, kur ai e kalonte fazën më të rëndë të misionit të tij. Ishte kjo koha kur muslimanët ishin të zënë me betejat vendimtare dhe të përzier në një rreth të pandërprerë të trazirave, sa nga ana e brendshme aq edhe nga ajo e jashtme. Kjo ndodhi në kohën kur legjislatura islame ende po formohej dhe kur ende po viheshin bazat e shoqërisë islame. Fakti se Muhammedi a.s., ishte figurë më dominante në këto ngjarje dhe qendra rreth së cilës silleshin të gjithë, dhe se shumica e martesave të tij ndodhnin gjatë kësaj periudhe të veçantë, është një fenomen mjaft interesant. Kjo i bën thirrje të veçantë vëmendjes së historianëve, sociologëve, legjislatorëve, psikologëve, etj. Kjo nuk mund të interpretohet vetëm si pjesë e tërheqjeve fizike dhe të mendjes së pasionuar.

8. Muhammedi a.s., jetoi një jetë të thjeshtë dhe modeste. Gjatë ditës ai ishte njeriu më i zënë i epokës së tij, për arsye se ishte kryetar shteti, gjykatësi kryesor, komandanti kryesor, instruktor, etj., dhe që të gjitha detyrat i kryente përnjëherë. Gjatë netëve

ai ishte njeriu më i devotshëm. Një të tretën e natës e kalonte në lutje vigjilente dhe në meditime (Kur'ani, 73:20). Mobiliet e tij i përbënin jastëkët dhe bataniet e thjeshta, edhe pse ai ishte mbreti dhe sovrani i Arabisë. Jeta e tij ishte aq e vrazhdë dhe e ashpër, saqë në një rast gratë e tij e nxitën për konforet e kësaj bote, por nuk patën gjë prej tyre (krahaso Kur'ani, 33:48). Natyrisht, kjo nuk qe jeta e një njeriu të dhënë pas pasioneve dhe joshjeve.

9. Gratë me të cilat qe martuar që të gjitha ishin vejusha apo gra të ndara, me përjashtim të vashës së vogël, Aishes. Asnjëra nga këto gra të ndara dhe vejusha nuk ishte posaçërisht e njohur me bukurinë dhe sharmin e vet. Disa nga këto gra ishin më të moshuara se ai dhe praktikisht të gjitha e kërkuan mbrojtjen e tij. Ato iu ofruan atij si dhurata, por ai i mori si gra legale.

Kjo është prapavija e përgjithshme e martesave të Pejgamberit a.s., e cila asnjëherë nuk mund të lë përshtypje se këto martesë u bënë për hir të nevojave fizike apo për hir të pasioneve biologjike. Është e pakuptueshme të thuhet se ai ka mbajtur një numër të madh grash për arsye të planeve të tij personale apo për arsye të dëshirave të tij fizike. Kushdo që të jetë, mik apo armik, që dyshon në integritetin moral apo në shkëlqesinë shpirtërore të Muhammedit a.s., lidhur me martesat e tij, duhet t'u gjejë përgjigje adekuate pyetjeve që vijojnë: Pse e bëri martesën e parë në moshën njëzetepesëvjeçare, pa pasur kurrfarë kontakti me ndonjë femër më parë? Pse zgjodhi një grua që ishte dy herë vejushë dhe pesëmbëdhjetë vjet më e moshuar se ai? Pse mbeti vetëm me të deri

në vdekjen e saj, duke e marrë parasysh se i kishte mbi pesëdhjetë vjet? Pse i pranoi të gjitha këto veju-sha dhe gra të ndara të pandihmuara, të cilat nuk posedonin kurrfarë vlerash përkatëse? Pse bëri një jetë të tillë të vrazhdë dhe të rëndë, kur pati mundësi të jetojë një jetë të lehtë dhe konfore? Pse e lidhi shumicën e martesave të tij në pesë vitet më të zëna të jetës së tij, kur misioni dhe karriera e tij ishin në rrezik? Si ia arriti të jetë ai që ishte, po ta kishte kapluar jeta e haremit dhe epsheet? Ekzistojnë edhe shumë pyetje të këtilla. Kjo çështje nuk është aq e thjeshtë saqë të mund të interpretohet vetëm me anë të dashurisë mashkullore dhe dëshirës për gra. Kjo është një thirrje për mendim dhe analizë më të thellë.

Duke i marrë parasysh martesat e Muhammedit a.s., në veçanti, lehtë mund t'i gjejmë edhe shkaqet faktike për këto martesa. Ato mund të klasifikohen në mënyrën që vijon:

1. Pejgamberi erdhi në këtë botë si shembull ideal i njerëzimit - e i tillë ishte në të gjitha aspektet e jetës. Vetë martesa është një ilustrim i shkëlqyer për këtë. Ai ishte bashkëshorti më i përzemërt e shoku më i dashur. Ai duhej të kalojë nëpër të gjitha fazat e përvojës njerëzore dhe të testit moral. Ai jetoj me një bashkëshorte, dhe me më tepër se një; më të moshuara e më të reja, me veju-sha e me të ndara, me të buta e me temperamente, me nam dhe të përulura; por në të gjitha rastet ai ishte shembull i përzemërsisë dhe i ngushëllimit. Ai duhej t'i përjetonte të gjitha këto aspekte të ndryshme të jetës njerëzore. Kjo për të nuk do të ishte një kënaqësi fizike; por një

provë morale si dhe një detyrë njerëzore - një detyrë mjaft e rëndë njerëzore.

2. Pejgamberi erdhi të vendosë moralin dhe t'i sigurojë çdo muslimani mbrojtje, siguri, integritet moral dhe jetë të rregullt. Misioni i tij u vu në sprovë të ndryshme në jetën e tij dhe nuk mbeti në formë të ndonjë koncepti teorik. Si zakonisht, ai e mori rolin më të rëndë dhe e bëri pjesën e tij në mënyrën më të pavolitshme. Luftërat dhe persekutimet i ngarkuan muslimanët me shumë vejusha, jetima dhe të shkurorëzuara. Ato duhej të mbroheshin dhe të mbaheshin nga muslimanët që i përjetuan këto persekutime. Ai praktikonte që t'u ndihmojë këtyre grave duke i martuar për shokët e tij. Disa gra qenë të refuzuara nga shokët e tij, ndërsa disa të tjera kërkuan patronazhin dhe mbrojtjen e tij personale. Duke i kuptuar kushtet dhe sakrificat e tyre për hir të fesë islame, ai duhej të bënte diçka që t'ua lehtësonte pozitën atyre. Një ndër mënyrat për ta zgjidhur këtë problem qe edhe martesat e tij personale me to dhe sprovat e përgjegjësive të vështirë. Kështu edhe veprimi: ai mbajti më tepër se një grua në të njëjtën kohë, gjë që nuk ishte lehtë. Ai duhej të merrte pjesë në rehabilitimin e këtyre vejushave, bonjakëve dhe të shkurorëzuarave, për shkak se ai nuk mund të kërkonte nga shokët e tij t'i kryejnë punët, për të cilat edhe vetë ishte i papërgatitur t'i kryejë apo të marrë pjesë. Këto gra ishin në besim të muslimanëve dhe duhej që të trajtoheshin në mënyrë të barabartë. Ai pas kësaj, e ndau përgjegjësinë e tij me ata, e si gjithmonë, pjesa e tij e përgjegjësive që më e madhe dhe

më e rëndë. Ja pse ai pati më tepër se një grua, e po ashtu, më tepër gra se të gjithë shokët e tij.

3. Në luftë u zunë shumë të burgosura nga ana e muslimanëve, të cilave përsëri duhej dhënë siguri dhe mbrojtje. Ato as nuk u vranë e as nuk iu privua ndonjë e drejtë, qoftë njerëzore apo fizike. Përkundrazi, ato u ndihmuan të vendosen e të mëkëmben me anë të martesave legale me muslimanët, në vend që të trajtoheshin si dashnore të zakonshme. Kjo po ashtu qe edhe një barrë tjetër e rëndë për muslimanët dhe duhej të kapërcehej në mënyrë të përbashkët si një përgjegjësi e përgjithshme. Këtu përsëri Muhammedi a.s., ishte pjesëmarrës dhe mori disa përgjegjësi duke u martuar me dy nga këto gra.

4. Pejgamberi a.s., i lidhi disa nga martesat e tij për shkaqe shoqërore-politike. Detyra e tij kryesore ishte ardhmëria e fesë islame. Ai më së shumti ishte i interesuar për t'i fuqizuar muslimanët me të gjitha lidhjet e fuqitë që i kishte. Ja pse edhe u martua me vajzën e vogël të Ebu Bekrit, trashëgimtarit të tij të parë dhe me vajzën e Umerit, trashëgimtarit të tij të dytë. Me martesën e tij me Xhujejrien, ai fitoi përkrahjen për fenë islame nga i gjithë klani i Beni Mustalikut dhe nga të gjitha fiset aleate të tyre. Me anë të martesës së tij me Safijen, ai neutralizoi një pjesë të madhe të hebrenjve armiqësorë nga Arabia. Me pranimin e Merjemes kopte nga Egjipti, ai lidhi një aleancë politike me një mbret shumë të rëndësishëm. Një gjest tjetër miqësie me mbretin fqinj ishte edhe martesa e tij me Zejneben, e cila atij iu prezantua nga Negusi i Abisinisë, në territorin e të cilit muslimanët e hershëm gjetën strehim të sigurt.

5. Me lidhjen e këtyre martesave Pejgamberi a.s., dëshironte ta eliminojë sistemin klanor, fodu-llëqet racore dhe nacionale dhe paragjykimet reli-gjioze. Ai u martua me disa nga gratë më të përulura e më të varfëra. Ai u martua me një femër kopte nga Egjipti, me një hebreje të religjionit dhe të racës së ndryshme, me një vajzë zezake nga Abisinia. Ai nuk ishte i kënaqur vetëm me atë që t'i mësojë njerëzit për vëllazërinë dhe barazinë, por ai atë që ua më-sonte, njëkohësisht edhe e mendonte dhe e zbatonte në praktikë.

6. Disa nga martesat e Pejgamberit a.s., u bënë për arsye legislative dhe me qëllim të eliminimit të disa traditave të korruptuara. E këtillë ishte martesa e tij me Zejneben, e që ishte ish-gruaja e skllavit të liruar Zeidit. Zeidin e kishte bijësuar Muhammedi a.s., dhe e kishte quajtur djalë të tij, siç ishte traditë në mesin e arabëve para fesë islame. Por, feja islame e anuloi këtë ligj dhe e ndaloi zbatimin e tij. Muhammedi a.s., ishte njeriu i parë që e shprehu moszbatimin e këtij ligji në mënyrë praktike. Kështu, ai u martua me gruan e ndarë të djalit të tij “të bijësuar”, që të tregojë se adoptimi nuk e bën fëmijën e adoptuar bir të vërtetë të babait adoptues, dhe që të tregojë se martesa është e ligjshme edhe për gratë e ndara. Rastësisht, Zejnebja që kushërira e Muhammedit a.s., e i që ofruar për martesë para se ta marrë Zeidi. Atëherë Muhammedi a.s., e refuzoi, por pasi u nda, ai e pranoi për dy qëllime legislative: për martesën e ligjshme të grave të ndara dhe për sta-tusin e vërtetë të fëmijëve të adoptuar. Tregimi i Zej-nebes disa herë lidhet me shpifjet qesharake sa i

përket integritetit moral të Muhammedit a.s. Këto shpifje të këqija, as që meritojnë të përmenden këtu (shih Kur'anin, 33:36,37,40).

Këto janë rrethanat me të cilat u ballafaqua Pejgamberi me rastin e martesave të tij. Për muslimanët nuk ka kurrfarë dyshimi se Muhammedi a.s., i posedonte standardet më të larta të moralit dhe se ishte një shembull i përsosur i njeriut në të gjitha rrethanat. Sa u përket jomuslimanëve, ata do t'i kishim ftuar për një diskutim serioz rreth kësaj çështjeje. Pas kësaj, edhe ata do të jenë në gjendje të sjellin përfundime më të shëndosha e më të drejta.

4. Martesa dhe shkurorezimi²⁷

Njëri ndër konceptet më të shfytëruara në lidhje me fenë islame, është kuptimi i vërtetë i martesës. Lidhur me fjalët që u thanë pak më parë, tani do të duhet të japim edhe disa vërejtje. Martesa në fenë islame nuk është një marrëveshje tregtare për të cilën bëjnë negociata dy partnerë, as nuk është kontratë shekullare ku përparësitë dhe obligimet vlerësohen në kundërshtim me njëri-tjetrin. Kjo është diç solemne, diç e shenjtë dhe do të ishte gabim i madh sikur ta definonim atë si diç fizike, materiale apo shekullare. Pastërtia morale, ngritja shpirtërore, integriteti social, stabiliteti njerëzor, paqja dhe mëshira, janë elementet kryesore të martesës. Kjo është një kontratë për të cilën vetë Zoti është dëshmitari i parë

²⁷ Lidhur me këtë pikë, shih pjesën për "Jetën familjare" më lart.

dhe pala e parë; kjo kontratë nënshkruhet nën emrin e Tij, në dëgjueshmërinë ndaj Tij dhe në pajtim me urdhëresat e Tij. Kjo është një shoqërueshmëri e rregullt njerëzore që organizohet dhe mbikëqyret nga Zoti. Kjo është shenjë e bekimeve të Tij dhe një mëshirë e pafundme, siç thotë edhe vetë Ai në Kur'an (30:31).

Sipas kësaj, është e qartë se në fenë islame martesë është një mjet i marrëdhënieve permanente dhe i një harmonie të vazhdueshme, jo vetëm ndërmjet burrit dhe gruas, por edhe ndërmjet tyre dhe Zotit. Po ashtu është e qartë se kur dy muslimanë bisedojnë për një marrëveshje martese, ata kanë për qëllim që ky të jetë një sukses që do të zgjasë shumë, si për gjendje të mirë ashtu edhe për të vështirë.

Që të sigurohet ky rezultat, feja islame ka dhënë disa rregullativa që na japin çdo siguri të mundshme se martesë i shërben plotësisht qëllimit të vet. Ndër këto rregullativa mund t'i përmendim:

1. Të dy palët duhet ta njohin mirë njëri-tjetrin, në mënyrë që të mos lejohet ndonjë sjellje jomorale, mashtruese apo eksploatuese.

2. Mashkulli duhet ta gjejë partneren e tij në bazë të vlerave të saj permanente; d.m.th., devocionit religjioz, integritetit moral, karakterit, etj., e jo në bazë të pasurisë apo prestigjit familjar, apo thjeshtë në bazë të bukurisë fizike.

3. Gruaja ka të drejtë që të sigurohet se njeriu që e propozon t'i përgjigjet, ta meritojë respektin dhe dashurinë e saj dhe të jetë i aftë që atë ta bëjë të lumtur. Në këtë drejtim ajo mund ta refuzojë propo-

zimin nëse mendon se mashkulli është nën nivelin e saj apo se nuk i përgjigjet, për arsye se kjo mund ta pengojë plotësimin e obligimeve të saj si bashkëshorte, e madje mund ta prishë edhe martesën e saj të paramenduar.

4. Gruaja ka të drejtë të kërkojë prikë (mehr, dhuratën e kurorës) nëpërmjet mësitit të saj në pajtim me standardet e saj, e po ashtu, në pajtim edhe me mjetet e burrit. Nëse dëshiron të mos e marrë parasysh këtë të drejtë dhe ta pranojë burrin me pak ose pa kurrfarë prike, ajo mund ta bëjë edhe këtë. Detyra e prikës te mashkulli ka për qëllim të tregojë se dikush e dëshiron, se ka nevojë për të dhe se burri është i aftë me plot dëshirë t'i marrë përgjegjësitë e tij, qoftë materialisht apo ndryshe. Prika po ashtu është një gjest simbolik, i cili tregon se gruaja do të jetë e sigurt dhe se mashkulli nuk e sheh motivin material si motiv për martesën e tij. Kjo e bën më se të qartë se secila palë duhet të presë njëra prej tjetrës.

5. Martesa duhet të bëhet publikisht dhe të festohet në një mënyrë sa më të gëzueshme. Pajtimi i lirë i të dy palëve është kushti thelbësor pa të cilin martesa nuk është valide.

6. Çdo martesë, që të jetë legale duhet të ketë dy dëshmitarë të rritur dhe të regjistrohet në dokumentet zyrtare.

7. Detyrë e burrit është mbrojtja e plotë e gruas. Nëse gruaja ka ndonjë pronë ose fond, ato duhet të jenë të saj edhe para dhe pas martesës; burri nuk ka të drejtë të marrë çfarëdo pjese nga prona e gruas së tij. Kjo bëhet vetëm për ta kufizuar martesën me

qëllimet e saj të mirëfillta dhe ta largojë atë nga qëllimet e këqija.

Me të gjitha këto masa, mund të shihet se feja islame i ka dhënë të gjitha siguritë e mundshme që ta bëjë martesën një shoqërueshmëri të fortë dhe një bazë solide për një harmoni të vazhdueshme dhe paqe permanente. Por, në saje të faktit se sjellja njerëzore ndonjëherë mund të ndryshojë dhe të jetë e paparaparë, feja islame ka një pikëpamje realiste ndaj jetës dhe i pranon të gjitha ngjarjet e papritura. Martesa, siç edhe përmendëm, ka qëllime të mirëfillta të cilat duhet të plotësohen. Feja islame nuk pranon apo nuk njeh kurrfarë martese që nuk është funksionale dhe efektive. Nuk mund të ekzistojë martesë formale apo e trilluar. Ose duhet të ketë martesë të suksesshme, ose nuk do të ketë kurrfarë martese. Martesa është një akt e marrëveshje tepër solemne për të qenë e përkohshme apo joefektive. Sipas kësaj, nëse ajo nuk i shërben qëllimit të saj, apo nëse nuk funksionon si duhet, ajo mund të marrë fund me anë të ndarjes, me bisedë të të gjitha palëve dhe me konsiderimin e të drejtave të tyre. Kjo është kështu për arsye se nuk ka kurrfarë qëllimi të mirëfilltë në mbajtjen e kontratës nominale dhe të pavlefshme, dhe për ta shpëtuar llojin njerëzor nga lidhja me kusht apo përbetime, të cilat nuk mund të ndërrohen.

Kur martesa islame, e cila bazohet në rregullativat e përmendura dhe e udhëhequr nga parakushtet e përmendura nuk funksionon si duhet, atëherë sigurisht duhet të ketë pengesa serioze në këtë drejtim - që nuk mund të kapërcehen vetëm me një pajtim të

thjeshtë. Në një situatë të këtillë duhet të aplikohet ndarja (shkurorëzimi). Edhe pse Pejgamberi ndarjen e ka përshkruar si gjënë më të keqe nga të gjitha gjërat e ligjshme në sytë e Zotit, megjithatë, kjo është zgjidhja e fundit. Por, para se të merret ky hap i fundit dhe deprimues, duhet të bëhen disa përpjekje sipas rendit që vijon:

1. Të dy palët duhet të përpiqen që mosmarrëveshjet dhe problemet e tyre t'i zgjidhin ndërmjet vetes.

2. Nëse nuk kanë sukses në këtë, dy vullnetarë, njëri nga farefisi i burrit e tjetri nga ai i gruas, duhet të përpiqen të vendosin paqen ndërmjet tyre dhe t'i zgjidhin mospajtimet e tyre.

3. Nëse edhe kështu çështja nuk zgjidhet, pason shkurorëzimi.

Lidhur me aplikimin e shkurorëzimit në një situatë kaq të rëndë, ligji islam kërkon që të bëhet pajtimi midis të dy palëve dhe ua garanton që të dyve të drejtën e kërkesës së ndarjes. Kjo nuk e kufizon të drejtën e ndarjes as nga ana e burrit e as nga ana e gruas. Që të dy mund ta ushtrojnë këtë të drejtë. Nëse cilado anë e të dy palëve nuk ndihet e sigurt apo e kënaqur me anën tjetër, e cila arbitrarisht refuzon ta lejojë ndarjen, dhe nëse kërkesa e ndarjes është e arsyeshme, duhet të ndërhyjë gjyqi dhe t'i ndihmojë anës së dëmtuar që ta aplikojë ndarjen. Kjo është një detyrë e administruesve ligjorë, të cilët duhet të shohin se të gjitha të drejtat janë mbrojtur dhe se dëmi është zvogëluar.

Pasi të kryhet procesi i ndarjes, ekziston një periudhë e pritjes apo periudhë provuese që nor-

malisht zgjat prej 3 deri më 12 muaj - gjatë së cilës gruan e ndarë ende e mbanë dhe e përkrah ish-burri i saj. Ajo nuk ka të drejtë të martohet edhe një herë para se të kalojë kjo periudhë. Periudha e pritjes paraqet edhe një mundësi tjetër për të dy palët që edhe një herë të mendojnë për veprimet e tyre në mënyrë më serioze dhe për qëllimin e ndarjes së tyre. Nëse gjatë asaj periudhe dëshirojnë të ribashkohen, atyre u lejohej ta bëjnë edhe këtë. Në të vërtetë, në këtë mënyrë ata inkurajohen për ribashkim sepse vetëm kështu ata mund ta çmojnë njëri-tjetrin sa më tepër. Kur kjo periudhë pritëse kalon, vejusha është e lirë përsëri të martohet. Ata më nuk kanë kurrfarë obligimi ndaj njëri-tjetrit.

Po të bëhet ribashkimi i të shkurorëzuarës me ish-burrin e saj, martesë e tyre do të jetë si një martesë e re. Nëse marrëdhëniet e tyre nuk përmirësohen, ata mund t'i kthehen solucionit të njëjtë të ndarjes, pas të cilit mund të ribashkohen përsëri me anë të një martesë të re, në rast se kanë dëshirë. Por, nëse edhe ribashkimi i dytë është i pasuksesshëm, atëherë mund të aplikohet ndarja përfundimtare.

Me lejimin e ndarjes në radhë të parë, feja islame deklarohet për atë se nuk mund t'i tolerojë martesat e palumtura, të ftohta dhe stagnante, të cilat dëmtojnë më tepër se sa ndarja. Me përsëritjen e njëpasnjëshme të këtij akti me zgjedhjen e palëve për t'u ribashkuar, kjo ofron një mundësi reale për ta bërë martesën efektive dhe qëllimplote. Këtu feja islame është e aftë të ballafaqohet me të gjitha llojet e problemeve dhe të situatave. Ajo me lejimin e ndarjes, nuk e rrezikon martesën. Përkundrazi, ajo e

siguron atë po me atë masë, për arsye se personi që vepron keq duhet ta dijë se ai (apo ajo) të cilit i bëhet e keqja, mund ta lirojë veten nga padrejtësia dhe dëmi përmes ndarjes. Duke e kuptuar atë se martesë është e vlefshme aq sa është funksionale dhe e suksesshme, që të dy palët duhet të bëjnë çmos që ta mbajnë të plotë martesën e tyre, para se të mund të bëjnë diçka që mund të ndikojë në kontinuitetin e martesës së tyre. Kjo e bën çdo palë të kujdesshme në zgjedhjen e partnerit tjetër para martesës dhe në trajtimin e partnerit pas saj.

Kur feja islame e bën ndarjen të vlefshme me pajtim të dyanshëm apo me ndërhyrjen e gjyqit në emër të palës të cilës i është bërë padrejtësi, ajo e bën këtë me një shikim të rreptë të moralit dhe të dinjitetit njerëzor. Ajo nuk e detyron njeriun të vuajë nga padrejtësia dhe nga dëmi i një partneri jobesnik. Ajo nuk i drejton njerëzit kah amoraliteti dhe parregullsia. Ajo që e thotë feja islame është kjo: ose do të jetoni bashkë legalisht dhe të lumtur, ose do të ndaheni me dinjitet dhe rregull të lartë. Ajo që është më e vlefshme në pikëpamje humane dhe morale për fenë islame në këtë drejtim, është se ajo nuk e detyron asnjë person ta ulë dinjitetin e tij apo të saj, dhe nuk lejon që ndarja të jetë shkak për degradimin e moralit të tij. Për muslimanin nuk është e nevojshme “të ndahet” nga partneri i tij apo i saj disa vjet para se të garantohet ndarja. Garantimi i ndarjes nuk kushtëzohet as për jetë të shfrenuar. “Ndarja”, siç vërtetojnë shumë sisteme, mund t’i marrë dhe sigurisht i merr parasysh edhe aksionet amorale dhe të turpshme. Në rastin e “ndarjes” së këtij lloji, personi

as nuk mund t'i gëzojë të drejtat e tij e as t'i plotësojë obligimet e tij të martesës. Ai apo ajo zyrtarisht janë të martuar, por sa e gëzojnë këtë jetë martesore? Ai është edhe tepër i lidhur, por edhe aq i lirë sa që kurrfarë restriksionesh nuk mund të ndikojnë në të. Ai nuk mund të ndahet apo të rimartohet, por a ekziston ndonjë kufi legal për qëllimin e tij të marrëdhënieve jashtëbashkëshortore? Ai mund të shkojë me kë të dojë pa u kontrolluar aspak. Këto janë gjëra që ndodhin çdo ditë dhe për to nuk duhet shpjegim i posaçëm. "Ndarja" e këtij lloji mund t'i ndihmojë dikujt që më në fund të ndahet, por sa i kushton ajo moralit dhe çfarë çmimi të lartë duhet të paguajë shoqëria! Kjo është një gjë që feja islame asnjëherë nuk mund ta pranojë ose ta vërtetojë, për arsye se do ta shkatërronte gjithë sistemin e vlerave morale të cilin e përkrah feja islame.

Duke e marrë parasysh dukurinë e prostitucionit (zinasë) dhe vërtetimin e saj nga ana e disa sistemeve si bazë për ndarje, mund ta themi vetëm këtë: është tepër poshtëruese për dinjitetin njerëzor dhe tepër shkatërruese për moralin, që një person të bëjë zina apo të shtiret sikur e ka bërë, me qëllim që ta sigurojë shkurorëzimin. Pikëpamja e fesë islame lidhur me zinanë u parashtrua edhe pak më parë. Megjithatë, ajo që ndodh në të shumtën e rasteve është kjo: njerëzit nuk ndahen për arsye të atij mëkati apo pse kanë pretenduar sikur e kanë bërë atë mëkat, por ata e bëjnë këtë mëkat që të përfitojnë dekrete të ndarjes, të cilat nuk mund të fitohen në ndonjë mënyrë tjetër. Çfarë mënyre e mbrapshtë dhe e turpshme në marrëdhëniet njerëzore!

Tani do ta prezentojmë qëndrimin e fesë islame lidhur me këtë çështje. Nëse ndarja duhet të aplikohet si rrugëdalje e fundit, atëherë kjo duhet të garantohet me dinjitet dhe respekt të duhur. Kur feja islame aplikohet në jetën bashkëshortore, atëherë aty nuk ka vend as për “ndarje” apo “kurvëri” si bazë për ndarje. Aty nuk do të ketë vend për ndonjë ndarje të tipit të Holivudit, e cila doli si reagim ekstrem kundër rreptësisë ekstreme. Çdo sistem që ka të bëjë me natyrën njerëzore duhet të jetë real dhe mesatar, e të bëjë lejime në të gjitha rrethanat, duke qenë i përgatitur t’ia dalë në krye në të gjitha kushtet. Përndryshe, ajo do të ishte vetë destruktive dhe e pabazë, një pikëpamje nga e cila feja islame është absolutisht e lirë. (Shih Kur’anin, 2:224-232; 4:34-35; 4:127-130).

Me një vërejtje të fundit do ta përfundojmë këtë diskutim. Në çdo shoqëri dhe religjion të njohur ekzistojnë mënyra për të ndarë çdo bashkëshortësi. Numri i ndarjeve në botën e industrializuar rritet në mënyrë drastike, kurse ligjet e ndarjes janë tepër të liberalizuara. Megjithatë, ndarja në fenë islame është një akt moral tejet i rëndësishëm. Zoti i urdhëron bashkëshortët të jenë të përzemërt dhe të durueshëm, dhe i përkujton se njeriu mund të mos e pëlqejë ndonjë sjellje të tjetrit, në të cilin Zoti ka vendosur mjaft të mira dhe virtyte. Atyre u sigurohet ndihma e Zotit nëse mendojnë mirë dhe janë së bashku. Por, nëse ata duhet të ndahen, kjo duhet të bëhet pa ndonjë qëllim lëndimi apo dëmtimi shpirtëror. Nëse ndahen në mënyrë të mëshirshme ose të ndershme, Zoti i siguron me pasurimin me anë të pasurisë së

Tij të pafundme. I gjithë konteksti martesor, qysh prej fillimit e deri në fundin e tij, është përqëndruar dhe orientuar ndaj besimit në Zotin xh.sh. Ajetet që flasin për ndarjen nuk janë vetëm kushte të thata legale, ato japin edhe përfundime për moralin e një rendi më të lartë. Anët morale të palëve do të jenë të vlefshme edhe shumë më vonë pas kohës së ndarjes. Në të vërtetë, e gjithë çështja është aq ngusht e lidhur me një sistem të moralit të lartë sa edhe ndarja, me të drejtë, konsiderohet si një akt moral.

5. Pozita e gruas në fenë Islame

Statusi i gruas në fenë islame nuk paraqet kurrfarë problemi. Qëndrimi i Kur'anit dhe i muslimanëve të hershëm dëshmon për atë se gruaja është, së paku, aq vitale për jetën sa edhe vetë burri, dhe se ajo nuk është inferiore ndaj tij apo as ndonjë lloj më i ulët. Po të mos ishte ndërhyrja e kulturave të huaja dhe ndikimeve të tjetërsuara, kjo çështje asnjëherë nuk do të parashtrohej para muslimanëve. Statusi i gruas merrej si i barabartë me atë të burrit. Kjo ishte një gjë e natyrshme dhe askush këtë nuk e konsideronte si problem.

Me qëllim që të kuptojmë se ç' thotë feja islame për gruan, nuk është e domosdoshme t'i hulumtojmë hallet e saj në periudhën paraislame, apo në botën e sotme moderne. Feja islame i ka dhënë gruas të drejta dhe privilegje që asnjëherë nuk i ka gëzuar në ndonjë sistem tjetër religjioz apo kushtetues. Kjo

mund të kuptohet më mirë kur e gjithë çështja do të studiohet në një mënyrë krahasimtare. Të drejtat dhe përgjegjësitë e gruas janë të barabarta me ato të burrit, por nuk janë domosdo identike me to. Barazia dhe njëjtësia janë dy gjëra krejtësisht të ndryshme. Ky ndryshim është i kuptueshëm për arsye se burri dhe gruaja nuk janë identikë, por ata janë krijuar të barabartë. Nëse e marrim parasysh këtë dallim (shquarje), atëherë nuk do të ketë problem. Është pothuaj e pamundur të gjesh dy burra apo dy gra identike.

Ky dallim midis barazisë dhe njëjtësisë ka rëndësi vendimtare. Barazia është e dëshirueshme, e drejtë, e mirë; por, njëjtësia jo. Njerëzit nuk janë të krijuar identikë, por ata janë krijuar të barabartë. Nëse e kemi këtë dallim ndërmend, nuk ka vend për të menduar se gruaja është indiferente ndaj burrit. Nuk ka bazë për të thënë se ajo është më pak e rëndësishme se ai, për arsye se të drejtat e saj nuk janë identikisht të njëjta si të burrit. Po të ishte statusi i saj identik me statusin e tij, ajo thjesht do të ishte një duplikat i tij, e që në realitet nuk mund të jetë. Fakti se feja islame i jep asaj të drejtat e njëjta - por jo edhe identike - na tregon se feja i jep asaj konsiderim të duhur e të drejtë, e çmon atë, duke e njohur personalitetin e saj të pavarur.

Nuk është zëri i fesë islame ai që e karakterizon gruan si prodhim të djallit apo si farë e së keqes. As Kur'ani nuk flet për burrin si zotërues dominant i gruas, e cila nuk ka zgjidhje tjetër pos dorëzimit ndaj tij. Feja islame nuk qe ajo që e parashtrroi pyetjen se a ka gruaja shpirt apo jo. Asnjëherë në historinë e

fesë islame ndonjë musliman nuk e ka vënë në dyshim statusin njerëzor të gruas apo posedimin e saj të shpirtit dhe të vlerave të tjera të mirëfillta shpirtërore. Ndryshe nga besimet e tjera të popullarizuara, feja islame nuk e kritikon vetëm Havën për Mëkatin e Parë. Kur'ani e bën shumë të qartë se që të dy, edhe Ademi edhe Hava, u ngasën; se që të dy bënë mëkat dhe se falja e Zotit iu dha që të dyve pas pendimit të tyre dhe se Zoti iu drejtua që të dyve së bashku. (Kur'ani, 2:35-36; 7:19,27; 20:117-123). Në të vërtetë, Kur'ani na jep përshtypje se Ademi pat faj më tepër për Mëkatin e Parë, prej të cilit doli edhe paragjykimi kundër gruas dhe dyshimi për veprat e saj. Por, feja islame nuk e arsyeton një paragjykim apo një dyshim të tillë, për arsye se që të dy, edhe Ademi edhe Hava, bënë gabim të njëjtë dhe po qe se e fajësojmë Havën duhet ta fajësojmë edhe Ademin - ndoshta këtë të fundit edhe më tepër.²⁸

Statusi i gruas në fenë islame është diçka unike, diçka që nuk ka kurrfarë ngjashmërie në cilindo sistem tjetër. Nëse hedhim një sy në botën lindore komuniste apo në popujt demokratikë, do të shohim se gruaja nuk është në pozitë aq të mirë. Statusi i saj nuk ndjell zili. Ajo duhet të punojë shumë për të jetuar dhe ndonjëherë mund ta bëjë të njëjtën punë që e bën edhe mashkulli, e përsëri rroga e saj është më e vogël se ajo e mashkullit. Ajo gëzon njëfarë lirie, e cila në disa raste na e përkujton shfrenimin. Me qëllim që të arrijë deri në pozitën e sotme, gruaja ka luftuar me dhjetëvjeçarë të tërë dhe me shekuj.

²⁸ Lidhur me këtë diskutim, shihe Konceptin e Mëkatit më lart.

Me qëllim që ta fitojë të drejtën e mësimin dhe lirinë e punës e fitimit, ajo duhej të bënte sakrifica të dhembshme dhe të heqë dorë nga shumë të drejta të saj natyrore. Ajo pagoi shumë rëndë që ta vendosë statusin e saj si një qenie njerëzore që posedon shpirt. Edhe pas të gjitha këtyre sakrificave të shtrenjta dhe luftërave të dhembshme, ajo ende nuk e ka arritur atë që feja islame e ka vendosur me Dekretin Hyjnor për gruan muslimane.

Të drejtat e gruas në kohët moderne nuk u dhanë vullnetarisht apo vetëm si rezultat i përzemërsisë ndaj gjinisë femërore. Gruaja moderne arriti në pozitën e saj të tanishme me anë të forcës e jo nëpërmjet proceseve natyrore apo pajtimit të dyanshëm, apo nëpërmjet mësimave hyjnore. Ajo duhej të krijojë rrugën e saj me forcë, kurse si ndihmë shfrytëzoi rrethana të ndryshme. Mungesa e fuqisë mashkullore gjatë luftërave, presioni i nevojave ekonomike dhe kërkesat e zhvillimeve industriale, e detyruan gruan të dalë jashtë shtëpisë së saj - të punojë, të mësojë, të luftojë për jetesën e saj, të paraqitet si e barabartë me mashkullin, “të vrapojë” në garën e saj në vazhden e jetës krah për krah me mashkullin. Atë e detyruan rrethanat, e si rezultat i gjithë kësaj, ajo e detyroi veten që më në fund të fitojë një status të ri. Çështja se a janë të gjitha gratë të kënaqura me këto rrethana që janë në anën e tyre dhe a janë të kënaqura me rezultatet e kësaj, është një problem tjetër. Por, mbetet fakti se të drejtat e gruas moderne të çfarëdo lloji që të jenë, nuk mund të barazohen me të drejtat e gruas muslimane. Ajo që feja islame ka thënë për gruan është ajo që për-

puthet edhe me natyrën e saj, i jep siguri të plotë dhe e siguron atë nga rrethanat e turpshme dhe nga shtigjet e pasigurta të jetës. Këtu nuk kemi nevojë ta elaborojmë statusin e gruas moderne dhe rrezikun që e ndërmerr ajo për të jetuar apo për ta mëkëmbur vetveten. Këtu nuk do t'i analizojmë as mizoritë as prapësimet në jetë që rrotullohen rreth kësaj, si rezultat i të ashtuquajturave të drejta të gruas. Ne as që kemi për qëllim të manipulojmë me situatën e shumë familjeve të palumtura, të cilat u shkatërruan pikërisht për arsye të "lirisë" dhe të "të drejtave" me të cilat mburret gruaja moderne. Shumë gra sot e ushtrojnë të drejtën e lirisë për të dalë të pavarura të punojnë e të fitojnë, të pretendojnë se janë të barabarta me mashkullin, por kjo, për fat të keq, shkon në dëm të familjeve të tyre. E gjithë kjo është e ditur dhe shihet qartë. Ajo që nuk është e njohur është statusi i gruas në fenë islame. Në tekstin që vijon do të përpiqemi ta japim pikëpamjen e fesë islame lidhur me trajtimin e gruas.

1. Feja islame e pranon gruan si partnere të plotë e të barabartë të mashkullit në parakrijimin e llojit njerëzor. Ai është babai; ajo është nëna dhe që të dy janë tejet të rëndësishëm për jetën. Roli i saj nuk është më pak i rëndësishëm se roli i tij. Me anë të këtij partneriteti ajo ka pjesë të barabartë në çdo aspekt, asaj i takojnë të drejtat e njëjta, ajo ndërmerr përgjegjësi të barabarta dhe në të ka aq vlera dhe aq humanitet, sa mund të gjenden edhe te partneri i saj. Për këtë partneritet në riprodhimin e llojit njerëzor, Zoti thotë:

“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet veti...” (Kur’ani, 49:13, krahaso 4:1).

2. Ajo është e barabartë me burrin në përgjegjësitë personale dhe të përgjithshme, si edhe në fitimin e shpërblimeve për veprat e saj. Ajo njihet si një personalitet i pavarur, që posedon vlera njerëzore dhe aspirata shpirtërore të vlefshme. Natyra e saj njerëzore nuk është as inferiore e as superiore ndaj asaj të burrit. Që të dy i takojnë njëri-tjetrit. Zoti thotë kështu:

“Zoti i tyre iu përgjigj lutjes së tyre (e tha): ‘Unë nuk ia humb mundin asnjërit prej jush, mashkull qoftë apo femër. Ju jeni njëri nga tjetri...” (Kur’ani, 3:195; krahaso, 9:71; 33:35-36; 66:19-21).

3. Ajo është e barabartë me mashkullin në ndjekjen e arsimit dhe diturisë. Kur feja islame flet për kërkimin e diturisë nga ana e muslimanëve, ajo nuk bën dallim ndërmjet burrit dhe gruas. Pothuajse 14 shekuj më parë, Muhammedi a.s., deklaroi se çdo musliman është i obligueshëm të kërkojë diturinë, pavarësisht a bëhet fjalë për mashkullin apo femrën. Kjo deklaratë ishte shumë e mirëseardhur dhe e zbatuar nga çdo musliman gjatë gjithë historisë.

4. Ajo ka të drejtë për liri të shprehjes, njësoj si edhe mashkulli. Mendimet e saj të shëndosha merren parasysh dhe nuk mund të hidhen poshtë, vetëm për shkak se ajo i përket gjinisë femërore. Në Kur’an dhe në histori është shënuar se gruaja jo vetëm që e ka thënë mendimin e saj lirisht, por po ashtu ka diskutuar e ka marrë pjesë në bisedat serioze me vetë

Pejgamberin a.s., si edhe me udhëheqësit e tjerë muslimanë. (Kur'ani, 58:1-4; 60:10-12). Përveç kësaj kanë ekzistuar edhe raste kur gratë muslimane i shprehnin pikëpamjet e tyre për çështjet legislative të interesit publik dhe qëndruan kundër halifëve, të cilët në atë kohë i pranonin argumentet e shëndosha të këtyre grave. Një shembull specifik i tillë ndodhi gjatë Halifatit të Umer ibn-ul- Hattabit.

5. Dokumentet historike tregojnë se gratë merrnin pjesë në jetën publike të muslimanëve të hershëm, posaçërisht në rastet urgjente. Gratë i shoqëronin ushtritë muslimane në luftëra për t'i shëruar të plagosurit, për të përgatitur ushqim, për t'u shërbyer luftëtarëve etj. Ato nuk i mbyllnin prapa grilave apo nuk konsideroheshin si krijesa të pavlefshme e shpirtra të privuar.

6. Feja islame i garanton gruas të drejta të njëjta, të lidhë marrëveshje, të prodhojë, të fitojë dhe të posedojë në mënyrë të pavarur. Jeta e saj, prona e saj dhe nderi i saj janë njësoj të shenjta si ato të mashkullit. Nëse ajo bën ndonjë mëkat, dënimi nuk është as më i madh e as më i vogël nga ai i mashkullit në ndonjë rast të ngjashëm. Nëse asaj i është shkaktuar ndonjë e keqe apo dëm, ajo i fiton kompensimet e duhura në të njëjtat sasi që do t'i merrte burri në situata të ngjashme. (Kur'ani, 2:178; 4:45, 92-93).

7. Feja islame nuk i jep këto të drejta vetëm në formë statike e pastaj të heshtë. Ajo i ka marrë të gjitha masat që t'i ruajë ato dhe t'i fusë në praktikë si pjesë përbërëse të besimit. Ajo asnjëherë nuk i toleron ata, të cilët kanë paragjykime kundër grave apo që bëjnë diskriminim ndërmjet burrave dhe

grave. Do ta përsërisim edhe një herë se Kur'ani i qorton ata të cilët besojnë se gruaja është inferiore ndaj burrit (Kur'ani, 16:57-59,62; 42:47-50; 43:15-19; 53:21-23).

8. Përveç njohjes së gruas si një qenie e pavarur njerëzore e cila është njësoj e rëndësishme për ekzistencën e mëtejshme të njerëzimit, feja islame i ka dhënë asaj edhe një pjesë të trashëgimisë. Para fesë islame, ajo jo vetëm që ishte e privuar nga kjo pjesë, por vetë konsiderohej si një pronë e trashëguar nga burri. Feja islame nga ajo pronë trashëguese, bëri trashëgimtare, duke i njohur të drejtat trashëgimtare njerëzore të gruas. Pavarësisht nga fakti se a është ajo bashkëshorte apo nënë, motër apo bijë, ajo pranon një pjesë të caktuar nga prona e kushëririt të ndjerë, një pjesë që varet nga shkalla e marrëdhënieve të saj me të ndjerin dhe nga numri i trashëguesve. Kjo pjesë është e saj dhe askush nuk mund t'ia marrë apo t'ia heqë nga trashëgimia. Madje edhe nëse i ndjeri ka dashur ta privojë atë, duke bërë një testament për faksinë tjetër apo për arsye të një shkakut tjetër, ligji nuk do ta lejojë atë të bëjë një gjë të tillë. Lejohet që çdo pronar ta bëjë testamentin e tij me kufizim të një të tretës së pronës së tij, me qëllim që kjo mos të ndikojë në të drejtat e trashëgimtarëve të tij, qofshin meshkuj apo femra. Në rastin e trashëgimisë, çështja e barazisë dhe njëjtësisë zbatohet plotësisht. Parimisht, që të dy, edhe mashkulli edhe femra kanë të drejtë të njëjtë ta trashëgojnë pronën e kushërinjve të ndjerë, por sasi të që do t'i marrin mund të ndryshojnë. Në disa instanca mashkulli fiton dy pjesë, kurse femra vetëm një.

Kjo nuk është shenjë se i jepet përparësi superioritetit të mashkullit ndaj femrës. Shkaqet pse mashkulli merr më tepër në këto raste të veçanta mund të klasifikohen në mënyrën si vijon:

- Së pari, burri është e vetmja qenie që personalisht përgjigjet për mbrojtjen e tërësishme të bashkëshortes së tij, familjes së tij dhe farefisnisë së tij që ka nevojë. Sipas ligjit, detyra e tij është t'i mbajë të gjitha përgjegjësitë financiare dhe të përkujdeset për të varurit e tij në mënyrë adekuate. Po ashtu detyrë e tij është të kontribuojë materialisht për të gjitha qëllimet e mira në shoqëri. Gjithë barrën financiare e mbanë vetëm ai.

- Së dyti, gruaja nuk ka kurrfarë përgjegjësie financiare, përveç nga harxhimet e saj të pakta personale për gjërat e luksit të lartë, që ajo dëshiron t'i ketë. Ajo është financiarisht e sigurt dhe e furnizuar. Nëse është bashkëshorte, atë e furnizon bashkëshorti; nëse është nënë e furnizon djali; nëse është motër vëllai, etj. Nëse nuk ka farefisni nga e cila mund të varet, atëherë aty më nuk ka çështje të trashëgimisë, për arsye se ajo s'ka se ç'të trashëgojë dhe nuk ekziston dikush që t'i lërë diçka në trashëgim. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se ajo në këtë rast duhet të vuajë nga uria; përkujdesja e një gruaje të këtillë është përgjegjësi e mbarë shoqërisë në përgjithësi. Asaj mund t'i jepet ndihmë apo punë për të jetuar dhe paratë që do t'i fitojë do t'i takojnë asaj. Ajo nuk përgjigjet për mbajtjen e dikujt tjetër, përveç vetvetes. Nëse në pozitën e saj gjendet ndonjë burrë, atëherë ai duhet të përgjigjet për familjen e tij dhe mundësisht edhe për ndonjërin nga kushërinjtë e

tij, të cilit i duhet ndihmë. Sipas kësaj, në situatat më të rënda, përgjegjësia e saj financiare është e kufizuar, kurse ajo e burrit e pakufizuar.

- Së treti, kur gruaja fiton më pak se burri, ajo faktikisht nuk është e privuar nga asgjë për çka vetë ka punuar. Prona e trashëguar nuk është rezultat i punës apo i përpjekjeve të saj. Kjo është diçka që vjen nga një burim neutral, diçka shtuese apo tepricë. Kjo është diçka për të cilën nuk janë përpjekur as burri e as gruaja. Kjo është një lloj ndihme dhe çdo ndihmë duhet të shpërndalet sipas nevojave dhe përgjegjësive urgjente, posaçërisht kur shpërndarja e ndihmës rregullohet sipas Ligjit të Zotit.

Tani në njërin anë e kemi mashkullin trashëgimtar të ngarkuar me të gjitha llojet e përgjegjësive dhe mbështetjeve financiare, ndërsa në anën tjetër e kemi femrën trashëgimtare, e cila nuk ka aspak apo ka shumë pak përgjegjësi financiare. Në mes të këtyre kemi një pronë dhe ndihmë që duhet të rindahet me anë të trashëgimit. Nëse këtu nuk e marrim parasysh femrën aspak, do të jemi të padrejtë ndaj saj, për arsye se ajo është në marrëdhënie me të ndjerin. Analogjikisht, nëse i japim sasi të njëjtë si burrit, do të jemi të padrejtë ndaj tij. Kështu, në vend që të bëhen padrejtësi nga të dyja anët, feja islame i jep mashkullit një sasi më të madhe të pronës (pasurisë) së trashëguar, me qëllim që t'i përdorë për nevojat e familjes së tij për përgjegjësitë sociale. Në të njëjtën kohë, feja islame nuk e harron as gruan, por i jep një sasi sa për t'i kënaqur vetëm nevojat e saj personale. Në të vërtetë, feja islame në këtë drejtim është më e përzemërt me femrën se sa me

mashkullin. Këtu mund të themi se marrë në përgjithësi, të drejtat e gruas janë të barabarta me ato të burrit, edhe pse nuk janë domosdoshmërisht identike (shih Kur'anin, 4:11-14,176).

9. Në disa raste të dëshimit të kontratave të caktuara qytetare, kërkohen dy burra ose një burrë e dy gra. Përsëri, kjo nuk do të thotë se gruaja është inferiore ndaj burrit. Kjo është një masë e sigurimit të të drejtave të palëve kontraktuese, sepse gruaja, si rregull, nuk ka përvojë në jetën praktike aq sa ka burri. Kjo mungesë e përvojës mund të shkaktojë humbje nga të dyja palët në një kontratë të dhënë. Sipas kësaj, ligji kërkon që së paku dy gra e një burrë të jenë dëshmitarë. Nëse njëra nga dëshmitaret harron diçka, gruaja tjetër duhet ta përkujtojë. Ose, nëse ajo bën ndonjë gabim për shkak të mungesës së përvojës, tjetra përsëri do t'i ndihmonte. Kjo është një masë parandaluese, me qëllim që të garantohen bashkëpunimet e ndershme dhe marrëdhëniet e rregullta ndërmjet njerëzve. Në të vërtetë, kjo i jep mundësi gruas të luajë një rol në jetën qytetare dhe ndihmon për ta vendosur drejtësinë. Në çdo rast mungesa e përvojës në jetën qytetare nuk do të thotë se domosdo gruaja është inferiore ndaj burrit në statusin e saj. Çdo qenieje njerëzore i mungon kjo apo ajo, por askush nuk e vë në dyshim statusin e tyre njerëzor, (shih Kur'anin, 2:282)²⁹.

²⁹ Është interesante se dëshmimi i gruas në disa çështje është i përjashtueshëm, ndërsa ekspertiza e saj vendimtare. Në këto raste nuk pranohet dëshmimi i ndonjë burri, apo nevoja e më shumë se një gruaje. Përveç kësaj, dëshmia për kontrata dhe bashkëpunime tregtare nuk është privilegj por detyrë (Kur'ani,

10. Gruaja gëzon disa privilegje të cilat burri nuk i ka. Ajo përjashtohet nga disa detyra fetare, respektivisht, namazet dhe agjërimi në periudhat e saj të rregullta dhe në kohët e lindjes (lehonisë). Ajo nuk është e detyruar të kryejë namazin e obligueshëm të Xhumasë. Ajo është e liruar nga të gjitha obligimet financiare. Si nënë, ajo gëzon mirënjohje dhe nder më të lartë para Zotit (Kur'ani, 31:14-15; 46:15). Pejgamberi a.s., e bëri të njohur këtë nder kur deklaroi se xhenneti gjendet nën shputat e këmbëve të nënave. Ajo është e dhuruar me tri të katërtat e dashurisë dhe përzemërsisë së fëmijëve të saj, ndërsa e katërta, e fundit, i takon babait. Si bashkëshorte, ajo ka të drejtë të kërkojë prikën përkatëse nga burri i saj, me kusht që t'i takojë vetëm asaj. Ajo gëzon të drejtën e një furnizimi të plotë dhe të një mirëmbajtjeje komplete nga ana e burrit të saj. Ajo nuk duhet të punojë apo t'i ndajë harxhimet familjare me bashkëshortin e saj. Ajo është e lirë të mbajë edhe pas martesës atë që e ka poseduar më parë, kurse bashkëshorti i saj nuk ka kurrfarë të drejtash lidhur me pronën dhe pronësinë e saj. Si bijë apo motër, ajo ka të drejtë sigurie nga babai apo vëllai. Ky është privilegji i saj. Nëse ajo dëshiron të punojë apo ta mbajë vetveten dhe të marrë pjesë në udhëheqjen e përgjegjësive familjare, ajo është e lirë ta bëjë edhe këtë, me kusht që të mos cenohen integriteti dhe nderi i saj.

2:282-283), që duhet plotësuar. Nëse pjesa e gruas lidhur me këtë detyrë zvogëlohet për një gjysmëhere, as që mund të quhet mohim i të drejtave të saj; nëse kjo është diçka, atëherë është favor apo një përjashtim.

11. Qëndrimi i gruas gjatë namazeve pas burrit, nuk do të thotë në asnjë mënyrë se ajo është inferiore ndaj tij. Gruaja, siç edhe përmendëm, nuk merr pjesë në namazet e obligueshme të përbashkëta, që janë të obligueshme për burrin. Por, nëse merr pjesë në namaz, ajo qëndron në vende të caktuara të dedikuara vetëm për gra, ashtu siç kanë vend të caktuar edhe fëmijët e vegjël prapa burrave. Kjo është një rregullativë për disiplinën në namaz e jo ndonjë klasifikim i rëndësishëm. Në radhët e meshkujve, udhëheqësi i shtetit qëndron krahas me të varfërin. Njerëzit e rangut më të lartë në shoqëri qëndrojnë afër njerëzve të tjerë të rangut më të ulët. Rendi i rreshtave në lutje bëhet që t'i ndihmojë çdokujt të përqëndrohet në meditim. Kjo është shumë me rëndësi, për arsye se namazet e muslimanit nuk i ngjasojnë vjershës apo këndimit të këngës. Në to ka veprime, lëvizje, qëndrime, përsëritje, përkulje përdhe, etj. Kështu, në rast se burrat përzihen me gratë në rreshtat e njëjtë, është e mundur të paraqiten pengesa. Vëmendja në këtë rast do të përqëndrohet në diçka që nuk ka lidhje me namazin dhe do të devijojë nga rruga e vërtetë e meditimit. Rezultat i kësaj është humbja e qëllimit të namazeve, përveç mëkatit të zinasë që bëhet me anë të syrit, për arsye se syri - duke shikuar gjërat e ndaluara - mund të jetë fajtor për zina (amoralitet) sa edhe vetë zemra. Përveç kësaj, asnjë musliman, qoftë burrë apo grua, gjatë namazit nuk guxon ta prekë trupin e një personi të gjinisë së kundërt. Nëse burrat dhe gratë gjatë namazit qëndrojnë në të njëjtin rresht, ata nuk mund t'i shmangen prekjes së njëri-tjetrit. Kur gruaja falet

para burrit apo afër tij, është e mundshme që ndonjë pjesë e trupit të veshur të saj të zbulohet pas ndonjë lëvizjeje të caktuar të përshëndetjes apo të përkuljes përdhe. Syri i mashkullit rastësisht mund ta shohë pjesën e zbuluar, e rezultati i kësaj do të ishte se ajo do të shqetësohej e atij do t'i zhvendosej vëmendja nga namazi dhe do t'i vinin mendime të këqija. Sipas kësaj, me qëllim që të largohen këto pasoja të këqija dhe për t'u përqëndruar në meditim dhe mendime të pastra, të mbahen harmonia dhe rendi në mesin e besimtarëve, feja islame ka urdhëruar organizimin e vendeve në mënyrën që vijon: burrat qëndrojnë përpara, fëmijët pas tyre, e gratë pas fëmijëve. Çdokush që ka pak dituri për natyrën dhe qëllimin e namazit të muslimanëve, mund ta kuptojë mençurinë e organizimit të rreshtave të besimtarëve në këtë mënyrë.

12. Gruaja muslimane çdoherë shoqërohet me një traditë të vjetër të njohur si “mbulesë”. Sipas fesë islame, gruaja duhet ta zbukurojë veten me mbulesën e nderit, dinjitetit, pastërtisë dhe integritetit. Ajo duhet të tërhiqet nga të gjitha veprat dhe gjestet që mund të provokojnë pasione te njerëzit e tjerë, me përjashtim të burrit të saj legjitim, apo që mund të shkaktojnë dyshime të këqija për moralin e saj. Asaj i tërhiqet vëmendja që mos t'i tregojë bukurinë e veta fizike para të panjohurve. Mbulesa, që duhet ta mbajë, është ajo që mund ta mbrojë shpirtin e saj nga dobësia, e mbron mendjen e saj nga shfrenimi, sytë e saj nga shikimet e këqija dhe e mbron personalitetin e saj nga demoralizimi. Feja islame më së tepërmi kujdeset për integritetin e gruas,

për mbrojtjen e moralit, të karakterit dhe personalitetit të saj (krahaso, Kur'ani: 24:30-31).

13. Tanimë është e qartë se statusi i gruas në fenë islame është tepër i lartë dhe realisht i takon natyrës së saj. Të drejtat dhe detyrat e saj janë të larta e të barabarta me ato të burrit, por jo domosdoshmërisht apo absolutisht të njëjta me to. Nëse asaj i merret vetëm një gjë në një aspekt, atëherë, në shumë aspekte të tjera ajo kompensohet me gjëra të tjera. Fakti se ajo i takon gjinisë femërore, nuk është i rëndësishëm për statusin e saj njerëzor apo për personalitetin e saj të pavarur dhe ajo nuk është bazë për arsyetim apo paragjykim kundër saj, apo për ndonjë padrejtësi kundër personalitetit të saj. Të drejtat e saj në mënyrë të shkëlqyeshme përputhen me detyrat e saj. Drejtpeshimi ndërmjet të drejtave dhe detyrave mbahet gjithmonë dhe asnjëra anë nuk e kalon tjetrën. I gjithë statusi i gruas është përfshirë në ajetin kur'anor:

“Edhe atyre (gruas) u takon e drejta sikurse edhe përgjegjësia në bashkëshortësi, e burrave u takon një përparësi ndaj tyre...” (Kur'ani, 2:228)

Kjo përparësi nuk është titull i superioritetit apo një autorizim i dominimit mbi të. Kjo bëhet me qëllim që të korrespondojë me përgjegjësitë e tjera të burrit dhe që t'i jepet atij pak kompensim për përgjegjësitë e tij të pakufizuara. Ajeti i sipërpërmendur çdoherë interpretohet në dritën e një ajeti tjetër. (Kur'ani, 4:34)³⁰

³⁰ Krahaso me pjesën “Jeta familjare” më lart.

Këto përgjegjësi tjera i japin burrit përparësinë mbi gruan në disa aspekte ekonomike. Kjo nuk është një përparësi në karakter apo njerëzi. Kjo as që është dominim i njeriut ndaj njeriut tjetër apo shtypje e njërit nga ana e tjetrit. Kjo është vetëm shpërndarje e begatisë së madhe të Zotit, në pajtim me nevojat e natyrës, krijues i së cilës është Zoti. Dhe Ai e di më së miri se ç'është më mirë për gruan, e ç'është më mirë për burrin. Zoti është absolutisht i sigurt kur thotë:

“O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqen) e saj, e prej atyre dyve u shtuan shumë burra e gra...” (Kur’ani, 4:1)

Shtojca

- ❖ *Kur'ani dhe urtësia e tij*
 - *Dinamizmi*
 - *Prakticiteti*
 - *Maturia*
- ❖ *Muhammedi (a.s.) - peygamberi i fundit*
- ❖ *Kalendari islam*

Kur'ani dhe urtësia e tij

Kur'ani është dhurata më e madhe e Zotit për njerëzimin, ndërsa urtësia e tij ka karakter unik. Thënë shkurt, qëllimi i librit është t'i ruajë shpalljet e mëparshme dhe ta rivendosë të vërtetën e amshueshme të Zotit; ta udhëheqë njerëzimin kah rruga e drejtë e për ta gjallëruar shpirtin e njeriut; për ta zgjuar vetëdijen njerëzore e për ta ndriçuar mendjen njerëzore.

Kur'ani është Fjala e Zotit që i është shpallur Muhammedit a.s., nëpërmjet Shpirtit të Shenjtë, Xhibrilit, ndërsa krijimi i një vepre të këtillë është përtej imagjinatës dhe aftësisë njerëzore. Bashkëkohanikët e Muhammedit a.s., ishin, me dëshmi publike, zotëruesit më të mëdhenj të gjuhës arabe dhe patën motive për të shkruar një tekst konkurrent me atë të Kur'anit. Por, ata nuk mundën të krijojnë diçka të ngjashme me Kur'anin, qoftë në përmbajtje apo në stil. Muhammedi a.s., nuk kishte ndonjë shkollim formal dhe ai nuk e fshihte këtë. Krenaria e tij më e madhe ishte se ai qe një analfabet që u ngrit nga populli analfabet për ta mësuar gjithë njerëzimin, qofshin ata njerëz analfabetë apo jo, me porosinë e vërtetë të Zotit. Ky është fakti i parë se Kur'ani është fjala e Zotit.

Fakti i dytë për këtë libër unik është autoriteti i padyshimtë në përmbajtjen dhe renditjen e tij, vlerë kjo të cilën asnjë libër i çfarëdo lloji qoftë nuk ka

qenë i aftë ta gëzojë dhe nuk do ta ketë mundësinë më të vogël për ta gëzuar. Autenticiteti i Kur'anit nuk lë asnjë dyshim sa i përket pastërtisë, origjinalitetit dhe tërësisë së tekstit të tij. Shkencëtarë seriozë, muslimanë si dhe jomuslimanë, kanë përfunduar pa dyshim se Kur'ani, që sot e përdorim, është libri i njëjtë të cilin e ka pranuar Muhammedi a.s., e ka mësuar, ka jetuar sipas tij dhe me të cilin e ka njoftuar njerëzimin pothuajse para katërmbëdhjetë shekujve. Disa shënime mund ta ilustrojnë këtë autoritet të pashembullt të Kur'anit:

1. Kur'ani u shpall pjesë-pjesë; por asnjëherë nuk ishte pa formë, pa rend apo i paharmonizuar. Emri i Kur'anit tregon se ky ishte një libër prej vetë fillimit (Kur'ani, 2:2; 41:41-42). Renditjet e Kur'anit dhe shpallja graduale e fragmenteve të tij, ishin plan dhe vullnet i Zotit, një vullnet të cilit iu nënshtuan Muhammedi a.s., dhe shokët e tij (Kur'ani, 25:32; kr. 75:17).

2. Arabët dalloheshin me shijen e tyre letrare tejet të rafinuar që u mundësonte atyre të kënaqen e t'i çmojnë veprat e vlefshme letrare. Kur'ani, unanimit, për shijen e tyre ishte pa dyshim kryevepër e letërsisë. Ata ishin të mahnitur nga tingulli i tij prekës dhe nga bukuria e tij e jashtëzakonshme. Ata në të gjetën kënaqësinë dhe gëzimin më të madh, e përveç kësaj, ata filluan ta recitojnë e ta mësojnë librin përmendsh. Ka qenë, dhe ende është, i admiruar, i theksuar dhe i gjallëruar nga të gjithë muslimanët dhe nga shumë jomuslimanë.

3. Është një urdhëresë speciale për çdo musliman, qoftë mashkull apo femër, të recitojë një pjesë

të Kur'anit çdo ditë në namaz dhe gjatë vigjilencës në mbrëmje. Recitimi i Kur'anit për muslimanët është një formë e lartë e adhurimit dhe një praktikë ditore.

4. Arabët në përgjithësi ishin njerëz analfabetë, plotësisht të mbështetur në mbamendjen e tyre, për t'i mësuar përmendsh poemat dhe fragmentet që atyre u pëlqenin më së tepërmi. Ata dalloheshin me kujtesën e tyre të freskët, në të cilën e mbanin të deponuar trashëgiminë e tyre letrare. Kur'anin të gjithë njerëzit me shije të lartë letrare e njohën si të paimitueshëm. Me këtë, ata shpejtuan që ta mësojnë sa më parë përmendsh, por vetëm në mënyrën më të respektuar dhe më të shquar.

5. Gjatë jetës së Muhammedit a.s., ekzistonin shkruar të specializuar dhe shënues të caktuar të ajeteve kur'anore. Kurdo që ai pranonte ndonjë ajet apo fragment, ai menjëherë i udhëzonte shkruarit që ta shënojë atë nën mbikëqyrjen e tij. Çkado që shënonin ata, kontrollohej dhe dëshmohej nga vetë Pejgamberi a.s. Çdo fjalë rishqyrtohej dhe çdo fragment vihej në vendin e tij të drejtë.

6. Në kohën kur u mbaruan shpalljet, muslimanët posedonin shumë shënime të plota të Kur'anit. Ato recitoheshin, mësoheshin përmendsh, studioheshin dhe përdreshin për të gjitha qëllimet ditore. Kurdo që të paraqitej ndonjë ndryshim, çështja i lihej vetë Pejgamberit a.s., që ta zgjidhë, qoftë kjo të ishte e lidhur me tekstin, kuptimin apo intonimin.

7. Pas vdekjes së Muhammedit a.s., Kur'anin veçmë e dinin shumë muslimanë dhe ishte i shënuar në shumë tabela shënuese. Megjithatë, as kjo nuk e

kënaqi Ebu Bekrin, halifin e parë, i cili kishte frikë se vdekja nëpër beteja e një numri të madh të atyre që e dinin Kur'anin përmendsh, do të shkaktonte paqartësi serioze lidhur me Kur'anin. Kështu, ai i konsultoi autoritetet udhëheqëse dhe pastaj ia la në besim Zejd ibn Thabitit, shënuesit kryesor të Muhammedit a.s., për shpalljet, që të përpilojë një kopje standarde dhe complete të librit, sipas të njëjtit rend siç e kishte autorizuar vetë Muhammedi a.s. Ai e bëri këtë nën mbikëqyrjen e shokëve të Pejgamberit a.s., dhe me ndihmën e tyre. Versionin e fundit e të kompletuar e kanë kontrolluar dhe aprovuar të gjithë muslimanët që e kishin dëgjuar Kur'anin nga Muhammedi a.s., dhe që e kishin mësuar atë përmendsh. Këtë e patën bërë më pak se dy vjet pas vdekjes së Muhammedit a.s. Shpalljet ishin ende të freskëta e të gjalla në mbamendjen e shkruesve, të atyre që e kishin mësuar Kur'anin përmendsh dhe të shokëve të tjerë të Pejgamberit a.s.

8. Gjatë halifatit të Uthmanit, afër pesëmbëdhjetë vjet pas Muhammedit a.s., kopjet e shumëfishuara të Kur'anit u ndanë nëpër territoret e reja që vinin në kontakt me fenë islame. Shumica e banorëve as nuk e shihnin e as nuk e dëgjonin Muhammedin a.s. Për arsye të faktorëve rajonalë dhe gjeografikë, ata e lexonin Kur'anin me thekse pak më të ndryshme. Ndryshimet në recitim dhe intonacion filluan të shtohen e të shkaktojnë mospajttime në mesin e muslimanëve. Uthmani reagoi me të shpejtë në këtë situatë. Pas një konsultimi të përbashkët me të gjitha autoritetet udhëheqëse, ai formoi një komitet prej katër personave, që ishin shkruesit e mëpar-

shëm të shpalljeve. Të gjitha kopjet që ishin në përdorim u mblodhën dhe u zëvendësuan me një kopje standarde, që do të përdorej në pajtim me theksin dhe dialektin e Kurejshitëve - theksi dhe dialekti i njëjtë që e pat përdorur vetë Muhammedi a.s. Ky dialekt që adaptuar dhe standardizuar për arsye se ky që dialekti më i mirë dhe ai në të cilin u shpall Kur'ani. Kështu, Kur'ani përsëri u kufizua në theksin dhe në dialektin e njeriut që e pranoi atë. E që prej asaj kohe përdoret i njëjti version i standardizuar, pa ndryshimin më të vogël në fjalë, në rend, apo madje edhe në shenjat e pikësimit.

Nga këto vërejtje, shkencëtarët kanë përfunduar se Kur'ani i sotëm është i formës së njëjtë në të cilën edhe ka ardhur dhe i tillë do të mbetet përgjithmonë. Atij asnjëherë nuk i është bërë ndonjë shtesë, as lëshim, e nuk i është bërë asnjë korrupsion. Historia e tij është e pastër si dita e bardhë; autenticiteti i tij është i paluhatshëm dhe ruajtja e tij e plotë është jashtë çdo dyshimi.

Kur'ani është i mbushur me një urtësi të pashembullt në relacion me burimin, karakteristikat dhe dimensionet e tij. Urtësia e Kur'anit vjen nga urtësia e autorit, i cili nuk mund të ketë qenë ndonjë tjetër pos Vetë Zoti xhel-le shanuhu. Kjo po ashtu vjen edhe nga fuqia e madhe e librit, i cili është i paimitueshëm, e që është objekt hulumtimi për dijetarët dhe shkencëtarët. Qasja reale e Kur'anit, zgjidhjet e tij praktike që i ofron për problemet njerëzore dhe qëllimet e mirëfillta që i jep për njeriun, e shënojnë urtësinë e Kur'anit që ka natyrë dhe karakteristika të posaçme.

Dinamizmi

Një ndër karakteristikat kryesore të urtësisë së Kur'anit është se ai nuk i takon tipit statik apo të thatë. Ai posedon njëfarë urtësie dinamike që e provokon mendjen dhe e gjallëron zemrën. Në këtë urtësi ka një dinamizëm të fortë dhe një forcë lëvizëse, që është vërtetuar me faktet historike si edhe me vetë Kur'anin. Në fillim kur Muhammedi a.s., e nxori në shesh Thirrjen e Zotit, forca e tij e vetme ishte Kur'ani dhe urtësia e tij e vetme që urtësia e Kur'anit. Dinamizmi depërtues i Kur'anit është madhështor dhe i perezistueshëm.

Ekzistojnë shembuj të shumtë që mund të tregojnë se personalitetet më dinamike dhe argumentet më përfundimtare nuk mund ta mbërrinin vlerën e urtësinë dinamike të Kur'anit. Zoti flet për Kur'anin si për një Ruh (shpirt) dhe jetë dhe si dritë me të cilën udhëhiqen robërit e Zotit për në rrugën e drejtë (Kur'ani, 42:52). Përsëri Ai thotë:

“Sikur Ne ta zbritnim këtë Kur'an mbi ndonjë kodër, do ta shihje atë të strukur e të çarë prej frikës nga All-llahu. Këta janë shembuj që ua shkoqisim njerëzve, në mënyrë që ata të mendojnë.” (Kur'ani, 59:21).

Fjalët kyç këtu janë Ruh dhe Sad'ë (çarje, shpërthim), që do të thonë se Kur'ani e fillon jetën, e gjallëron shpirtin, e rrezaton dritën udhëheqëse dhe i udhëheq objektet që na duken se janë të palëvizshme. Ky është lloji i dinamizmit shpirtëror për të cilin flet Kur'ani.

Prakticiteti

Një karakteristikë tjetër e Kur'anit është prakticiteti i tij. Ai nuk jepet pas mendimeve të dëshirueshme. Mësimet e tij nuk e kërkojnë as të pamundurën apo nuk lundrojnë larg për t'i arritur idealet e paarritshme. Kur'ani e pranon njeriun ashtu siç është dhe e këshillon të bëhet ai që mund të jetë. Ai nuk e çmon njeriun si një krijesë të pandihmë apo të pashpresë, të dënuar që nga lindja e deri në vdekje dhe të zhytur në mëkat që nga gjiri i nënës e deri në varr, por ai e paramendon njeriun si një krijesë bujare, të ndershme dhe plot dinjitet.

Prakticiteti i mësimave të Kur'anit përcaktohet me shembujt e Muhammedit a.s., dhe muslimanëve gjatë të gjitha periudhave. Qasja e dallueshme e Kur'anit është se udhëzimet e tij kanë për qëllim mirëqenien e përgjithshme të njeriut dhe bazohen në mundësitë që janë të arritshme edhe për njeriun.

Maturia

Karakteristika e tretë është maturia apo harmonia ndërmjet asaj që është hyjnore dhe njerëzore, shpirtërore dhe materiale, individuale dhe kolektive, etj. Kur'ani u kushton vëmendje të duhur të gjitha fakteve jetësore dhe të gjitha nevojave të njeriut, dhe vepron me to në atë mënyrë që t'i ndihmojë njeriut t'i kuptojë qëllimet bujare të qenies së tij. Për këtë qasje të maturisë, Kur'ani i quan muslimanët Popull Mesatar (Kur'ani, 2:143), dhe me këtë "mesatari" ata veçohen si njerëz më të mirë dhe më të zhvilluar të njerëzimit; për arsye se ata e urdhërojnë të drejtën,

luftojnë kundër të keqes dhe i besojnë Zotit (Kur'ani, 3:110).

Urtësia e Kur'anit funksionon në tre dimensione kryesore: përbrenda, jashtë dhe lartë (për nga lartësia). Përbrenda ai depërton në pjesët më të imta të zemrës dhe i mbërrinë thellësitë më të largëta të mendjes. Qëllimi i tij është kultivimi i shëndetshëm i individit nga brendia. Ky depërtim i brendshëm ka formë tjetër dhe është shumë më i thellë nga çdo sistem tjetër ligjor apo etik, sepse Kur'ani flet në emër të Zotit dhe për të gjitha problemet i drejtohet Atij.

Funksioni i jashtëm i përfshin të gjitha sferat e jetës dhe i mbulon parimet e të gjitha fushave të veprimtarisë njerëzore, duke filluar nga çështjet më personale e deri te marrëdhëniet komplekse ndërkombëtare. Kur'ani arrin edhe te fushat që janë të panjohura për çdo sistem shekullar të ligjit apo të kodit të etikës dhe të paarritshme për çdo doktrinë të popullarizuar të religjionit. Ajo që është me rëndësi për Kur'anin në këtë drejtim, është ajo se ai ka të bëjë me bashkëveprimet njerëzore në mënyrë të tillë që atyre u jep një ngjyrë hyjnore dhe një mësim moral. Ai bën që të ndjehet prania e Zotit në çdo bashkëpunim dhe ia njeh Atij burimin e parë të udhëheqjes si dhe qëllimin e fundit të të gjitha bashkëpunimeve. Ai është udhëheqës i jetës shpirtërore të njeriut, i sistemit të ligjit të tij, i kodit të etikës së tij, dhe mbi të gjitha, ai është mënyrë e jetesës së tij.

Funksioni lartësues (vertikal) i Kur'anit përqëndrohet në Një Zot Fuqiplotë. Çdo gjë që ka qenë, që është apo që do të jetë, duhet të analizohet në këtë

fokus: në praninë aktive të Zotit në Gjithësi (Univers). Njeriu është vetëm një i besuar në fushëveprimin e gjerë të Zotit, dhe qëllimi i vetëm i krijimit të tij është adhurimi i Zotit. Kjo nuk është pretekst për vetmi apo tërheqje pasive nga jeta. Kjo është një thirrje e hapur drejtuar njeriut për të qenë një mishërim i vërtetë në tokë i vlerave të shkëlqyera të Zotit. Kur flitet për aspektin lartësues të Kur'anit, mendja përqëndrohet te Zoti, ai i hapë njeriut horizonte të reja të mendimit, e udhëheq atë drejt standardeve të pashembullta të moralit të lartë njerëzor dhe e njofton atë me burimin e amshueshëm të paqes dhe mirësisë. Ta kuptosh vetëm Zotin si qëllim të fundit të njeriut, është një revolucion, qëllimi i të cilit është kundër ecurive të popullarizuara të mendimit njerëzor dhe të doktrinave religjioze; një revolucion, i cili duhet ta lirojë mendjen nga dyshimi, ta lirojë shpirtin nga mëkati dhe ta emancipojë vetëdijen duke e larguar atë nga nënshtrimi.

Në të gjitha dimensionet urtësia e Kur'anit është vendimtare. Ai as nuk e ndalon apo torturon mishin (trupin), e as nuk e mohon shpirtin. Ai nuk e "humanizon" Zotin, por as nuk e hyjnizon njeriun. Çdo gjë në mënyrë shumë të kujdesshme është e vendosur pikërisht aty ku e ka vendin, në skenën e përgjithshme të krijimit. Ekziston një marrëdhënie përpjesëtuese ndërmjet veprave dhe shpërblimeve, ndërmjet mjeteve dhe qëllimeve. Urtësia e Kur'anit nuk është neutrale. Ajo është një urtësi kërkuese dhe kërkesat e tij janë të mirëseardhura me miratim dhe kuptim nga të gjithë të bekuarit.

Urtësia e Kur'anit kërkon të vërtetën në mendime dhe devotshmërinë në veprim, unitet, synim dhe vullnet të mirë në qëllim.

“Ky është libri që nuk ka dyshim në të (sepse është prej All-llahut)...” (Kur'ani, 2:2)

“(Ky është) Libër, Ne ta shpallëm ty që me urdhrin e Zotit t'i nxjerrësh njerëzit prej errësirave në dritë (t'i nxjerrësh prej errësirës)...” (Kur'ani, 14:2).

Muhammedi (a.s.) - peygamberi i fundit

Besimi i muslimanëve se Muhammedi a.s., është peygamberi i fundit i Zotit është keqkuptuar nga shumë njerëz, prandaj lidhur me këtë, tani do të japim edhe disa sqarime. Ky besim në asnjë mënyrë nuk do të thotë se Zoti e ka mbyllur derën e Tij të mëshirës dhe se është tërhequr. Kjo nuk imponon asnjë restriksion në ngritjen e personaliteteve të mëdha fetare, as nuk e pengon paraqitjen e udhëheqësve të mëdhenj shpirtërorë, e as nuk e pengon evolucionin e njerëzve të mëdhenj të devotshëm. Kjo madje nuk do të thotë se Zoti i ka bërë arabët, nga të cilët u zgjodh Muhammedi a.s., si favor i Tij i fundit, me përjashtim të çdokujt tjetër. Zoti nuk është subjektiv për asnjë racë, epokë apo gjeneratë dhe dera e Tij është çdoherë e hapur dhe e pranueshme për ata që e kërkojnë Atë. Ai flet me njeriun dhe njerëzimin në këto tri mënyra:

1. Me inspirimin që ndodh në formë të sugjerimeve apo ideve, të futura nga Zoti në zemrat dhe mendjet e njerëzve të devotshëm.

2. Pas një velloje (perdeje), e cila paraqitet në formë të shikimeve apo vizioneve, kur pranuesi i kualifikuar flen ose është në gjendje të kllapisë.

3. Nëpërmjet engjëllit të Zotit, Xhibrilit, i cili është i dërguar me fjalë konkrete hyjnore për t'ia transmetuar Të Dërguarit të zgjedhur njerëzor (Kur'ani, 42:51). Kjo formë e fundit është më e larta, me anë të së cilës Kur'ani i zbriti Muhammedit a.s. Kjo përkufizohet te pejgamberët nga të cilët Muhammedi a.s., që i fundit dhe vula e tyre.

Por, përsëri kjo nuk e hedh poshtë ekzistencën apo vazhdimësinë e inspirimit në dy format tjera, atij që dëshiron Zoti. Duke e zgjedhur Muhammedin a.s., që të jetë pejgamber i fundit, Zoti nuk e ka humbur kontaktin dhe interesin për njeriun dhe njeriu në këtë mënyrë nuk privohet nga kërkimi i Zotit, apo nuk largohet nga synimet dhe frymëzimet e Tij. Përkundrazi, me zgjedhjen e Muhammedit a.s., që të jetë kulmi i Pejgamberisë dhe me Kur'anin që të jetë plotësimi i shpalljeve, Zoti ka vendosur një vendim permanent komunikimi ndërmjet vetë Atij dhe njeriut, dhe ka ngritur e inicuar një ndriçim të përhershëm të dritës e të udhëheqjes. Përveç këtyre vërejtjeve të përgjithshme, ekzistojnë pika të tjera specifike, të cilat na tregojnë pse Muhammedi a.s., është pejgamberi i fundit i Zotit. Nga këto, mund të përmendim disa:

1. Kur'ani me fjalë të qarta thotë: *“Thuaj (Muhammed): ‘O ju njerëz! Unë jam I Dërguari i*

All-llahut te të gjithë ju. All-llahut që vetëm i Tij është sundimi i qiejve dhe i tokës...’’ (Kur’ani, 7:158). Po ashtu thotë: *“E Ne të dërguam ty (Muhammed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat.”* (Kur’ani, 21:107), dhe se: *“...ai ishte I Dërguari i All-llahut dhe vula e të gjithë peygamberëve...”* (Kur’ani, 33:40). Kur’ani është fjala e Zotit dhe çkado që thotë ai është e vërteta e Zotit të cilës i nënshtrohet çdo musliman dhe për të cilën duhet të mendojë çdo njeri. Porosia e Muhammedit a.s., nuk ishte thjesht një gjallërim nacional, një monopol racor apo një ndarje e përkohshme nga kufizimi dhe shtypjet. Kjo as nuk qe një ndryshim i menjëhershëm apo një revidim i menjëhershëm i ecurive të historisë. Porosia e Muhammedit a.s., ishte, dhe natyrisht ende është, një gjallërim universal, një bekim i përgjithshëm, një trashëgim mbinacional dhe një dorëzim i përhershëm shpirtëror. Ky është një kontinuitet evolutiv i porosive të mëparshme dhe një inkuadrim i drejtpeshuar i të gjitha shpalljeve të mëparshme. Porosia e Muhammedit a.s., i transcendenton të gjithë kufijtë e racës, moshës, ngjyrës dhe të gjitha karakteristikat rajonale. Ajo i drejtohet njeriut të të gjitha kohëve dhe kjo është pikërisht ajo që i duhet njeriut. Sipas kësaj, muslimani beson se Muhammedi a.s., është peygamberi i fundit, për arsye se porosia e Muhammedit a.s., i ka vlerat më të larta të një besimi të vërtetë universal dhe përfundimtar.

2. Vetë Muhammedi a.s., ka thënë se ai qe peygamberi i fundit i Zotit. Një musliman, ose çdokush tjetër që e analizon këtë çështje, nuk mund ta vërë në

pyetje vërtetësinë e kësaj thënieje. Gjatë jetës së tij, Muhammedi a.s., ishte i njohur si më besniku, më i ndershmi dhe më modesti. Integriteti dhe modestia e tij janë të padyshimta, jo vetëm në sytë e muslimanëve, por edhe në mendjen e kundërshtarëve më të mëdhenj të tij. Karakteri i tij, arritjet e tij shpirtërore dhe reformat e tij botërore, nuk janë të ngjashme me asgjë tjetër në tërë historinë e njerëzimit. Ende mbetet të shohim se a do të mundet historia të nxjerrë diçka të ngjashme si Muhammedi a.s. Ai ka thënë se ka qenë peygamberi i fundit për arsye se kjo ishte e vërteta e Zotit, e jo për arsye se ai lakmonte ndonjë popullarizim personal, apo për arsye se kishte fitime personale. Fitorja atë nuk e llastoi, triumfi nuk i dobësoi virtytet e tij të shkëlqyera dhe fuqia nuk ia korruptoi karakterin. Ai ishte i pakorruptueshëm, i qartë dhe larg çdo nocioni të fitimit apo glorifikimit personal. Fjalët e tij i hedhin një dritë të fortë e shkëlqyese urtësisë të së vërtetës.

3. Muhammedi a.s., ishte i vetmi peygamber, i cili e plotësoi misionin dhe e kreu punën e tij gjatë jetës së tij. Para se të vdiste, Kur'ani dëshmoi se feja e Zotit u përsos, dashamirësia e Zotit te besimtarët është plotësuar, se e vërteta e Shpalljes është ruajtur dhe se do të ruhet me kujdes (Kur'ani, 5:3 dhe 10:9). Kur vdiq Peygamberi, feja islame ishte kompletuar dhe bashkësia e besimtarëve muslimanë u formua në mënyrë të drejtë. Kur'ani u mbajt mend e u shkrua gjatë jetës së tij, dhe u ruajt në versionin e tij të tërësishëm origjinal. E gjithë kjo do të thotë se fenë e Zotit e ka kompletuar e plotësuar Muhammedi a.s., si në koncept ashtu edhe në aplikim dhe se mbretëria

e Zotit është vendosur këtu në Tokë. Misioni i Muhammedit a.s., shembulli dhe arritjet e tij, e kanë dokumentuar atë se mbretëria e Zotit nuk është një ideal i paarritshëm, apo diçka që i takon vetëm asaj bote, por është diçka që gjithashtu i takon edhe kësaj bote, diçka që ka ekzistuar dhe ka lulëzuar në kohën e Muhammedit a.s., dhe që mund të ekzistojë e të lulëzojë në çdo epokë, kudo që të ketë besimtarë të sinqertë dhe njerëz të besimit. Kështu, nëse ndonjë njeri që i destinuar të jetë kulmi i Pejgamberisë, kush mund të ketë qenë përveç Muhammedit a.s.? Dhe nëse ndonjë libër është caktuar të jetë kompletim i Shpalljes, a mund të ishte ndonjë tjetër pos Kur'anit? Plotësimi i vërtetë i misionit të Muhammedit a.s., në tokë dhe shënimi autentik i tërë Kur'anit gjatë jetës së tij, nuk duhet të lërë kurrfarë gjurmë dyshimi në çdo mendje - sa i përket besimit se ai ishte pejgamberi i fundit.

4. Dekreti i Zotit se Muhammedi a.s., është pejgamberi i fundit, është i bazuar në autenticitetin e pastër dhe origjinal të Kur'anit, në detyrat përfundimtare dhe unike të Muhammedit a.s., në universalitetin e fesë islame dhe në zbatimin e mësimëve të Kur'anit në çdo situatë, në çdo epokë dhe te çdo njeri. Ky është religjioni i cili i kapërcen të gjithë kufijtë dhe depërton përtej barrierave të racës, ngjyrës dhe statusit të pasurisë apo prestigjit. Ky është religjioni, i cili i siguron të gjithë njerëzit me barazi e vëllazëri, me liri e dinjitet, me paqe e nder, me udhëheqje e shpëtim. Ky është thelbi i pastër i religjionit të Zotit dhe lloji i ndihmës që Ai përgjithmonë ia ofron njeriut, qysh prej fillimit të historisë.

Muhammedi a.s., dhe Kur'anit janë kulmi i evolucionit religjioz. Kjo, megjithatë, nuk e shënon fundin e historisë apo fundin e nevojës së njeriut për udhëheqje hyjnore. Ky është vetëm fillimi i një afrie të re, është inaugurim i një epoke të re, ku njeriu në sasi të mjaftueshme ka qenë i furnizuar me gjithë udhëheqjen hyjnore dhe me shembuj praktikë që i nevojiten. Kjo udhëheqje hyjnore gjendet në Kur'an, e vetmja shpallje autentike dhe e pakorruptuar e Zotit; dhe këta shembuj praktikë mund të gjenden në personalitetin e Muhammedit a.s. Po të vinte ndonjë peygamber i ri, apo të shpallej ndonjë libër i ri, a mund t'i shtonte kjo vlerat e peygamberisë apo të vërtetën e Kur'anit? Po të bëhet kjo për ruajtjen e fjalës së Zotit apo për ruajtjen e së vërtetës së shpalljes, - e gjithë kjo është bërë përmes Kur'anit. E nëse bëhet kjo vetëm për të treguar se Ligji i Zotit mund të përfshihet edhe në historinë, apo se mbretëria e Zotit mund të vendoset në tokë, - është fakt se të gjithë këtë e ka treguar Muhammedi a.s. E nëse bëhet kjo për ta udhëhequr njeriun kah Zoti dhe në rrugën e drejtë të jetës, - kjo përsëri është bërë nëpërmjet Kur'anit dhe Muhammedit a.s. Njeriut nuk i duhen shpallje të reja dhe peygamberë të rinj. Ajo që i duhet më së tepërmi është zgjimi i njeriut - këndellja e mendjes së tij dhe gjallërimi i zemrës së tij. Ajo që i duhet njeriut tonë është se ai duhet t'i fusë në përdorim shpalljet që i ka në disponim, t'i unifikojë burimet e tij ekzistuese dhe të fitojë nga pasuritë e pashtershme të fesë islame të cilat e kanë bashkuar, e kanë ruajtur dhe e kanë përsosur pastërtinë e shpalljeve të mëparshme.

5. Zoti urdhëroi se Muhammedi a.s., do të jetë peygamberi i fundit, dhe me të vërtetë ishte ashtu. Asnjë peygamber para Muhammedit a.s., nuk bëri, nuk kreu dhe nuk la në trashëgim aq shumë sa la ai. E askush pas tij, prej atyre që pretendonin peygamberinë, nuk ka bërë diçka të krahasueshme me atë që e bëri ai. Megjithatë, ky dekret hyjnor u bë përpara ngjarjeve historike të cilat pasuan pas tij. Ai solli lajme të mira për njeriun se ai do të hyjë në një fazë të re të pjekurisë dhe të lartësisë shpirtërore; dhe se ai (njeriu) prej atëherë do të duhet të jetojë pa peygamberë apo shpallje të reja, do të jetë vetë, do t'i ndihmojnë trashëgimitë e peygamberisë dhe shpalljet e Muhammedit a.s., dhe të paraardhësve të tij. Ky qe një anticipim i faktit se kulturat, racat dhe rajonet e botës do të afroreshin sa më tepër me njëri-tjetrin dhe se njerëzimi mund t'ia dilte në krye me një religjion universal, në të cilin Zoti zë pozitën e Tij të duhur dhe ku njeriu e kupton vetveten. Kjo qe një dëshmi solemne për rolin e madh të cilin dituria e përparuar dhe përpjekjet serioze intelektuale do ta luanin në drejtim të afrimit të njeriut me Zotin. Është po ashtu e vërtetë se nëse njeriu e kombinon diturinë e tij të përparuar dhe potencialin e tij intelektual me mësimet shpirtërore dhe morale të Kur'anit, ai patjetër do ta njohë ekzistencën e Zotit dhe do ta adaptojë veten sipas Ligjit të Zotit.

Faza historike e peygamberisë ka mbaruar me Muhammedin a.s., me qëllim që t'i dokumentojë njeriut se ai mund të piqet dhe të formohet me anë të iniciativës së vet; me qëllim që shkencës t'i japë mundësi të funksionojë me rregull dhe ta hulumtojë

dominimin e gjerë të Zotit; dhe që t'ia japë mendjes mundësinë të mendojë dhe të depërtojë. Natyra e fesë islame është e tillë që përmban sasi të madhe të fleksibilitetit dhe praktikitetit dhe mund të diskutojë rreth çdo çështjeje. Natyra e Kur'anit është universale dhe gjithmonë zbuluese, e udhëheqja në të është e sigurt pa kurrfarë dyshimi. Natyra e porosisë së Muhammedit a.s., është e tillë që u drejtohet të gjithë njerëzve të të gjitha gjeneratave. Muhammedi a.s., nuk ishte vetëm një lider racor apo vetëm një çlirues kombëtar. Ai ishte, dhe ende është, një njeri i historisë dhe shembulli më i mirë për atë që e kërkon Zotin. Çdo njeri prej tij ka se ç'të mësojë dhe në të mund t'i gjejë shembujt e shkëlqyer të mirësisë dhe devotshmërisë. Dhe në të çdo gjeneratë mund ta gjejë shpresën e saj të humbur.

Kalendari islam

Epoka muslimane ka filluar me ngjarjen e madhe të Hixhretit, apo me migrimin e peygamberit Muhammed a.s., nga Mekka në Medine (622).

Kalendari islam është lunar, kështu që muajt e tij përcaktohen sipas pozitave të ndryshme të Hënës. Çdo vjet i ka dymbëdhjetë muaj, ndërsa çdo muaj ka 30 ose 29 ditë, varësisht nga pozita e Hënës. Këto janë: muaji Muharrem, Safer, Rebi-ul-Evvel, Rebi-uth-Thani, Xhumade-l-Ula, Xhumade-th-Thani, Rexheb, Shaban, Ramazan, Shevval, Dhu-l-Kade dhe Dhu-l-Hixhe.

Çdo javë ka një ditë speciale, që duhet të mbahet mend. Kjo është Dita e Premte dhe rëndësia e saj vjen nga namazi i përbashkët i mesditës - Xhumaja, të cilin duhet ta kryejë çdo musliman i shëndoshë. Ekzistojnë edhe raste të tjera të rëndësishme të cilat duhet të mbahen mend:

1. Hixhreti (Viti i Ri islam), që bie në mbrëmjen e ditës së parë të muajit Muharrem.
2. Ditëlindja e Muhammedit a.s., që bie në mbrëmjen e ditës së dymbëdhjetë të Rebi-ul-Evvelit.
3. Ramazani, muaji i agjërimit, në të cilin u shpall Kur'ani.
4. Nata e Kadrit, në të cilën filloi shpallja e Kur'anit, e cila supozohet se bie në mbrëmjen e 23-të, të 25-të ose të 27-të të Ramazanit.
5. 'Iid-ul-Fitr (Bajrami i Ramazanit), që bie në ditën e parë të muajit Shevval.
6. 'Iid-ul-Ad'ha (Bajrami i Kurbanit), që bie në ditën e dhjetë të Dhu-l-Hixhhes.

ISLAMI NË FOKUS është libër që merret me bazat e fesë islame, por njëkohësisht u shmanget debateve joproduktive teologjike dhe argumenteve sektariane. Libri pikësëpari u dedikohet lexuesve të rinj dhe laikë në një mënyrë sqaruese, ndërsa intelektualëve të moshuar në mënyrë provokative, por megjithatë respektuese. Aty ku ka qenë e nevojshme dhe e zbatueshme, autori i ka shqyrtuar çështjet historike dhe krahasimtare. Ajo që më së tepërmi do t'i joshë lexuesit e këtij libri është faki se ai e paraqet Islamin si fe universale, mbijetuese, gjallëruese dhe kozmopolite, e cila jo vetëm që është relevante për çdo lëmi të ekzistencës njerëzore, por gjithashtu është edhe e domosdoshme pikërisht për mirëqenien e njerëzimit. Qasja e autorit është jashtëzakonisht e kapshme dhe ka një stil që gjallëron, si dhe një qartësi që është e lehtë dhe e kuptueshme për lexuesit. E gjithë kjo e bën këtë libër tejet të dobishëm dhe të afërt për të gjithë ata që synojnë të vërtetën.

Dr. Hamude Abdulati diplomoi në Universitetin "el-Ezher" të Egjiptit, magjistroi në Shkencat islame në Universitetin "McGill", ndërsa titullin e Doktorit të Shkencave të Sociologjisë e fitoi në Universitetin "Princeton" (SHBA). Më 1958 punoi në Departamentin e Kulturës Islame pranë "el-Ezherit". Më 1960 u zgjodh drejtor i parë i Qendrës Islame Kanadeze në Edmonton, Alberta. Që nga viti 1967 e deri kur ndërroi jetë (në shtator 1976), dr. Abdulati ishte profesor me korrespondencë i sociologjisë në Kolegjin "Utika" të Universitetit "Siracusa". Ai ishte i mirënjohur në mesin e komuniteteve muslimane të Amerikës Veriore si dhe në mesin e grupeve të tjera ndërkulturore. Me vite ligjëroi për Islamin, mori pjesë në konventa të ndryshme islame, shkruajti artikuj në gjuhën angleze dhe arabe, si dhe u ofroi ndihmë të pakursyeshme shkencore hulumtuesve të ndryshëm në këtë sferë.

Dr. Abdulati ishte dijetar i vyer, të cilit shumë nxënës dhe studentë të shkencave dhe të kulturës islame i drejtoheshin për ndihmë.

Përveç librit ISLAMI NË FOKUS, dr. Abdulati është autor edhe i veprës së rëndësishme STRUKTURA FAMILJARE NË ISLAM: Hulumtime në Sociologjinë Kulturore-Historike.

ISBN - 9989-904-07-3



9 789989 904073